



ICCROM
UNESCO
ICOMOS

UDHËZUES PËR MENAXHIMIN E TRASHËGIMISË KULTURORE BOTËRORE

Bernard M. Feilden dhe Jukka Jokilehto

CH
WB

Cultural
Heritage without Borders
KULTURARV UTAN GRÄNSER

UDHËZUES PËR MENAXHIMIN E TRASHËGIMISË KULTURORE BOTËRORE

Bernard M. Feilden dhe Jukka Jokilehto



© Cultural Heritage without Borders 2010

Përkthim i autorizuar i botimit të dytë në gjuhën angleze © 1998 ICCROM. Ky përkthim është publikuar me lejen e ICCROM, pronar i të gjitha të drejtave të publikimit dhe shitjeve të botimit original.

Titulli në origjinal: **Managment Guidelines for World Cultural Heritage Sites**

Autorë: Bernard M. Feilden dhe Jukka Jokilehto

Botuar në origjinal nga Qendra Ndërkombëtare për Studimin e Ruajtjes dhe Restaurimit të Pasurive Kulturore (ICCROM)

Përktheu nga origjinali: Boiken Abazi
Jeta Limani Andreassen

Redaktoi: Sonila Danaj

Parathënie për botimin
në gjuhën shqipe: Prof. Emin Riza

Botimi i këtij përkthimi në gjuhën shqipe është financuar nga “Cultural Heritage without Borders” (CHwB) përmes Agjencisë Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida), si dhe nga Ambasada e Mbreterisë së Bashkuar në Kosovë.

Kopertina dhe faqosja: C&PR Studio (www.cprstudio.com)
Shtëpia Botuese: Shtypshkronja “Gent Grafik”

Bernard Feilden dhe Jukka Jokilehto në gjuhën shqipe

Fondacioni Suedez “Cultural Heritage without Borders”, i pranishëm prej vitesh në Kosovë dhe Shqipëri, me nismën për botimin e veprës sintetike “Udhëzues për menaxhimin e trashëgimisë kulturore botërore” të autorëve Bernard Feilden dhe Jukka Jokilehto, barazisht të shquar ndërkombëtarisht për veprimtarinë e tyre shumëplanëshe në fushën e vlerësimit të monumenteve, meriton falënderimet e ndjera prej profesionistëve vendas dhe organeve për mbrojtjen e monumenteve në Shqipëri. Kjo vepër e cila, gjithë duke u emërtuar, do të thoshim modestisht, udhëzues është në thelb një përmbledhje e koncentruar e parimeve bashkëkohore të vlerësimit të siteve të trashëgimisë kulturore botërore. Ne do të theksonim me pamëdyshje se megjithëse autorët përqendrohen në këtë temë, trajtimi, natyrshëm, konsideron mbarë trashëgiminë e kulturës materiale në këndshikimin e vlerësimit të saj, duke nënkuptuar me vlerësim, gjurmimin, vënien në mbrojtje, administrimin, restaurimin dhe popullarizimin e saj. Autorët, duke u përqendruar në sitet e shpallura pasuri botërore, kuptueshëm theksojnë rrugët për zbatimin e parimeve të përgjithshme të vlerësimit të monumenteve në këtë fushë krahasimisht të re, duke u shprehur me theks të preکشëm të konkretizimit të njësisë historiko-kulturore të mbarë njerëzimit, në hapësirë dhe kohë. Ky udhëzues është sintetizim i arritur i parimeve, tashmë të konsoliduara, mbi vlerësimin e monumenteve, siç shprehen ato sa përmbledhtas aq edhe qartas në kartën e Venecias të vitit 1964, të cilën, besojmë me të drejtë, i nderuari Xhevat Erder e cilësonte: “monumentet për monumentet”. Ky dokument themelor, i cili i ka qëndruar kohës, duke pasur parasysh veprimtaritë vijuese dhe përherë dhe më të thelluara për vlerësimin e trashëgimisë historiko-kulturore, nuk mund të jetë një lloj dhiate e pacënueshme, siç e provojnë ndërhyrjet e mëvonshme për pasurimin e saj, ndër të cilat mjaft të përmendim “Dokumentin e Naras-s mbi autenticitetin”.

Ashtu si përgjithësisht, fusha e kulturës i ka paraprirë konceptit racional mbi njësinë mbarënjërzore, apo siç cilësohet sot në globalizëm. Rasti i njësisimit, madje kapilar, pa mohuar veçantitë rajonale, etnike apo kohore të lidhura me veprat cilësuar Pasuri botërore, ashtu si mbarë monumentet, është qartësisht domethënëse.

Ky udhëzues, përsëris sintetik, është një arritje e nivelit të lartë profesional, e cila parakupton veprimtari të dendur praktike dhe teorike të bashkautorëve. Renditja e qartë e çështjeve dhe metodika thelbësisht koherente ka bashkëpërfshirë dhe arritjet madhore të kontributeve të shumtë, të shtrira gjerësisht në kohë, të mbarë autorëve të fushës. Me këtë vepër bashkautorët Feilden dhe Jokilehto, kanë realizuar me nivele të larta profesionale përkujdesjet konkrete për trajtimin e siteve Pasuri botërore dhe më gjerë të monumenteve, duke kontribuar ndijshëm

në formimin e stafëve të profesionistëve në nivelet më të arrira të kohës. Është për t'u theksuar se vepra, krahas theksimit të parimeve të përgjithshme, trajton dhe probleme, në dukje dytësore, madje të zakonshme, por tepër të rëndësishme, sepse potencialisht, mjerisht dhe praktikisht çënuese të vlerave autentike, pra të pakthyeshme të Pasurive kulturore.

Punimi, paraqet veçanërisht vlera të rëndësishme për shtetin Pasuri botërore të Shqipërisë. Është rasti për të përmendur se në kolokiumin ndërkombëtar "Kosturi, liqeni, qyteti dhe monumentet" të mbajtur prej 27 shtatorit deri më 1 tetor 1987, pas kumtesave mbi qytetet-muze të Beratit dhe Gjirokastrës dhe Qendrës historike të Korçës, prej meje dhe kolegut Pirro Thomo, Jukka Jokilehto, na pohoi shkurt dhe qartas: "Si është e mundur që Shqipëria një vend i vogël, kaq herët, pra që në vitin 1960 është sensibilizuar për vlerat e arkitekturës popullore, duke shpallur qytete-muze Gjirokastrën dhe Beratit", sot Pasuri botërore. Gjithë duke vlerësuar vijueshëm autorin e kësaj vepre madhore për kulturën shqiptare dhe botërore ark. Gani Strazimirin, punimi në shqyrtim, na jep një ndihmesë autoritare në planin profesional për të zbatuar më gjerë dhe saktë praktikatat për vlerësimin e këtyre qendrave.

Kjo vepër në thelb i drejtohet specialistëve të fushës, por padyshim edhe intelektualëve të interesuar për vlerat historiko-kulturore. Do të doja të theksoja se ajo do të jetë një mbështetje për institucionet e ngarkuara për vlerësimin e monumenteve në vendin tonë dhe sensibilizuese edhe për organet qeveritare të cilat subvencionojnë financiarisht këtë vlerësim dhe ndërtojnë sistemin organizativ të ruajtjes dhe menaxhimit të këtyre vlerave.

Shqipërimi me profesionalizëm të spikatur prej Boiken Abazit dhe Jeta Limani Andreassen, meriton vlerësim madhore, sepse në shqip vepra ruan të pacenuara parametrat thelbësor të përmbajtjes së saj sa mësimdhënëse aq edhe të qartë.

Prof. Emin Riza

30 mars 2010

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	IX
-----------------------------	-----------

1 PËRMBLEDHJE E PARIMEVE UDHËZUESE

OBJEKTIVAT	1
DOKUMENTIMI	2
PLANET E PUNËS	2
MIRËMBAJTJA PARANDALUESE	3
PERSONELI	3
KOMISIONI I SITIT	4

2 POLITIKA E PËRGJITHSHME E KONVENTËS

KOMITETI I TRASHËGIMISË BOTËRORE	5
UDHËZUES PËR MËNYRËN E FUNKSIONIMIT	6
EMËRIMI PËR NË LISTËN E TRASHËGIMISË BOTËRORE	6
STRATEGJIA GLOBALE	9
OBJEKTIVAT E MBROJTJES DHE KONSERVIMIT	10
LISTA E TRASHËGIMISË BOTËRORE NË RREZIK	11
HEQJA NGA LISTA E TRASHËGIMISË BOTËRORE	11
EMBLEMA	12

3 VLERËSIMI PËR KONSERVIM

PËRMBLEDHJE	13
ÇFARË ËSHTË TRASHËGIMIA KULTURORE SOT?	13
Si përkufizohet trashëgimia kulturore botërore?	15
ÇFARË MBROHET NË NJË MONUMENT APO NË SIT?	16
Procesi kritik	16
Vlerat e lidhura me një burim të trashëgimisë	17
Përkufizimi i burimit të trashëgimisë	17
Etapat historike	19
Çfarë është autenticiteti?	20
CILAT VLERA NDIKOJNË TEK NDËRHYRJET	21
Vlerat kulturore	22
Vlerat bashkëkohore sociale dhe ekonomike	23

4 MENAXHIMI I SITEVE TË TRASHËGIMISË BOTËRORE

HYRJE	27
MENAXHIMI.	28
Objektivat e menaxhimit	28
Të dhënat mbi të cilat bazohet plani i menaxhimit	28
Inventari dhe dokumentimi	29
Menaxhimi i informacionit	32
Planifikimi i punimeve kërkimore	33
Programi i përgjithshëm i punës	34
Administrimi	35
Kontrolli i kostos dhe politikat	36
Instrumentet ligjore	36
Programimi	37
RISHIKIMI I PROGRAMIT DHE PLANIFIKIMI PËR TË ARDHMEN	38
BUXHETIMI	38
Buxheti vjetor	39
Roli i UNESCO-s	39
LISTA E KONTROLLIT PËR MENAXHIMIN	40

5 MENAXHIMI NË BAZË TË PROJEKTEVE TË BURIMEVE

PËRGATITJA E PLANIT TË MENAXHIMIT.	42
Procedura	42
Kërkesat.	42
Procedurat e përgatitjes dhe këshillimit.	43
RAPORTIMI	44
Raportimi afatshkurtër dhe rishikimi	44
Raportimi afatgjatë dhe rishikimi.	45
Formati i planit të menaxhimit	45
Komentet mbi formatin	48
Paraqitja e planeve të menaxhimit	48

6 PROGRAMI I MIRËMBAJTJES

HYRJE	50
MIRËMBAJTJA PARANDALUESE.	50
Kontributi profesional	51
Konteksti i inspektimit të ndërtesave dhe siteve historike	53

Monitorimi i programit të mirëmbajtjes	54
PROBLEME TË VEÇANTA	54
Vandalizmi dhe vjedhja	54
Lokalizimi dhe mbrojtja ndaj zjarreve	55

7 PËRZGJEDHJA DHE SHËRBIMET E PERSONELIT

KOMISIONI I SITIT	58
PËRZGJEDHJA E PUNONJËSVE PËR MENAXHIMIN E PËRGJITHSHËM	59
Përzgjedhja e ekspertëve dhe profesionistëve	59
Kualifikimet e burimeve njerëzore	60
Nevoja për personel të kualifikuar	61
Roli i profesioneve të konservimit	61
Puna e mirë	62
SHEMBUJ AFTËSISH TË LIDHURA ME KONSERVIMIN	62
Arkitektët e konservimit dhe ekipet e tyre të bashkëpunëtorëve	63
Konservuesit arkitekturorë	64
Konservuesit e artit dhe të arkeologjisë.	64
Dokumentuesit e trashëgimisë	65
REKRUTIMI DHE KARRIERAT	66
AMBIENTET E PËRDORURA PËR KONSERVIMIN	66
MENAXHIMI I PERSONELIT	69
Shërbimet e kontraktuara	70
Standardet dhe formimi profesional	71

8 TRAJTIMET DHE AUTENTICITETI

QËLLIMI I TRAJTIMEVE	73
Gatishmëria	74
Prioritetet	74
Përkufizimi i metodave të ndryshme të trajtimeve	75
Trajtimet dhe arkitektura	79
Trajtimet dhe rrënojat	81
SI LIDHET TRAJTIMI ME AUTENTICITETIN?	82
Trajtimet në lidhje me autenticitetin e materialit	85
Trajtimet në lidhje me autenticitetin e punës	87
Trajtimet në lidhje me autenticitetin e projektimit	88
Trajtimet në lidhje me autenticitetin e kontekstit	91
KONKLUZIONI	93
Lista e kontrollit për menaxhimin	94

9 PLANIFIKIMI URBAN DHE QYTETET E TRASHËGIMISË BOTËRORE

HYRJE	95
Cilësitë e qyteteve historike.	96
Rreziqet ndaj qyteteve historike	97
OBJEKTIVAT E PLANIFIKIMIT	99
Konservimi i integruar	99
Kontrolli i ndryshimeve.	102
PROCEDURA E PLANIFIKIMIT	103
Inspektimet dhe sondazhet	105
Zbatimi	106
Kërkesat ndaj personelit	107
Raporti dhe plani i konservimit.	107
Nivelet e ndërhyrjes.	110
Mirëmbajtja.	111
Riaftësimi	112
Projektimi i strukturave të reja	114
Veprimet administrative.	115
LISTA E KONTROLLIT PËR KONSERVIMIN URBAN.	116

10 VIZITORËT E VENDODHJEVE TË TRASHËGIMISË BOTËRORE

HYRJE	119
Nevojat e vizitorëve.	120
Vandalizmi dhe dëmtimet.	121
Mirëpritja e vizitorëve	121
MIRËMBAJTJA E SITIT	122
PREZANTIMI DHE INTERPRETIMI	123
MENAXHIMI I VIZITORËVE.	126
Reklamimi	128
Kodi i praktikave të veprimtarive.	129
REFERENCAT	131
SHTOJCA A – Karta e Venecias	135
SHTOJCA B – Dokumenti i Nara-s mbi autenticitetin	140
SHTOJCA C – Konventat dhe rekomandimet e UNESCO-s	143
SHTOJCA D – Sitet e trashëgimisë kulturore botërore	145
SHTOJCA E – Udhëzuesi i ICOMOS-it për edukimin dhe formimin profesional	161
SHTOJCA F – Parimet e ICOMOS-it për dokumentimin.	167

PARATHËNIE PËR BOTIMIN E DYTË

Ky udhëzues mbi menaxhimin u publikua për herë të parë në gjuhën angleze në vitin 1993. Ai përmbledh dhe paraqet parimet më të rëndësishme rreth konservimit dhe menaxhimit të trashëgimisë kulturore. Kjo përmbledhje ka qenë e mirëpritur nga lexuesi, i cili ka pasur reagime inkurajuese. Reagimet pozitive dallohen qartë edhe nëpërmjet kërkesave të vazhdueshme për përkthimin e udhëzuesit në gjuhë të ndryshme. Përkthimet përfshijnë botimin e ICCROM në gjuhën franceze, në vitin 1996, si dhe atë në gjuhën spanjolle të publikuar në Kolumbi, në vitin 1995. Sot janë duke u botuar përkthime të këtij libri edhe në gjuhën kineze, tajlandeze, perse, polake, gjermane, ruse dhe lituane.

Duke marrë parasysh larminë e vlerave dhe kompleksitetin e çështjeve që lidhen me ruajtjen e trashëgimisë kulturore në vende të ndryshme, lexuesi duhet ta ketë të qartë se një libër i vetëm vështirë se mund t'i trajtojë të gjitha situatat e mundshme. Për rrjedhojë, ky udhëzues duhet të kuptohet si një kornizë e përgjithshme dhe duhet të interpretohet në një mënyrë që përshtatet me situata të veçanta për çdo rast specifik.

Ky botim është publikuar me disa përmirësime të vogla në krahasim me botimin origjinal të vitit 1993. Disa nga këto përmirësime përfshijnë edhe përditësimin e udhëzuesit administrativ në përputhshmëri me botimin e fundit të “*Operational Guidelines*” (*Udhëzues për mënyrën e funksionimit*) të Komitetit të UNESCO-s për Trashëgiminë Kulturore (shkurt 1997). Këto dokumente zyrtare rishikohen në mënyrë të vazhdueshme, dhe për pasojë është e këshillueshme që të verifikohen ndryshime të tjera që mund të kenë ndodhur më pas. Versionet e reja mund të gjenden në Qendrën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s, ose në faqen e internetit të UNESCO-s për Trashëgiminë Botërore. Disa korrigjime të tjera janë kryer edhe për të qartësuar pjesë të tekstit origjinal, si p.sh. përkufizimin e konceptit të “vlerës” dhe çështjen e “autenticitetit” në lidhje me konservimin modern. Këto rishikime janë kryer si rezultat i përfundimeve të takimit në Nara, në vitin 1994. Gjithashtu janë vendosur edhe disa shtojca të reja.

Bernard Feilden dhe Jukka Jokilehto
Maj 1998

HYRJE

Ky udhëzues e ka zanafillën e tij në një takim të përbashkët të organizuar në Romë, në prill të vitit 1983, nga Qendra Ndërkombëtare për Studimin e Ruajtjes dhe Restaurimit të Pasurisë Kulturore (ICCROM) dhe Këshillit Ndërkombëtar për Monumentet dhe Sitet (ICOMOS), nën mbikëqyrjen e Sektorit të Trashëgimisë Kulturore të UNESCO-s.

Ekspertët që kontribuuan me përvojën e tyre të gjerë në formulimin e këtij udhëzuesi janë:

BOURKE, Max	Australi
DIMACOPOULOD, Jordan	Greqi
FEILDEN, “Sir” Bernard	Mbretëria e Bashkuar
JOKILEHTO, Jukka	ICCROM
LEBLANC, François	Kanada
MILLER, Hugh	SHBA
MOJSILOVIC-POPOVIC, Svetlana	Jugosllavi
MTURI, Amini A.	Tanzani
QUDSI, Adli	Siri

Struktura e pikave të planit të përmbajtjes u përgatit nga ekipi i punës, ndërkohë që Sir Bernard Feilden u ngarkua me detyrën e shkrimit të tekstit. Varianti i parë u rishikua nga Komisioni i Fshatrave të Mbretërisë së Bashkuar, Z. Andrew Thornburn dhe Dr. Jukka Jukilehto, të cilët përfshinë edhe komentet dobiprurëse të të gjithë anëtarëve të komitetit krijues. Më pas, varianti i rishikuar iu dërgua disa ekspertëve dhe menaxherëve të fushës së konservimit të trashëgimisë nga vende të ndryshme, të cilët dhanë komentet e tyre që u morën gjithashtu parasysh gjatë shkrimit të variantit përfundimtar. Teksti përfundimtar u përgatit bashkërisht nga Bernard Feilden dhe Jukka Jukilehto, me ndihmën e Susan Bronson-it dhe Barrett Kennedy-t si redaktues.

Ndërkohë, kanë filluar të shkruhen edhe doracakë dhe udhëzues të tjerë. Për rrjedhojë, ky publikim duhet të shihet si pjesë përbërëse e një konteksti më të gjerë. Në veçanti, ia vlen të përmendet edhe një doracak tjetër i sapo-publikuar me titullin “Risk Preparedness: A Management Manual for World Cultural Heritage” (Gatishmëria në raste rreziku: doracak i menaxhimit për trashëgiminë kulturore botërore), shkruar nga Herb Stovel, ish Sekretar i Përgjithshëm i ICOMOS-it.

Konteksti

Sistemi i propozuar në këtë udhëzues mund të duket i ndërlikuar për ato Shtete Anëtare të Konventës së UNESCO-s mbi Trashëgiminë Botërore që nuk kanë zhvilluar një sistem për mbrojtjen e trashëgimisë së tyre kulturore. Sfida më e madhe është sigurimi i personelit të mjaftueshëm dhe të specializuar në përkujdesjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë së tyre. Sidoqoftë, sistemi i propozuar është krijuar me qëllim që të ndiqet në vija të trasha dhe të përdoret si një kornizë për përshtatjen e sistemeve që zhvillohen brenda secilit shtet të anëtarësuar. Shpesh herë, vendet në zhvillim kanë burime të shumta artizanale që përbëjnë një “trashëgimi kulturore të gjallë” dhe jetike për konservimin e vendndodhjeve.

Kur një sit përfshihet në Listën e Trashëgimisë Botërore, ai njihet si një vend me vlera universale të jashtëzakonshme, duke qenë se është edhe një nga 500 sitet e tilla në të gjithë botën. Është vërejtur se vetëm disa prej Shteteve Anëtare kanë përshtatur procedurat e tyre administrative dhe ato të planifikimit urban në përputhje me statusin e ri prestigjioz që jep anëtarësimi në Listën e Trashëgimisë Botërore. Ky fenomen e rrit numrin e sfidave në lidhje me turizmin dhe zhvillimet e reja. Përcaktimi i zonave të mbrojtura përbën një nevojë urgjente që duhet adresuar me përparësi.

Shtetet Anëtare duhet të mbajnë një qëndrim pozitiv ndaj Trashëgimisë Botërore duke u përkushtuar ndaj parimeve të saj. Kjo do të thotë se të gjitha palët e lidhura me këtë çështje duhet t'i dinë edhe t'i zbatojnë këto parime, përfshirë këtu edhe pjesëmarrjen e komunitetit – një trashëgimi e përbashkët me detyrime të përbashkëta.

Duke marrë parasysh shumëllojshmërinë e sitet të Trashëgimisë Botërore, nga pikturat parahistorike e deri te qytete si Roma, autorët duhet të paraqesin një skicë të përgjithshme të parimeve dhe jo receta të veçanta të cilat duhen vënë në zbatim.

Planifikimi i menaxhimit duhet të përqendrohet mbi vlerat, duke i përdorur ato si baza të qarta mbi të cilat merren vendimet.

Ky libër tanimë është përkthyer në disa gjuhë. Parashikohet që përkthimi do t'u vijë në ndihmë menaxherëve dhe punonjësve të siteve kur ta lexojnë këtë udhëzues në gjuhën e tyre.

Kush e ka përgjegjësinë e menaxhimit të një siti të Trashëgimisë Kulturore Botërore në çdo hap të zhvillimit të tij, dhe nga njëra ditë te tjetra? Ndodh që siti të mbushet me vizitorë, por kush mban përgjegjësi? Mund të ketë një Drejtor të Përgjithshëm, por nëse ai, apo ajo, nuk i ka deleguar përgjegjësitë përkatëse, atëherë efektivisht asnjë individ në nivel vendor nuk do të mbajë përgjegjësi efektivisht. Çdo gjë mund të ndodhë në mungesë të kontrollit të menaxhimit në nivel vendor. Masat parandaluese për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore duhet të ndërmerren nga punonjës të stërvitur posaçërisht për këtë detyrë, të cilët arrijnë të kuptojnë rëndësinë e saj.

Ky udhëzues është shkruar për të gjithë ata që merren me sitet e Trashëgimisë Botërore, por ai është gjithashtu i zbatueshëm edhe për site të tjera të cilat ruhen për shkak të vlerave të tyre kulturore. Qëllimi i udhëzuesit është që të ndihmojë ekipet menaxhuese në rritjen e nivelit të gatishmërisë dhe vetë-administrimit, duke siguruar kështu edhe burimet e përshtatshme dhe mbështetjen e vazhdueshme nga qeveria në nivel qendror. Konservimi është një element përbërës kryesor i procesit të menaxhimit, kështu që ai duhet udhëhequr nga një ekip menaxhimi i përgatitur në fusha të ndryshme dhe i aftë të kuptojë dhe të zbatojë teorinë e fushës së konservimit.

Emërimi i një siti në Listën e Trashëgimisë Botërore nënkupton ndryshime. Rritja e numrit të vizitorëve kërkon hapësira të reja dhe rrit edhe numrin e tregtarëve. Ndodh që ato dyqane të cilat ‘mbijnë’ në sit brenda pak ditësh të qëndrojnë aty për vite të tëra pa u shpërngulur, edhe pse ekzistenca e tyre mund të jetë tërësisht e jashtëligjshme. Një qeveri mund të kërkojë ta përmirësojë sitin e saj duke kryer ndërhyrje restauruese të tepërta. Peizazhi dhe përmbajtja e sitit mund të dëmtohen nga zhvillime të padëshiruara, siç janë punimet inxhinierike, nxjerrja e mineraleve, etj. Menaxhimi duhet të përqendrohet tek vlerësimi i rreziqeve.

Menaxhimi është një element thelbësor që mund të zbatohet vetëm në terren. Cilat janë përgjegjësitë e një menaxheri të sitit? Vizitorit mund t’i ndodhë një aksident shumë i rëndë dhe dikush duhet të merret me të. Një grup nxënësish mund të vijë pa paralajmëruar për të bërë një vizitë gjatë një dite me shi, pa patur një vend ku të strehohen. Ka patur raste kur shtrati i tharë i një lumi ka vërshuar pas një stuhie të papritur, duke marrë me vete edhe vizitorët. Erozioni i vazhdueshëm i sitit bën që mbishkrimet në dysheme të shuhen. Edhe gurët e Akropolit kanë nevojë të mbrohen. Tubimet e vizitorëve mund të çojnë drejt acarimeve duke shkaktuar vandalizëm. Mbeturinat duhen pastruar. Shtigjet duhen riparuar. Bimët duhen mbrojtur, dhe ndërkohë duhen respektuar edhe nevojat e kafshëve të egra. Menaxheri i sitit duhet të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme sigurinë në sit,

duke qenë i vëmendshëm edhe ndaj vënies së qëllimshme të zjarreve. E gjithë kjo barrë që rëndon mbi ekipin menaxhues i mundëson qytetarëve nga mbarë bota të shijojnë trashëgiminë e tyre kulturore. Këta qytetarë duhen nxitur që të raportojnë në Qendrën e Trashëgimisë Botërore.

Në lidhje me menaxhimin e një siti, politikanët dhe administratorët do të jenë kryesisht të interesuar në parimet e menaxhimit; Drejtori i Përgjithshëm do të jetë i interesuar në politikat e funksionimit; kurse punonjësit në aspektet praktike të menaxhimit. Teoria e konservimit duhet të shërbejë si baza për çdo veprim. Menaxheri i sitit e gjen veten midis problemeve të përditshme dhe çështjeve më të mëdha që parashtrihen nga mbikëqyrësit. Këta mbikëqyrës monitorojnë buxhetin, por qëllimi i tyre kryesor është konservimi i sitit të Trashëgimisë Botërore.

Kënaqësia që na jep trashëgimia jonë varet nga ruajtja e saj. Ky udhëzues ka për qëllim t'i ndihmojë menaxherët e siteve në përmbushjen e detyrës së tyre si ruajtës të trashëgimisë kulturore nëpërmjet përkrahjes së komisionit të ekspertëve, si dhe nëpërmjet ndihmës mbi konceptimin e asaj *çka e bën të rëndësishme një sit*, duke e mbrojtur atë nga rreziket e shumta që i kanosen.

Trashëgimia Botërore na tregon se industria, mjeshtëritë, dashuria dhe kujdesi i qytetërimeve të së kaluarës kanë ekzistuar për t'i dhënë një kuptim mjedisit të këtyre qytetërimeve. Kureshtja jonë mbi to nuk duhet të rreshtë asnjëherë. E kaluara mund të na flasë dhe të na ndihmojë të kuptojmë se ku do të shkojmë në të ardhmen.

Bernard Feilden dhe Jukka Jokilehto

Maj 1998

Kapitulli 1

PËRMBLEDHJE E PARIMEVE UDHËZUESE

1.1 OBJEKTIVAT

- *Ky Udhëzues për Menaxhimin synon të ofrojë këshilla dhe sugjerime për zbatimin e qëllimeve të Konventës së Trashëgimisë Botërore.*

Udhëzuesi përmban njohuri të dobishme për të gjitha Shtetet Anëtare të Konventës së UNESCO-s për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore Botërore. Tashmë, Shtetet Anëtare kanë site të cilat janë përfshirë në Trashëgiminë Botërore në përputhshmëri me konventat, udhëzimet dhe mënyrat e parashikuara nga UNESCO.¹

Teknikat e menaxhimit mund të zbatohen në çdo nivel të sofistikimit teknik dhe mund të përdoren për rritjen e nivelit të kompetencës teknike.

- *Vendosja e kuadrit të menaxhimit teknik duhet parë me përparësi.*
- *Të gjitha aktivitetet e propozuara duhet të bazohen në bashkëpunimin ndërdisiplinor duke përdorur teorinë e konservimit për të vlerësuar sugjerimet e ndryshme.*
- *Plani i menaxhimit duhet të përmbajë disa plane projektesh mbi burimet që janë në dispozicion, dhe këto plane duhet të jenë të ndërlidhura më njëra-tjetrën.*

Çdo Shtet Anëtar duhet t'i zbatojë parimet e paraqitura në këtë udhëzues sipas shkallës së nivelit të sofistikimit të tij menaxherial, në mënyrë që të ketë sa më shumë ndikim dhe që të jetë sa më efikas. Nëse ndiqet që në fillim kuadri bazë i veprimtarisë që propozohet në këtë udhëzues, në fazat në vijim mund të arrihet në një nivel më të lartë sofistikimi sipas përcaktimit të nevojave dhe disponueshmërisë së profesionistëve të veçantë.

1 Për informacione të përditësuara mbi Konventën e Trashëgimisë Botërore dhe çështjeve të tjera të lidhura me të mund të vizitoni faqen e internetit: <<http://www.unesco.org:80/whc/>>. Konventat e UNESCO-s duhen parë me kujdes pasi ky udhëzues bazohet mbi supozimin se Shteti Anëtar i përmbahet rregullave të Konventës, duke i zbatuar ato. Rekomandimet e UNESCO-s ofrojnë gjithashtu udhëzime shtesë rreth zbatimit të politikave të konservimit. Krahas bibliografisë në kapitullin e fundit, referenca të tjera të përzgjedhura mund të kërkohen edhe nga ICCROM në Romë, Itali, apo edhe nga "Conservation Information Network – CIN" (Rrjeti i Informacionit mbi Konservimin) në Otavë, Kanada, rreth menaxhimit të zonave, objekteve dhe siteve historike.

Veprimet për zbatimin e menaxhimit të siteve të Trashëgimisë Botërore duhet të bazohen në traditat dhe legjislacionin e Shtetit Anëtar, i cili duhet ta rishikojë dhe përditësojë legjislacionin e tij aty ku është e nevojshme.

Menaxhimi i një siti të Trashëgimisë Botërore bazohet në analizën e detajuar të rëndësisë së tij, sipas identifikimeve të kryera gjatë procedurës së emërimit. Plani i menaxhimit përfshin pikat në vijim:

- sigurimin që të gjithë punonjësit e sitit të arrijnë të kuptojnë se cilat janë vlerat kulturore që duhen ruajtur në sit;
- shpërndarjen e udhëzimeve specifike të bazuara mbi deklaratën e rëndësisë së sitit;
- inventarizimin e plotë të të gjitha burimeve kulturore në sit;
- kryerjen e inspektimeve të rregullta dhe përpilimin e raporteve zyrtare nga profesionistët me kualifikimet dhe përvojën e duhur;
- hartimin e planeve strategjike të mirëmbajtjes që çojnë drejt hartimit të projekteve për burime të caktuara sipas përparësisë së tyre dhe në mënyrë të integruar me planin vjetor të punës;
- respektimin e etikës së konservimit gjatë të gjitha punimeve, sipas rekomandimeve ndërkombëtare të UNESCO-s dhe udhëzimeve si ato të Kartës së Venecias .

1.2 DOKUMENTIMI

E gjithë literatura e botuar në lidhje me sitin duhet të grumbullohet, arkivohet, si dhe të vihet në dispozicion. Deklarata e rëndësisë duhet të marrë parasysh gjithë materialin e shkruar. Nëse ky proces ende nuk ka ndodhur, ai duhet të kryhet urgjentisht.

Menaxhimi i sitit duhet të bazohet në legjislacionin mbi përdorimin e tokës (pronës) së Shtetit Anëtar. Megjithatë, ka raste kur duhen zbatuar edhe masa të tjera mbrojtëse, sidomos në zonën përreth sitit. Inventarizimi duhet t'i përfshijë të gjitha objektet, dhe aty ku është e përshtatshme, edhe përmbytjen e tyre, si dhe burimet që ka siti në lidhje me urbanistikën dhe peizazhin natyror.

1.3 PLANET E PUNËS

Bazat e planifikimit të menaxhimit, programimit dhe buxhetimit janë planet afatgjata të punës (5-30+ vite), ato afatmesme (<5 vjet), si dhe planet vjetore të punës. Programet vjetore mund të përbëhen nga një numër projektsh të ndërlidhura me njëri-tjetrin, të cilët mund të miratohen në faza të ndryshme.

Menaxhimi duhet të organizohet me projekte të bazuara mbi burimet në dispozicion, si dhe sipas një metodologjie standarde. Meqenëse zhvillimi i programit është në varësi të kapaciteteve të punonjësve dhe buxhetit, projektet e bazuara mbi burimet në dispozicion duhen identifikuar paraprakisht dhe duhen zbatuar me radhë, sipas përparësisë së tyre.

Është e nevojshme që puna kërkimore (hulumtuese) të planifikohet, koordinohet dhe menaxhohet nga një Komitetit i veçantë. Plani i menaxhimit duhet të ketë të bashkëngjitur një shtojcë me pikat e planit të punës kërkimore. Në planin e menaxhimit bëjnë pjesë gjithashtu edhe studimet e planifikimit urban, të cilat përditësohen në bazë të inspektimeve të rregullta.

Njëri prej qëllimeve të konservimit është të **mos** i ulë standardet e jetesës së banorëve të zonave historike. Për rrjedhojë, mund të jetë e nevojshme që rehabilitimi të udhëhiqet nga standarde dhe udhëzime që përputhen me këtë qëllim.

1.4 MIRËMBAJTJA PARANDALUESE

Është e nevojshme që të zhvillohet një strategji për mirëmbajtjen parandaluese e cila përdor një qasje që mbulon shumë fusha. Pasi të jenë shqyrtuar mundësitë alternative në praktikë, atëherë duhet përdorur teoria e konservimit për të vlerësuar se cilat do të jenë veprimet më të përshtatshme.

Mirëmbajtja përfshin të gjitha masat praktike dhe teknike të cilat duhen ndërmarrë në mënyrë që siti të mbahet në ato lloj kushtesh dhe standardesh që japin kënaqësinë maksimale, pa dëmtuar burimet kulturore. Ky është një proces i vazhdueshëm. Shpeshësia e masave dhe veprimeve duhet të përcaktohet duke u nisur nga të dhënat, mendimi profesional dhe formimi profesional i punonjësve dhe artizanëve. Programi i mirëmbajtjes duhet monitoruar.

Një përkujdesje e veçantë i duhet dhënë edhe masave mbrojtëse dhe parandaluese kundër vandalizmit, vjedhjes, zjarrit, përmbytjeve dhe tërmeteve.

1.5 PERSONELI

Ekspertë të përshtatshëm duhet të përzgjidhen për të dhënë këshilla rreth planit të punës dhe për të ndihmuar në ekzekutimin e tij. Plani duhet të nisë me një deklaratë e cila përshkruan filozofinë e menaxhimit. Deklarata duhet shkruar me fjalë të cilat janë të kuptueshme nga i gjithë personeli i sitit. Nevojat e personelit duhen vlerësuar duke i dhënë përparësi punësimit/emërimit të njerëzve në rolet kyçe. Punësimi dhe personeli trajtohen në Kapitullin 7.

1.6 KOMISIONI I SITIT

Është e rekomandueshme që të themelohet një Komision për Sitin.

Komisioni i Sitit duhet të luajë rolin e rojtarit të vendndodhjes së Trashëgimisë Botërore. Detyra kryesore e këtij Komisioni duhet të jetë konservimi dhe menaxhimi i sitit. Struktura e Komisionit të Sitit duhet të diktohet nga rrethanat praktike; ndërsa emri i tij – qoftë grupi i punës, agjenci, komision, etj – duhet të përputhet me praktikën administrative kombëtare. Në ato raste kur disa site të vogla të Trashëgimisë Botërore janë afër njëra-tjetrës për nga pozita e tyre gjeografike, dhe kur kanë probleme të ngjashme, atëherë ato mund të menaxhohen nga një Komision i vetëm (p.sh. në kuadër të organizatës së arkeologjisë së Shtetit Anëtar). Gjithashtu, rolin e Komisionit të Sitit mund ta kryejnë edhe organe të tjera, si p.sh. komitete të caktuara nga këshilli bashkiak.

Do të ishte e pëlqyeshme që Komisioni i Sitit të ketë buxhetin e tij për shpërndarjen e informacionit të përgjithshëm, ndërgjegjësimin e publikut, gërshetimin me programet edukative shkollore dhe reklamimin në nivel botëror të sitit nëpërmjet mediave dhe kanaleve të tjera të komunikimit. Krijimi i udhërrëfyesve duhet të merret seriozisht në konsideratë. Duhet siguruar shërbimet për vizitorët dhe komunitetin, por pa e tejkaluar kapacitetin maksimal të sitit, si dhe duke garantuar edhe sigurinë e njerëzve. Politikat rreth çmimeve të biletave të hyrjes duhen studiuar mirë. Në përgjithësi, formimi profesional dhe licencimi i ciceronëve është përgjegjësi e Komisionit të Sitit.

Faktorët ekonomikë janë ata që do të drejtojnë shumicën e aktiviteteve të Komisionit të Siteve. Edhe pse Komisioni varet në masë të gjerë nga fondet shtetërore për **ruajtjen** e sitit dhe studimet **kërkimore**, këtij komisioni duhet t'i lejohet që të mbledhë fonde nga turistët për ta zhvilluar më tej sitin në lidhje me rritjen e nivelit të kënaqësinë që ai u jep vizitorëve, si dhe për të mbuluar një pjesë të shpenzimeve. Buxheti vjetor duhet caktuar nën kuadrin e financimit qeveritar, me mundësinë për t'i lëvizur këto fonde fiskale nga njëri vit buxhetor tek tjetri. Buxhetimi duhet të kryhet me formate (tituj, letra me kokë, etj.) të standardizuara.

Kapitulli 2

POLITIKA E PËRGJITHSHME E KONVENTËS

2.1. KOMITETI I TRASHËGIMISË BOTËRORE

Konventa për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore Botërore është njëra prej tri Konventave të UNESCO-s që kanë të bëjnë me trashëgiminë kulturore². Kjo konventë u ratifikua në Konferencën e Përgjithshme të UNESCO-s në seancën e saj të shtatëmbëdhjetë, e cila u mbajt në Paris, më 16 nëntor 1972. Që prej datës 28 tetor 1997, 152 shtete kanë depozituar ratifikimin, miratimin ose njohjen e kësaj Konvente.

Konventa menaxhohet nga Komiteti i Trashëgimisë Botërore, i cili mbështetet nga Sekretariati i UNESCO-s në Qendrën për Trashëgiminë Botërore. Vendimet për Komitetin e Trashëgimisë Botërore përgatiten nga Byroja e Trashëgimisë. Byroja është e përbërë nga kryetari, zëvendës-kryetari dhe raportuesi. Komiteti përbëhet nga përfaqësues të Shteteve Anëtare, dhe zakonisht mblidhet një herë në vit. Tre funksionet thelbësore të Komitetit janë:

- të identifikojë, në bazë të emërimeve të dorëzuara nga Shtetet Anëtare, site kulturore dhe natyrore me vlera të jashtëzakonshme universale të cilat duhet të mbrohen nga kjo Konventë, si dhe t'i vendosë ato në Listën e Trashëgimisë Botërore;
- të përcaktojë ato site të Listës së Trashëgimisë Botërore që duhen vendosur në Listën e Trashëgimisë Botërore në Rrezik (p.sh.: site në Listën e Trashëgimisë Botërore të cilat janë të rrezikuara, dhe për mbrojtjen e të cilave nevojiten disa ndërhyrje të konsiderueshme. Për këto ndërhyrje, në përgjithësi nevojitet të dorëzohet një kërkesë për ndihmë);
- të vendosë se në ç' mënyrë dhe në cilat kushte do mund të përdoren burimet e Fondit të Trashëgimisë Botërore në mënyrë sa më të favorshme, për t'i ardhur në ndihmë Shteteve Anëtare në mbrojtje të siteve të tyre me vlera të jashtëzakonshme universale.

2 Dy të tjerat janë si në vijim: (1) Konventa për Mbrojtjen e Pasurisë Kulturore në Raste Konfliktesh të Armatosur (Konventa e Hagës), e miratuar në vitin 1954, dhe (2) Konventa e Masava të Ndalimit dhe Parandalimit të Importit, Eksportit dhe Transferimit të Jashtëligjshëm të Pronësisë mbi Pasurinë Kulturore, e vitit 1970.

2.2 UDHËZUES PËR MËNYRËN E FUNKSIONIMIT

Udhëzuesi për Mënyrën e Funkzionimit dhe Zbatimit të Konventës së Trashëgimisë Botërore (më tej i përmendur vetëm si *Udhëzuesi për Mënyrën e Funkzionimit*), është shkruar së pari në vitin 1977, e më pas është rishikuar në mënyrë periodike³. Udhëzuesi është përgatitur me qëllim informimin e Shteteve Anëtare të Konventës mbi parimet që udhëheqin punën e Komitetit në përcaktimin e Listës së Trashëgimisë Botërore dhe Listës së Trashëgimisë Botërore në Rrezik, si dhe mbi shpërndarjen e ndihmës ndërkombëtare nga Fondi i Trashëgimisë Botërore. *Udhëzuesi për Mënyrën e Funkzionimit* konsiderohet si një mjet pune dhe mund të redaktohet dhe rishikohet nga Komiteti i Trashëgimisë Botërore sipas nevojave në nivel vendor dhe në përputhshmëri me politikën e përcaktuar nga Komiteti për Konventën.

2.3 EMËRIMI PËR NË LISTËN E TRASHËGIMISË BOTËRORE

Një nga qëllimet kryesore të Konventës së Trashëgimisë Botërore është identifikimi i siteve specifike të trashëgimisë – qofshin ato kulturore, apo natyrore – për t'i emëruar më pas në Listën e Trashëgimisë Botërore. Për të qenë e pranueshme trashëgimia kulturore duhet të ketë një vlerë të jashtëzakonshme universale. Kriteret specifike për emërimin në Listën e Trashëgimisë Botërore janë të përcaktuara tek *Udhëzuesi për Mënyrën e Funkzionimit* (Seksioni C, prg. 23-34), dhe u referohen tri kategorive të siteve të Trashëgimisë Botërore: (a) monumenteve, grupeve të ndërtesave dhe siteve; (b) grupeve të ndërtesave urbane; dhe (c) peizazheve kulturore.

Kriteret për kategorinë [a] përcaktojnë se siti duhet:

- (i) të përfaqësojë një kryevepër të krijimtarisë gjeniale të njeriut; ose
- (ii) të prezantojë një shkëmbim të rëndësishëm të vlerave njerëzore përgjatë një periudhe kohore, apo brenda një zone të caktuar kulturore të botës, në aspektin e zhvillimeve arkitektonike, arteve monumentale, planifikimit urban apo projektimit të peizazheve natyrore; ose
- (iii) të bartë dëshmi unike, apo së paku të jashtëzakonshme, të një tradite kulturore apo të një qytetërimi që vazhdon të jetojë, ose që është zhdukur; ose
- (iv) të jetë një shembull i jashtëzakonshëm i një tipi ndërtese, një

3 Ky Udhëzues i Menaxhimit reflekton të gjitha rishikimet deri tek, e duke përfshirë edhe ndryshimet në *Udhëzuesin për Mënyrën e Funkzionimit* i miratuar nga Seanca e 16-të e Komitetit të Trashëgimisë Botërore në Merida, Meksikë, në dhjetor të vitit 1996 (WHC-97-2, shkurt 1997).

- grupi objektsh arkitektonike, ose një peizazhi i cili ilustron faza të rëndësishme – apo një fazë të rëndësishme – në historinë e njerëzimit; ose
- (v) të jetë një shembull i jashtëzakonshëm i vendbanimit tradicional njerëzor, apo përdorimit tradicional të tokës, që përfaqëson një kulturë (apo disa kultura), veçanërisht nëse kjo kulturë është vënë në rrezik si pasojë e ndikimit të ushtruar nga ndryshime të pakthyeshme; ose
 - (vi) të jetë e lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë, apo të prekshme, me ngjarje të ndryshme apo tradita që mbahen ende gjallë, me ide, ose me besime, me vepra letrare e artistike të një rëndësie të jashtëzakonshme universale (Komiteti është i mendimit se ky kriter duhet të përdoret si justifikim për anëtarësimin në Listë vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, apo së bashku me kritere të tjera kulturore ose natyrore).

Për më tepër, një sit i Trashëgimisë Botërore duhet:

- (i) të kalojë provën e autenticitetit në projektim, material, punim ose prezantim, dhe në rastin e peizazheve kulturore duhet marrë në konsideratë edhe karakteri i tyre i veçantë bashkë me elementet e tyre përbërës (Komiteti ka theksuar që rindërtimi është i pranueshëm vetëm nëse kryhet në bazë të dokumentimit të plotë të detajeve të origjinalit, dhe në asnjë rast mbi baza supozimesh).
- (ii) të ketë mbrojtjen e përshtatshme ligjore, dhe/ose mbrojtjen nëpërmjet një kontrate, apo qoftë edhe mbrojtjen tradicionale me mekanizmat e menaxhimit të cilat duhet të sigurojnë konservimin e sitit kulturor apo peizazhit kulturor të emëruar. Si rrjedhojë, ekzistenca e legjisllacionit mbrojtës në nivel kombëtar, krahinor dhe vendor, apo zbatimi i mirë i mbrojtjes tradicionale dhe i mekanizmave të menaxhimit është diçka thelbësore dhe duhet shprehur qartë në formularin e kërkesës për emërim. Gjithashtu, pritjet që të ngrihen argumente bindës mbi mënyrën se si do të zbatohen ligjet dhe mekanizmat e menaxhimit në një mënyrë sa më efikase. Për më tepër, në mënyrë që të ruhet integriteti i siteve kulturore, dhe në veçanti i atyre me një numër të madh vizitorësh, Shteti Anëtar në fjalë duhet të jetë në gjendje të dëshmojë se është i aftë të zbatojë detyrat e përshtatshme administrative që nevojiten për të kryer menaxhimin e sitit, konservimin e tij dhe pritjen e publikut.

Kategoria [b] mbulon **grupet e ndërtesave urbane**, dhe u referohet kryesisht qyteteve historike.⁴ Ato janë kategorizuar në tre lloje (Prg. 27):

- (i) qytete të cilat nuk janë më të banuara, por të cilat japin dëshmi arkeologjike të pandryshuara mbi të kaluarën. Në përgjithësi, këto qytete, e përmbushin kriterin e autenticitetit dhe gjendja e tyre e konservimit mund të kontrollohet në mënyrë relativisht të thjeshtë;
- (ii) qytete historike të cilat janë ende të banuara, që janë zhvilluar nga vetë natyra e tyre, dhe që do të vazhdojnë të zhvillohen nën ndikimin e ndryshimeve sociale, ekonomike dhe kulturore. Kjo situatë e vështirëson vlerësimin e autenticitetit të tyre dhe i bën më problematike politikat e tyre të konservimit;
- (iii) qytete të reja të shekullit të njëzetë të cilat në mënyrë paradoksale kanë diçka të përbashkët me të dyja kategoritë e përmendura më lart. Në këto lloj qytetesh, organizimi i tyre fillestar urban mund të dallohet lehtësisht dhe autenticiteti është i pamohueshëm, por e ardhmja e tyre nuk është e qartë për shkak të zhvillimit të tyre kryesisht të pakontrolluar.

Udhëzuesi për Mënyrën e Funksionimit përcakton kriteret për emërimin e qyteteve historike ashtu siç paraqitet në vijim (prg. 29):

Për të pasur kualifikimin e duhur për t'u emëruar, qytetet duhet të jenë bindëse për njohjen që kërkojnë të fitojnë në lidhje me interesin arkitektonik që ngjallin, e jo të shqyrtohen thjesht mbi bazat intelektuale të rolit që kanë luajtur në të kaluarën, apo qoftë edhe për vlerën e tyre si simbole historike nën kriterin [vi] për anëtarësim në Listën e Trashëgimisë Botërore. Për të qenë i pranueshëm për t'u përfshirë në Listë, organizimi hapësinor, struktura, materialet, format, dhe aty kur është e mundur edhe funksionet e grupeve të ndërtesave duhet të reflektojnë në mënyrë thelbësore qytetërimin, ose trashëgimtarët e qytetërimin që e kanë nxitur këtë emërim.

Qytetet historike që emërohen mund të bëjnë pjesë në disa kategori në varësi të shtrirjes së tyre, duke përfshirë tërë qytetin historik (siç është Roma) e deri vetëm te përfshirja e një pjese të rëndësishme brenda zonës historike të qytetit (siç

⁴ Termi *qytete* është përdorur në mënyrë të përgjithshme gjatë librit *Udhëzues për Menaxhimin* duke përfshirë edhe qytetet dhe site të tjera urbane.

është Sheshi Meidan-e-Shah në Isfahan); apo duke bërë një përzgjedhje të atyre monumenteve të rëndësishme që dokumentojnë karakteristikat e veçanta historike të qytetit. Sidoqoftë, **një përqsasje e integruar është e domosdoshme** në të gjitha rastet për shkak se: së pari, këto elemente janë pjesë përbërëse e kontekstit të tyre urban, qoftë edhe kur përfaqësojnë një periudhë tjetër historike; dhe së dyti, konservimi i tyre në shumicën e rasteve varet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga menaxhimi i kontekstit të tyre fizik, social dhe ekonomik.

Kategoria [c] është identifikuar që prej vitit 1992, dhe ajo përfshin ato peizazhe kulturore që janë të pranueshëm për njërën prej tri kategorive kryesore (*Udhëzuesi për Mënyrën e Funksionimit*, prg. 39):

- (i) peizazh i projektuar dhe i krijuar qëllimisht nga njeriu (p.sh. kopshtet, parqet);
- (ii) peizazh i zhvilluar në mënyrë natyrore si rezultat i urdhrimit social, ekonomik, administrativ apo/edhe fetar (peizazhet relikte apo fosile, peizazhet e vazhdueshme);
- (iii) peizazhet bashkëshoqëruese kulturore – që justifikohen në sajë të lidhjeve me organizata të fuqishme fetare, artistike, kulturore, apo qoftë edhe me elemente natyrore.

Në këtë kontekst, çështja e **provës së autenticitetit** duhet të kuptohet në lidhje me ndërtesat historike, ndërsa për peizazhet kulturore duhet të merret parasysh karakteri dhe elementet e tyre të veçanta.

Fjala *sit* do të përdoret për t'iu referuar të gjitha kategorive që përfshihen në përkufizimet e lartpërmendura. Në disa raste megjithatë, të dy burimet e trashëgimisë kulturore dhe natyrore gjenden edhe brenda të njëjtit sit. Metodologjia e menaxhimit në bazë të projekteve të burimeve është shumë e ngjashme në të dyja rastet. Kriteret për anëtarësimin e pasurive natyrore në Listën e Trashëgimisë Botërore janë të përcaktuara në seksionin D (prg. 43-45) të *Udhëzuesit për Mënyrën e Funksionimit*.

2.4 STRATEGJIA GLOBALE

Në vitin 1990, Komiteti i Trashëgimisë Botërore nisi projektin e ashtuquajtur **Studimi Global**, qëllimi i të cilit ishte krijimi i një kornize të përgjithshme për trashëgiminë kulturore botërore, si dhe prezantimi i një reference për emërimet e ardhshme. Në vitin 1994, ky projekt mori një emër të ri, dhe u njoh si **Strategjia Globale**, e hartuar si një kornizë konceptuale që u ndërtua për të siguruar përfaqësimin dhe besueshmërinë e Listës së Trashëgimisë Botërore. Më vonë, kjo kornizë u zgjerua duke përfshirë edhe trashëgiminë natyrore. Strategjia parashikon

organizimin e takimeve rajonale dhe tematike, siç janë ato mbi peizazhet kulturore me vlerë të jashtëzakonshme universale (von Droste *et al* 1995) dhe takimet mbi autenticitetin (Larson dhe Marstein 1994, Larson 1995). Ky projekt i vazhdueshëm realizohet në bashkëpunim me autoritetet përgjegjëse dhe specialistët e Shteteve Anëtare, ICOMOS-it dhe ICCROM-it.

2.5. OBJEKTIVAT E MBROJTJES DHE KONSERVIMIT

Konventa e Trashëgimisë Botërore mund të shihet në kontekstin më të përgjithshëm të bashkëpunimit ndërkombëtar, duke marrë parasysh edhe konventat dhe rekomandimet e tjera të UNESCO-s (referoju listës tek shtojcat), dhe në veçanti zbatimin e Rekomandimit për Mbrojtjen, në nivel kombëtar, të Trashëgimisë Kulturore e Natyrore (1972), dhe Rekomandimin në lidhje me Ruajtjen dhe Rolin Bashkëkohor të Zonave Historike (1976). Duke marrë parasysh objektivat e mbrojtjes dhe konservimit të siteve me Trashëgimi Botërore, janë dhënë disa udhëzime specifike në Seksionin II (Nenet 4-7) të Konventës, që kanë të bëjnë me *Mbrojtjen Kombëtare dhe Mbrojtjen Ndërkombëtare të Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore*. Parimet në vijim, të cilat trajtojnë masat e mbrojtjes (Neni 5), kanë një rëndësi të veçantë për udhëzimet e menaxhimit që janë parashtruar në këtë publikim.

Për t'u siguruar që secili Shtet Anëtar i kësaj Konvente është duke ndërmarrë masa efikase për mbrojtjen, konservimin dhe prezantimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore që ndodhet në territorin e tij, çdo Shtet Anëtar duhet të përpiqet sa më shumë që të jetë e mundur dhe aq sa është e përshtatshme që:

- të miratojë një politikë të përgjithshme e cila ka për qëllim që t'i japë një funksion trashëgimisë kulturore dhe natyrore për jetën e komunitetit, dhe të integrojë mbrojtjen e kësaj trashëgimie në programe të qarta planifikimi;
- të sigurojë shërbime brenda territorit të tij për mbrojtjen, konservimin dhe prezantimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore – aty ku këto shërbime nuk ekzistojnë – me punonjësit e duhur që zotërojnë mjetet e përshtatshme për t'i zbatuar funksionet e tyre;
- të zhvillojë studime dhe hulumtime shkencore dhe teknike për të përzgjedhur ato metoda funksionimi që do ta lejojnë Shtetin Anëtar të jetë i gatshëm për t'iu kundërvënë rreziqeve që kërcënojnë trashëgiminë e tij kulturore dhe natyrore;
- të ndërmarrë masat e duhura ligjore, shkencore, teknike, administrative dhe financiare për identifikimin, mbrojtjen, konservimin, prezantimin dhe rehabilitimin e kësaj trashëgimie; dhe

- të nxisë themelimin ose zhvillimin e qendrave kombëtare dhe rajonale për formimin profesional në lidhje me mbrojtjen dhe konservimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore; si dhe të inkurajojë hulumtimet shkencore në këtë fushë.

Pasi siti të jetë klasifikuar si një sit që i plotëson standardet e Trashëgimisë Botërore dhe bën pjesë në Listën e Trashëgimisë Botërore, pritet që vlerat dhe kushtet që i japin rëndësinë e tij universale, dhe të cilat e bëjnë një shembull të veçantë, të mirëmbahen në mënyrë të përhershme. Kjo do të thotë se veprimet të cilat do të zbehnin autenticitetin apo vlerat e sitit nuk do të jenë më të pranueshme, pasi këto veprime do të kishin penguar edhe emërimin e tij. Rrjedhimisht, dokumenti i vlerësimit mbi të cilin është bazuar emërimi si pjesë e Trashëgimisë Botërore shërben si një referencë e rëndësishme themeltare. Ky dokument, duhet të identifikojë sa më të qartë, dhe për të gjithë të interesuarit, ato vlera të sitit që kontribuojnë në rëndësinë e tij.

2.6 LISTA E TRASHËGIMISË BOTËRORE NË RREZIK

Nëse vendndodhja dhe integriteti i saj kërcënohen nga rreziqe të veçanta dhe serioze (të verifikuara apo të mundshme) të shkaktuara nga njeriu apo nga natyra, me kërkesë të Shtetit Anëtar ajo mund të vendoset në **Listën e Trashëgimisë Botërore në Rrezik**. Ky veprim ndërmerret me qëllim që të sigurohen ndihma ndërkombëtare për Shtetin Anëtar, deri atëherë kur të jetë eliminuar rreziku (shiko *Udhëzues për Mënyrën e Funkcionimit*, III-A. prg. 76-89). Te këto lloj kërcënimesh nuk bënë pjesë vetëm trysnia e jashtme për të kryer ndryshime të padëshiruara në vendndodhje, por edhe propozimet e papërshtatshme për trajtimin dhe/ose përdorimin e pritsëm të vendndodhjes.

2.7 HEQJA NGA LISTA E TRASHËGIMISË BOTËRORE

Siç përshkruhet në botimin *Udhëzues për Mënyrën e Funkcionimit* (Seksioni I-E, prg. 46-56), një vendndodhje mund të hiqet nga Lista e Trashëgimisë Botërore në rastet kur:

- gjendja e vendndodhjes është përkeqësuar deri në atë masë saqë ka bërë të humbasin karakteristikat të cilat mundësuan anëtarësimin e saj në Listën e Trashëgimisë Botërore; dhe
- masat e nevojshme korrigjuese që qenë përcaktuar nga Shteti Anëtar në kohën e emërimit nuk janë ndërmarrë brenda periudhës së propozuar, duke zbehur ato cilësi thelbësore të sitit të trashëgimisë botërore që ishin

të rrezikuara prej aktiviteteve njerëzore që në kohën e emërimit të tij.



2.8 EMBLEMA

Sitet të cilat janë emëruar në Listën e Trashëgimisë Botërore mund të përdorin **Emblemën** e Trashëgimisë Botërore si dhe emrin, simbolin dhe përshkrimin e siteve të Trashëgimisë Botërore. Emblema është krijuar nga Z. Michel Olyff, dhe “simbolizon varësinë e ndërsjellë të siteve kulturore dhe natyrore: katrori qendror është një formë e krijuar nga njeriu, ndërkohë që rrethi përfaqëson natyrën, dhe që të dyja janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Emblema është e rumbullakët, ashtu si dhe bota, por në të njëjtën kohë ajo është edhe simbol i mbrojtjes” (*Udhëzues për Mënyrën e Funkcionimit*, Seksioni VII-A, prg. 122-125).

Kapitulli 3

VLERËSIMI PËR KONSERVIM

3.1 PËRMBLEDHJE

Koncepti modern i trashëgimisë kulturore lidhet me të gjithë mjedisin e ndërtuar, dhe ky koncept duhet të marrë në konsideratë edhe kontekstin ekologjik të botës. Brenda këtij konteksti, sitet në Listën e Trashëgimisë Botërore dallojnë për vlerën e tyre të jashtëzakonshme universale. Politikat e konservimit duhet të bazohen në një proces kritik i cili fillon me një anketim, dokumentim dhe përcaktim të esencës së burimit kulturor, si dhe vlerave që lidhen me të. Këto vlera mund të ndahen në dy grupe: vlera kulturore dhe vlera bashkëkohore ekonomike.

Konservimi i trashëgimisë kulturore është një problem kulturor. Restaurimi nuk ka receta, por ai varet nga kuptimi i saktë i vlerave që përmban burimi kulturor. Vendimet lidhur me trajtimin e siteve të Trashëgimisë Botërore duhet të jenë të bazuara mbi një gjykim të baraspeshuar i cili merr në konsideratë me përparësi objektivat e Konventës. Politika e konservimit përfshin ndërhyrje në shkallë dhe nivele të ndryshme intensitetit. Ky intensitet përcaktohet nga gjendja fizike, shkaqet e përkeqësimit dhe pritshmëria mbi të ardhmen e mjedisit të burimit kulturor që është duke u trajtuar. Secili rast duhet të konsiderohet në tërësi, si dhe individualisht, duke marrë parasysh të gjithë faktorët. Qëllimi final dhe parimet e konservimit dhe restaurimit duhen pasur gjithnjë parasysh, dhe në përgjithësi është vërtetuar se politikat që çojnë drejt ndërhyrjeve minimale, kanë rezultuar edhe si më frytdhënëset.

3.2 ÇFARË ËSHTË TRASHËGIMIA KULTURORE SOT?

Koncepti i sotëm i trashëgimisë kulturore është rezultat i procesit të lidhur me zhvillimin e shoqërisë moderne, vlerat dhe kërkesat e saj. Në të kaluarën, i është kushtuar më shumë vëmendje veprave të veçanta të artit apo monumenteve kryesore, por shkatërrimet masive që ndodhën si rrjedhojë e luftërave botërore, si dhe zhvillimi i madh industrial që prej vitit 1950, kanë bërë që njerëzit të kuptojnë se jeta e tyre është e lidhur ngushtë me kontekstin në të cilin jetojnë dhe punojnë. Ky kontekst përbën thelbin e identitetit të tyre kulturor, dhe shërben edhe si një referencë intelektuale dhe shpirtërore për një cilësi të ekuilibruar të jetesës.

- *Tendenca e sotme është që trashëgimia kulturore të kuptohet sa më shumë në tërësinë e saj, si diçka që përmban të gjitha shenjat që dokumentojnë aktivitetet dhe arritjet e qenieve njerëzore në rrjedhën e kohës.*

- ❑ Që prej revolucionit industrial, ndërgjegjësimi mbi varësinë e ndërsjellë mes njeriut dhe natyrës është dobësuar gjithnjë e më shumë. Edhe pse burimet natyrore janë shfrytëzuar, qoftë dhe pa mëshirë edhe para epokës industriale, njerëzit dhe mjedisi i ndërtuar kanë qenë më të varur nga natyra se ç'janë sot. Në vija paralele, është krijuar edhe një problem i ri me rritjen marramendëse të popullsisë në shumë vende të botës, të cilat kanë pasur edhe një prirje drejt urbanizimit. Kjo situatë ka shkaktuar një mungesë vetëpërmbajtjeje në konsumin e burimeve të papërtërishme (siç janë nafta dhe mineralet), si dhe një mungesë kujdesi për ato burime që janë qoftë dhe pjesërisht të përtërishme (siç janë uji, ajri dhe pyjet), duke shkaktuar një problem në nivel ndërkombëtar.
- ❑ *Meqenëse trashëgimia kulturore fizike është një prej burimeve më të rëndësishme botërore i cili nuk ripërtërihet, atëherë duhen bërë disa përpjekje të veçanta për të rivendosur ekuilibrin ndërmjet nevojave tona dhe mbrojtjes së këtij burimi.*

Trashëgimia kulturore përbëhet nga lloje të ndryshme pasurishë që ndërlidhen me një shumëllojshmëri mjedisesh. Kjo trashëgimi përfshin jo vetëm monumente të rëndësishme, zona historike dhe kopshte, por edhe tërësinë e mjedisit të ndërtuar nga njeriu. Burimet e trashëgimisë kulturore mund të lidhen me vlera të ndryshme në varësi të kontekstit të tyre. Si pasojë, edhe trajtimi i tyre mund të ndryshojë nga njëri rast në tjetrin.

- ❑ *Konceptet që lidhen me përkufizimin e objektit, vlerave dhe trajtimit të burimeve të trashëgimisë duhet të jenë të përcaktuara qartë në mënyrë që të shmangin paqartësitë mbi qëllimin e tyre.*

Karakterizimi i trashëgimisë kulturore, vlerat e lidhura me të dhe politikat vijuese për mbrojtjen dhe trajtimin e saj janë paraqitur në dokumente të ndryshme ndërkombëtare të UNESCO-s, nga të cilat më të rëndësishmet janë një seri Rekomandimesh dhe Konventash. Rekomandimet japin udhëzime për mbrojtjen e llojeve të veçanta të trashëgimisë – siç janë vendet arkeologjike, ndërtesat historike dhe zonat historike –, ndërsa Konventat – siç është *Konventa e Trashëgimisë Botërore* – ratifikohen nga Shtetet Nënshkruese si instrumente ligjore.

Dokumenti më i rëndësishëm ndërkombëtar mbi këto politika është *Karta Ndërkombëtare për Konservimin dhe Restaurimin e Monumenteve dhe Siteve*, e njohur si Karta e Venecias, e cila mori jetë gjatë Kongresit të Dytë të Arkitektëve dhe Teknikëve të Monumenteve Historike, që u mbajt në Venecia, në vitin 1964. (ICOMOS-i, i themeluar në vitin 1965, e miratoi më vonë Kartën e Venecias si udhëzuesin e tij kryesor doktrinor.)

Ky dokument (Shtojca A e *Udhëzues për Menaxhimin*) është kthyer në një referencë bazë për hartimin e politikave të konservimit në të gjithë globin.⁵

3.2.1 Si përkufizohet trashëgimia kulturore botërore?

Konferenca e Përgjithshme e UNESCO-s, në vitin 1972, ishte një reagim ndaj rreziqeve që i kanoseshin trashëgimisë kulturore dhe natyrore në mbarë botën. Për më tepër, kjo konferencë përfaqëson edhe një shprehje të vullnetit për të siguruar ndihmë të organizuar ndërkombëtare në mbrojtje të Siteve të Trashëgimisë Botërore dhe vlerave të tyre. Në këtë konferencë u miratua *Konventa për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore Botërore*.

Qëllimi i kësaj Konvente është të mbrojë sitet që përfaqësojnë një “vlerë të jashtëzakonshme universale” siç është përcaktuar në *Udhëzues për Mënyrën e Funksionimit* (I-C). Lista e Trashëgimisë Botërore, e cila u themelua dhe u mbështet nga kjo konventë, identifikon sitet në Shtete të ndryshme Anëtare si burime me rëndësi ndërkombëtare që meritojnë të kenë mbrojtje dhe reputacion të veçantë. Së bashku, këto burime unike përfaqësojnë larminë e pasur të trashëgimisë botërore, dhe për rrjedhojë ato bartin edhe vlera të rëndësishme edukative.

Sipas Konventës trashëgimia kulturore përfshin monumente, grupe ndërtesash apo sitesh që përcaktohen si në vijim (Neni 1):

- **monumente:** vepra arkitektonike, vepra monumentale të skulpturës dhe pikturës, elemente apo struktura të natyrës arkeologjike, mbishkrime, banesa në shpella dhe kombinime elementesh të cilat janë me vlerë të jashtëzakonshme universale në aspektin historik, artistik, apo shkencor;
- **grupe ndërtesash:** grupe ndërtesash të ndara ose të lidhura, që për shkak të arkitekturës, homogjenitetit, apo pozitës së tyre, kanë vlerë të jashtëzakonshme universale në aspektin historik, artistik, ose shkencor; ose

⁵ Lista e Konventave dhe Rekomandimeve të UNESCO-s është paraqitur në Shtojcën C; tekset janë publikuar nga UNESCO në vitin 1985 në *Konventat dhe Rekomandimet e Unesco-s Rreth Mbrojtjes së Trashëgimisë Kulturore (Conventions and Recommendations of UNESCO concerning the protection of cultural heritage)*. Për sa i përket *Kartës së Venecias*, ajo është shkruar në vitin 1964, gjatë periudhës së restaurimeve dhe rindërtimeve intensive pas dëmeve të shkaktuara nga Lufta e Dytë Botërore. Kjo Kartë thekson problemet e veçanta të asaj kohe, dhe i kushton më pak vëmendje atyre çështjeve që janë të rëndësishme në ditët e sotme. Që nga ajo kohë, janë bërë shumë përpjekje për ta përmirësuar këtë Kartë, duke hartuar një numër rekomandimesh ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare të cilat shpesh u referohen llojeve të veçanta të trashëgimisë apo problemeve të posaçme. Sidoqoftë, *Karta e Venecias* vazhdon të jetë një deklaratë e vlefshme e disa prej parimeve themelore.

- **sitet:** vepra të krijuara nga njeriu apo vepra të ndërthurura përmes aktivitetit natyror dhe njerëzor, dhe zona që përfshijnë vende arkeologjike që kanë një vlerë të jashtëzakonshme universale në aspektin historik, estetik, etnologjik apo antropologjik.

Kushti kryesor për emërimin e një siti në Listën e Trashëgimisë Botërore është se ai duhet të përfaqësojë një vlerë të jashtëzakonshme universale. Ky koncept është i përcaktuar në *Udhëzues për Mënyrën e Funksionimit* duke shpjeguar edhe zbatimin e tij gjatë procesit të emërimit, ashtu siç është paraqitur në detaje më herët në Seksionin 2.3.

3.3 ÇFARË MBROHET NË NJË MOMENT APO NË NJË SIT?

Në të kaluarën, teoritë e restaurimit shpesh janë përqendruar në mënyrat e ndryshme të trajtimit, por konservimi dhe *mise-en-valeur* (vlerësimi) i trashëgimisë kulturore nuk duhet të konsiderohet thjesht si një seri recetash. Sot, koncepti i trashëgimisë kulturore ka një kuptim shumë më të gjerë. Si rrjedhojë, disa strategji të veçanta të mbrojtjes dhe konservimit mund të dallojnë në mënyrë të konsiderueshme nga njëra-tjetra në varësi të kontekstit dhe vlerave që lidhen me secilën prej monumenteve apo siteve.

Pavarësisht nga kjo, parimet e përgjithshme të praktikave të mira të konservimit mund të shërbejnë si bazë për identifikimin dhe mbrojtjen e burimeve të trashëgimisë.

3.3.1 Procesi kritik

Restaurimi dhe konservimi duhet të bazohen në përcaktimin e qartë të burimit të trashëgimisë dhe marrëdhënies së tij me mjedisin. Ky përcaktim është pjesë e atij procesi kritik që synon të kultivojë vlerat e trashëgimisë si pjesë e pandarë e shoqërisë së sotme, duke zhvilluar një kornizë për vlerësimin e vlerave të burimit, vendosjen e objektivave të menaxhimit dhe përgatitjen e politikave të prezantimit dhe interpretimit. Ky proces është i përbërë nga katër faza të veçanta:

- **Rilevimi (vrojtimi):** inspektimi, rilevimi dhe dokumentimi metodik i burimit, mjedisit të tij historik dhe ambientit fizik;
- **Përkufizimi:** përkufizimi dhe vlerësimi kritik dhe historik i objektit dhe i kontekstit të tij, duke i dhënë atij rëndësinë e merituar;
- **Analiza:** analiza dhe diagnostikimi shkencor i substancës materiale dhe sistemit strukturor të burimit, duke pasur në mendje konservimin e tij; dhe

- **Strategjia:** programet afatgjata dhe afatshkurtra për konservimin dhe menaxhimin e ndryshimeve, duke përfshirë edhe inspektimet e rregullta, mirëmbajtjen periodike dhe kontrollin mjedisor.

3.3.2 Vlerat e lidhura me një burim të trashëgimisë

Vlerat mund të përkufizohen si cilësi relative sociale të kualitetit të sendeve të cilat varen nga shoqëria dhe që mund të ndryshojnë gjatë kohës. Në rastin e trashëgimisë kulturore, duhet t'i kushtohet një vëmendje e veçantë atyre që perceptohen si bartëse të vlerave kulturore, por pa anashkaluar edhe aspektin ekonomik. Disa prej vlerave mund të jenë të lidhura më ngushtë me aspektet thelbësore të monumentit apo sitit – si projektimi, materiali, apo lloji i punës –, ndërsa vlera të tjera mund të jenë të lidhura me vendndodhjen gjeografike të burimit dhe marrëdhënien e tij me mjedisin rrethues. Një burim historik i të kaluarës pëson amortizime të shkaktuara nga kushtet atmosferike, si dhe nga ushtrimi i funksioneve të tij. Në shumë raste, burimi ka pësuar edhe modifikime të ndryshme. Totali i këtyre ndryshimeve përbën një pjesë të karakterit historik dhe substancës materiale të burimit. Substanca materiale përmban konceptin artistik ose estetik të ndërtuesve, si dhe përbën një dëshmi historike të vlerave kulturore të së shkuarës dhe të tashmes.

- *Qëllimi i konservimit është të ruajë cilësinë dhe vlerat e burimit, të mbrojë substancën e tij materiale dhe të sigurojë integritetin e tij për brezat e ardhshëm.*

3.3.3 Përkufizimi i burimit të trashëgimisë

Burim i trashëgimisë është një monument historik, e në të njëjtën kohë edhe një vepër arti – qoftë ndërtesë historike, kopsht, grupim strukturash apo sit që është zhvilluar si rezultat i procesit të krijimtarisë projektuese –, dhe mund të përkufizohet në bazë të disa koncepteve specifike. Në përgjithësi, një vepër e tillë, mund të perceptohet si një **tërësi artistike**, e përbërë nga elemente të ndryshme. Tërësia formohet nëpërmjet procesit krijues dhe përfaqëson një njësi të vetme të bashkuar me të cilën ndërlidhen edhe përshkrimet dhe përkufizimet e secilit prej elementeve të saj. (Një vepër arti nuk duhet të shihet si “shuma në total e pjesëve të saj”.) Një prej synimeve të vëzhgimit dhe vlerësimit kritik historik është dhe përcaktimi i tërësisë së burimit dhe vlerësimi i unitetit potencial të tij.

Një zonë historike e cila është krijuar nga rritja apo zhvillimi i përshkallëzuar, qoftë vendbanim apo peizazh kulturor, mund të përkufizohet në bazë të **integritetit të saj historik**. Në vija të përgjithshme, integriteti i referohet tërësisë materiale dhe gjendjes së qëndrueshme të objektit apo sitit; ndërsa ‘integriteti historik’ ka të bëjë

me formën aktuale të burimit të trashëgimisë që është krijuar si rezultat i zhvillimit dhe ndryshimeve gjatë rrjedhës së kohës. Identifikimi i këtij integritetit historik mund të jetë gjithashtu i rëndësishëm edhe për përkufizimin e siteve arkeologjike. Cilësitë thelbësore të një burimi të trashëgimisë u referohen **cilësisë** së projektimit të tij, materialeve, drejtimit të punës, vendndodhjes dhe marrëdhënies me të.

Me kalimin e kohës, burimi origjinal i trashëgimisë mund të dëmtohet pjesërisht, të modifikohet qëllimisht apo edhe të shkatërrohet, duke shkaktuar kështu pakësimin apo edhe humbjen e plotë të mundësive për të ruajtur unitetin potencial. Nga ana tjetër, në periudha të ndryshme historike, burimi historik mund të bëhet pjesë e një tërësie të re, nëpërmjet së cilës ripërkufizohet si pjesë e një njësie të re të mundshme. Këto transformime janë pjesë e shtresëzimit historik. Trajtimet që kanë për qëllim restaurimin e një burimi të trashëgimisë duhet t'i referohen këtij uniteti potencial të ri dhe duhet të kryhen brenda kornizave të përcaktuara prej tij.

Zonat historike dhe rrethina e tyre kanë nevojë për studime dhe vlerësime specifike, pasi monumentet individuale dhe ndërtesat historike janë pjesë e një ansambli më të gjerë të burimit të trashëgimisë. *Rekomandimi i UNESCO-s për Mbrojtjen dhe Rolin Bashkëkohor të Zonave Historike*, i formuluar në Nairobi në vitin 1976, shpreh udhëzimin në vijim (Parimet e Përgjithshme, II,2):

Secila zonë historike dhe rrethinat e saj duhet të vlerësohen në tërësinë e tyre si një njësi koherente, ekuilibri dhe natyra specifike e së cilës varet nga bashkëshkrirja e pjesëve përbërëse, të cilat përfshijnë aktivitetet njerëzore po aq sa edhe ndërtesat, organizimin hapësinor dhe rrethinat. Për rrjedhojë, të gjitha elementet e vlefshme, duke përfshirë aktivitetet njerëzore sado modeste qofshin ato, kanë rëndësinë e tyre në lidhje me tërësinë, dhe kjo gjë nuk duhet shpërfillur.

Për këtë arsye, tërësia e zonave historike nuk duhet të vlerësohet vetëm në lidhje me kuadrin arkitektonik, pa përfshirë edhe vlerat njerëzore që ndërlidhen me kontekstin e saj ekonomik dhe social. Një çështje tjetër e rëndësishme lidhet edhe me parqet dhe peizazhet historike. Gjatë rrjedhës historike, në shumë vende projektimi i kopshteve ka qenë i lidhur ngushtë me arkitekturën (p.sh.: Kina, Anglia, Franca, Irani, Italia dhe Japonia). Gjatë përkufizimit të sitit është e rëndësishme që t'i kushtohet mjaftueshëm vëmendje këtyre tipareve, të cilat kanë nevojë për hulumtime të përshtatshme arkeologjike dhe njohuri rreth historisë dhe parimeve të projektimit të kopshteve, në mënyrë që gjatë procesit të rehabilitimit të mos humbasin këto tipare të rëndësishme, që shpesh janë edhe të brishta. Në vitet e

fundit, një vëmendje e madhe në nivel ndërkombëtar u është kushtuar parqeve dhe kopshteve historike, si dhe dokumentimit të tyre. Në lidhje me këtë çështje janë zhvilluar udhëzues për mirëmbajtjen, konservimin dhe restaurimin e tyre.⁶

Posaçërisht, që prej vitit 1980, me rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e marrëdhënies dhe ndërvërsisë mes ambientit të ndërtuar dhe atij natyror, çështja e mbrojtjes së peizazheve kulturore është bërë shumë e rëndësishme për shumë vende të botës – si në vende të industrializuara ashtu edhe në ato vende që po kalojnë një zhvillim të hovshëm (ku zhvillimi modern shpesh i shpërfill vlerat e kontekstit ekzistues ekologjik, apo edhe traditën kulturore dhe nevojën për t'i mirëmbajtur burimet ekzistuese). Çështja e përkufizimit të kriterëve për emërimin e peizazheve kulturore për në Listën e Trashëgimisë Botërore vazhdon të analizohet, por pavarësisht nëse zbatohen apo jo këto kriterë, ekziston një nevojë urgjente për një përkujdesje kushtuar jo vetëm monumenteve specifike apo grupeve të ndërtesave, **por edhe sigurimit të mjeteve të mjaftueshme të planifikimit për kontrollin dhe zhvillimin e ekuilibruar të kontekstit të tyre më të gjerë.**

3.3.4 Etapat historike⁷

Marrëdhënia e një burimi të trashëgimisë – siç është një vepër arti, një ndërtesë historike, apo një qytet historik – me kohën dhe historinë mund të ndahet në tri etapa:

- Etapa e parë, e cila rezultoi me **krijimin** e objektit;
- Etapa e dytë, që shtrihet nga fundi i etapës së krijimit e deri në kohën e sotme; dhe
- Etapa e tretë, e cila lidhet me perceptimin e monumentit në vetëdijen tonë në **të tashmen.**

Kjo rrjedhë e etapave formon **rrjedhën kohore historike** të burimit. Rrjedha kohore historike është e pakthyeshme. Ajo është produkt i kushteve specifike kulturore, sociale, ekonomike dhe politike të etapave të cilat kontribuuan në krijimin dhe zhvillimin e burimit të trashëgimisë. Kjo lidhje mes etapave specifike historike është thelbësore gjatë vlerësimit të një burimi historik. Alois Riegl, historian i artit dhe konservues me origjinë austriake, zhvilloi konceptin e *Kunstwollen*⁸ në vitin 1903, për të shprehur faktin se një objekt i krijuar në cilëndo periudhë reflekton njëkohësisht edhe prirjet artistike të periudhës edhe kontributin që iu është dhënë

6 Komiteti Ndërkombëtar i ICOMOS-it për Kopshte Historike mund të konsultohet për të gjetur informacione për rrjetin e ekspertëve në konservimin e kopshteve historike.

7 Kjo korrespondon me *tempo storico* në shkrimet e Brandi-t

8 Shih Riegl, 1903, dhe Holly, 1984, në bibliografi

këtyre prirjeve. Një burim i trashëgimisë i cili sot rindërtohet në mënyrë rrënjësore, do të ishte një produkt i së tashmes.

- *Meqenëse një burim i trashëgimisë është **unik** në raport me rrjedhën historike, ai nuk është i **ripërtërishëm**.*

3.3.5 Çfarë është autenticiteti?

Autenticiteti është një aspekt kyç i vlerësimit të burimeve të trashëgimisë. Në terma të përgjithshme, burimi i trashëgimisë është autentik kur materiali me të cilin është ndërtuar është *original* apo *i mirëfilltë*, dhe i vjetruar nga koha.⁹ Në lidhje me një monument apo sit historik që konsiderohet si vepër arti, të qenit ‘autentik’ mund të kuptohet në raport me procesin krijues që e prodhoi atë si një produkt original të kohës së tij, dhe përfshin edhe efektet e kalimit të tij nëpër rrjedhën e historisë. (Të qenit ‘autentik’ nuk duhet të ngatërrohet me të qenit ‘identik’; p.sh.: rindërtimi modern mund të jetë identik me formën historike, por nuk është autentik.) *Dokumenti i Nara-s mbi Autenticitetin*, i vitit 1994, thekson nevojën që burimet e informacionit për vlerësimin e autenticitetit të jenë të besueshme dhe të vërteta, si dhe nënvizon se larmia e kulturave dhe trashëgimisë mund të kuptohet si një burim i pazëvendësueshëm i pasurisë shpirtërore dhe intelektuale për tërë njerëzimin.

Autenticiteti rrjedh nga përkufizimi i burimit. Kështu që, autenticiteti mund të kuptohet në mënyra të ndryshme në varësi të kontekstit dhe rëndësisë së tij historike.

- *Në rastin e burimit të trashëgimisë, autenticiteti i tij historik duhet që në përgjithësi të reflektojë etapat e rëndësishme të ndërtimit dhe shfrytëzimit përgjatë rrjedhës historike të tij.*

Autenticiteti mund të rrezikohet me prishjen e shtresave historike, zëvendësimin e elementeve origjinale me elemente moderne (sidomos nëse kjo bazohet në supozime) dhe shtimin e elementeve të reja. Një burim trashëgimie që e ka kaluar **provën e autenticitetit**, e ruan integritetin e tij origjinal, ashtu siç është krijuar apo siç ka evoluar gjatë rrjedhës historike. Meqenëse aspekte të ndryshme të burimit të trashëgimisë duhet të analizohen për të përcaktuar shkallën e autenticitetit, është e rëndësishme që të merret një vendim gjithëpërfshirës – d.m.th. nuk mjafton të merret parasysh vetëm njëri prej aspekteve. Sipas *Udhëzuesit për Mënyrën e*

⁹ Fjala *autentik* mund të kuptohet edhe si *original*, *i dorës së parë* (në krahasim me kopjen), apo si *i vërtetë, aktual*, *i mirëfilltë* (në krahasim me të shtrurur), sipas *Fjalorit të shkurtuar të anglishtes së Oxford-it*

Funksionimit, duhet të merren parasysh katër aspekte të autenticitetit:

- autenticiteti i projektimit (“*design*”)
- autenticiteti i materialeve
- autenticiteti i punës së aplikuar, apo
- autenticiteti i mjedisit.

Për t’u emëruar në Listën e Trashëgimisë Botërore, burimi i trashëgimisë duhet të ketë një integritet të paprekur në raport me këto katër aspekte të autenticitetit. Nëse, për shembull, burimi origjinal është shkatërruar, kopja e tij nuk do t’i përmbushte kriteret pasi do të humbiste autenticiteti i materialit. Autenticiteti i materialeve është një kriter parësor në përcaktimin e autenticitetit të projektimit dhe punës, të cilat së bashku me autenticitetin e kontekstit përkufizojnë burimin e trashëgimisë kulturore. Nga ana tjetër, dhe në të njëjtën kohë, shumica e burimeve historike ndryshojnë për shkak të përdorimit të tyre dhe si pasojë ndikimeve të ushtruara nga forcat natyrore. Këto ndryshime janë pjesë e **shtresëzimit historik** të burimit.

Për më tepër, duhet shqyrtuar urgjentisht edhe koncepti i *Autenticitetit në kontekstin social dhe ekonomik*.

3.4 CILAT VLERA NDIKOJNË TE NDËRHJRJET?

Janë të shumta vlerat që mund të lidhen me burimin e trashëgimisë. Ato që do të konsiderohen si të rëndësishme do të përbëjnë edhe argumentet për mbrojtjen dhe konservimin e tij. Këto vlera përfshijnë një spektër të gjerë që nga ato historike e deri tek ato tregtare. Një burim i vetëm mund të ketë vlera që kundërshtojnë njëra-tjetrën, gjë që i bën vendimet e menaxhimit veçanërisht të vështira. Për më tepër, gjykimi mbi vlerat mund të ndryshojë me kalimin e kohës.¹⁰

¹⁰ Që në shkrimet e tij të vitit 1903, Riegl filloi të analizonte në detaj vlerat e ndryshme të cilat lidheshin me monumentet historike në fillim të shekullit të XX. (Shiko bibliografinë)

Kur kemi të bëjmë me vende të Trashëgimisë Botërore, duhen marrë parasysh që të dyja:

- vlerat kulturore; dhe
- vlerat bashkëkohore, sociale dhe ekonomike.

Prezenca apo mungesa e këtyre vlerave do të çojë drejt ruajtjes dhe mbrojtjes së burimeve të trashëgimisë kulturore, dhe në raste të tjera mund të çojë deri te braktisja dhe shkatërrimi i tyre. Për shembull, vlerat nacionaliste, apo politike, mund të përbëjnë një motiv për mbrojtjen dhe restaurimin e ndonjë burimi, por po këto vlera mund të shkaktojnë edhe humbjen e atij burimi që nuk bën pjesë në konceptin mbizotërues politik mbi çka është e rëndësishme.

3.4.1 Vlerat kulturore

Vlerat kulturore që lidhen me burimet e trashëgimisë, si dhe raporti i tyre me vëzhguesit e sotëm, janë detyrimisht subjektive (d.m.th. ato varen nga interpretimet që reflektojnë kohën në të cilën jetojmë). Këto vlerësime do të përcaktojnë shkallën e interesit të përgjithshëm për objektin në fjalë dhe mjedisin e tij rrethues, interpretimin e karakterit të tij thelbësor kulturor, si dhe zhvillimin e politikave të trajtimit. Njohja e **rëndësisë së jashtëzakonshme universale** në sitet e Trashëgimisë Botërore dhe trajtimi i përshtatshëm për to duhet të përcaktohet në bazë të këtyre vlerësimeve, duke respektuar përmbajtjen historike dhe potencialin arkeologjik.

Grupimet e paraqitura më poshtë kanë për qëllim që të ndihmojnë në identifikimin e llojeve të ndryshme të vlerave që diskutohen shpesh, si dhe të ndihmojnë në kuptimin e raportit të tyre me burimin kulturor, vendin dhe kontekstin e tij. Çështja e trajtimit të përshtatshëm diskutohet më tej në Kapitullin 8, *Trajtimet dhe autenticiteti*.

Vlerat kulturore mund të klasifikohen në mënyra të ndryshme.

Vlera e identitetit (bazuar në njohjen përmes argumenteve)

Vlerat: Ky grupim vlerash identifikohet nëpërmjet lidhjeve emocionale të shoqërisë për një objekt apo vend të caktuar. Grupimi mund të përfshijë këto veçori: vjetërsinë, traditën, vazhdimësinë, përkujtimorësinë, vlerën legjendare; mahnitjen, ndjenjën shpirtërore, fetare; si dhe simbolike, politike, patriotike dhe nacionaliste.

Ndikimi: Ky grupim vlerash ka një ndikim të madh në mbrojtjen, konservimin dhe restaurimin e burimit, pasi ky grupim shpesh krijohet nga perceptime emocionale. Këto vlera mund ta përmirësojnë trajtimin që i bëhet burimit, por nga ana tjetër ato gjithashtu mund të çojnë deri në ndërhyrje restauruese të tepërta. Në të njëjtën kohë, mungesa e këtij identiteti mund të përbëjë shkak për moskujdesje dhe shkatërrim. Këto vlera mund të theksohen dhe nxirren në pah nëpërmjet edukimit, seminareve, kurseve të formimit profesional, etj.

Vlera relative artistike ose teknike (bazuar mbi hulumtimin):

Vlerat: Ky grupim vlerash bazohet mbi vlerësime shkencore dhe kritike historike për rëndësinë e projektimit të burimit të trashëgimisë, si dhe rëndësinë e konceptimit teknik, strukturor, funksional dhe konceptimit të punës së përdorur.

Ndikimi: Këto vlera janë rezultat i hulumtime të kryera nga profesionistë. Ato kanë për qëllim paraqitjen e rëndësisë relative të burimit në raport me kohën kur është krijuar, periudhat e tjera dhe të tashmen. Këto vlera krijojnë një bazë të mirë që mund të përdoret për klasifikimin, listimin dhe hartimin e strategjisë së trajtimit përkatës.

Vlera e rrallësisë (bazuar në statistika):

Vlerat: Ky grupim vlerash ndërlihd burimin me ndërtime të tjera të njëjta sipas tipit, stilit, ndërtuesit, periudhës, rajonit, apo qoftë edhe të ndonjë kombinimi të këtyre kategorive. Ato përcaktojnë rrallësinë e burimit, përfaqësueshmërinë dhe të qenit unik.

Ndikimi: Ky grupim vlerash lidhet me dy grupet e para të vlerave dhe ndikon në nivelin e mbrojtjes që caktohet për burimin. Vlera e rrallësisë së lartë mund ta përforcojë rëndësinë e cilësive që kanë vlerë të jashtëzakonshme universale, duke rritur kështu mundësinë për ta emëruar sitin në Listën e Trashëgimisë Botërore.

3.4.2 Vlerat bashkëkohore sociale dhe ekonomike

Vlerat e përdorimit lidhen me shoqërinë e sotme dhe infrastrukturën e saj sociale, ekonomike dhe politike. Kategoritë e identifikuara janë si në vijim:

Vlera ekonomike:

Vlerat: Meqenëse ekonomia inkurajon shpërndarjen e burimeve për të plotësuar një spektër sa më të gjerë nevojash, vlera ekonomike nuk kufizohet domosdoshmërisht vetëm në vlerën financiare. Për sa i përket trashëgimisë kulturore, vlera ekonomike mund të kuptohet si vlerë e cila prodhohet nga vetë burimi i trashëgimisë apo nga punimet e konservimit.

Ndikimi: Vlerat ekonomike kanë katër burime të mundshme të ardhurash: turizmin, tregtinë, përdorimin dhe shërbimet për argëtim gjatë kohës së lirë. Keqmenaxhimi i cilitdo prej këtyre burimeve mund të sjellë zhvillime të padëshiruara; dhe kjo ndodh shpesh kur vlera e fitimeve matet gabimisht në vend që të përlllogaritet nëpërmjet një qasjeje më të përshtatshme që merr parasysh kostot dhe përfitimet kolektive.

Vlera funksionale:

Vlerat: Vlera funksionale lidhet me vlerën ekonomike, pasi ajo përfshin vazhdimësinë e funksionit origjinal apo fillimin e një funksioni të ri që përshtatet me ndërtesën apo zonën historike. Vlera origjinale funksionale humbet në strukturat e shkatërruara, por vlera e re gjendet në përmbushjen e kritereve programatike që kërkohen për interpretimin e burimit, apo qoftë edhe kur ai përdoret si një hapësirë për aktivitete artistike pamore ose teatrale.

Ndikimi: Vazhdimësia e funksioneve tradicionale përforcon kuptimin e siteve në mënyrën më të mirë të mundshme, dhe nuk mund të krahasohet me asnjë lloj ekspozite. Përdorimi apo shfrytëzimi i përshtatshëm favorizon konservimin; ndërkohë që shfrytëzimi i papërshtatshëm, apo përshtatja e pamenduar mirë, mund të shkaktojë degradim, ndryshime të padëshiruara, ose shembje.

Vlera edukative:

Vlerat: Vlera edukative e burimit të trashëgimisë përfshin potencialin e tij për të zhvilluar turizmin kulturor, si dhe ndërgjegjësimin mbi kulturën dhe historinë që ky burim përfaqëson si një mënyrë për të integruar burimet historike me jetën e ditëve të sotme.

Ndikimi: Integrimi i përshtatshëm i siteve të Trashëgimisë Botërore në programet edukative dhe arsimore është një element thelbësor. Sidoqoftë, përqendrimi te turizmi mund të çojë drejt rindërtimeve të pajustificueshme, apo drejt shkatërrimit të materialit origjinal, duke shkaktuar humbje të dëshmimeve të pakthyeshme arkeologjike.

Vlera shoqërore:

Vlerat: Vlera shoqërore e burimit të trashëgimisë lidhet me aktivitetet tradicionale shoqërore dhe përdorimin e përshtatshëm të burimit në kohët e sotme. Kjo, përfshin ndërveprimin shoqëror bashkëkohor në komunitet, dhe luan rolin e saj në vendosjen e identitetit shoqëror dhe kulturor.

Ndikimi: Vlera shoqërore mund të krijojë interesimin e duhur të komunitetit vendor, duke e shtyrë këtë të fundit ta mirëmbajë dhe riparojë materialin e burimit të trashëgimisë. Nga ana tjetër, mungesa e kësaj koherence dhe e këtij vlerësimi shoqëror mund të krijojë pengesa për konservimin. Ky interesim në nivel vendor ka qenë forca shtyese e lëvizjeve sociale ambientaliste.

Vlera politike:

Vlerat: Vlera politike shpesh lidhet me ngjarje specifike në historinë e burimit të trashëgimisë në raport me rajonin, ose shtetin. Këto ngjarje mund të kenë një ndikim tek rëndësia e sotme e burimit kur ato përputhen me prioritetet e objektivave politik bashkëkohor.

Ndikimi: Rëndësia politike e monumentit apo sitit mund të ndihmojë në ngritjen e fondeve, ose tërheqjen e vëmendjes së opinionit të gjerë publik për ruajtjen dhe mbrojtjen e burimit të trashëgimisë. Nga ana tjetër, veprimet e pamenduara mund të çojnë drejt një zhvillimi të padëshiruar, ose drejt shkatërrimit të autenticitetit.

Grupimi i lartpërmendur duhet të shikohet si një sugjerim. Ky grupim mund të krahasohet me vlerat e tjera të njohura përmes vlerësimeve të kryera në nivel kombëtar apo vendor mbi burimet e trashëgimisë. Ky grupim vlerash mund të shërbejë gjithashtu edhe si një kornizë e dobishme që mund të merret si referencë për të kryer një proces vlerësimi sa më të detajuar.

Shumë nga këto vlera – posaçërisht ato bashkëkohore sociale dhe ekonomike

– mund të kenë një ndikim qoftë pozitiv qoftë negativ për burimin kulturor, në varësi të llojit të vlerës dhe rëndësisë që i është dhënë secilës vlerë gjatë vlerësimit të përgjithshëm. Prandaj, formulimi i një deklarate të qartë është diçka tejet thelbësore për vlerat për të cilat një burim i trashëgimisë kulturore është emëruar në Listën e Trashëgimisë Botërore. Vetë ICOMOS-i u referohet këtyre vlerave specifike dhe çështjes së autenticitetit të vendndodhjes në dokumentin vlerësues të përgatitur për Komitetin e Trashëgimisë Botërore gjatë kohës së emërimit. Ky dokument duhet të jetë gjithnjë në dispozicion të menaxherëve konservues të sitit, në mënyrë që të shërbejë si një dokument referues.

Nëse vlerat për të cilat siti emërohet kanë humbur ose rrezikohen, dhe në veçanti ‘vlerat e tij’ të jashtëzakonshme universale, atëherë mund të propozohet që ky sit të vendoset në Listën e Trashëgimisë Botërore në Rrezik. Ky veprim nënkupton gjithashtu edhe dorëzimin e kërkesës për ndihmë teknike pranë Komitetit të Trashëgimisë Botërore, në mënyrë që të përkrahen përpjekjet e autoriteteve vendore lidhur me menaxhimin dhe ndërhyrjet e nevojshme.

Kapitulli 4

MENAXHIMI I SITEVE TË TRASHËGIMISË BOTËRORE

4.1 HYRJE

- *Planifikimi, programimi dhe buxhetimi janë procese të vazhdueshme që duhet të rishikohen dhe përditësohen në intervale të rregullta kohore.*

Procesi i planifikimit duhet të jetë një aktivitet shumëdisiplinor i cili realizohet me kontributin e ekspertëve në ato fusha që kanë lidhje me rëndësinë e sitit. Kjo do të thotë se vlerat e sitit duhet të listohen, dhe mundësisht të renditen sipas përparësisë së tyre.

Procesi i planifikimit krijon kontradikta të pashmangshme të cilat duhen zgjidhur paraprakisht, duke kryer ekzaminimin e çdo alternative të mundshme. Më pas, duhet zgjedhur ajo alternativë e cila e dëmton më pak rëndësinë e sitit të trashëgimisë. Gjatë diskutimeve të hapura mes ekspertëve mund të lindin ide mbi disa zgjidhje të reja që mund ta rrisin nivelin e rëndësisë së sitit, apo qoftë edhe të mesazheve që ai përcjell, por duhet patur parasysh se ky proces kërkon një angazhim kohor të caktuar.

- *Rishikimet në intervale të rregullta kohore, mund të përmirësojnë gabimet dhe t'i përpunojnë konceptet, nëse procesi i planifikimit bazohet mbi parime shkencore dhe logjike.*

Planifikimi duhet të jetë i bazuar mbi supozime të cilat janë të shprehura shumë qartë. Me kalimin e kohës, ndodh që supozimet fillestare të ndryshojnë. Disa supozime frymëzohen nga vetë kultura, të tjera mund të bazohen mbi prirje politike ose të modës së kohës. Të gjitha supozimet duhet të analizohen. Plani afatgjatë (deri në 30 vjet) i menaxhimit duhet të integrojë të gjitha informacionet e dokumentacionit dhe planeve të veprimit. Gjithashtu, duhen hartuar edhe planet afatmesme (le të themi, 5 vjeçare) dhe vjetore të projektit.

4.2 MENAXHIMI

4.2.1 Objektivat e menaxhimit

Shteti Anëtar mund të dëshirojë t'i realizojë objektivat e planifikimit dhe menaxhimit të koordinuar dhe të integruar të sitit të Trashëgimisë Botërore përmes mjeteve të ndryshme, dhe për këtë arsye mund t'i nevojitet të marrë në konsideratë pikat në vijim:

- Nëse Shteti Anëtar ka më shumë se një sit të Trashëgimisë Botërore, a duhet që këto site të menaxhohen në mënyrë individuale apo kolektive?
- Nëse menaxhohen në mënyrë kolektive, a do t'i kushtohet vëmendja e duhur secilit prej siteve?
- Qytetet, apo fshatrat historike, që bëjnë pjesë në Listën e Trashëgimisë Botërore, mund të menaxhohen në mënyrë individuale. Megjithatë duhet kuptuar marrëdhënia e tyre në raport me territorin e tyre, duke pasur parasysh që mund të kenë nevojë për hapësira më të mëdha rrethuese për t'u mbrojtur dhe ruajtur.
- Nëse Shteti Anëtar ka një këshill kombëtar për konservimin e trashëgimisë, a duhet që shteti t'i delegojë këtij këshilli edhe detyra për menaxhimin e siteve të Trashëgimisë Botërore? Nëse po, a duhet të shqyrtohet edhe mundësia e krijimit të njësiteve të menaxhimit?

Ka disa mënyra efikase për të mobilizuar profesionistët, artizanët dhe akademikët për të përdorur aftësitë e tyre artistike, artizanale dhe njohuritë mbi historinë. Këtyre njerëzve mund t'u jepen detyra dhe përgjegjësi që sigurojnë mbrojtjen e burimeve kulturore të sitit, si dhe kalimin e këtyre burimeve si të padëmtuara tek brezi i ardhshëm. Ky *Udhëzues për Menaxhimin* ka për qëllim ta ndihmojë një Komision të tillë në zbatimin e detyrave të ndërlikuara që kanë lidhje me konservimin e sitit të Trashëgimisë Botërore.

4.2.2 Të dhënat mbi të cilat bazohet plani i menaxhimit

Plani i Përgjithshëm i Menaxhimit duhet të marrë parasysh planet kombëtare dhe vendore, aty ku është e nevojshme, dhe njëkohësisht duhet edhe të parashikojë ndryshimet demografike, faktorët ekonomikë, si dhe projektimet e lidhura me trafikun e automjeteve dhe zonat industriale. Për më shumë, ky plan duhet të bazohet në inspektime dhe raporte të hartuara nga ekipe ekspertësh të fushave të ndryshme.

Një prej veprimeve kryesore që duhet ndërmarrë është sigurimi i regjistrimeve dhe dokumentimeve sistematike para, gjatë dhe pas çdo ndërhyrjeje. Nëse procesi i dokumentimit nuk është i rregullt, ajo që pas ndërhyrjes mund të jetë hequr apo ndryshuar do të jetë e humbur përgjithnjë. **Regjistrimi dhe dokumentimi janë aktivitete të vazhdueshme gjatë gjithë procesit të konservimit.**

Në përgjithësi, duhet ruajtur funksioni historik i sitit, pasi ky është dhe aspekti që i jep sitit rëndësinë e tij. Por, asgjë nuk është e përhershme, kështu që ndryshimet janë të pashmangshme. Mjeshtëria e planifikimit qëndron në orientimin e ndryshimeve në atë drejtim që bën të mundur rritjen e rëndësisë së sitit, me ndërhyrje sa më të vogla në pikat kyçe. Kjo gjë sjell në mendje dy pyetje:

- Si gjenden pikat kyçe?
- Cilat janë ndërhyrjet minimale?

Këto pyetje duhet të merren në konsideratë nga ekipi planifikues. Për më tepër, për planin e përgjithshëm të menaxhimit duhet të merren parasysh edhe aspekte të tjera, si p.sh.:

- analiza e planeve për përdorime alternative dhe zbatimin e tyre, duke kryer edhe vlerësimin e zbatueshmërisë dhe kostos së tyre;
- aty ku është e nevojshme, duhen përcaktuar zonat e përdorimit;
- kontrolli i lartësisë, madhësisë dhe proporcionit të ndërtesave të reja plotësuese në qytetet ose zonat historike;
- përcaktimi i zonave të konservimit, duke e shoqëruar këtë proces me subvencione që nxisin mirëmbajtjen dhe përmirësimet e duhura, veçanërisht kur bëhet fjalë për pamjen e rrugëve;
- kontrolli i kabllove elektrikë, i telave të tjerë, si dhe i tabelave, vitrinave dhe reklamave të dyqaneve;
- vendosja e zonave për zhvillimin e aktiviteteve të përshtatshme, nga të cilat do të përfitonin të gjithë përdoruesit e sitit të trashëgimisë, përveç atyre aktiviteteve që nuk janë të përshtatshme – për të cilat nuk jepet leje.

4.2.3 Inventari dhe dokumentimi

- *Duhet të përgatitet inventari dhe dokumentimi i plotë i ndërtesave dhe përmbajtjeve të tyre, si dhe i pamjes së jashtme të sitit.*

Ky inventar duhet të paraqesë një përshkrim të shkurtër të burimit, datat e rëndësishme historike dhe vendin ku ndodhet. Kjo strukturë informacioni mund të plotësohet me referenca. Meqenëse ka shumë metoda të ndryshme për të kryer inventarizimin, duhet vënë në përdorim ajo metodë që është sa më në harmoni me

procedurat ekzistuese të Shtetit Anëtar.¹¹

Inventari dhe dokumentimi i përshtatshëm janë një mjet i pazëvendësueshëm në rastin e fatkeqësive si zjarri, përmbytjet, apo vjedhja. Për arsye sigurie duhen ruajtur të paktën dy kopje të këtij dokumentacioni në dy vende të ndryshme, dhe njëra nga kopjet duhet të mbahet në një vend të mbrojtur nga zjarri. Për të siguruar objektet e lëvizshme të inventarit, ato duhet të klasifikohen si në vijim:

- i pazëvendësueshëm,
- i zëvendësueshëm
- i riprodhueshëm.

Për më shumë, inventari mund të katalogohet duke përdorur një sistem të kompjuterizuar. Zhvillimi i teknologjisë moderne ka bërë të mundur që të sigurohen pajisjet dhe programet e kompjuterizuara me çmime shumë të leverdishme. Mund të thuhet, madje, se kompjuteri është bërë një mjet i domosdoshëm për menaxhimin e sofistikuar të siteve të Trashëgimisë Botërore, dhe ai mund të përdoret edhe në vendet në zhvillim. Sistemi i kompjuterizuar i vendos punonjësit e siteve para përgjegjësisë për t'u përgjigjur sa më shpejt dhe në mënyrë sa më pozitive.

Brezat e rinj të kompjuterëve personalë bëjnë të mundur që çdo sit i madh të ketë kompjuterin e tij. Duhet punësuar një teknik i aftë dhe me përvojë për vendosjen e kompjuterëve për dokumentimin e trashëgimisë kulturore, si dhe për të ndihmuar në përgatitjen e një fjalorthi të posaçëm. Për më tepër, tekniku do të duhej të kryente edhe stërvitjen e punonjësve në përgatitjen e materialit.

Duhet theksuar se kompjuteri e kryen punën në bazë të të dhënave që hidhen në të. Nëse grumbullimi i të dhënave në terren është kryer ashtu siç duhet, atëherë kompjuteri kthehet në një vegël shumë të rëndësishme për menaxhim, duke qenë se ai mund t'i përpunojë të dhënat bazë në mënyra nga më të ndryshmet. Kjo do të thotë, gjithashtu, se i tërë personeli i përfshirë do të përdorë të njëjtin informacion, i cili mund të përditësohet, rishikohet, apo zgjerohet me një komandë të vetme.

Sidoqoftë, duhet nënvizuar çështja e ruajtjes së të dhënave në kompjuter në përputhshmëri me standardet e pranuar ndërkombëtare, në mënyrë që të dhënat të ndahen lehtë apo të transferohen lehtësisht në sistemet e ardhshme kompjuterike. Brenda këtij konteksti, duhet të theksohet dhe të bëhet e qartë nevoja për udhëzues të thjeshtë të funksionimit për përdoruesit – në gjuhën e tyre – si dhe duhet shpjeguar qartë niveli minimal i të dhënave të nevojshme.

¹¹ Parimet e Regjistrimit dhe Dokumentimit të hartuara nga ICOMOS-i në vitin 1996, të cilat janë të paraqitura tek Shtojca F, paraqesin disa koncepte të dobishme mbi këtë temë.

Duke parë nga e ardhmja, të dhënat që grumbullohen sot duhet të ruhen në grupime sa më të ndara në mënyrë që të mundësohet përdorimi sa më i lehtë dhe në mënyrë sa më elastike i këtyre të dhënave në të ardhmen.

Për ato site të cilat mbulojnë sipërfaqe të mëdha, apo qoftë edhe për ato që bartin elemente të ndërlikuara urbane, duhet të merret në konsideratë mundësia e përdorimit të Sistemit të Informacioneve Gjeografike (GIS), në mënyrë që të dhënat të menaxhohen në mënyrë sa më efikase.

Pavarësisht kësaj, është e rëndësishme që përparësia t'i jepet fillimisht konservimit dhe mbrojtjes së ndërtesave të rrezikuara dhe jo blerjes së pajisjeve.

Çështja e menaxhimit të dokumentacionit dhe informacioneve të burimeve kulturore është një çështje thelbësore në procesin e konservimit. Para fillimit të punimeve duhet përgatitur plani i punës, i cili përkufizon qartë burimin dhe kontekstin e tij, si dhe objektivat dhe shtrirjen e dokumentimit, nivelet e rekomanduara të dokumentimit, teknologjia ekzistuese, apo ajo që do të vihet në dispozicion, afati kohor, si dhe kërkesat për organizimin dhe zbatimin e projektit.

□ *Burimet e trashëgimisë duhet të dokumentohen sistematikisht duke përdorur fotografitë dhe metoda të tjera të përshtatshme.*

Fotografitë satelitore, fotografitë ajrore, si dhe fotogrametria ajrore e tokësore japin një ndihmë të madhe në krijimin e një inventari sa më të plotë qoftë për shtet natyrore, qoftë për ato që janë krijuar nga njeriu. Sidoqoftë, teknologjia e përdorur për dokumentimin do të varet nga tipi dhe karakteri i burimit, si dhe nga objektivat dhe përdorimi i këtyre dokumentimeve. Për dokumentimin mund të merren parasysh teknika të ndryshme. Këto teknika, sipas rastit, mund të jenë qoftë të pavarura, qoftë në kombinim me njëra-tjetrën. Nga njëra anë, teknikat mund të përfshijnë dokumentimin me dorë të lirë, fotografi, si dhe fotografi të korrigjuara apo video-regjistrime të përpunuara. Nga ana tjetër, mund të përdoren gjithashtu teodolite elektronike ose stereo-fotogrametri, të skicuara me kompjuter (duke përdorur “CAD”), ose me përpunim imazhesh. Nivelet e rekomanduara të dokumentimit mund të përfshijnë një dokumentim fillestar, paraprak apo të detajuar, i cili mund të jetë i pjesshëm (për nevojat e funksionimit të përditshëm) ose i plotë (për t'u përdorur si referencë në të ardhmen).

4.2.4 Menaxhimi i informacionit

Duke marrë parasysh sasinë e informacionit që nevojitet dhe prodhohet për secilin sit, është e nevojshme që të hartohet një **politikë e qartë për menaxhimin e informacionit të trashëgimisë**. Kjo gjë është e domosdoshme edhe për standardizimin e procedurave. Ky standardizim garanton që forma në të cilën është ruajtur informacioni përshtatet me atë të burimeve të tjera, dhe si rrjedhojë informacioni mund të shkëmbehet në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar. Ky aspekt duhet theksuar edhe më shumë, dhe i duhet kushtuar më tepër vëmendje kur bëhet fjalë për site të Trashëgimisë Botërore.

- *Deri më tani, shumica e bazave të të dhënave të trashëgimisë janë krijuar në mënyrë të izoluar, shpesh pa u këshilluar apo pa pasur lidhje jashtë grupit të ngushtë, duke harxhuar kështu shumë energji në këtë drejtim. Për këtë arsye, do të ishte e nevojshme që të fillonte një proces unifikimi i standardeve që ndihmon në marrjen e këtyre të dhënave dhe interpretimin e tyre. Një nismë e tillë do të ndihmonte procesin e përgatitjes së të dhënave, dhe do të lehtësonte përcaktimin e qartë të shtrirjes së të dhënave, pa harruar ato çështje që janë thelbësore në këtë proces.*

Për të grumbulluar gjithë literaturën e botuar në lidhje me sitin e trashëgimisë mund të nevojitet shumë kohë, dhe ndoshta duhet të merren edhe fotografi apo kopje në mikrofilm të dokumenteve të cilat mbahen në vende të tjera. Në një situatë ideale, këto kopje duhet të **katalogohen**, mundësisht duke përdorur sistemin UNISIST, dhe të **abstragohen** me kujdes në mënyrë që informacionet thelbësore të bëjnë sa më të disponueshëm informacionin thelbësor përmes inventarizimit të kompjuterizuar. Dokumentet që kanë të bëjnë me politika dhe hulumtime duhet të ruhen së bashku me nga një kopje të secilit vendim dhe procesverbal të mbledhjeve që kanë çuar deri në momentin kur siti ka fituar statusin si pjesë e Trashëgimisë Botërore.

Prioriteti kryesor duhet të jetë që këto dokumente të menaxhohen në mënyrë të vazhdueshme, por njëkohësisht duhet inkurajuar edhe përdorimi i tyre për hulumtime nga studentë dhe individë të interesuar për këto dokumente. Për këtë arsye është shumë e rëndësishme që me këtë proces të merren bibliotekarë dhe arkivistë të kualifikuar, si dhe të vihen në dispozicion hapësira dhe kushtet e përshtatshme të ruajtjes së dokumentacionit. Të gjitha sendet duhet të ekzaminohen nga konservues me përvojë, si dhe të trajtohen nëse do të jetë e nevojshme, para se të vendosen në vendin ku do të ruhen/magazinohen.

- *I duhet dhënë përparësi mbrojtjes së dokumenteve qoftë nga zjarri, qoftë atëherë kur ekziston rreziku ndaj çdo lloj fatkeqësie natyrore. Rreziku duhet të vlerësohet me kujdes dhe duhen ndërmarrë masat e nevojshme parandaluese, siç është për shembull përkujdesja për ruajtjen sa më të sigurt të kopjeve të dyta në një vend tjetër të sigurt, jashtë vendndodhjes.*
- *Ekipi i menaxhimit duhet të vendosë një **kontroll të rregullt vjetor** të situatës, si dhe të kërkojë një raport nga personi përgjegjës për ruajtjen e dokumenteve. Individit përgjegjës për ruajtjen e dokumenteve mund të njihet si **punonjësi i reagimit ndaj fatkeqësive**, dhe ky vend pune duhet të ketë edhe një punonjës tjetër në rolin e mëkëmbësit.*

Për të përgatitur një **plan për mirëmbajtjen** e mirë-dokumentuar, një arkitekt i përgjithshëm duhet të koordinojë dhe vlerësojë punën e ekspertëve të ndryshëm; siç janë historianët e artit dhe inxhinierët. Në këtë mënyrë, arkitekti do të ketë mundësinë t'i vlerësojë problemet në kontekstin më të gjerë të tyre. Arkitekti i përgjithshëm duhet të ketë njohuri të mjaftueshme shkencore, teknike, artistike, historike dhe kulturore për të qenë në gjendje të vlerësojë kontributin e ekspertëve dhe specialistëve. Ekspertët duhet t'i **komunikojnë** idetë dhe mendimet e tyre me një fjalor të qartë dhe pa përdorur zhargone.

4.2.5 Planifikimi i punimeve kërkimore

- Cilat çështje kanë nevojë për hulumtime kërkimore?
- Si duhet të menaxhohen këto kërkime?

Këto pyetje të thjeshta nuk gjejnë përgjigje të thjeshta. Secili sit i Trashëgimisë Botërore përmban një spektër të gjerë elementesh të cilat meritojnë të hulumtohen – shumica prej tyre thjesht në një mënyrë të pastër akademike. Duhet të ruhen **lidhje të ngushta me universitetet** dhe organizatat e tjera që janë të interesuara në burimet kulturore. Grumbullimi i të gjithë dokumentacionit të vlefshëm për sitin është normalisht diçka thelbësore për këtë proces.

Sot universitetet inkurajojnë punimin e tezave mbi tema të cilat stimulojnë hulumtimin me vlera krijuese dhe origjinale. Ata studentë të cilët përmes punës së tyre kërkimore mund të kontribuojnë mbi zberthimin kuptimor të burimeve kulturore, ndonjë ditë mund të bëhen edhe anëtarë të rëndësishëm të komisionit të sitit.

Për t'u dhënë një përgjigje dy pyetjeve të thjeshta që u parashtruan në fillim të këtij seksioni, është e këshillueshme që të formohet **komiteti koordinues i punimeve**

kërkimore për sitin. Ky komitet, i cili përgjigjet para Komisionit të Sitit, mund të organizojë **programe afatgjata** që përfshijnë një sërë hulumtimesh, ose **programe afatshkurta** për individë të caktuar. Për më tepër, ky komitet mund të vendosë qëllimet, planet e punës dhe datat e vlerësimit të ecurisë së të gjitha projekteve kërkimore, si dhe të japë këshilla rreth dhënies së bursave dhe kontratave që lidhen me këto aktivitete.

4.2.6 Programi i përgjithshëm i punës

Hartimi, përzgjedhja dhe miratimi i planit të përgjithshëm të mirëmbajtjes nënkupton realizimin e këtyre fazave përgatitore:

- ✓ **Rëndësia** e sitit është e dokumentuar dhe i njihet vlera;
- ✓ **Qëllimi** i planit është i përcaktuar qartë;
- ✓ **Dëshmitë** dhe opinionet e ekspertëve të përshtatshëm janë marrë në konsideratë. Janë kryer inspektime dhe raportime;
- ✓ Mënyrat alternative të **veprimit** dhe efektet e tyre janë studiuar dhe dokumentuar.

Tani jemi të gatshëm të zgjedhim atë plan menaxhimi që është më pak i keq se të tjerët, dhe ta dorëzojmë për t'u miratuar.

- ✓ Plani duhet të fillojë me **deklaratën e qëllimit të menaxhimit**. Kjo deklaratë duhet të formulohet në një mënyrë që të jetë e kuptueshme nga të gjithë punonjësit.
- ✓ Duhet përcaktuar **niveli minimal i mirëmbajtjes së përshtatshme** që pajtohet me rëndësinë e burimit kulturor, nevojat e shfrytëzuesve dhe kushtëzimet klimatike vendore.
- ✓ Meqenëse **rregullorja e planifikimeve** e Shtetit Anëtar ndikon mbi gjithë sitin, duhet të përgatitet një përmbledhje e kësaj rregulloreje.
- ✓ Komisioni i Sitit duhet të marrë parasysh **planet dhe ligjet** e tjera që ndikojnë mbi sitin, si dhe t'i integrojë ato në skemat e përgjithshme të menaxhimit, mirëmbajtjes, zhvillimit dhe punës kërkimore.
- ✓ Plani i përgjithshëm i menaxhimit duhet të identifikojë **personelin** e nevojshëm për funksionimin dhe mirëmbajtjen e sitit, të përcaktojë detyrat e këtij personeli, dhe ndër të tjera të parashikojë skenarë për situata të ndryshme, aktivitete afatgjata dhe afatshkurta, si dhe në raport me buxhetin.
- ✓ Plani i menaxhimit duhet të përfshijë edhe propozimet për **zhvillimin** e ambienteve të ndryshme, por këto propozime duhen vendosur në zëra të ndarë të buxhetit.

Miratimi i projekteve mund të kryhet në faza të ndryshme:

- ✓ Miratimi i konceptit.
- ✓ Studimet e zbatueshmërisë (fizibilitetit) dhe kostot e përafërta të alternativave të ndryshme.
- ✓ Studime projektuese dhe miratimi i skemave të përzgjedhura – këshillimet.
- ✓ Projektimi i detajuar dhe kostot.
- ✓ Miratimi fiskal dhe programimi.
- ✓ Nisja dhe zbatimi.
- ✓ Dokumentimi i projektit.

□ *Hulumtimet dhe studimet duhet të planifikohen dhe programohen.*

Në përgjithësi, këshillohet që kontratat t'i jepen ekspertëve të pavarur apo institucioneve akademike që kanë një interes për studimin e burimit. Për të qenë sa më konsistentë në të gjitha aktivitetet, duhet që të përgatiten modelet e formave të ndryshme të kontratave me nene standarde që kanë të bëjnë me detaje si e drejta e autorit, publikimi dhe ruajtja e materialeve.

□ *Të gjithë hulumtuesit duhet të dorëzojnë raporte vjetore të ecurisë së punimeve.*

Raporti vjetor i ecurisë së punimeve duhet të jetë i ndarë në dy pjesë: pjesën teknike, e cila përfshin detajet e tërë punës së kryer (rezultatet, kostot, kuptimin e zbulimeve, etj.) dhe pjesën e përgjithshme, e cila është e përshtatshme për informimin e publikut, përmbledhjen e aktiviteteve dhe zbulimeve të rëndësishme. Raporte të tilla shërbejnë si mjete shumë të vlefshme. Varianti i përgjithshëm i raportit ndihmon në marrëdhënien me publikun dhe ngritjen e fondeve, kurse raporti teknik përbën një pjesë të arkivimit të vazhdueshëm të dokumenteve të sitit.

4.2.7 Administrimi

□ *Roli i ekipit administrues dhe menaxhues është konservimi i burimit të trashëgimisë, si dhe t'i shërbejë interesit publik pa cenuar sitin.*

Përgjegjësitë duhet të delegohen, dhe pjesëtarët e stafit duhet të jenë në gjendje t'i marrin vetë vendimet që u takojnë në kuadër të planit të menaxhimit, si dhe në kuadër të përgjegjësisë të tyre të paracaktuara. Kjo mënyrë pune duhet të rrisë efikasitetin dhe nivelin e kënaqësisë në punë.

Kënaqësia në punë është një element tërheqës dhe i mban në punë punonjësit e

mirë, çka përbën garancinë më të mirë për të kryer një punë sa më të mirë.

- ❑ *Për të arritur efikasitetin në menaxhim, të gjithë punonjësit duhet të jenë në dijeni për udhëzimet që kontrollojnë punën e tërë administratës.*

Detyrat administrative bëhen më të thjeshta kur e tërë prona menaxhohet vetëm nga një pronar. Në disa raste, një prej objektivave afatgjatë të Komisionit të Sitit mund të jetë edhe fitimi i pronësisë mbi të gjitha pronat në sit. Edhe pse kjo do ta bënte menaxhimin më të lehtë, ndryshimi i pronësisë mund të bartë edhe kosto sociale, siç është për shembull përçarja e jetës së komunitetit dhe prishja e modeleve të përdorimit. Një alternativë më frytdhënëse do të ishte kontrolli më rigoroz i planifikimit urban dhe edukimi i publikut.

4.2.8 Kontrolli i kostos dhe politikat

Kontrolli i kostos së projekteve është një çështje thelbësore. Shpesh, koha dhe paraja shkojnë dëm, dhe nganjëherë shkaktohen edhe dëme ndaj ndërtesave kulturore vetëm për shkak të mungesës së koncepteve të qarta mbi politikat e konservimit, si dhe për shkak të mungesës së kontrollit rigoroz gjatë zbatimit të punimeve.

- ❑ *Kontrolli duhet t'i delegohet një personi kompetent, pasi të jenë vendosur politikat nga grupi i përbërë nga ekspertë të fushave të ndryshme.*

Politika e konservimit për një ndërtesë të veçantë duhet të bazohet mbi një inspektim të tërthortë, si dhe çdo studim tjetër të nevojshëm. Politikat nuk duhet të vendosen në asnjë rast vetëm nga një individ, për shkak se kjo do të ishte një përgjegjësi shumë e madhe. Megjithatë, një person i vetëm mund të vihet në krye të zbatimit të këtyre politikave, duke drejtuar në të njëjtën mënyrë siç bën edhe një dirigjent orkestre.

4.2.9 Instrumentet ligjore

Instrumentet ligjore dhe rregulloret të cilat respektojnë rregullat sociale dhe ato të punësimit të një Shteti Anëtar duhet të hartohen duke përfshirë edhe:

- **aktin** e themelimit të sitit si një Sit i Trashëgimisë Kulturore Botërore, si dhe ngritjen e Komisionit të Sitit;
- **statutin e Komisionit të Sitit dhe rregullat që përcaktojnë procedurat financiare.** Meqenëse Komisioni duhet të ruajë distancën nga qeveria e Shtetit Anëtar, në kushte ideale financimi i Komisionit do të duhej të kryhej mbi baza të fondeve pesë-vjeçare (që rregullohen në bazë të inflacionit).

Ky lloj planifikimi financiar do t'a lejonte Komisionin që të kryente me vetëbesim planifikimin për të ardhmen, dhe për më tepër ky planifikim do të ulte numrin e ndërhyrjeve të pamenduara mirë;

- **rregulloren e brendshme dhe kriteret e punësimit;** dhe
- **fuqizimin e Komisionit të Sitit** për të ndërmarrë aktivitete dhe për të kontraktuar palë të tjera për punime të ndryshme brenda sferës së tij të kompetencave.

4.2.10 Programimi

Programimi lidhet me punonjësit dhe buxhetin në dispozicion. Problemet e burimeve njerëzore dhe financiare duhet të identifikohen paraprakisht, duke u dhënë përparësi atyre problemeve që janë më urgjente:

- Problemet e **menjëhershme** krijojnë një rrezik potencial për publikun apo burimin, dhe ato duhet të zgjidhen të parat. Plani fiskal duhet të caktojë një rezervë në raste urgjence për t'u marrë me problemet e menjëhershme sa më parë të jetë e mundur, pas raportimit nga personi përgjegjës. Natyrisht që fatkeqësitë natyrore mund të jenë tepër të mëdha për t'u zgjidhur në këtë mënyrë, por probleme tipike të menjëhershme mund të përfshijnë riparimin e dëmeve pas erërave të forta, apo pastrimin e shtigjeve në parkun e sitit.
- Nëse nuk zgjidhen në kohë, problemet **urgjente** shkaktojnë dëme të mëtejshme ose rrënim, kështu që ato duhen adresuar direkt pas problemeve të menjëhershme. Për shembull, tek ndërtesat përhapja e kërpudhave ose dyndja e termiteve duhet të adresohet urgjentisht, dhe sistemi i heqjes së ujërave të grumbulluara nga reshjet duhet të mirëmbahet për të parandaluar shkatërrimin.
- Problemet e **nevojshme përbëjnë** atë grup punimesh të cilat duhet të kryhen për ta ruajtur burimin gjatë periudhës pesë-vjeçare (apo qoftë edhe një afat tjetër kohor) të financimit.
- Gjërat e **dëshirueshme** mund të konsiderohen si pjesë e **Buxhetit për Zhvillim**.
- Gjërat për t'u mbajtur nën **vëzhgim** janë ato të cilat duhet të monitorohen dhe të studiohen për të përcaktuar nëse janë apo jo serioze. Këtu përfshihen lëvizjet e themeleve, apo edhe rendimenti i instalimeve.
- Duhet të rishikohen gjithashtu edhe **problemet e ardhshme**, siç janë zëvendësimi i ndonjë bime të kalbur, rinovimi i çatave apo rimbjellja e kopshtit.

Komisioni i Sitit duhet të shqyrtojë ndërveprimin dhe programimin efikas të të gjithë faktorëve të parashikueshëm në bazë të propozimeve të dorëzuara nga Drejtori. Më pas, projektet mund të përcaktohen dhe të veçohen për t'u zbatuar.

4.3. RISHIKIMI I PROGRAMIT DHE PLANIFIKIMI PËR TË ARDHMEN

Shteti Anëtar ka një rrjet të brendshëm komunikimi dhe të lëvizjes së dokumentacionit brenda ministrisë përgjegjëse, qendrës së Komisionit të Sitit, zyrave rajonale dhe vendore të planifikimit dhe punonjësve të sitit. Do të ishte mirë që të krijohej një ndërlidhje mes profesionistëve të Shtetit Anëtar, punonjësve të sitit dhe një organi ndërkombëtar në rolin e këshilluesit. Siç kemi sugjeruar edhe më parë, profesionistët e nivelit të lartë të një Shteti Anëtar mund të bëhen edhe anëtarë të Komisionit të Sitit. Është e rëndësishme që ky organ të jetë nën një ministri që ka mandatin e caktuar për t'u marrë drejtpërdrejtë me Konventën e Trashëgimisë Botërore, dhe që ministritë e tjera që kanë lidhje me këtë proces të mbahen gjithashtu të informuara.

Komiteti i Trashëgimisë Botërore e kupton procesin e monitorimit dhe raportimit sistematik si një proces të vazhdueshëm të vëzhgimit të kushteve të Siteve të Trashëgimisë Botërore nëpërmjet raportimeve periodike mbi gjendjen e konservimit. Megjithëse monitorimi në terren është një detyrë kryesore e Shtetit Anëtar, ekziston nevoja për një komunikim të vazhdueshëm dhe të dyanshëm mes atyre që janë përgjegjës për sitin dhe Komitetit të Trashëgimisë Botërore. Ky komunikim duhet të përfshijë edhe raportet mbi:

- statusin dhe gjendjen aktuale,
- dokumentet e planifikimit dhe veprimit,
- kërkesat për fonde dhe ndihmë teknike, si dhe
- rreziqet e mundshme, qoftë aktuale, qoftë ato që parashikohen për të ardhmen.

4.4 BUXHETIMI

Formulimi i buxhetit kërkon njohuri dhe përvojë të mëparshme me këtë punë. Kushtet vendore dhe niveli i pagave ndryshojnë shumë, por në përgjithësi konservimi i trashëgimisë kulturore është një punë intensive dhe kërkon njohuri e përkushtim të veçantë. Do të ishte e vështirë që të ndërtohej një buxhet i saktë për pesë vitet e para pas themelimit të Komisionit të Vendndodhjes, prandaj dhe Shteti Anëtar duhet të vendosë në dispozicion një asistencë bujare për themelimin e

Komisionit dhe fillimin e aktiviteteve të tij. Në mënyrë që të realizojë me efikasitet zbatimin e programit të tij, Komisioni duhet të jetë në gjendje të planifikojë me vetëbesim për pesë vitet e ardhshme. Gjithashtu Komisioni duhet të ketë edhe mundësinë për t'i ruajtur fondet që teprojnë nga një vit në tjetrin, pasi projektet e zhvillimit dhe hulumtimit zakonisht zbatohen më ngadalë nga ç'janë planifikuar. Asistenca fiskale është e domosdoshme në mënyrë që punëtorët me përgatitje profesionale të mbahen në punë me kohë të plotë.

4.4.1 Buxheti vjetor

Buxheti vjetor duhet të vendoset në kuadër të planit financiar afatgjatë. Buxheti do të duhet ndahet në disa pjesë, me nëntituj (nën-zëra) sipas detyrave përkatëse. Një sistem efikas i kontabilitetit është tepër i nevojshëm për menaxhimin e një operacioni të tillë të ndërlikuar dhe për mbikëqyrjen e zbatimit të buxhetit nëpërmjet kontrolleve tre-mujore, mujore, apo të rastësishme. Përdorimi i pajisjeve moderne të kontabilitetit është diçka me leverdi për sitin nëse punësohet edhe personel i kualifikuar për këtë punë. Kontabilisti duhet t'i raportojë Drejtorit. Raportet vjetore duhet të auditohen nga kontabilistë të pavarur të cilët do t'i raportojnë Komisionit të Sitit nëpërmjet Drejtorit. Krerët e departamenteve do të menaxhojnë fondet të cilat u delegohen nga Drejtori, dhe do të jenë përgjegjës për përdorimin e tyre në mënyrë korrekte. Nëse tejkalohe njëri prej zërave të buxhetit, atëherë **para** se të bëhet shpenzimi apo pagesa duhet marrë fillimisht miratimi nga Drejtori. Duhet mbajtur mend se planifikimi, programimi dhe buxheti janë procese të vazhdueshme të cilat duhet të rishikohen dhe përditësohen në intervale të rregullta dhe të paracaktuara.

4.4.2 Roli i UNESCO-s

Qendra e UNESCO-s për Trashëgiminë Botërore vepron si një sekretariat në kuadër të Komisionit të Trashëgimisë Botërore, dhe për qëllime të ndryshme mund t'u ofrojë Shteteve Anëtare edhe ndihmë financiare nga Fondi i Trashëgimisë Botërore. Kjo ndihmë financiare mund të përfshijë ndihmë në kualifikime profesionale, në shërbime teknike dhe pajisje. Procedura e aplikimit është caktuar nga Komiteti i Trashëgimisë Botërore dhe është publikuar. Fondet për asistencë apo kualifikime teknike shpërndahen nga Komiteti i Trashëgimisë Botërore vetëm nëse plani i menaxhimit është miratuar paraprakisht, dhe nëse raporti profesional mbi gjendjen e sitit është dorëzuar në intervale të rregullta, ashtu siç është parashikuar në udhëzimet e Komitetit të Trashëgimisë Botërore.

Organet ndërkombëtare që njihen nga Konventa e Trashëgimisë Botërore janë:

- Qendra Ndërkombëtare për Studimin e Ruajtjes dhe Restaurimit të Pasurisë Kulturore (ICCROM – *The International Centre for the Study of the Preservation and Restoration of Cultural Property*)
- Këshilli Ndërkombëtar i Monumenteve dhe Siteve (ICOMOS – *The International Council on Monuments and Sites*), dhe
- Bashkimi Ndërkombëtar për Konservimin e Natyrës dhe Burimeve Natyrore për ato site me trashëgimi natyrore (IUCN – *The International Union for Conservation of Nature and Natural Resources*).

Bashkë me Qendrën e UNESCO-s për Trashëgiminë Botërore, këto organe do të bashkëpunojnë me Shtetet Anëtare rreth çështjeve që lidhen me menaxhimin e siteve të tyre. Komiteti i Trashëgimisë Botërore ka për qëllim që pas pranimin të *Udhëzuesit për Mënyrën e Funksionimit* t'i rishikojë dhe përditësojë udhëzimet çdo pesë vjet në mënyrë që të ecë me të njëjtin hap me kërkesat aktuale operationale dhe të menaxhimit.

Një çështje e rëndësishme në lidhje me menaxhimin e siteve të Trashëgimisë Botërore është nisja e procesit i cili konsolidon bazat e bashkëpunimit ndërkombëtar mes atyre që janë përgjegjës për menaxhimin e siteve dhe organeve të ndryshme ndërkombëtare, siç është Komiteti i Trashëgimisë Botërore, UNESCO, ICCROM dhe ICOMOS-i. Ky proces mund të përfshijë disa cikle takimesh teknike për të diskutuar rreth çështjeve të menaxhimit, sistemit të raportimit mbi ecurinë e punimeve, si dhe gjithashtu edhe pjesëmarrjen në aktivitete të formimit profesional, qoftë brenda kontekstit të vetë sitit, qoftë në kurse dhe seminare rajonale e ndërkombëtare, siç janë ato të organizuara nga ICCROM-i në Romë.

4.5 LISTA E KONTROLLIT PËR MENAXHIMIN

- ✓ A e keni planin e menaxhimit për strategjinë e mirëmbajtjes së sitit tuaj të Trashëgimisë Botërore, dhe a përditësohet rregullisht ky plan?
- ✓ A janë përcaktuar qartë objektivat afatgjata, afatmesme dhe afatshkurta?
- ✓ A janë marrë parasysh brenda këtij plani vlerat, prioritetet dhe veprimet që janë më pak të dëmshme për sitin?

- ✓ A ka një inventar të burimit, dhe a është regjistruar dhe dokumentuar ai në mënyrë të përshtatshme?
- ✓ A është i disponueshëm dokumentacioni që ka lidhje me sitin?
- ✓ A janë bërë kopje të dokumentacionit të sitit dhe a janë vendosur ato në një vend të sigurt?
- ✓ A ekziston një plan për t'u mbrojtur në rast zjarri, dhe a kryen simulime të rregullta për të provuar efikasitetin e tij?
- ✓ A keni plan veprimi në raste fatkeqësie për rajonin tuaj?
- ✓ A është emëruar punonjësi i reagimit ndaj fatkeqësive dhe mëkëmbësi i tij?
- ✓ A janë vendosur kontakte për programe efikase kërkimore me universitete dhe institucione të tjera?
- ✓ A reflektohen njohuritë dhe zhvillimet e fundit teknike të konservimit në ligjet dhe rregulloret që po zbatohen?
- ✓ A zbatohen ato në mënyrë efikase? Nëse jo, ku kanë dështuar?
- ✓ A është menaxhimi i infrastrukturës i përshtatshëm dhe efikas në përmbushjen e rolit të tij?
- ✓ A janë hapur rrugët e komunikimit me organizatat ndërkombëtare të cilat merren me ruajtjen e Trashëgimisë Botërore?

MENAXHIMI NË BAZË TË PROJEKTEVE TË BURIMEVE

5.1 PËRGATITJA E PLANIT TË MENAXHIMIT

Përgatitja e planit të menaxhimit për një sit të Trashëgimisë Botërore nënkupton marrjen në konsideratë të **të gjitha** burimeve të tij. Një burim përbën një pjesë të identifikueshme të sitit të Trashëgimisë Botërore. Disa site mund të kenë vetëm një burim, siç janë gdhendjet primitive në gurët e shpellave. Site të tjera mund të kenë disa burime. Një ndërtesë e madhe, p.sh., bart burime që përfshijnë materialin e ndërtimit të saj, gdhendjet, xhamin, mobiliet, tekstilet, etj.

5.1.1 Procedura

Në përgatitjen e planit të menaxhimit duhet të përfshihen hapat në vijim:

- rilevimi fillestar i sitit
- përshkrimi i sitit dhe përcaktimi i kufijve të tij
- identifikimi i burimeve
- vlerësimi i burimeve
- formulimi i objektivave dhe marrja në konsideratë e kufizimeve
- përcaktimi i projekteve
- programi i punës dhe planet vjetore
- zbatimi i punimeve
- regjistrimi, raportimi dhe rishikimi i rezultateve
- ruajtja e informacioneve dhe e të dhënave
- rishikimi i përshkrimit të sitit dhe rivlerësimi
- formulimi i objektivave të rishikuara dhe rishqyrtimi i kufizimeve
- përcaktimi i projekteve të mëtejshme
- rishikimi i programit të punës dhe plani vjetor i ardhshëm

5.1.2 Kërkesat

Kërkesa e parë e menaxhimit të sitit është konservimi dhe mbrojtja e burimeve të tij kulturore, dhe, aty ku është e mundur, duhen përmirësuar ato elemente për të cilat ekziston një interes i veçantë. Pasi të jetë plotësuar kjo kërkesë, atëherë siti mund të përdoret për një sërë qëllimesh të tjera, siç është edukimi, puna kërkimore, turizmi dhe punësim. Natyrisht, kuptohet që duhet ruajtur integriteti i sitit të Trashëgimisë Botërore.

Planet e detajuara të menaxhimit për këto burime nuk duhet të jenë të ndërlikuara apo të gjata. Me kusht që objektivat kryesore të njihen mirë dhe punonjësit e sitit të kenë kualifikimet e duhura, atëherë burimet mund të menaxhohen edhe bazuar mbi përkujdesjen dhe mirëmbajtjen. Çdo 3-5 vjet duhet të bëhet një rishikim i plotë i burimeve, por vetë sistemi i menaxhimit do të duhet të jetë në gjendje t'i mirëpresë ndryshimet që vijnë si rrjedhojë e punimeve që kryhen në sit, apo të zhvillimeve të papritura, si dhe t'i integrojë ato në programin e menaxhimit.

5.1.3 Procedurat e përgatitjes dhe këshillimit

Procedurat e zbatuara gjatë përgatitjes së planit të menaxhimit ndryshojnë në bazë të formatit të vetë planit, dhe krijohen përmes punës në grup. Edhe plani më i thjeshtë i menaxhimit është shumë i ndërlikuar në përgatitjen dhe zbatimin e tij, dhe kjo gjë justifikon përfshirjen e profesionistëve të ndryshëm në hartimin e tij, siç janë arkitektët, arkeologët, historianët, inxhinierët dhe urbanistët. Puna në një grup të përbërë nga profesionistë të fushave të ndryshme rrit mundësinë e hartimit të objektivave të qarta dhe racionale, dhe shmang vështirësitë që mund të lindin kur ekziston vetëm një person përgjegjës për menaxhimin e një burimi të trashëgimisë. Puna në grup është diçka tepër e rëndësishme për vendosjen e vazhdimësisë së objektivave që shtrihen në një periudhë kohore zakonisht më të gjatë sesa prezenca e cilitdo anëtar të ekipit të punës. Cilado qoftë përbërja e ekipit, nismat kryesore për përgatitjen e planit të menaxhimit do të ndërmerren nga një apo dy persona, zakonisht nga arkitekti, apo arkeologu dhe nga një administrator.

Edhe përgatitja e planit të menaxhimit duhet të përfshijë këshillime nga jashtë ekipit të punës, si dhe shqyrtimin e objektivave të planeve të menaxhimit për burime të tjera të ngjashme. Burimet e informacionit përfshijnë:

- **Burimet e orientuara drejt punës kërkimore dhe informimit**, duke përfshirë arkivat vendore dhe kombëtare, universitetet, raportet e planifikimit urban dhe grupet vullnetare me interesa të veçanta; dhe
- **Burimet e orientuara drejt menaxhimit**, duke përfshirë pronarët, qiramarrësit, fqinjët dhe menaxherët e tjerë të pronës.

Këshillimi me pronarët, qiramarrësit dhe fqinjët duhet të përfshijë diskutime rreth atyre rreziqeve të mundshme që janë identifikuar gjatë propozimit për emërimin e sitit në Listën e Trashëgimisë Botërore.

Pasi të jetë krijuar varianti i parë i planit të menaxhimit, ai duhet të shqyrtohet me kujdes nga një grup i qeverisë qendrore. Kjo analizë mundëson një ekzaminim më të hollësishëm, një debat mbi objektivat në lidhje me sitet e tjera, dhe një vlerësim

të financave të programit të punës. Qeveria qendrore duhet të mbajë një kopje të plotë të të gjitha planeve të menaxhimit të miratuara, si dhe të raporteve vjetore të ecurisë së punës për secilin plan. Nga ana tjetër, është e këshillueshme që edhe autoritetet rajonale të bëjnë të njëjtën gjë.

Për shkak të kompleksitetit të procesit të përgatitjes, si dhe serisë së këshillimeve dhe kohës së kufizuar që punonjësit kanë në dispozicion, përgatitja e planit të menaxhimit të burimit mund të zgjatet në kohë nga tre muaj (në rastin e siteve të thjeshta) deri në dy vite (për sitet më të ndërlikuara si dhe qytetet). Siç u përmend edhe më herët, ekziston mundësia që menaxhimi i sitit të nisë duke u bazuar edhe në një plan pjesërisht të kompletuar.

5.2 RAPORTIMI

5.2.1 Raportimi afatshkurtër dhe rishikimi

Efikasiteti i menaxhimit varet nga raportimi në intervale të rregullta kohore, qofshin ato mujore, tre-mujore, apo vjetore. Plani i menaxhimit do t'i caktojë punonjësve të sitit programin vjetor të projekteve bashkë me kostot e tyre, kohën e nevojshme për zbatimin e tyre, etj. Për këto projekte hartohen dy lloj raportesh:

- vlerësime mujore, apo tre-mujore, mbi ecurinë e secilit projekt. Këto vlerësime mundësojnë modifikimin e prioriteteve dhe planit kohor të punës, në mënyrë që nëse lind nevoja këto elemente të ndryshojnë sa më parë të jetë e mundur;
- një përmbledhje vjetore e ecurisë së projekteve individuale (apo grupeve të projekteve), së bashku me kostot përkatëse financiare, si dhe me ato që lidhen me oraret e punës së punonjësve.

Raportet duhet të mbulojnë të gjitha projektet brenda kuadrit të planit vjetor të punës. Mund të jetë e dobishme që projektet të klasifikohen në bazë të qëllimeve që kanë, llojit të punës dhe kohëzgjatjes së tyre.

Meqenëse mund të ketë vonesa në përfundimin e **Planeve Vjetore të Punës**, apo edhe shtyrje të afateve, atëherë duhet të dorëzohet një përmbledhje vjetore e ecurisë së punës - **Raporti Vjetor i Ecurisë** (i cili duhet të bazohet mbi projektet). Ky raport përmbledh informacionet e dhëna në raportet mujore, ose tre-mujore, dhe mundëson krahasimin me listën e projekteve të propozuara në planin e përgjithshëm të menaxhimit. Gjithashtu, ky raport mundëson identifikimin e problemeve dhe mangësive, si dhe modifikimin e mëtejshëm të planeve të punës.

5.2.2 Raportimi afatgjatë dhe rishikimi

Planet e menaxhimit duhet të hartohen për një periudhë minimale kohore pesë vjeçare, në fund të së cilës duhet kryer rishikimi i tyre. Në të njëjtën kohë, duhen përmbledhur edhe Raportet Vjetore të Ecurisë së planit aktual të menaxhimit, në mënyrë që ato të përfshihen në planin e ri. Kjo praktikë mundëson transmetimin e informacionit rreth ecurisë së planeve paraprake, dhe në të njëjtën kohë siguron edhe trajtimin e çështjes së vazhdimësisë, ndryshimet në personel dhe grumbullimin e atyre njohurive lidhur me vendndodhjen që sa vinë e rriten.

5.2.3 Formati i planit të menaxhimit

Sistemi i njësuar i planifikimit do të rezultojë i suksesshëm vetëm nëse ai zbatohet përmes një formati të standardizuar. Standardizimi do të caktonte kornizën brenda të cilës interpretimet e planit do të ndiqnin gjithnjë të njëjtën rrjedhë logjike, si dhe do të lejonte krahasimin e referencave të informacionit lidhur me një spektër të gjerë burimesh. Standardizimi i aktiviteteve të menaxhimit për çdo sit luan gjithashtu një rol vendimtar për planifikimin e menaxhimit në grup, si dhe monitorimin në grup të siteve të Trashëgimisë Kulturore. Një tjetër epërsi e formatit të standardizuar është se ai lehtëson nxjerrjen e informacionit statistikor në varësi të kërkesave dhe qëllimeve të ndryshme. Formati që ne rekomandojmë është i ndarë në tre pjesë të veçanta: (1) përshkrimi i sitit; (2) vlerësimi dhe objektivat; (3) propozimet, së bashku me një parathënie të domosdoshme, e cila përmbledh gjendjen dhe kontekstin e sitit. Më specifikisht, për të pasur një bazë paraprake për punën në të ardhmen, ne rekomandojmë formatin në vijim:

PLANI VJETOR I MENAXHIMIT
për {emri i burimit apo projektit}
i {emri i sitit} gjatë {periudha kohore}

Parathënie

- Gjendja dhe konteksti i vendndodhjes

Pjesa 1: Përshkrimi i sitit

1.1 Informacion i përgjithshëm

- Pozicioni gjeografik, përshkrimi i përmbledhur, vjetërsia
- Harta, tabela, fotografi

1.2 Informacion kulturor

- Antropologjik, etnografik, arkeologjik, historik, i historisë së artit, arkitektonik, teknologjik, shkencor

1.3 Informacion mjedisor

- Klima, hidrologjia, gjeologjia, gjeomorfologjia, sizmologjia, dherat, rreziqet e shkaktuara nga njeriu

1.4 Interesat

- Historia e përdorimit të tokës dhe e burimit
- Interesat publike dhe private, modeli i pronësisë
- Interesat ekonomike, duke përfshirë edhe turizmin

1.5 Shtojcat e Pjesës 1

- Lista e referencave për Pjesën 1
- Lista e amendamenteve në Pjesën 1

Pjesa 2: Vlerësimi dhe objektivat

2.1 Gjendja e konservimit të sitit

- Statusi i sitit të Trashëgimisë Botërore, statusi historik
- Të dhëna mbi veprimtari të mundshme dëmtuese ose kërcënuese
- Përkufizimi i burimit dhe i kufijve

2.2 Vlerësimi i tipareve dhe i potencialit të sitit

- Vlerat kulturore lidhur me materialin historik origjinal dhe potencialin arkeologjik të sitit (autenticiteti i materialeve, puna e përdorur, projektimi dhe mjedisi rrethues)
- Vlerat kulturore të lidhura me sitin (rëndësia universale, vlerat

përkujtimore, legjendare dhe emocionale, si dhe vlerat relative artistike, dhe veçantia e saj)

- Vlerat bashkëkohore ekonomike dhe vlerat e përdorimit

2.3 Identifikimi dhe vërtetimi i tipareve të rëndësishme

- Objektivat e menaxhimit ideal
- Faktorët që ndikojnë në menaxhim
- Objektivat për mënyrën e funksionimit dhe mundësitë menaxheriale
- Mundësitë e menaxhimit të konservimit
- Mundësitë e menaxhimit të përdorimit
- Mundësitë e studimit dhe punës kërkimore
- Mundësitë e edukuese dhe interpretuese

1.4 Shtojcat e Pjesës 2

- Lista e referencave për Pjesën 2
- Lista e amendamenteve në Pjesën 2

Pjesa 3: Propozimet për menaxhimin e përgjithshëm të sitit

3.1 Projektet

- Identifikimi i projektit, titulli, klasifikimi
- Regjistri i projektit
- Përshkrimi i projektit

3.2. Orari i punës

- Plani vjetor i punës
- Lidhja e planit vjetor me planet afatmesme dhe afatgjata

3.3 Kostot dhe fazat e punimeve

3.4 Shtojcat e Pjesës 3

- Lista e referencave për Pjesën 3
- Lista e amendamenteve në Pjesën 3

Bibliografia

- Bibliografia e përzgjedhur dhe regjistri i materialit të papublikuar
- Bibliografia e përgjithshme
- Amendamentet në bibliografi

5.2.4 Komentet mbi formatin

Formati i rekomanduar përfaqëson rrjedhën logjike e cila nën kushte ideale do duhej ndjekur gjatë hartimit të Planit të Menaxhimit për sitit. Sidoqoftë, për të plotësuar nevojat e menjëhershme të menaxhimit mund të shkruhet së pari Pjesa 3 – Propozimet për menaxhimin e përgjithshëm të sitit –, por kjo pjesë nuk duhet të fillohet pa përfunduar vlerësimin fillestar të tipareve të rëndësishme dhe objektivat për mënyrën e funksionimit të vendndodhjes. Pjesa 3 mund të përdoret si një udhëzues për vazhdimin e programit të punës, dhe ajo mund të shërbejë për të ndërtuar pikat e planit për të gjithë punën që duhet kryer.

Plani i menaxhimit duhet të prezantohen në formën e një dokumenti të papërfunduar, dhe jo si botim i lidhur dhe përfundimtar i një libri. Përdorimi i formatit me fleta të lira nëpër skedarë, do të mundësonte që versionet e ndryshme dhe rishikimet të përfshihen në një ose në disa seksione njëkohësisht. Nëse një seksion nuk mund të plotësohet i tëri (p.sh.: për Seksionin 1.3 mbi Informacionin mjedisor nuk ka të dhëna), apo nëse nuk është bërë vlerësimi i potencialit të sitit, atëherë për këtë mungesë informacioni duhet të jepet një deklaratë e shkurtër, duke shënuar dhe datën përkatëse. Në këtë mënyrë, rivlerësimet apo seksionet e plotësuara më vonë mund të përfshihen në një kohë të dytë. Në ato raste kur seksionet, apo deklarata e planeve të mëparshme të menaxhimit e ruajnë ende vlefshmërinë e tyre, atëherë ato mund të përfshihen në seksionin e duhur të planit të ri duke vendosur edhe referencat dhe shënimet përkatëse.

5.2.5 Paraqitja e planeve të menaxhimit

Në vijim rekomandohen këto metoda paraqitjeje:

- Përdorni formatin me fleta të lira në një skedar të përshtatshëm.
- Përdorni sistemin e referimit të tabelës së lëndës që është paraqitur më lart. Kur nuk përdoret hapësira në dispozicion të një pike plani ose të një nën-çështjeje, kjo hapësirë duhet të ruhet bosh dhe **nuk duhet** të përdoret për qëllime të tjera.
- Hartat dhe shtojcat duhet të vendosen menjëherë pas çdo pike plani të tabelës së lëndës, dhe nuk duhen ndarë veçmas nën një pikë plani të posaçme, si dhe nuk duhet të vendosen në fund të planit të menaxhimit.
- Fillimi i çdo pike plani të re duhet të shkruhet në një faqe të re.
- Në skajet e sipërme të fletëve vendosni numrat e plotë të pikës së planit (në mënyrë që të shmangni përdorimin e numrave të faqeve, të cilët

vështirësojnë rishikimet dhe përditësimet).

- Për të treguar se kur një pikë plani është shkruar ose rishikuar, vendosni datën përkatëse në fund të fletës, dhe gjithashtu përditësoni Listën e Amendamenteve për secilën pjesë, në mënyrë që të lehtësohet identifikimi dhe datimi i rishikimeve.
- Vendosni një numër të veçantë për secilin projekt.
- Paraqitni referencat në fund të secilës pjesë (ose pikë plani), si dhe në bibliografi.

Kapitulli 6

PROGRAMI I MIRËMBAJTJES

6.1 HYRJE

Procesi i mirëmbajtjes duhet t'i përdorë forcat natyrore për të theksuar bukurinë e burimit kulturor, por një mirëmbajtje e tepruar mund edhe ta shkatërrojë bukurinë e burimit. Planifikimi i procesit të mirëmbajtjes është një lloj arti më vete, i cili duhet të jetë i ndjeshëm ndaj kulturës dhe ekologjisë. Niveli i mirëmbajtjes përcaktohet përmes vlerësimit të klimës natyrore, shkaqeve të degradimit dhe nevojave të përdorimit. Megjithatë, politikat dhe programet e mirëmbajtjes duhet të marrin parasysh edhe natyrën specifike të një kulture, duke u përpjekur që ta ekuilibrojnë atë kundrejt ndikimit të forcave natyrore.

- ❑ *Programi i mirëmbajtjes ka për qëllim t'i mbajë burimet kulturore në atë lloj gjendjeje e cila do të shmangte humbjet për secilën pjesë të tyre. Mirëmbajtja ka të bëjë me të gjitha masat praktike dhe teknike të cilat duhet të ndërmerren për mirëmbajtjen e siteve në një gjendje të mirë. Mirëmbajtja nuk është produkt, por një proces i vazhdueshëm.*

Programi i mirëmbajtjes duhet të paraqesë cikle të përcaktuara mirë rreth çështjeve të tilla si përgjegjësia mbi një detyrë të caktuar, mënyrën se si kryhet një punë dhe sa shpesh duhet kryer ajo. Veprimet duhet të përshkruhen në terma të thjeshta të cilat mund të ndiqen dhe zbatohen nga punonjësit që merren me pastrimin, mjeshtrit artizanë, mbikëqyrësit dhe gjithë personat e tjerë të përfshirë në procesin e mirëmbajtjes së burimit kulturor.

Zbatimi i programit të mirëmbajtjes vijohet nga rivlerësimi i tij, duke u bazuar në rezultatet që ka dhënë ai dhe kohën e harxhuar për të. Mbajtja e shënimeve të hollësishme rreth orarit të punës dhe materialeve të përdorura është diçka thelbësore. Koha që harxhohet gjatë udhëtimeve duhet të matet në mënyrë të veçantë nga koha tjetër e punës. Detyrat duhet të jenë të përshkruara qartë në mënyrë që punëtorët që kontraktohen jashtë personelit të përhershëm të dinë se çfarë veglash dhe materiali të sjellin me vete, duke evituar kështu udhëtime të panevojshme.

6.2 MIRËMBAJTJA PARANDALUESE

- ❑ *Parandalimi është forma më e lartësuar e konservimit. Nëse shkaqet e degradimit do mund të mënjanohen, apo të paktën të zvogëlohen, atëherë mund të themi se është arritur diçka e vlefshme.*

Faktorët e ndotjes atmosferike dhe lëkundjet e shkaktuara nga trafiku mund të minimizohen, apo edhe të eliminohen nëpërmjet planifikimit urban ose masave të ndryshme qeveritare. Mirëmbajtja dhe përkujdesja ndaj rreziqeve dhe kërcënimeve që shkaktohen prej fatkeqësive natyrore mund të rezultojë shumë efektive në zvogëlimin e dëmeve ndaj burimeve kulturore.

- *Procedurat administrative dhe simulimet e ushtrimeve që ndërmerren në rast fatkeqësie i zbehin paqartësitë dhe çojnë drejt zbatimit të planeve që janë provuar mirë paraprakisht.*
- *Dokumentimi është një aspekt thelbësor i mirëmbajtjes parandaluese në përkufizimin më të gjerë të saj.*
- *Procedurat e mbajtjes së shënimeve të cilat identifikojnë çështjet problematike që shfaqen vazhdimisht gjatë mirëmbajtjes kontribuojnë në mirëmbajtjen parandaluese, duke mundësuar identifikimin dhe korrigjimin e shkaqeve që i krijojnë këto probleme.*
- *Aty ku është e mundur, detyrat e mirëmbajtjes duhet të integrohen brenda **një regjimi me orare të caktuara.***

Oraret e këtij regjimi të mirëmbajtjes mund të përfshijnë:

- detyrat ditore, përfshi pastrimin dhe mirëparaqitjen
- detyrat javore
- detyrat mujore, p.sh. kontrollin e rritjes së bimëve mbi muret e ndërtesave dhe nëpër vendndodhje
- detyrat e tre-mujorit, p.sh.: në pranverë dhe në vjeshtë
- detyrat vjetore
- detyrat pesëvjeçare.

Regjimi i përcaktuar duhet të jetë edhe lehtësisht i ndryshueshëm, për të mundësuar kryerjen e **detyrave urgjente** të cilat duhet të adresohen menjëherë, siç janë:

- detyrat pas një shiu të fuqishëm
- detyrat pas erërave të forta
- detyrat pas një zjarri, tërmeti, përmytjeje, apo edhe ndonjë fatkeqësie tjetër natyrore.

6.2.1 Kontributi profesional

Një **strategji e suksesshme e mirëmbajtjes** kërkon përfshirjen e profesionistëve të përgjegjshëm, të cilët kanë kualifikimet e duhura për të gjetur dhe diagnostikuar

shkaqet e mundshme të shkatërrimit, për të kryer inspektimet e rregullta dhe për të kryer raporte zyrtare për Komisionin e Sitit. Meqenëse siti e Trashëgimisë Botërore ka një vlerë tepër të madhe, atëherë kjo gjë nënkupton se edhe profesionistët e përfshirë në përkujdesjen e treguar ndaj tij duhet të jenë të një kalibri po aq të lartë në fushat e tyre përkatëse.

Në një situatë ideale, për të siguruar vazhdimësinë, profesionistët duhet të ishin të lidhur me Komisionin e Sitit mbi baza pune me kohë të pjesshme, ose me honorare. Atyre duhet t'u jepet autoriteti që të zbatojnë rekomandimet e dhëna në **Raportet Vjetore të Ecurisë**, si dhe e drejta për të kërkuar një opinion të dytë duke thirrur këshilltarë shkencorë nga jashtë.

Gjatë zbatimit të veprimeve të mirëmbajtjes, profesionistët përfshihen në punime së bashku me mbikëqyrësit, mjeshtrit artizanë, konservuesit dhe personelin e përgjithshëm që punon nën Komisionin e Sitit.

Profesionistët e emëruar duhet:

- **të sigurohen që të gjitha shenjat e përkeqësimit** të raportohen nga ata që merren me mirëmbajtjen e sitit, duke përfshirë këtu edhe çështje të cilat kërkojnë një vëmendje të veçantë. Për shembull, pastruesit duhet të raportojnë sulmet nga insektet si dhe ato raste kur pikojnë çatitë ose tubacionet;
- **të udhëzojnë mjeshtrit** në mënyrë që të mos shkatërrojnë dëshmi historike apo materiale, me zellin e tyre për të bërë një punë sa më të mirë. Ata duhet të mësohen si të konservojnë, e jo se si “ta bëjnë atë gati si të re”;
- **të mbajnë takime të rregullta** me mbikëqyrësit dhe administratorët për të planifikuar punët dhe për të dhënë këshilla rreth kontrollit të shpenzimeve;
- **të takohen me Komisionin e Sitit** së paku një herë në tre muaj, dhe të kenë gjithnjë mundësinë për të komunikuar me Drejtorin;
- **të jenë të përgatitur për t'u takuar me publikun** dhe për të shpjeguar strategjinë e mirëmbajtjes përmes leksioneve, apo artikujve të botuar; dhe
- **të përfshihen në projektet kërkimore** që mund të jenë të rëndësishme për strategjinë e mirëmbajtjes.

Një strategji e mirë e mirëmbajtjes mund të parandalojë shumë dëme dhe përkeqësime, dhe në këtë mënyrë edhe të kursejë para. Fatkeqësisht, është vështirë

që këto kursime të maten dhe për rrjedhojë ata që janë përgjegjës për administrimin e trashëgimisë kulturore shpesh përqendrohen vetëm tek kostoja e një shërbimit profesional. Për pasojë, administratorët mund të joshen që të kursejnë në këtë drejtim, duke ulur shpenzimet për shërbimet profesionale pa u menduar thellë mbi pasojat.

6.2.2 Konteksti i inspektimit të ndërtesave dhe siteve historike

- *Inspektimi fillestar i një ndërtese apo i një siti historik është diçka vendimtare.*

Ky inspektim duhet të përfshijë një analizë të problemeve në një mënyrë sa më gjithëpërfshirëse dhe brenda një kohe sa më të shkurtër.¹²

Shkaqet e shkatërrimit – në të vërtetë mund të ndodhë që dy apo tre shkaqe të veprojnë në të njëjtën kohë – janë aq të ndërlikuara sa që është e zakonshme që gjatë inspektimit të parë arkitekti të mos i vërejë të gjitha, përveç atyre gjërave që normalisht janë të dukshme. Sido që të jetë, detyra e inspektorit është që së pari të shënojë faktet, dhe më pas të kërkojë shkaqet.

Aty ku shihet si e nevojshme, rilevimi, inspektimi dhe raportimi duhet ta analizojnë ndërtesën, ose sitin, në kontekstin e tij më të gjerë. Autoritetet vendore që merren me planifikimin mund të ndihmojnë në parandalimin e lëkundjeve që shkaktohen nga trafiku, duke u ndërruar rrugën mjeteve të rënda, duke zvogëluar ndotjen atmosferike me caktimin e zonave të përshtatshme për industrinë dhe stacionet energjetike, si dhe duke ulur rrezikun nga zjarri përmes krijimit të hapësirave për lëvizjen e automjeteve zjarrfikëse.

- *Inspektori nuk duhet të ketë paragjykime për sitin.*
- *Inspektimet që plotësohen me punë kërkimore, analiza dhe regjistrime të kryera me kujdes, nuk përbëjnë një qëllim në vetvete, por një mjet. Ato duhet të shërbejnë si mjeti që përdoret për veprimet në vijim.*
- *Veprimi i parë duhet të jetë hartimi i planit strategjik të mirëmbajtjes.*

Përvoja ka treguar se nëse plani i mirëmbajtjes zbatohet për dhjetë vjet radhazi, niveli i mirëmbajtjes që nevojitet gjatë një viti zvogëlohet në mënyrë të theksuar.

¹² Për sa i përket ndërtesave historike, normat e sugjeruara të punës për një arkitekt konservues me përvojë janë: 5 orë pune në terren për një ndërtesë të vogël; 10 orë pune për një ndërtesë më të ndërlikuar; dhe nga 20 deri në 40 orë pune për një ndërtesë të vështirë, ose të madhe. Sidoqoftë, objektet monumentale dhe komplekset, siç janë katedralet, mund të kërkojnë shumë më tepër kohë – mbi 1,000 orë pune.

Menaxhimi i konservimit të siteve historike mbi bazat e mirëmbajtjes parandaluese ka treguar se mund të kursehen para. Megjithatë, shumë administratorë nuk e kuptojnë këtë dhe nuk janë të gatshëm të autorizojnë inspektime të rregullta dhe të organizojnë një program mirëmbajtjeje për shkak të kostove të shërbimeve profesionale si dhe personelit të nevojshëm.

6.2.3 Monitorimi i programi të mirëmbajtjes

Pasi të ketë filluar zbatimin e programit të mirëmbajtjes, shpesh nevojiten vite për të ulur barrën e punimeve të mirëmbajtjes që janë përcaktuar nga inspektimet e para profesionale. Sidoqoftë, nëse kostot e parashikuara dhe ato reale kontrollohen dhe përditësohen në raport me inflacionin dhe luhatje të tjera, në fund kostoja totale do të jetë më e vogël se shumica e shpenzimeve të një sërë reagimesh “*ad hoc*”.

Për të lehtësuar monitorimin e kostos duhen vendosur sisteme kontabiliteti. Të gjithë personat e përfshirë në punime do të duhet të mbajnë regjistrin javor të orëve të punës, si dhe të përdorin klasifikimet dhe përshkrimet e duhura për punën që kanë kryer. Mbikëqyrësit duhet t’i kontrollojnë dhe t’i nënshkruajnë regjistrat e orëve të punës, duke bërë kujdes ndaj ndonjë mospërputhjeje në orare pune, si dhe duke parandaluar shpërdorimin apo vjedhjen e materialeve. Gjithashtu, mbikëqyrësit duhet të vendosin objektiva për secilin punonjës dhe të krahasojnë koston aktuale në kohë dhe materiale me koston e parashikuar në fillim.

□ *Menaxhimi dhe mbikëqyrja e mirë është e domosdoshme kur punët e mirëmbajtjes kryhen nga persona që janë të shpërndarë në vende të ndryshme, dhe merren me lloje të ndryshme pune. Mjeshtrit artizanë dhe konservuesit e përfshirë në këto detyra duhet të jenë në gjendje ta kuptojnë thelbin e punës së tyre.*

6.3 PROBLEME TË VEÇANTA

6.3.1 Vandalizmi dhe vjedhja

Në vitin 1851, gjatë Ekspozitës së Madhe në Londër nuk pati asnjë problem me sjelljen e publikut pavarësisht faktit se diamantet ishin ekspozuar pa asnjë lloj mbrojtjeje! Duket se respekti i publikut për pronën kulturore është përkeqësuar dukshëm gjatë shekullit të fundit. Ndoshta, ky përkeqësim është shkaktuar pjesërisht nga ndikimi që ka turizmi, edhe pse në këtë drejtim ka dallime shumë të mëdha mes shteteve dhe kulturave.

Të gjithë punonjësit, ashtu si dhe publiku, duhet të vihen në dijeni për detyrën që kanë për parandalimin e vandalizmit dhe vjedhjes, si dhe për raportimin e

menjëhershëm të çdo episodi të kësaj natyre. Punonjësit në uniformë duhet të jenë në gjendje të identifikojnë individët me prirje për të kryer vandalizëm, dhe duhet t'u afrohen atyre duke ruajtur një qëndrim pozitiv, duke i pyetur nëse mund t'i ndihmojnë dhe duke u shpjeguar diçka që mund t'u interesojë në lidhje me sitin. Duke reaguar në këtë mënyrë, mund të frenohen veprimet e shpërqendruara dhe injoranca e verbër që janë shpesh shkaktarë të vandalizmit. Disa aktivitete të tjera të rrezikshme përfshijnë hyrjen në zona të ndaluara për të mbledhur lule të egra dhe nderzjen e zjarreve për piknik. Këto lloj aktiviteteve me rrezikshmëri të lartë duhet të parandalohen përmes leksioneve prezantuese dhe shpërndarjes së kodit të sjelljes së mirë. Një mënyrë për të ulur rastet e vandalizmit dhe vjedhjes brenda ndërtesave, ose edhe për t'i eliminuar këto raste, është përdorimi i kamerave televizive të cilat regjistrojnë në kushte të dobëta ndriçimi duke përdorur rreze infra të kuqe. Komunikimi me radio mes punonjësve dhe qendrës së kontrollit mundëson monitorimin efikas të veprimeve të personave të dyshuar.

Vjedhja e materialit artistik dhe arkeologjik është kthyer në një industri të madhe ndërkombëtare. Përvoja tregon se asnjëri prej sistemeve të shumta të sofistikuar që janë zhvilluar për ta ndaluar këtë lloj vjedhjeje nuk është plotësisht efikas. Kontrolli i pikave të hyrjes në site dhe ndalimi i automjeteve në zonat më të ndjeshme ndihmon në rritjen e sigurisë, pasi hajdutët interesohen shumë për rrugëdaljet. Siguria është përgjegjësi e menaxherëve të sitit dhe nuk duhet të lihet vetëm në duart e rojeve të punësuar, të cilët thjesht do të rrisnin koston e sigurisë. Në këto raste, është mirë që të kryen këshillime me specialistë të fushës, të cilët duhet të marrin parasysh edhe mbrojtjen nga zjarri dhe sigurinë e personave që mund të ndodhen në objekt.

6.3.2 Lokalizimi dhe mbrojtja ndaj zjarreve

Zjarret e shkaktuara nga njerëzit janë zakonisht të parandalueshëm. Ndërsa zjarret e pyjeve përbëjnë një çështje krejtësisht të ndryshme, dhe duhen shqyrtuar në mënyrë të veçantë. Rrufetë mund të përbëjnë një rrezik të madh nëse nuk është instaluar sistemi i duhur i mbrojtjes, dhe nëse ky sistem nuk mirëmbahet rregullisht çdo vit. Shkatërrimi nga zjarri i pronës kulturore të pazëvendësueshme duhet të parandalohet duke zbatuar masa të ndryshme, siç janë masat e sigurisë për të ulur rrezikun nga zjarrvënia e qëllimshme, apo duke kufizuar pirjen e duhanit në vende të caktuara.

Një nga rreziqet më të mëdha të zjarrit janë instalimet me defekte elektrike. Instalimet elektrike duhet të kontrollohen një herë në vit, dhe do të duhet të zëvendësohen nëse janë përdorur mbi më shumë se njëzet vjet. Instalimet elektrike

mund të planifikohen nga e para, në mënyrë që gjatë natës të furnizohen vetëm shërbimet më të domosdoshme.

Sistemet e lokalizimit të zjarrit janë të ndjeshme ndaj zjarrit, tymit, ose nxehtësisë. Meqenëse ato shpesh mund të japin alarme të rreme, sensorët e ndryshëm të tyre duhet të lidhen me njëri-tjetrin në atë mënyrë që nëse aktivizohet njëri prej tyre, tjetri nuk shkakton një alarm të rremë, dhe nëse aktivizohen dy prej tyre atëherë aktivizohet edhe alarmi për zjarr. Në përgjithësi, sistemet e lokalizimit të zjarrit janë përshtatur për objekte tregtare, dhe funksionimi i tyre në lidhje me ndërtesat historike mund të jetë i kufizuar. Për rrjedhojë, menaxherët duhet të jenë të vetëdijshëm për këto kufizime. Aty ku është e mundur, duhet të instalohen dy sisteme të pavarura, pasi njëri prej tyre mund të dështojë gjatë një momenti kritik. Është e këshillueshme që sistemi i lokalizimit të lidhet drejtpërdrejt me stacionin e zjarrfikësve. Aparatet e dorës për fikjen e zjarrit (me pluhur, ose me gaz – siç është CO₂ – janë më të sigurta për pasuritë kulturore), zorrët e ujit dhe hidrantët e zjarrit duhet të vendosen me kujdes në sit, dhe duhet të jenë të shënuara qartë. Burimet vendore të ujit për shuarjen e zjarrit duhet të identifikohen dhe të regjistrohen.

Është e domosdoshme që i **tërë** stafi të ketë kualifikimin bazë për mbrojtjen nga zjarri, shuarjen e zjarrit dhe ndihmën e shpejtë. Ky kualifikim duhet shoqëruar me simulime të rregullta gjatë orarit të punës për të praktikuar procedurat në rast rreziku. Drejtori duhet të emërojë një Nëpunës për Parandalimin e Zjarrit.

Nëse zjarri nuk mund të vihet nën kontroll brenda tre minutave të para, pas pesë minutave ai fiton një fuqi që mund të jetë plotësisht shkatërruese. Kjo do të thotë se në rastin e atyre ndërtesave historike që ndodhen larg, është e këshillueshme që të instalohet një sistem automatik i mbrojtjes nga zjarri, i cili të paktën do të parandalonte shkatërrimin e plotë të ndërtesës. Përvoja e fituar në Norvegji, Japoni dhe Mbretërinë e Bashkuar mund të shërbejë si një shembull i vlefshëm udhëzues (shiko Organizatën për Mbrojtjen nga Zjarri, pa datë; dhe Larsen dhe Marsterin, 1992, në bibliografi).

Sistemet automatike të mbrojtjes nga zjarri me gaz dhe me impiante ujitës janë një investim i mirë, por si çdo aparat tjetër teknik modern ato duhen kontrolluar që konstruksioni i tyre të jetë i përshtatshëm me teknikat e instalimit në ndërtesat historike. Më parë, edhe pse të shtrenjtë, sistemet me gazra halogjenë janë konsideruar si forma më e mirë e mbrojtjes pasi përqendrimet e ulëta të gazit nuk rrezikojnë jetën e njeriut, ose pronën kulturore. Mirëpo së fundmi, është konstatuar se këto gazra dëmtojnë shtresën mbrojtëse të ozonit, dhe për rrjedhojë nuk përdoren më. Problemi me impiantet ujitës është se uji zakonisht e dëmton ndërtesën, duke shkaktuar rrezikun e rritjes së kërpudhave në materialin dhe përmbajtjet

e ndërtesës. Pavarësisht nëse përdoret ujë apo gaz, është e rëndësishme që të eliminohen alarmet e rreme në mënyrë që të shmanget harxhimi i panevojshëm i gazit – që kushton shtrenjtë –, apo qoftë edhe dëmtimet ndaj pasurisë kulturore.

- ❑ *Simulimet stërvitore për raste zjarri për punonjësit dhe përdorimi i aparateve për fikjen e zjarrit janë shumë të rëndësishme. Ndërkohë që edhe zjarrfikësit duhet të kryejnë një simulim stërvitor të paktën një herë në vit, duke pasur në dispozicion një hyrje të veçantë dhe disa pika kontrolli.*
- ❑ *Në rastin e qyteteve historike, duhet të ekzistojë plani strategjik për shuarjen e zjarrit që parashikon dy hyrje/dalje në të gjitha ndërtesat në rastin kur njëra nga rrugët është e bllokuar, dhe që gjithashtu siguron furnizimin e mjaftueshëm me ujë për shuarjen e zjarrit.*

Simulimet stërvitore për mbrojtjen nga zjarri do të nxjerrin në pah dobësi të cilat më pas mund të korrigjohen. Hapësirat që përdoren për shuarjen e zjarrit duhet të planifikohen dhe të përmirësohen në mënyrë që t'u mundësohet hyrja makinerive të mëdha të zjarrfikësve nëpër pikat kyçe. Duhet të sigurohet, gjithashtu, edhe furnizimi i bollshëm me ujë nga hidrantët, cisternat dhe burimet e tjera.

Mbrojtja pasive ndaj zjarrit – siç janë dyert e qëndrueshme ndaj zjarrit (që nuk mbyllen me çelës gjatë natës), perdet që i rezistojnë zjarrit dhe ndarja e hapësirave të çative – duhet të jetë gjithnjë e pranishme, pasi ndihmon në kufizimin e përhapjes së zjarrit. Në rastin e siteve natyrore, për mbrojtjen pasive ndaj zjarrit mund të përdoren edhe segmente brazdash të hapura në tokë.

PËRZGJEDHJA DHE SHËRBIMET E PERSONELIT

7.1 KOMISIONI I SITIT

Pasuritë kulturore botërore mund të ruhen dhe të mirëmbahen në mënyrë të përshtatshme vetëm nëpërmjet angazhimit në sit të një sërë nëpunësish të stërvitur, duke filluar nga nivelet më të larta politike dhe administrative, e deri te mjeshtrit artizanë, mbikëqyrësit e vendit, rojet dhe ciceronët. Gjithashtu, edhe më parë janë bërë rekomandime të cilat sugjerojnë që për secilin sit, apo grupim sitesh, të themelohet një komision i cili do të kryente funksionin e rojës së sitit të trashëgimisë kulturore. Struktura profesionale dhe administrative e Komisionit të Sitit mund të ndryshojë në varësi të situatës ose sitit në secilin shtet, por në të gjitha rastet pjesëtarët e tij duhet të jenë profesionistë me përvojë në fusha të ndryshme (arkitektë, arkeologë, planifikues, juristë, etj). Po ashtu, do të ishte në interesin e sitit të Trashëgimisë Botërore që marrëdhënia e Komisionit të Sitit me qeverinë qendrore të ndërtohet në mënyrë të tillë që t'i lejojë Komisionit lirinë e mjaftueshme për të vepruar në mënyrë të pavarur. Komisioni i Sitit duhet të mbajë lidhje të ngushta me Komitetin e Trashëgimisë Botërore, i cili mund të japë përkrahjen e tij aty ku do të jetë e nevojshme.

- ❑ *Roli i Komisionit të Sitit përfshin informimin e publikut mbi rëndësinë e sitit të Trashëgimisë Botërore; qoftë ky një monument i izoluar, një ndërtesë historike, një bërthamë historike e qytetit apo një kompleks industrial. Detyra e tij është që të pranojë dhe të zbatojë konventat dhe kartat ndërkombëtare, duke patur parasysh ligjet vendore si dhe rregullat dhe zakonet e brendshme. Për më tepër, Komisioni duhet dhe të përcaktojë dhe të mbikëqyrë zbatimin e mënyrave më të pranueshme të mirëmbajtjes, duke e përdorur dhe duke e mbrojtur sitin që ka nën kontroll.*

Kur bëhet fjalë për sitet e Trashëgimisë Botërore, interesat vendore shpesh bien në kundërshtim me qëllimet kombëtare dhe ndërkombëtare. Komisionet përgjegjëse të sitit duhet të pajtojnë interesat legjitime të vendasve me interesat e njerëzve që vizitojnë sitin. Njëra prej çështjeve më të rëndësishme që duhet zgjidhur është niveli i turizmit. Turizmi intensiv mund ta shqetësojë jetën e popullsisë vendore duke i ulur vlerën ose duke çuar deri në rrënimin e kulturës së banorëve.

7.2 PËRZGJEDJHA E PUNONJËSVE PËR MENAXHIMIN E PËRGJITHSHËM

7.2.1 Përzgjedhja e ekspertëve dhe profesionistëve

Lista e profesionistëve të cilët do të mund të përfshiheshin në nivele te ndryshme në menaxhimin e trashëgimisë kulturore është e gjatë.

• administratorë	• koleksionistë	• arkivues të trashëgimisë
• antropologë	• artizanë	• historianë
• antikuarë	• kuratorë	• hidrologë
• arkeologë	• dokumentues	• arkitektë të peizazheve natyrore
• arkitektë	• ekologjistë	• ligjvënës
• konservues arkitektonikë	• historianë ekonomie	• studiues të mineraleve
• arkivistë	• inxhinierë	• muzeologë
• historianë arti	(të të gjitha llojeve)	• petrologë
• biologë	• entomologë	• politikanë
• botanistë	• etnologët	• menaxherë pronash
• roje ndërtesash	• gjeografë	• sizmologë
• kimistë	• gjeologë	• sociologë
		• anketues

Lista e paraqitur më lart nuk është një listë e plotë. Ajo thjesht tregon spektrin e aftësive të nevojshme, duke u bërë të ditur të rinjve se në fushën e konservimit të pronës kulturore ka mundësi të shumta punësimi, pasi kjo fushë është në zhvillim e sipër.

□ *Meqenëse përshihen kaq shumë fusha, është shumë e rëndësishme që puna në praktikë të udhëhiqet nga koncepte të qarta. Kjo do të thotë se zbatimi i punimeve duhet kryer përmes ndërthurjes së aftësive gjatë punës fizike, dijeve shkencore dhe ndjeshmërisë artistike e historike që fitohet nëpërmjet përgatitjes në fushën kulturore. Konservimi do të dështojë në arritjen e objektivave të tij nëse mungojnë konceptet dhe parimet e qarta.*

Përzgjedhja e ekspertëve mund të jetë e vështirë. Organizatat dhe institucionet profesionale mund të shërbejnë si një pikënisje për të gjetur burime njerëzore.

Është e rekomandueshme që ekspertët të shërbejnë në detyrë për të paktën shtatë vjet, në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia; dhe jo më shumë se dymbëdhjetë vjet, përveç atyre rasteve kur ata tregojnë se janë ndërgjegjësuar mbi konceptet dhe praktikatat e reja. Ashtu si dhe në fushën e mjekësisë, eksperti i konservimit duhet të pranojë gjithnjë që të marrë një mendim të dytë, apo edhe të tretë, të pavarur.

7.2.2 Kualifikimet e burimeve njerëzore

Kërkesat e kualifikimeve për përzgjedhjen e punonjësve duhet të vendosen vetëm pasi të jetë vlerësuar niveli i aftësive të nevojshme dhe i detyrave për secilën fushë. Buxheti i rrogave duhet ndërtuar në bazë të përvojës vendore dhe ligjeve kombëtare mbi nivelin e rrogave sipas profesioneve. Në disa shtete niveli i rrogave të paracaktuara me ligj është tepër i ulët, dhe personeli shpesh joshet nga rroga më të larta që ofrohen prej industrisë ose tregtisë.

- ❑ *Komisioni i Sitit duhet të vendosë nivelin e tij të rrogave. Niveli i rrogës për mjeshtrit artizanë me përvojë duhet përlllogaritur në mënyrë të ngjashme me nivelin e rrogave të teknikëve, dhe jo si nivel rrogash për punëtorët e punës fizike. Po ashtu, duhet të ketë edhe një marrëveshje me Shtetin Anëtar që të bëhet rishikimi në intervale të rregullta kohore i fondeve që janë në dispozicion të rrogave, për shkak se mund të rriten nevojat si dhe mund të zhvillohen aktivitete në fusha të reja.*

Zgjidhja më e mirë do të ishte që fillimisht të emërohet personelin kyç, e më pas, sipas nevojës, të punësohet personeli që luan një rol përkrahës. Fillimisht, me personelin mund të lidhen kontrata për një kohë provë, dhe aty ku është e përshtatshme, mund të lidhen më tej kontrata të gjata pune.

Shumë qeveri mund të kenë dëshirë për t'i menaxhuar vetë burimet e trashëgimisë kulturore botërore në mënyrë të drejtpërdrejtë, për të rritur prestigjin politik si dhe për të vendosur një sistem klientelist gjatë qeverisjes së tyre. Kjo gjë mund të bjerë në kundërshtim me interesin për të interpretuar vlerat e qenësishme kulturore të sitit, pasi përfaqësues të qeverisë mund t'i mungojë ndjeshmëria, elasticiteti dhe shpejtësia e nevojshme për marrjen e vendimeve; elemente këto që karakterizojnë një Komision Siti që është efikas dhe që ruan distancën e nevojshme nga qeveria. Kjo nuk do të thotë se duhet mohuar interesimi legjitim i qeverisë në menaxhimin e sitit, pasi qeveria do të jetë përgjegjëse për emërimin e anëtarëve të Komisionit të Sitit si dhe për emërimet e reja në kohën e duhur.

7.2.3 Nevoja për personel të kualifikuar

Nevoja për personel të kualifikuar është e natyrshme duke marrë parasysh se një sit i Trashëgimisë Botërore është realisht e pazëvendësueshme. Edhe pse vlera monetare nuk duhet të merret si një kriter absolut, kosto e shpëtimit të burimeve kulturore nga shkatërrimi mund të vlerësohet më mirë kur vendoset në raport me koston e zëvendësimit të një burimi të trashëgimisë.

Administratorët në fushën e konservimit duhet të jenë në gjendje t'i kuptojnë mirë pikat e forta dhe të dobëta të personelit të ndryshëm që është angazhuar në aktivitetet e konservimit. Pengesat në sigurimin e sasive të vogla të produkteve dhe shërbimeve të veçanta përbëjnë një element të procesit të administrimit që shpesh shkakton një nervozizëm të theksuar tek punonjësit. Disa kufizime mund të jenë të nevojshme për arsye politike ose financiare kur flitet për shuma të mëdha parash, por për hir të efikasitetit konservuesve duhet t'u lejohet që të porosisin produktet në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe në sasi të vogla, sepse shpesh për këto lloj produktesh ekziston një furnizues i vetëm në tërë botën. Nuk është vetëm koha ajo që bën dallimin – le të themi 1 muaj kundrejt 2 viteve –, por duhet marrë parasysh gjithashtu edhe dëmi që mund të shkaktohet gjatë vonesës. Kosto e përpilimit të shkresave për të shqyrtuar këto kërkesa të vogla shpesh e tejkalon në mënyrë të konsiderueshme koston e vetë produktit që nevojitet.

- *Vonesat në marrjen e vendimeve ulin efikasitetit dhe rrisin koston, sepse përkeqësimi i gjendjes së burimit kulturor nuk është diçka që ndalon, por në të kundërt ai përshpejtohet, dhe nganjëherë edhe krejt papritur brenda një kohe të caktuar. Komisioni i Sitit dhe Drejtori duhet të punojnë së bashku për t'i kufizuar vonesat administrative.*

7.2.4 Roli i profesioneve të konservimit

Fusha e konservimit përfshin një gamë të gjerë aftësish të profesioneve të ndërtimit: që nga punët më të thjeshta të riparimit dhe mirëmbajtjes së shtëpive, e deri te punët më të ndërlikuara që kërkojnë aftësi shumë të specializuara. Personat të cilët kryejnë këto lloj punimesh të specializuara duhet të klasifikohen si teknikë të fushës së konservimit, dhe duhet t'u jepet e njëjta pozitë e barabartë me atë të specialistëve të tjerë në fushën e konservimit. Akrepat e orës nuk mund të kthehen mbrapa dhe larmia e madhe e zanateve të shekullit të tetëmbëdhjetë dhe të nëntëmbëdhjetë nuk mund të rikrijohet në mënyrë artificiale.

Sidoqoftë, një mjeshtër i ri në moshë, por që ka fituar mjaftueshëm përvojë, mund të fitojë edhe aftësi të reja, dhe nëpërmjet disa udhëzimeve artistike, zotësisë

në zbatim dhe ndihmës së shkencës mund të riprodhohen vepra artizanale të së kaluarës.

- *Në fakt, aftësitë fitohen me kalimin e kohës, me përvojë dhe me stërvitje. Drejtimit e dhëna nga mjeshtrit artizanë me përvojë janë thelbësore për të siguruar vazhdimësinë, dhe seminarët e organizuara në sit e lehtësojnë këtë proces. Mjeshtrit artizanë të konservimit duhet të kuptojnë historinë e teknologjisë së zanatit të tyre, si dhe të jenë në gjendje të analizojnë mënyrën se si janë organizuar dhe zbatuar punimet historike. Disa shembuj punimesh të zhvilluara në të kaluarën duhet të grumbullohen dhe të përdoren si referencë (siç bëhet në Amsterdam, Holandë, dhe në Torun, Poloni).*

7.2.5. Puna e mirë

Puna e mirë varet pjesërisht nga pagesa e drejtë dhe e përshtatshme për ditën e punës. Puna e kryer jashtë orarit dhe punimet e kryera pjesë-pjesë për një vepër të caktuar nuk kanë sjellë rezultate të mira, dhe këto metoda nuk duhet të përdoren për të rritur rendimentin kur bëhet fjalë për punën e kryer në një sit të Trashëgimisë Botërore.

Puna e mirë është rezultat i kualifikimit të përshtatshëm profesional, vazhdimësisë në punë dhe vlerësimit dhe respektit ndaj statusit të punonjësit. Mjeshtrit artizanë janë personat kryesorë që mbajnë përgjegjësinë për cilësinë e punës. Fatkeqësisht, industria e ndërtimit e ditëve të sotme ka objektiva të ndryshme krahasuar me ato të së kaluarës, duke e vendosur theksin mbi sasinë, dhe shpesh edhe duke shpërfillur përdorimin e aftësive të mjeshtërve artizanë.

Aftësia për të vlerësuar cilësinë e punës varet vetëm nga përvoja e fituar gjatë inspektimeve të shumta të ndërtesave të periudhave të ndryshme historike. Komisioni i Sitit duhet të marrë në konsideratë mundësinë e angazhimit të një force punëtore të specializuar për punimet në sit, duke kryer kontrollet e nevojshme buxhetore që do të mundësonin një rendiment me cilësi të lartë dhe kosto sa më të ulët.

7.3 SHEMBUJ AFTËSISH TË LIDHURA ME KONSERVIMIN

Numri i profesionistëve të konservimit që janë të përfshirë në procesin e trajtimit të siteve të Trashëgimisë Botërore është i madh, por për sa i përket kategorive të profesioneve më kryesore në vijim janë parashtruar disa komente:

- arkitektët e konservimit dhe ekipet e tyre të bashkëpunëtorëve;
- konservuesit arkitekturorë;
- konservuesit e artit dhe arkeologjisë; dhe
- dokumentuesit e trashëgimisë

Shumica e profesionistëve që punojnë në fushën e konservimit arkitektonik janë mësuar të punojnë në ekip dhe të bëjnë kompromise që janë në të mirë të punës. Për më tepër, ata duhet të kenë njohuri mbi historinë, dhe posaçërisht mbi historinë e stileve dhe teknologjisë, si dhe të kuptojnë rolin që duhet të luajnë mjeshtrit artizanë, historianët e artit dhe arkeologët.

7.3.1 Arkitektët e konservimit dhe ekipet e tyre të bashkëpunëtorëve

Arkitektët e konservimit – të njohur edhe si arkitektë restaurues apo arkitektë të ndërtesave historike – duhet të kenë një përvojë bazë si arkitektë të përgjithshëm në praktikë. Ata duhet të kenë njohuri mbi kuptimin e teknologjive të hershme të ndërtimit, si dhe aftësinë për të identifikuar dhe interpretuar materialin origjinal të objektit dhe shtesat e mëvonshme. Gjithashtu, këta arkitektë duhet të jenë në gjendje të koordinojnë punën e arkeologëve, historianëve, inxhinierëve, planifikuesve, urbanistëve, kontraktuesve, furnizuesve, mjeshtrëve artizanë të konservimit, konservuesve dhe personave të tjerë të cilët mund të jenë të përfshirë në projektin e konservimit.

Arkitekti i konservimit (arkitekti i restaurimit) është individ që zotëron një larmi njohurish të përgjithshme në lidhje me procesin e konservimit të ndërtesave. Ai/ajo duhet të ketë njohuri të mira mbi të gjitha periudhat e arkitekturës, të kombinuara me njohuri të gjera rreth praktikave bashkëkohore të ndërtimit. Këto njohuri janë të domosdoshme për vlerësimin dhe ruajtjen e vlerës historike dhe artistike të sitit të trashëgimisë, brenda të cilës duhet të plotësohen edhe nevojat bashkëkohore. Këto nevoja përfshijnë edhe zbatimin e punimeve në përputhje me kodin e punës dhe rregulloren e ndërtimit që është në fuqi. Këta individë duhet të jenë të aftë edhe që të mundësojnë marrjen e lejeve për t'u përfshirë nga zbatimi i atyre neneve të rregullores së ndërtimit dhe kodit të punës që mund të jenë të pazbatueshme për raste të veçanta, duke u bazuar mbi një arsytim që i referohet parimeve themelore. Krahas njohjes së teknologjisë së ndërtimit, është tepër e rëndësishme që arkitekti i konservimit të njohë mirë edhe patologjinë e ndërtesave (siç mund të jenë shkaqet e fundosjes së themeleve, e shembjes së mureve dhe e kalbjes së drurit).

Ekziston shpresa që në të ardhmen do të specializohen më shumë **kontraktues**

ndërtimi në riparimin dhe mirëmbajtjen e objekteve, dhe se do të shfaqet një brez i ri teknikësh konservimi me njohuri të mira mbi historinë e teknologjisë së profesionit të tyre, të cilët do të kenë të njëjtin status dhe pagesë që kanë edhe arkitektët. Roli që luajnë **inxhinierët** e drejtimeve të ndryshme është me rëndësi të madhe për punimet konservuese, sidomos roli i inxhinierëve të ndërtimit. Inxhinierët duhet të marrin kualifikimet e përshtatshme profesionale për të kuptuar mënyrën e trajtimit të materialeve të vjetra, si dhe për të qenë në gjendje për të bashkëpunuar me ekipet e punës së konservimit. Ndosht shpesh që dëmet të shkaktohen më shumë nga trajtimet e gabuara (metodat, materialet) sesa nga neglizhenca.

7.3.2 Konservuesit arkitekturorë

Vështirësitë që hasin arkitektët e konservimit në identifikimin dhe komunikimin efikas me shkencëtarë të cilët i kuptojnë problemet e tyre ka bërë që *Këshilli Kombëtar Amerikan për Këshilla në Fushën e Konservimit (American National Conservation Advisory Council)* të rekomandojë njohjen e nevojës për një nivel më të lartë specializimi në fushën e konservimit arkitekturorë. Personat me këto përgjegjësi të veçanta do të quheshin Konservues Arkitekturorë dhe do duhet të zotëronin një gamë më të gjerë aftësish, qoftë në krahasim me ato të arkitektit të restaurimit (historik), qoftë edhe me ato të konservuesit të artit.

Konservuesit arkitekturorë duhet të marrin kualifikime profesionale (trajtime) rreth teknologjive të reja dhe metodave shkencore laboratorike të cilat zbatohen në fusha të tjera për konservimin e objekteve të krijuara nga njeriu. Për më tepër, ata duhet të fitojnë njohuri edhe në disa nëndegë të kimisë, siç është analiza spektrografike, datimi radiokarbonik dhe analiza e rezistencës. Ata duhet të dinë të përdorin teknikat e reja arkeologjike për analizimin e provave në vendndodhje, teknologjinë e kompjuterëve për nxjerrjen e informacionit të regjistruar, fotogrametrinë për punimin e vizatimeve me dimensione të sakta, si dhe të dinë të zgjidhin problemet e vështira që lidhen me dokumentimin e objektit. Për momentin, ekzistojnë shumë pak persona të tillë.

7.3.3. Konservuesit e artit dhe të arkeologjisë

Në disa vende të botës, kërkimet arkeologjike janë të detyrueshme para fillimit të çfarëdolloj ndërhyrjeje, dhe kjo praktikë duhet të zbatohet edhe në rastet e vendndodhjeve të Trashëgimisë Botërore. Konservuesit e artit dhe arkeologjisë duhet të kenë aftësi të mira në punën në praktikë dhe punën me dorë; si dhe duhet të kenë marrë kualifikimet përkatëse në fushën e historisë së artit dhe në fushat

shkencore. Por mbi të gjitha, ata duhet të kenë një “sy të mprehtë”. Ky kombinim aftësish është i rrallë, pasi sistemi aktual arsimor nuk arrin dot të ndërtojë këtë lloj ndërlidhjeje hibride mes shkencave ekzakte dhe atyre shoqërore. Shkathtësia në punën në praktikë është diçka thelbësore, megjithatë një diplomë akademike në degën e historisë së artit, arkeologjisë, apo antropologjisë mbetet gjithnjë një pikënisje e mirë. Megjithatë, pavarësisht diplomës, gjithnjë u duhet shtuar diçka më shumë njohurive akademike.

Konservuesit e artit dhe arkeologjisë i fitojnë njohuritë përmes kurseve akademike në universitet, por megjithëse këto kurse zhvillojnë aftësitë e tyre intelektuale, ato nuk u mësojnë studentëve aftësitë e administrimit, bashkëpunimit, apo punës në skuadër. Do të ishte një ndihmë për ta nëse gjatë kurseve akademike do të merrej parasysh edhe historia e zhvillimit të degës së tyre, duke i transmetuar atyre njohuri të vlefshme mbi rëndësinë e degës që po studiojnë, si dhe mbi ide të reja që mund të ndikojnë gjatë planifikimit afatgjatë në fushën e tyre. Në të vërtetë, ekzistojnë edhe disa kurse të specializuara për konservuesit. Këto kurse janë renditur në Listën e kurseve të formimit profesional (“*Training Directory*”) të ICCROM-it. Për formimin e plotë profesional të një konservuesi me një mori aftësish në fusha të ndryshme, nevojitet një kualifikim i konsiderueshëm që përfshin përvojën e fituar në punën në terren dhe specifikisht në vendndodhjet e trashëgimisë. Teoria dhe kualifikimet akademike nuk janë të mjaftueshme.

7.3.4 Dokumentuesit e trashëgimisë

Regjistrimi dhe dokumentimi i trashëgimisë në shumë vende të botës është zhvilluar si një profesion i specializuar. Edhe pse konservuesit mund të jenë të përfshirë në regjistrime dhe dokumentime të një siti, duke kryer edhe raportimin rreth inspektimeve dhe rievimeve, kompleksiteti i procesit të dokumentimit të saktë dhe të menaxhuar në mënyrë racionale ka krijuar nevojën për të pasur dokumentues të specializuar në fushën e trashëgimisë. Këta të fundit duhet të jenë në gjendje të lexojnë dhe të kuptojnë karakterin dhe vlerat e siteve të trashëgimisë, që t’i dokumentojnë ato në mënyrën e duhur. Për më tepër, dokumentuesit duhet të jenë të informuar mbi standardet bashkëkohore të dokumentimit, të zotërojnë njohuri mbi teknologjitë që kanë lidhje me këtë fushë, të krijojnë lidhjet me qendrat e dokumentimit dhe të punojnë në bashkëpunim të ngushtë me konservuesit e tjerë të trashëgimisë, duke u bazuar në objektiva të përbashkëta.

7.4 REKRUTIMI DHE KARRIERAT

Zakonisht, angazhimi në fushën e konservimit vjen pas marrjes së diplomës për nivelin e parë universitar, por në këtë fushë duhet lejuar edhe angazhimi i teknikëve dhe mjeshtëreve artizanë që kanë potencialin e duhur dhe që janë të gatshëm të studiojnë. Kurset e formimit profesional në distancë – si ato të Universitetit të Hapur (Open University) në Mbretërinë e Bashkuar – mund ta zgjerojnë numrin e kandidatëve që mund të angazhohen në këtë fushë.

Megjithëse ende ka mbetur pa u përfunduar një nivel i madh punimesh në fushën e konservimit (p.sh.: vetëm për një muze kombëtar është vlerësuar se ende kanë mbetur rreth 250 vjet punë për t'u bërë), disa konservues nuk kanë mundur dot të punojnë për shkak të mungesës së fondeve, ndërsa në disa shtete puna nuk është kryer për shkak se nuk janë gjetur ekspertët e duhur. Kjo situatë e pështjelluar është shkaktuar si pasojë e faktit që qeveritë (me disa përjashtime të dukshme, siç është Polonia) nuk e kanë zgjidhur çështjen e financimit të fushës së konservimit, dhe nuk kanë ndërtuar një strukturë për zhvillimin dhe klasifikimin e karrierave në këtë fushë. Meqenëse nevojiten të paktën rreth 20 vjet që një shërbim i kryer në fushën e konservimit të bëhet realisht funksional, është e këshillueshme që të themelohet një komitet qendror për ta udhëhequr këtë proces, siç është Komiteti Këshillimit i Shteteve të Bashkuara për Fushën e Konservimit (*State Advisory Committee for Conservation*). Ish Bashkimi Sovjetik ka pasur një strukturë interesante të zhvillimit të karrierës për akademikët dhe mjeshtër artizanët që punonin në fushën e konservimit.

Konservuesit duhet të renditen në nivel të barabartë me përgjegjësit e ekspozitave të muzeve, dhe nëse kanë interes të mësojnë më shumë mbi menaxhimin, atyre duhet t'u ofrohen mundësi të njëjta me profesione të tjera për t'u emëruar në poste drejtuese, siç ndodh në Mbretërinë e Bashkuar. Sfidat që lindin nga nevoja për të menaxhuar sitet e Trashëgimisë Botërore, duhet të shërbejnë si një stimul për Shtetet Anëtare për t'i shtyrë ata ta rishikojnë të gjithë çështjen e rekrutimit dhe të karrierave në fushën e konservimit. Procedurat normale duhet të zbatohen edhe në rastet e emërimeve. Disa prej aftësive që duhen vlerësuar shumë janë aftësitë në praktikë, iniciativa, si dhe aftësia për të improvizuar.

7.5 AMBIENTET E PËRDORURA PËR KONSERVIMIN

Në mënyrë që procesi i konservimit të funksionojë në rregull, nevojiten nivele të ndryshme punësimi dhe mbështetjeje.¹³

13 Për një diskutimin rreth kësaj çështjeje, shiko: R.M. Organ, në bibliografi.

Ekziston nevoja për të ndërtuar **qendra të mirëfillta dokumentimi**, siç janë bibliotekat dhe arkivat, të cilat mund të ruajnë materialet e burimeve të trashëgimisë dhe të dhënat mbi to. Për më shumë, nevojiten edhe hapësira për prodhimin e regjistrimeve fotografike, fotogrametrike dhe të vizatimeve bazuar mbi matjet në terren – që nga vizatimet me dorë të lirë e deri tek ato të punuara me Auto-CAD, përfshi këtu edhe përdorimin e teknikave të përpunimit të imazheve. Ndërkohë që ato site të trashëgimisë që janë më të mëdha shpesh kanë nevojë për njësitë e tyre të veçanta të dokumentimit, në disa raste mund të përdoren edhe njësi qendrore dhe laboratorë fotogrametrie.

Ambientet e konservimit për punën kërkimore shkencore dhe trajtimin e burimeve të trashëgimisë mund të kategorizohen në bazë të funksionit të tyre, dhe brenda një kategorie mund të përshkruhen funksionet specifike që ndryshojnë në varësi të detyrave që janë përcaktuar për profesionistët e fushës së konservimit që i përdorin këto ambiente. Këtu mund të përfshihen mjeshtrit artizanë, restauruesit e fushës së konservimit, shkencëtarët e shkencave të aplikuara dhe ata të punës kërkimore akademike.

- **Punishtja e artizanatit** ka disa funksione që përfshijnë punë të tilla si vendosjen e kornizave, shtresëzimi apo petëzimin. Një objekt futet në një punishte vetëm për t'i kryer një trajtim specifik. Ekzaminimi është i kufizuar në mbledhjen e të dhënave përgatitore për një trajtimin specifik. Në një punishte të tillë mund të perfeksionohet një numër specifik dhe i ngushtë aftësish praktike, duke rritur kështu edhe rendimentin e secilit individ. Tipi dhe cilësia e materialeve të përdorura zakonisht janë ato që përdoren edhe në punishte të tjera të ngjashme, por edhe kërkesat e veçanta të një klienti mund të plotësohen nëse klienti është i gatshëm të japë një pagesë shtesë.

Në fushën e konservimit është dora ajo që shpesh e informon trurin, kështu që aftësitë në punën në praktikë janë tepër të rëndësishme. Megjithatë, përvoja shumëvjeçare e fituar në praktikë nga mjeshtrit artizanë shpeshherë nënvlerësohet. Duhet pasur parasysh fakti se është shumë më e lehtë të fitohen njohuri shkencore, apo të mësohet historia e artit, sesa të specializohesh në punë artizanale. **Procedurat e një profesioni të caktuar mbajnë të mishëruara në to teknologjinë e së kaluarës, dhe pa kuptuar së pari rrjedhën logjike të kësaj teknologjie, çdo propozim për të sjellë ndryshime do të ishte i nxituar.**

- Një **hapësirë e vogël për praktikën e konservimit** mund të drejtohet ndoshta edhe nga një person që ka eksperiencën dhe njohjen e duhur në

fushën e konservimit, i cili mund të ketë në dispozicion edhe disa asistentë që mbase nuk kanë marrë kualifikimin zyrtar në këtë fushë. Në këtë hapësirë mund të trajtohen një sërë objektesh. Hapësira mund të përdoret për të kryer ekzaminime të ndryshme për të përcaktuar llojin e trajtimit, por funksioni kryesor i hapësirës do duhet të jetë zbatimi i ndërhyrjeve të ndryshme bazuar mbi përvojën e fituar. Në këtë hapësirë përdoren vetëm materiale të kontrolluara dhe të miratuara paraprakisht. Punonjësit që merren me objektet në këtë hapësirë, duke i lëvizur, ruajtur dhe ekspozuar ato, duhet të respektojnë një rregullore të brendshme.

- **Një hapësirë për t'u marrë me objekte të ndryshme nga koleksione specifike të ndryshme por lidhura ngushtë me njëra-tjetrën** duhet të ketë si të punësuar konservues restoratorë të cilët kanë përvojën përkatëse për secilën kategori të objekteve që gjendet në këto koleksione. Këtu, ekzaminimi do të kryhet në mënyrë më të detajuar në krahasim me hapësirat e lartpërmendura. Megjithatë, duke marrë parasysh përvojën e konsiderueshme të punonjësve, gjendja e shumicës së objekteve do të mund të përcaktohet lehtë edhe me sy të lirë. Në ndonjë rast, do të duhet të kryhen edhe analiza laboratorike për të konfirmuar atë që ka konstatuar me sy konservuesi restorator. Një hapësirë e tillë do duhet të ishte e kompletuar me të gjitha pajisjet në mënyrë që të ruhet e njëjta cilësi konservimi e barabartë me atë të një muzeu. Praktika të tilla në këtë lloj hapësire do të rezultojnë shumë produktive, pasi përmes përvojës së gjatë të fituar nga kontakti i drejtpërdrejtë me objektet, do të zhvilloheshin njëkohësisht edhe aftësitë në punë.
- **Laboratori i konservimit** ndërtohet për të ekzaminuar në brendësi ato objekte të cilat nuk mund të analizohen përmes një trajtimi të zakonshëm. Këtu hartohen procedurat e reja dhe përdoren materiale të veçanta për zgjidhjen e problemeve specifike të konservimit. Në një laborator të tillë duhet të punësohen individë të kualifikuar në shkencat ekzakte dhe në përdorimin e pajisjeve të ndërlikuara analitike. Personeli përgjegjës për trajtime të ndryshme duhet të jetë i përbërë nga individë me një mendje të mprehtë, të cilët janë novatorë dhe zotërojnë aftësi të shumta në një gamë të gjerë aktivitetesh. Nuk është e thënë që këta individë të kenë shumë përvojë në ndonjë kategori të caktuar objektesh. Për më tepër, numri i objekteve që do trajtohet nga secili pjesëtar i stafit do të jetë shumë më i vogël sesa ai i trajtuar në hapësirat e tjera të lartpërmendura. Për të mundësuar trajtimin e problemeve të vështira të konservimit, rekomandohet që secili shtet të ketë të paktën një laborator të tillë.

- Hapësira e fundit reflekton pastër shumëllojshmërinë dhe thelbin e ekzaminimeve që kryhen nga shkencëtarët hulumtues, të cilët zakonisht janë studentë të doktoraturës në **departamente universitare që kanë në dispozicion edhe pajisjet e nevojshme**. Këta individë zakonisht trajtojnë objekte që iu është verifikuar origjina, por që nuk bartin domosdoshmërisht cilësi artistike. Megjithatë këta laboratorë zakonisht nuk janë të lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me koleksione të ndryshme, ata nuk mund të ekzistojnë pa këto koleksione.

Kjo paraqet plotësimin shkencor për studimin stilistik të historianëve të artit. Shkencëtarët nganjëherë mund të punojnë me kampione të vogla, të nxjerra nga pjesët e padukshme të objekteve me vlerë. Në një situatë të tillë nuk këshillohet asnjë lloj trajtimi përveç atyre rasteve kur shkencëtari është plotësisht i vetëdijshëm për estetikën e objektit si dhe zotëron aftësitë e duhura për trajtimin në fjalë. Por, pa pasur ato njohuri bazë që fitohen përmes studimeve të gjera dhe të hollësishme, konservuesi i një objekti specifik mund të mos i ketë të dhënat e duhura për përzgjedhjen e një metode të përshtatshme trajtimi.

Në rastet kur kemi të bëjmë me projekte të mëdha në të cilat puna e konservimit zgjat me vite të tëra, duhet kryer një baraspeshim i punës së personelit nëpër kategoritë e ndryshme të punës. Për shembull tre apo katër mjeshtër artizanë të konservimit të nivelit A mund të punojnë së bashku me një konservues, apo restaurator të nivelit C, të këshilluar nga një shkencëtar hulumtues i nivelit D, dhe të koordinuar nga një profesionist i përgjithshëm, siç mund të jetë një arkitekt apo një *kurator* (përkujdesës). Përgjegjësia për vlerësimin e saktë të numrit të punonjësve që nevojiten në secilin nivel të punës i takon konservuesit restaurator, nga ku varet dhe efikasiteti në punë. Një skuadër ka nevojë për një udhëheqës që është i aftë të organizojë dhe të sigurojë ekuilibrin e duhur midis aftësive të ndryshme të punonjësve si dhe të punojë në harmoni me ta. Udhëheqësi duhet të jetë i motivuar nga ambicia për të kryer një punë sa më të mirë dhe jo nga rivaliteti apo praktikat kufizuese për punëtorët e tjerë.

7.6 MENAXHIMI I PERSONELIT

Është shumë e rëndësishme që përgjegjësitë të delegohen për secilin nivel pune, në mënyrë që personeli të mund të ketë mundësi të marrë vendimet e duhura si dhe të ketë autoritetin për t'i zbatuar ato. Por, secili nëpunës duhet të japë llogari para dikujt në pozitë më të lartë, dhe kjo nënkupton që menaxherët e nivelit të lartë duhet të kenë marrë një orientim profesional lidhur me punën që kryejnë.

Administratorët nuk janë të kualifikuar të marrim vendime teknike, artistike, apo mjedisore që përbëjnë dhe thelbin e konservimit. Një menaxher i mirë duhet t'i udhëheqë punonjësit duke u lejuar atyre të japin mendimin përkatës kur bëhet fjalë për marrje vendimesh. Në këtë mënyrë, menaxheri do të ndikonte pozitivisht tek punonjësit duke ndërtuar një moral të lartë dhe duke rritur nivelin e kënaqësisë në vendin e punës – gjë që çon drejt një pune rezultative.

Ngritja në pozitë e punonjësve duhet të realizohet duke u bazuar kryesisht mbi meritat dhe iniciativën, pasi fusha e konservimit është në zhvillim e sipër. Vitet e gjata në shërbim dhe kontributi i dhënë mund të shpërblehen me rritje vjetore të rrogës (mbi rritjen për inflacionin dhe koston e nivelit të jetesës).

7.6.1 Shërbimet e kontraktuara

Meqenëse fusha e konservimit është aq e gjerë dhe ndodh që aftësitë profesionale dhe pajisjet e duhura të mos jenë në dispozicion për një sit, do të jetë e nevojshme që shpesh të kontraktohen ekspertë të pavarur. Sigurisht që është më e leverdishme nga ana ekonomike nëse puna e kontraktuar jashtë personelit të përhershëm bëhet për ato veprimtari të cilat kërkojnë pajisje të sofistikuara që mund të mos nevojiten më në të ardhmen, dhe që mund të mos përdoren rregullisht, apo të cilat edhe do të kërkonin një kualifikim profesional të posaçëm për punonjësit. Ndodh që palë të treta të kontraktohen për të kryer punë edhe për vetë faktin se punonjësit mund të jenë tepër të ngarkuar me detyrat e tyre të zakonshme në punë. Megjithatë, para se të merret ky vendim duhet kërkuar mendimi i vetë punonjësve, të cilët nëse nuk pyeten mund të ndihen të anashkaluar dhe t'u ulet morali, ose mund të mendojnë se menaxhuesit e kanë humbur besimin tek ta (gjë që duhet të diskutohet brenda kolektivit nëse rezulton e vërtetë).

Përpilimi i kontratave të drejta dhe të paanshme kërkon shumë aftësi. Do të ishte në të mirën e punës nëse para firmosjes së kontratës të kryej së pari një vizitë nga kontraktuesi, dhe ai/ajo të ftohej që të merrte pjesë në hartimin paraprak të kontratës. Misionet e huaja shfaqin gjithnjë probleme komunikimi. Një person me kualifikimet e duhura duhet të ndihmojë në përcaktimin e detyrave specifike që duhen zbatuar nga kontraktuesi. Në rastin ideal, ai person që do ta jepte këtë ndihmë do të ishte dikush që ka marrë pjesë në një kurs të ICCROM-it, ose një anëtar i Institutit Ndërkombëtar për Konservimin e Veprave Historike dhe të Artit (IIC), një anëtar i Këshillit Ndërkombëtar të Muzeve (ICOM), apo edhe nga vetë ICOMOS-i. Një procedurë e tillë ndihmon në gjetjen e kontraktuesit më të përshtatshëm për trajtimin e secilës çështje.

Është e vështirë që pagesa për personat e kontraktuar nga jashtë personelit të caktohet paraprakisht, pasi nivelet e pagave në shtete të ndryshme ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme. Këta persona të kontraktuar nga jashtë personelit duhet të paguhet në bazë të përvojës, njohurive dhe kohës që vendosin në dispozicion. Përfitimet për kontraktuesit jepen në formë monetare dhe nëpërmjet prestigjit që shoqëron punën e kryer në një vendndodhje të trashëgimisë botërore. Kjo e fundit duhet të vlerësohet më shumë. Të gjitha shpenzimet e kontraktuesit duhet të mbulohen, dhe nuk duhet pritur që ai/ajo të lërë gjithçka pezull lidhur me angazhime të tjera, dhe të fillojë menjëherë nga puna qoftë edhe i/e papërgatitur mirë për detyrën e re.

Disa kontraktues shpesh vonohen dhe janë të papërgjegjshëm kur vjen momenti i dorëzimit të raporteve të tyre, prandaj këshillohet që të paktën një e treta e pagesës së tyre të mos transferohet pa dorëzuar edhe raportin përfundimtar. Pas marrjes së raportit, duhet të mbahet edhe një seancë informative ku duhet diskutuar ballazi.

7.6.2 Standardet dhe formimi profesional

Formimi profesional, si edukimi i zbatuesve dhe i menaxherëve kompetentë për zbatimin e projekteve ka qenë një çështje e rëndësishme në zhvillimin e politikave të konservimit që prej zhvillimit të filozofive dhe praktikave të fundit të restaurimit dhe konservimit. Një numër i madh programesh të formimit profesional janë themeluar në vitet 1970 dhe 1980. Ndërkohë që shumica e tyre zhvillohen në Evropë, ato kanë filluar të përhapen edhe në kontinentet e tjera të botës.

Shumë dokumente ndërkombëtare rekomandojnë që t'i kushtohet një vëmendje e veçantë formimit profesional dhe edukimit. Ndër këto dokumente mund të përmendim Rekomandimet e UNESCO-s dhe Konventën e Trashëgimisë Botërore¹⁴. Ka pasur edhe organe të tjera ndërkombëtarë që kanë siguruar fonde në këtë drejtim, dhe për më tepër janë ndërmarrë edhe angazhime konkrete në nivel rajonal dhe kombëtar.

Drejtoria Ndërkombëtare për Formimin Profesional në Konservimin e Trashëgimisë Kulturore, nën ICCROM, ka publikuar lista për të gjitha kurset që ekzistojnë në botë të cilat kanë një përqendrim të veçantë në fushën e konservimit, përfshirë këtu edhe projektimet e peizazheve natyrore dhe të kopshteve. Këto publikime janë kryer në bashkëpunim me UNESCO-n dhe me Institutin “Getty” për Konservimin (*Getty Conservation Institute*). Megjithëse është shumë e rëndësishme që programet e formimit profesional të jenë të lidhura me infrastrukturën arsimore kombëtare,

14 Shih gjithashtu edhe Udhëzuesin e Formimit Profesional të ICOMOS-it, të përfshirë si Shtojca E.

këto programe nuk duhet të zhvillohen në izolim nga vendet e tjera. ICCROM mund t'i ndihmojë shtetet anëtare duke dhënë këshilla mbi leksione të ndryshme, apo qoftë edhe duke bashkëpunuar në kurse të shkurtra që merren me aspekte të ndryshme të konservimit.

Politikat kombëtare duhet të kenë për qëllim t'i ndërgjegjësojnë profesionistët (arkitektët, arkeologët, historianët e artit, dhe mjeshtrit artizanë) për rëndësinë e Siteve të Trashëgimisë Kulturore Botërore në shtetet e tyre, si dhe t'i inkurajojnë ata për t'u përfshirë në fushën e konservimit. Por pavarësisht këtyre përpjekjeve, nëse rrogat në fushën e konservimit mbeten shumë më të ulëta në krahasim me ato të sektorit privat, atëherë do të jetë e vështirë për të angazhuar profesionistë në këtë fushë. Nëse rrogat qeveritare vazhdojnë të mbeten tepër të ulëta, dhe Komisioni i Sitit arrin të mbajë distancën nga qeveria, atëherë vetë Komisioni mund të caktojë strukturën e tij të veçantë për një nivel rrogash të kalibrit të duhur.

Gjatë formimit profesional, prioriteti i parë duhet të jetë mëvetësimi i parimeve dhe i normave të etikës në fushën e konservimit, në mënyrë që profesionistët të njohin standardet përmes të cilave do të mund të vlerësojnë veprimet e propozuara. Së dyti, duhet analizuar edhe roli i profesionistit, dhe aty ku të jetë e nevojshme duhen kryer edhe praktika inspektimesh dhe raportesh. Së treti, duhet studiuar natyra e materialeve dhe e teknologjive të kaluara dhe të ditëve të sotme, në mënyrë që të zhvillohen zgjidhjet e përshtatshme për një projekt të caktuar duke i kushtuar vëmendjen e duhur aftësive dhe materialeve tradicionale. Së fundmi, duhet studiuar edhe legjislacioni, dokumentimi, si dhe procedurat e planifikimit.

Kapitulli 8

TRAJTIMET DHE AUTENTICITETI

8.1 QËLLIMI I TRAJTIMEVE

Gjatë dy shekujve të kaluar përmes parimeve të restaurimit është zhvilluar një qasje koherente ndaj trajtimit dhe menaxhimit të objekteve. Kjo është veçanërisht e vërtetë kur bëhet fjalë për koleksionet dhe monumentet. Sidoqoftë, menaxhimi i tipeve të tjera të burimeve të trashëgimisë është një çështje më e ndërlikuar, sidomos në lidhje me ansamblet historike, qytetet historike, ose peizazhet natyrore. Në këto raste del në pah një konvergjencë e parimeve metodologjike, ku përvoja e grumbulluar përfordhet përmes hulumtimeve, formimit profesional, bashkëpunimit teknik dhe shkëmbimit të përvojës në menaxhimin e burimeve. Trajtimet nuk mund të shmangin humbjen e disa vlerave të pronës kulturore, por këto humbje zakonisht mund të justifikohen me ruajtjen e integritetit thelbësor të pronës kulturore për brezat e ardhshëm.

Strategjitë e trajtimeve për vendndodhjet e trashëgimisë kulturore duhet të hartohen duke u bazuar në parimet e mëposhtme:

Trajtimet duhet të sigurojnë kthyeshmërinë, d.m.th.,

- nëse është e mundur nga ana teknike do të duhet të përdoren materiale pasojat e të cilave mund të kthehen mbrapsht nëpërmjet një ndërhyrjeje të re në të ardhmen,
- të mos paragjykohet një ndërhyrje në të ardhmen, kurdo që ajo të jetë e nevojshme,
- të mos krijohen pengesa për të kryer shqyrtimin në të ardhmen të të gjitha fakteve që përmban objekti.

Trajtimet duhet ta ruajnë autenticitetin, d.m.th.:

- të mundësojnë ruajtjen e sasisë më të madhe të mundshme të materialit ekzistues historik (autenticiteti në material),
- të sigurojnë harmoni mes projektimit origjinal dhe mjeshtërisë së realizimit (në ngjyrë, ton, thurje, formë dhe në madhësi) të punës,
- të mos lejojë që shtesat e reja të mbizotërojnë në raport me materialin origjinal, duke respektuar potencialin arkeologjik të objektit, dhe

- të kalojë provën e autenticitetit në projektim, material, realizim të punës (mjeshtëri), apo lidhur me kontekstin, dhe në rastin e peizazheve kulturore duhet respektuar edhe karakteri i veçantë i elementeve përbërëse të tyre.

8.1.1 Gatishmëria

Trajtimi i burimeve të trashëgimisë kulturore është një proces i ndërlikuar i cili duhet të udhëhiqet duke pasur një ekspertizë në parimet dhe udhëzimet ndërkombëtare për konservimin. Konservuesit duhet të jenë të plotësuar në formimin e tyre profesional mbi zbatimin e metodave dhe procedurave të përshtatshme. Secili projekt i konservimit duhet të studiohet dhe vlerësohet mirë, dhe problemet e një projekti duhet të zgjidhen sipas nevojave dhe kushteve përkatëse. Konservuesit duhet t'i shmangen zgjidhjeve të paramenduara. Megjithatë, zhvillimi i strategjive të përshtatshme të trajtimit duhet të përfshijë ekzaminimin e përvojave të fituara përmes trajtimeve të mëparshme në të njëjtin sit, ose edhe në site të ngjashme. Trajtimi duhet të monitorohet në mënyrë periodike për të vlerësuar efikasitetin e tij.

8.1.2 Prioritetet

Formulimi i strategjive të trajtimit do të ndikohet nga marrëdhënia vendimtare e krijuar mes objektivave të konservimit për vlerat e burimit dhe procesit të vlerësimit fizik. Duke marrë parasysh që qëllimi më i rëndësishëm i konservimit të siteve të Trashëgimisë Botërore është që të ruhet autenticiteti i tyre, është e domosdoshme që të vendoset hierarkia e çështjeve që lidhen në mënyrë specifike me burimin:

- Prioriteti i parë është përcaktimi, ruajtja dhe mirëmbajtja e **vlerave kulturore** në bazë të të cilave është marrë vendimi për anëtarësimin e sitin në Listën e Trashëgimisë Botërore.
- Të gjitha trajtimet konservuese (p.sh. mbrojtja, konsolidimi, ose restaurimi) duhet të garantojnë mbrojtjen e **autenticitetit** të sitit të trashëgimisë, të zgjasin ruajtjen e integritetit të saj në të ardhmen, si dhe ta përgatisin objektin për interpretimin e specialistëve.
- Aty ku është e mundur burimi i trashëgimisë duhet të vazhdojë të ketë funksionin e tij tradicional, nëse kjo gjë nuk i shkakton dëme integritetit të tij historik. Kur vazhdimësia e funksionit nuk

është më e mundur, atëherë burimi duhet të përshtatet në mënyrë që të ketë një **përdorim të përshtatshëm** si pjesë e një plani të menduar me kujdes për të theksuar vlerat e tij të jashtëzakonshme universale si dhe rolin edukativ.

Vlera të ndryshme shpesh sugjerojnë qasje të ndryshme rreth trajtimit të burimeve të trashëgimisë. Shpesh, ato janë në konflikt me njëra-tjetrën. Theksimi i disa vlerave të caktuara (si p.sh. i atyre nacionaliste, edukative, turistike, funksionale, ekonomike apo politike) mund të çojë drejt një restaurimi të tepruar, një zhvillimi të sforcuar, apo qoftë edhe drejt shkatërrimit të autenticitetit.

- *Në përcaktimin metodologjisë së përshtatshme të konservimit dhe strategjisë së trajtimit nevojitet një gjykim i ekuilibruar dhe i bazuar mbi hierarkinë e vlerave të burimeve dhe procesin e vlerësimit sistematik.*

Konservimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore është një element i domosdoshëm i planifikimit dhe zhvillimit modern social dhe ekonomik. Si i tillë, ai duhet të konkurrojë me aspekte të tjera të procesit të planifikimit. Për rrjedhojë, kur kemi të bëjmë me site të Trashëgimisë Botërore, është veçanërisht e rëndësishme që të kryhet vlerësimi real dhe kritik i secilës vendndodhje në kontekstin e saj fizik, kulturor dhe social. Ky vlerësim duhet të marrë parasysh vlerat kulturore të burimit dhe mundësinë e arritjes së nivelit të përshtatshëm të konservimit, integritetit dhe rritjes së këtyre vlerave në kontekstin më të gjerë social dhe ekonomik.

8.1.3 Përkufizimi i metodave të ndryshme të trajtimeve

Strategjitë e trajtimit përfshijnë që nga mirëmbajtja periodike deri tek nivelet e ndryshme të konsolidimit, përforcimit, restaurimit apo edhe përshtatjes së funksionit. Përshtatshmëria e një trajtimi të caktuar duhet të arsyetohet nëpërmjet një procesi kritik të vlerësimit të vlerave të vendndodhjes. Për të zhvilluar politika konservimi që janë sa më të qarta, është e domosdoshme që konceptet e përgjithshme të lidhen me veprimet specifike. Terminologjia e përdorur për të shprehur secilin lloj trajtimi duhet të sqarohet për të mundësuar një komunikim koherent mes atyre që janë të përfshirë në proceset e konservimit dhe të menaxhimit.

Më poshtë janë paraqitur përkufizimet e koncepteve më të përdorura në fushën e konservimit. Këto përkufizime janë më tepër referuese sesa të sakta, prandaj dhe mbeten të hapura ndaj diskutimeve të mëtejshme.

8.1.3.1 Mbrojtja

Në terma juridikë, mbrojtja kuptohet si veprimi i nevojshëm për të siguruar kushtet për mbijetesën e një monumenti, e një siti, apo e një zone historike. Ky term lidhet gjithashtu edhe me mbrojtjen fizike të vendndodhjeve historike ndaj vjedhjes, vandalizmit, si dhe sulmeve ndaj ambientit dhe ndërhyrjeve në panoramën. Zonat mbrojtëse të ndërmjetme sigurojnë gjithashtu edhe mbrojtjen e zonave historike.

Mbrojtja ligjore që bazohet mbi legjisllacionin si dhe mbi standardet e planifikimit, ka për qëllim të garantojë mbrojtjen ndaj trajtimeve dëmtuese, të japë udhëzime mbi veprimet e nevojshme si dhe të vendosë sanksionet ndëshkuese përkatëse.

Mbrojtja fizike nënkupton vendosjen e çative, strehëve, mbulesave, etj., apo qoftë edhe vendosjen e objektit të rrezikuar në një vend të sigurt.

8.1.3.2 Ruajtja

Ruajtja ka për qëllim ndërmarrjen e masave të domosdoshme për të mos ndryshuar gjendjen ekzistuese të një siti. Në gjuhët latine kjo fjalë tregon një veprim parandalues. Në Shtetet e Bashkuara, termi “ruajtje historike (*historic preservation*)” përkon me termin e “konservimit” që përdoret në Britaninë e Madhe kur flitet për ndërtesat historike.

Masat e ruajtjes përfshijnë inspektimet e rregullta dhe mirëmbajtjen periodike. Kjo nënkupton se riparimet duhet të kryhen atëherë kur lind nevoja për të siguruar integritetin e burimit. Në praktikë, kjo do të thotë se kur zbulohen dëme dhe përkeqësime (siç janë ato të shkaktuara nga uji, kimikatet, insektet, brejtësit ose gjallesat e tjera të dëmshme, bimët dhe mikro-organizmat), ato duhet të frenohen dhe pasojat duhen trajtuar për ta rikthyer objektin në gjendjen e mëparshme.

8.1.3.3 Konservimi

Konservimi nënkupton ruajtjen e gjendjes ekzistuese të burimit të trashëgimisë nga shkatërrimi apo ndryshimi¹⁵; d.m.th. veprimi që ndërmerret për të parandaluar prishjen dhe për të rritur jetëgjatësinë (Feilden, 1982: 3). Koncepti i përgjithshëm i konservimit nënkupton disa lloje të ndryshme trajtimesh që kanë për qëllim ruajtjen e ndërtesave, siteve dhe qyteteve historike; duke përfshirë këtu edhe mirëmbajtjen, riparimin, konsolidimin dhe përforcimin.

Në lidhje me zonat urbane, apo peizazhet kulturore, konservimi është pjesë e një

15 Fjalori i Shkurtër i Anglishtes së Oxfordit – *The Shorter Oxford English Dictionary*.

qasjeje të integruar të menaxhimit. Për pasojë, është e nevojshme që të pranohet një nivel ndryshimi shkallë-shkallë, i cili merr në konsideratë vlerat dhe autenticitetin për të cilat këto zona janë cilësuar si zona të mbrojtura. Në *Rekomandimet e UNESCO-s për Ruajtjen dhe Rolin Bashkëkohor të Zonave Historike* (të miratuara në Nairobi, 1976), funksionet shoqërore dhe përdorimi i vazhdueshëm kanë një rëndësi jetike për konservimin e këtyre zonave.

Konservimi përdoret gjithashtu edhe për trajtimin e elementeve individuale të ndërtesave, objekteve të koleksione, si dhe materialeve të ndryshme. Në këtë kontekst trajtimet konservuese kufizohen në mbrojtjen e materialit origjinal, pastrimin dhe konsolidimin.

Qëllimi kryesor i konservimit është të ruhet autenticiteti dhe integriteti i burimit kulturor.

8.1.3.4 Konsolidimi

Konsolidimi është shtesa fizike ose vendosja e materialeve ngjitëse apo mbështetëse tek materiali ekzistues i pronës kulturore, në mënyrë që të sigurohet qëndrueshmëria dhe vazhdimësia e integritetit strukturor.

Trajtimet konsoliduese mund të kenë ndikime negative nëse kryen pa patur një kuptim të plotë mbi pasojat fizike afatgjata dhe afatshkurtra të trajtimit, si dhe një ekzaminim mbi mundësinë e ndryshimeve që mund t'i ndodhin objektit origjinal, duke patur gjithnjë parasysh edhe parimin e kthyeshmërisë.

8.1.3.5 Restaurimi

Restaurimi ka pasur disa kuptime në të kaluarën. Përkufizimi më i përdorur i referohej kthimit të formës ose të pamjes së jashtme të humbur të një objekti¹⁶. Në Amerikën Veriore, ky term shpesh lidhet me “restaurimin e periudhës”, d.m.th. rikrijimin e konceptit të projektimit estetik të një periudhe të caktuar. Në Angli, pas debateve të udhëhequra nga Xhon Raskin (John Ruskin) gjatë gjysmës së dytë të shekullit të nëntëmbëdhjetë, “restaurimi” është konsideruar si një trajtim negativ dhe i dëmshëm. Në gjuhët latine, “restaurimi” shpesh është përdorur si term i përgjithshëm që lidhet me konservimin e trashëgimisë kulturore të ndërtuar.

Sidoqoftë, sot restaurimi ka marrë një përkufizim specifik të paraqitur në Nenet 9 - 13 të Kartës së Venecias. Qëllimi i restaurimit nuk është vetëm të konservojë

16 “Kthimi në gjendjen origjinale” *Ibid* – “To bring back to original state” *Ibid*.

integritetin e burimit, por edhe të nxjerrë në pah vlerat e tij kulturore, si dhe të përmirësojë lexueshmërinë e projektimit të tij origjinal. Restaurimi është një punë shumë e specializuar e bazuar në procesin e vlerësimit kritik të historisë, dhe kjo punë nuk duhet bazuar mbi hamendësime. Qëllimi i restaurimit modern – nxjerrja në pah e gjendjes origjinale brenda kufijve të materialeve ekzistuese – dallon nga qëllim i mëparshëm i kthimit të origjinalit përmes rindërtimit të formës së tij të humbur. Termi francez *mise-en-valeur* është i lidhur shumë ngushtë me këtë koncept.

8.1.3.6 Rindërtimi

Rindërtim do të thotë ndërtim nga e para.¹⁷ Termi mund të përdoret në lidhje me punën që kryhet duke përdorur materiale moderne ose të vjetra (apo që të dyja), me qëllim rindërtimin e elementeve të dëmtuara ose të shkatërruara, apo qoftë edhe të disa pjesëve të tyre. Rindërtimi nuk duhet bazuar kurrë mbi hamendësime. Në të kundërt, rindërtimi duhet bazuar mbi dokumentimet arkeologjike dhe arkitekturore.

Rindërtimi mund të rezultojë një strategji e përshtatshme për t'u ndjekur pas një zjarri, tërmeti apo një lufte. Megjithatë, vlera e rindërtimit vihet në dyshim kur ai përdoret si një masë për të përmirësuar prezantimin e siteve të trashëgimisë. Edhe zhvendosja e plotë ose e pjesshme e një monumenti në një vendndodhje të re kërkon rindërtim. Zhvendosja mund të jetë e justifikueshme atëherë kur gjykohet se është e domosdoshme që burimi të mbrohet nga rreziqet mjedisore, si përmbytjet apo ndotja e mjedisit. Zhvendosja e burimit nga vendndodhja origjinale nuk duhet të lejohet, përveç rasteve kur ky proces “justifikohet përmes interesave me rëndësi madhore kombëtare ose ndërkombëtare.”¹⁸

8.1.3.7 Anastiloza

Anastiloza, është fjala greke për “restaurimin” ose “ringritjen e kolonave”. Sot, ky term ka fituar kuptimin e “rivendosjes së pjesëve ekzistuese që janë të shkëputura nga objekti”¹⁹. Në përgjithësi, anastiloza përdoret për struktura të përbëra nga elemente që janë lehtësisht të identifikueshme, siç janë muret pa llaç ose muret me dru²⁰, dhe jo për strukturat monolitike, si në rastin e mureve me tulla të lidhura me llaç.

¹⁷ *ibid.*

¹⁸ *Karta e Venecias*, Neni 7.

¹⁹ *Karta e Venecias*, Neni 15 - Gërmimet.

²⁰ Përkufizimi i *anastilozës* i referohet kryesisht blloqeve të gurëve (p.sh. restaurimi i tempujve grekë), por gjithashtu është e pranueshme edhe anastiloza e strukturave të drurit (p.sh. restaurimi i tempujve orientalë).

Anastiloza është një lloj “restaurimi”. Ajo ka për qëllim që ta bëjë më të kuptueshëm karakterin hapësinor pamor të një strukture të shkatërruar, duke ia rikthyer formën e saj origjinale përmes përdorimit të materialit origjinal që gjendet në vendndodhje. Puna duhet të udhëhiqet mbi bazën e rregullave të njëjta me ato të restaurimit, si dhe duhet të mbështetet në dëshmi të forta arkeologjike. Në përgjithësi, kjo është e vetmja mënyrë rindërtimi e cila është e pranueshme për vendndodhjet e Trashëgimisë Botërore.

8.1.4 Trajtimet dhe arkitektura

Arkitektura përfshin trajtimin e materialeve që lejojnë përdorimin funksional, dhe ajo është nën efektin e ndryshimeve mjedisore. Një ndërtesë duhet të funksionojë pikë së pari si një strukturë e qëndrueshme që i reziston ngarkesave statike dhe dinamike. Gjithashtu, ndërtesa duhet të përfshijë një ambient të brendshëm i cili është i përshtatshëm për funksionin e programuar, si dhe duhet të jetë e mbrojtur nga rreziqet si zjarri, vandalizmi, erërat, përmytjet dhe tërmetet. Përveç këtyre çështjeve që kanë të bëjnë me materialin e ndërtesës, konservimi i burimit të trashëgimisë kërkon vëmendje edhe ndaj çështjeve që kanë të bëjnë me ruajtjen e vendndodhjes, ruajtjen e përmbajtjes së saj dhe ruajtjen e ambientit fizik.

- *Në shumicën e rasteve mirëmbajtja parandaluese duhet të arrijë të eliminojë nevojën për ndërhyrje të konsiderueshme, dhe tashmë është dokumentuar me hollësi që mirëmbajtja e mirë e ul koston e konservimit të burimeve historike.*

Konservimi i burimeve të trashëgimisë kulturore është një sfidë e madhe kulturore. Kjo sfidë krijohet pjesërisht për shkak të numrit dhe kompleksitetit të çështjeve të lidhura me të, si dhe për shkak të përfshirjes në këtë proces të shumë profesioneve të ndryshme. Aktivitetet e konservimit nuk ndjekin një formulë të thjeshtë, pasi ato varen nga aftësia për të kuptuar në mënyrë sa më të qartë vlerat e burimit të trashëgimisë.

Politika e konservimit nënkupton ndërhyrje në shkallë dhe niveleve të ndryshme intensiteti.

- *Udhëzimet për veprimet që duhet të ndërmerren përcaktohen nga kushtet fizike, shkaqet e përkeqësimit dhe pritshmëria mbi ndryshimet e ardhshme lidhur me mjedisin që rrethon secilin burim kulturor.*

Megjithëse duhet të adresohen simptomat specifike dhe problemet e lidhura me to, çdo burim duhet të konsiderohet gjithnjë në tërësinë e tij. Për rrjedhojë, gjatë përcaktimit të trajtimeve për ruajtjen e burimit duhet pasur parasysh spektri i gjerë i ndikimeve të faktorëve të ndryshëm.

Vendimet në lidhje me trajtimin e siteve të Trashëgimisë Botërore duhet të bazohen mbi gjykimet e ekuilibruara të një ekipi të përbërë nga profesionistë të disiplinave të ndryshme. Objektivat e Konventës shërbejnë si referencë për vendosjen e qëllimeve dhe rekomandimeve që kanë më shumë përparësi. Në të njëjtën kohë, duhet të merren në konsideratë edhe objektivat finale të menaxhimit, parimet e përgjithshme të konservimit të mirë dhe praktikatat e restaurimit. Kjo gjë nënkupton kryesisht:

- kuptimin e objektiveve;
- komunikimin e detyrave të caktuara; dhe
- mbikëqyrjen e zbatimit të tyre.

Duhet të keni parasysh se politika e ndërhyrjes minimale është vërtetuar se është politika më e mirë për të siguruar një konservim me efikasitet të lartë, dhe se mënyra më e mirë e ruajtjes së ndërtesave apo vendndodhjeve – për dallim nga koleksionet e muzeve – është që ato të mbahen në përdorim. Funkzioni origjinal zakonisht është dhe zgjidhja më e mirë, pasi kërkon dhe më pak ndryshime për tërë ndërtesën. Kur kjo gjë nuk është e mundur, mund të propozohen funksione të tjera të përshtatshme që përputhen me projektimin dhe vlerat e lidhura me ndërtesën. Kjo praktikë mund të kërkojë zbatimin e asaj që quhet *mise-en-valeur*, ose modernizimi me ose pa ndryshime përshtatëse.

Konvertimi i burimit kulturor për ta përshtatur me një funksion të ri (siç është përshtatja e një manastiri mesjetar në Venecia për t’u përdorur si shkollë ose laborator për konservimin e gurit; apo konvertimi i një stalle të shekullit të tetëmbëdhjetë në një vendbanim) nganjëherë është e vetmja mënyrë e justifikueshme nga pikëpamja ekonomike për të shpëtuar vlerat historike dhe estetike të tij. Në këtë mënyrë, ndërtimet dhe sítet historike sillen në jetë me kushte sigurie dhe standarde funksionale bashkëkohore.

Edhe konvertimi i një objekti historik për qëllime **muzeale** (p.sh. për të ekspozuar koleksione apo për të shërbyer si një shtëpi-muze), nënkupton gjithashtu përshtatjen me një funksion të ri. Kjo përshtatje shpesh mund të kërkojë transformime në mënyrë që të mundësojë vizitat nga një numër i madh turistësh. Si pasojë e këtij transformimi do të nevojitej vendosja e kushteve të sigurisë, plotësimi i standardeve lidhur me ambientin, ndriçimin, sigurinë ndaj zjarrit, sigurimin e disa shërbimeve, hyrjet e përshtatshme për njerëz me aftësi të kufizuara, etj.

Çështja e funksionit të ri është një çështje veçanërisht e rëndësishme për zonat historike urbane, në të cilat duhet të adresohen probleme të vështira sociale dhe

ekonomike që kanë të bëjnë me menaxhimin dhe kontrollin e riaftësimit të një objekti. Është e qartë se transformimi i një qyteti historik në muze, ose transformimi i ndërtesave në hotele ose qendra rezidenciale turistike, do të ndryshonte plotësisht funksionet e tij origjinale shoqërore, duke i dhënë qytetit një karakter të ri dhe krejtësisht të ndryshëm. Përderisa një ndryshim i tillë ndonjëherë mund të jetë një zgjidhje e arsyeshme, ruajtja ose rigjallërimi i funksioneve të përputhshme shoqërore duhet të shikohet me përparësi.

8.1.5 Trajtimet dhe rrënojat

- *Një sit i rrënuar mund të përkufizohet si një ndërtim që ka humbur aq shumë nga forma dhe substanca e tij origjinale sa që tërësia e tij potenciale si një formë strukturore funksionale tanimë është e humbur²¹.*

Sidoqoftë, gjendja në rrënoja mund të jetë me rëndësi dhe mund të përfaqësojë vlera specifike kulturore. Për shkak të humbjes së integritetit të tyre fizik, rrënojat historike janë subjekt i problemeve të lidhura me rrënimin, prandaj dhe meritojnë një trajtim dhe kujdes të veçantë, qoftë dhe në ato raste kur kemi të bëjmë me elemente relativisht të thjeshta fizike që nuk kanë ornamente apo strukturë të ndërlikuar. Suksesi i rezultatit përfundimtar varet nga përzgjedhja e përshtatshme e trajtimeve konservuese, ose restauruese, si dhe cilësia e punimeve riparuese.

Shtirja e çdo punimi të ri dhe vendi ku do të kryhet ky punim duhet të shqyrtohen me vëmendjen më të madhe, pasi këto ndërhyrje mund të kenë një efekt të konsiderueshëm në karakterin historik të vendndodhjes. Edhe në rastet kur këto ndërhyrje kanë për qëllim stabilizimin, mbrojtjen apo interpretimin e rrënojave, çështja e punimeve të reja krijon polemika dhe ka nevojë për një shqyrtim të hollësishëm dhe të bazuar mbi një arsyetim të shëndoshë lidhur me objektivat e konservimit.

- *Qëllimi parësor i trajtimit të rrënojave të Trashëgimisë Botërore është ruajtja e substancës historike, në mënyrë që kjo substancë t'i prezantohet publikut.*

Interpretimi dhe vlerësimi i rrënojave varet nga cilësia, vendndodhja dhe sasia e materialit dhe e integritetit strukturor të humbur. Njëkohësisht, një rol shumë të rëndësishëm në përkufizimin e monumentit dhe ambientit të tij rrethues luajnë edhe njohuritë lidhur me dokumentacionin e besueshëm mbi tiparet dhe elementet e humbura, si dhe rëndësia kulturore e vetë burimit në gjendjen e tij të shkatërruar.

21 "Ajo çka mbetet pas prishjes dhe shkatërrimit". "Mbetjet e një ndërtese apo qyteti të prishur apo të shkatërruar." *Shorter Oxford English Dictionary*.

Anastiloza duhet të vihet në funksion vetëm atëherë kur (1) elementet origjinale ende ekzistojnë në vendndodhje në një gjendje aq të mirë sa që e justifikojnë këtë proces, si dhe (2) atëherë kur puna e realizuar nuk e prish ekuilibrin e ambientit dhe vlerave të përgjithshme të burimit të trashëgimisë. Brenda ambientit të një siti historik mund të shfaqet një potencial i rëndësishëm arkeologjik. Nga ana tjetër, marrëdhënia mes sitit dhe kontekstit bashkëkohor social dhe ekonomik mund të jetë aq e rëndësishme sa t'i mbivendoset vlerave kulturore, dhe kjo gjë mund të justifikojë përshtatjen e burimit të trashëgimisë me një funksion të ri përmes trajtimeve të ndryshme.

Sidoqoftë, njerëzit duhet të jenë të vetëdijshëm mbi rreziqet që mund të sjellë një proces i tillë, i cili në raste ekstreme mundet edhe të përdhosë prestigjin dhe reputacionin e një Siti të Trashëgimisë Botërore.

8.2 SI LIDHET TRAJTIMI ME AUTENTICITETIN?

Sipas parimeve të *Konventës së Trashëgimisë Botërore* (Neni 4), qëllimi parësor i menaxhimit të burimit kulturor është garantimi i vlerave për të cilat siti është përfshirë në Listën e Trashëgimisë Botërore, duke i mirëmbajtur dhe duke i prezantuar vlerat në një mënyrë të përshtatshme tek publiku. Për të arritur këtë objektiv, duhet hartuar një strategji gjithëpërfshirëse e mirëmbajtjes që ka si element përbërës edhe inspektimet e rregullta. Pranimi i një burimi në Listën e Trashëgimisë Botërore krijon vetvetiu edhe një presion mbi menaxherët e sitit për shkak të rritjes së numrit të turistëve; gjë që mund edhe të ndikojë në përkeqësimin e gjendjes së burimit, duke u hapur rrugë zhvillimit të aktiviteteve tregtare që mund të kenë efekte shkatërruese ose të padëshiruara. Njëkohësisht, anëtarësimi në Listën e Trashëgimisë mund të prodhojë edhe propozime për projekte restaurimi të planifikuara keq, ose edhe propozime për ndërhyrje të kryera përmes anastilozës apo rindërtimit të stimuluar nga motive politike ose tregtare. Prandaj, është e domosdoshme që siti të menaxhohet me shumë kujdes, duke u siguruar që të gjitha veprimet të shqyrtohen në përputhje me kërkesat e Konventës.

Sipas *Udhëzuesit për Mënyrën e Funksionimit* të Konventës, një monument apo vendndodhje që pranohet në Listën e Trashëgimisë Botërore duhet të plotësojë kriterin e autenticitetit në projektim, punim, material dhe në mjedisin rrethues. Vlerat e rëndësishme të burimit duhet të konservohen përmes hartimit të një strategjie të përshtatshme. Si pasojë, çdo trajtim i planifikuar për një monument apo site të Listës duhet të respektojë kriteret. Përmbledhja e mëposhtme prezanton shkurtimisht ato aspekte të burimit kulturor që lidhen me elementet e ndryshme të autenticitetit dhe me veprimet e përshtatshme të konservimit. Duhet theksuar se megjithëse elementet në vijim janë prezantuar të veçuar nga njëri-tjetri, duhet bërë

kujdes që në zgjedhjen e trajtimeve për ruajtjen e autenticitetit të merren vendime të baraspeshuara në raport me karakterin dhe rëndësinë historike të burimit të trashëgimisë.

Autenticiteti në materiale:

Evidencat: Materiali origjinal ndërtimor, shtresëzimi historik, prova dhe shenjat e lëna nga faza të rëndësishme të historisë, dhe procesi i vjetërsimit (cipa e krijuar nga vjetërsia).

Qëllimi i trajtimit: Të respektohet materiali historik, të bëhet dallimi midis materialit të ri dhe atij historik për të mos e hutuar apo gënjyer vëzhguesin; në zonat apo qytetet historike, materiali duhet të kuptohet si pjesë e strukturës fizike, nga e cila është e përbërë dhe vetë zona.

Zbatimi: Mirëmbajtja dhe konservimi i substancës së materialit të periudhave të ndryshme të ndërtimit. Në zonat apo qytetet historike kjo nënkupton mirëmbajtjen e materialit historik dhe shmangien e zëvendësimit të këtij materiali, qoftë edhe për strukturat më të vjetruara nëse ato dëshmojnë për vazhdimësinë historike të zonës.

Autenticiteti në punë:

Evidencat: Substanca dhe shenjat e teknologjisë së ndërtimit, si dhe teknikat e trajtimit të strukturave dhe materialeve historike.

Qëllimi i trajtimit: Të respektohen evidencat që dëshmojnë për realizimin e punimeve origjinale të përdorura për materialet ndërtimore dhe sistemet strukturore.

Zbatimi: Konservimi dhe mirëmbajtja e materialit dhe e strukturave origjinale, duke krijuar një harmoni mes riparimeve dhe pjesëve të reja të mundshme të shtuara përmes punës së kryer në mënyrë tradicionale.

Autenticiteti në projektim:

Evidencat: Elementet apo aspektet në të cilat dallohet projektimi

artistik, arkitektonik, inxhinierik apo funksional i burimit të trashëgimisë dhe i ambientit të tij rrethues (kuptimi dhe mesazhi origjinal, ideja artistike dhe funksionale, aspekti përkujtitor). Në sitet, zonat apo peizazhet historike, projektimi duhet t'i referohet kontekstit më të gjerë të vlerësuar sipas çdo rasti individual.

Qëllimi i trajtimit: Të respektohet koncepti i projektimit (kompozimit) ashtu siç është shprehur dhe dokumentuar në format historike të strukturës origjinale, të arkitekturës, apo të një kompleksi që ndodhet në qytet ose në fshat.

Zbatimi: Konservimi, mirëmbajtja, riparimi, konsolidimi, restaurimi apo anastiloza e strukturave historike dhe harmonizimi i çdo ndërtimi të ri të mundshëm me konceptet origjinale të projektimit që janë të shprehura në format historike.

Autenticiteti në mjedisin rrethues:

Evidencat: Siti ose mjedisi rrethues i burimit në lidhje me periudhat kur është ndërtuar; park ose kopsht historik; peizazh kulturor ose historik; vlerat e peizazhit urban; dhe vlera në grup.

Qëllimi i trajtimit: Të mbahet burimi i trashëgimisë *in situ* në vendndodhjen e tij origjinale, dhe të ruhet raporti i sitit me mjedisin rrethues;

Zbatimi: Kontrolli i planifikimit, planifikimi konservues urban dhe territorial, si dhe konservimi i integruar.

Ndërkohë që çështjet e autenticitetit dhe të trajtimeve të përshtatshme që janë përmendur këtu janë të lidhura kryesisht me strukturat historike, është e nevojshme që me të njëjtin seriozitet të trajtohen edhe vendbanimet tradicionale, sidomos ato të zonave jashtë qyteteve. Këtu përfshihen fshatrat dhe peizazhet kulturore të karakterizuara nga forma tradicionale jetese dhe funksionesh, duke përfshirë edhe ndryshimin gradual të tyre si dhe aktivitetet ndërtimore. Në këto raste, vazhdimësia e profesioneve dhe e aftësive tradicionale mund të jetë një element thelbësor i politikës së përshtatshme të menaxhimit, në mënyrë që të garantohet koherenca brenda një sistemi ekonomik tradicional, stilit të jetesës dhe vendbanimit. Duhet

të tregohet kujdes që të sigurohet një nivel i lartë cilësie lidhur me këto zanate, si dhe të shmanget zëvendësimi me produkte apo metoda industriale. Për më tepër, përvoja ka treguar se në përgjithësi duhet rekomanduar përdorimi i materialeve tradicionale, sidomos kur duhet të vendosen shtresa të reja ngjyrash, llaçi, etj., në mënyrë që të garantohet koherenca fizike dhe estetike në raport me strukturën ekzistuese.

8.2.1 Trajtimet në lidhje me autenticitetin e materialit

Autenticiteti në material bazohet në vlerat e lidhura me përbërjen fizike të **burimit origjinal të trashëgimisë**. Një vëmendje e veçantë i duhet kushtuar mbrojtjes, konservimit, dhe mirëmbajtjes së materialit origjinal – për një ndërtesë të vetme apo edhe për një zonë historike.

- *Qëllimet e trajtimit janë rritja e jetëgjatësisë së materialeve dhe strukturave origjinale, mbajtja e tyre në pozicionin origjinal brenda konstruksionit dhe në vendndodhje (in situ), ruajtja e vlerës së vjetërsisë dhe e cipës së krijuar nga vjetërsia e burimit, si dhe ruajtja e dëshmimeve të historisë së tij, funksionit dhe ndryshimeve që i kanë ndodhur me kalimin e kohës.*

Në lidhje me bimët dhe kopshtet origjinale çështja e autenticitetit të materialeve ka nevojë për specifika të tjera për shkak se bimët janë qenie të gjalla dhe dinamike, me një cikël natyror të rritjes, kalbjes dhe tharjes. Për pasojë, ato duhet të zëvendësohen në intervale të ndryshme dhe të gjata kohore. Duke përdorur kujdesin e duhur, bimët origjinale mund të mirëmbahen për një kohë të gjatë, dhe zëvendësimet mund të kryen duke përdorur gjenet e të njëjtave bimë. Kjo është njëra nga mënyrat e ruajtjes së autenticitetit. Sidoqoftë, me rritjen e tyre, problemet e konkurrencës midis bimëve mund të krijojnë nevojën për të zhvendosur disa prej tyre nëpër vende të tjera.

Në fakt, në rastin e kopshteve problemi që ngrihet ka lidhje me integritetin e tyre, duke ngritur pyetjen nëse ky integritet vazhdon të ekzistojë. Për më tepër, duhen identifikuar ato veprime që konsiderohen si të përshtatshme për të ruajtur ekuilibrin e duhur mes tipareve historike të ndryshme të kopshtit. Një vendim i rëndësishëm që duhet të merret kur kemi të bëjmë me politikën e konservimit të një kopshti, apo të një pjese të caktuar të tij, është përzgjedhja e një pike referimi brenda ciklit të rritjes gjatë të cilës duhet kryer ndërhyrja. Në të kundërt, mund të përcaktohet që zëvendësimi i një bime të kryhet vetëm pasi bima të ketë përfunduar ciklin e plotë, ose thjesht një pjesë të këtij cikli. Këto vendime duhet të merren në mënyrë individuale brenda kontekstit të secilit kopsht. Autenticiteti duhet t'i referohet kryesisht shtrirjes fizike dhe tipareve të materialeve jo-organike.

Veprimet parandaluese përfshijnë mirëmbajtjen e rregullt dhe zbatimin e riparimeve të nevojshme para se të ndodhë dëmi. Kjo nënkupton gjithashtu edhe parashikimin e rreziqeve të mundshme përmes planifikimit dhe ndërhyrjes së drejtpërdrejtë, të cilat rrjedhimisht parandalojnë edhe dëmet. Vjetrimi dhe shembja përshpejtohen në rastin e rrënojave që kanë humbur mbulesën e tyre mbrojtëse. Në këto raste, veprimi mbrojtës mund të përfshijë mbulesa ose çati të cilat mbrojnë pjesët e ndjeshme, apo të rrezikuara. Ky trajtim duhet të bëhet pa u imponuar me forcë ndaj objektit, duke ruajtur një ndjeshmëri të lartë ndaj karakterit të monumentit dhe vlerave të sitit. Një veprim ekstrem do të ishte heqja e pjesëve dekorative të monumentit për t'i konservuar ato në një muze. Një veprim i tillë duhet të jetë i përkohshëm, dhe këshillohet vetëm në ato raste kur nuk mund të ndërmerren masa të tjera mbrojtëse. Në të vërtetë, ky veprim bie në kundërshtim me parimin e mbajtjes së materialit me rëndësi historike brenda kontekstit të tij origjinal.

Zëvendësimi i elementeve origjinale. Në çastin kur një material është prerë dhe është përdorur si pjesë e konstruksionit, ai është kthyer në një material historik që lidhet me periudhat kohore që ka kaluar vetë objekti. Megjithatë restaurimi nëpërmjet zëvendësimit të materialeve dhe elementeve strukturore që janë prishur, e redukton autenticitetin e materialit në monument, ky proces mund të jetë i pranueshëm brenda kufijve të mundësisë për të ruajtur një njësi të bashkuar, dhe vetëm nëse kjo gjë është e domosdoshme për mbijetesën e strukturës origjinale që ka mbetur. Në këto raste, rezultati i punës duhet të përputhet me karakterin origjinal të strukturës, nëse puna zbatohet në mënyrë e duhur dhe me materiale të ngjashme. Zëvendësimi i elementeve origjinale duhet të jetë një proces i kufizuar, i cili zbatohet pa ulur vlerën e substancës origjinale.

Konsolidimi dhe përforcimi. Kur stabiliteti i materialeve dhe i elementeve strukturore është reduktuar deri në atë masë sa që nuk mundet më të përballojë rreziqet e parashikuara, atëherë rekomandohet të zbatohen masat e konsolidimit ose të përforcimit. Sido që të jetë, një trajtim i tillë e redukton autenticitetin e burimit për shkak se ndryshon substancën origjinale. Kombinimi i materialeve tradicionale me produktet moderne industriale mund të mos jetë i përshtatshëm. Përdorimi i produkteve moderne industriale për konsolidimin e materialeve në ndërtesa tradicionale mund ta transformojë origjinalin në aspektin fizik apo kimik të tij, deri në atë masë sa të bëjë që origjinali të humbasë autenticitetin e materialit të tij, edhe pse duke ruajtur të njëjtën pamje. Trajtime të tilla duhet të ndërmerren vetëm pas një vlerësimi kritik dhe të kujdesshëm mbi pasojat në secilin rast. Gjithashtu, duhet pasur parasysh se trajtimet si injektimet apo mbushjet, në rastin kur nuk rezultojnë të suksesshme, mund të kenë pasoja të pakthyeshme. Para se

të ndërmerren ndërhyrje të tilla duhet gjetur ekuilibri i duhur mes mbrojtjes dhe konsolidimit, duke marrë parasysh analizat e detajuara shkencore të karakterit dhe përbërjes së materialit origjinal, kontekstit mjedisor dhe kurës së propozuar. Në asnjë rast nuk mund të lejohet që të shkatërrohen provat historike.

- ❑ *Para se të zbatohet në masë të gjerë, një trajtim i caktuar duhet të kalojë disa prova për të vlerësuar efikasitetin dhe përshtatshmërinë e tij për materialin në fjalë. Këto **prova duhen kryer për një kohë të gjatë** para fillimit të punimeve.*

Periudha e provës duhet të jetë e gjatë, pasi trajtimi nganjëherë mund të dështojë edhe pas dhjetë apo pesëmbëdhjetë viteve. Është e rëndësishme që të mbahet një regjistër i saktë i të gjitha trajtimeve të kryera në ndërtesat historike dhe monumentet antike, si dhe të kryhen inspektime të rregullta të pasojave të tyre, të shoqëruara me raporte me shkrim. Hulumtimi mbi trajtimet e konservimit duhet t'i referohet historikut të këtyre regjistrave.

Për të mos humbur autenticitetin në lidhje me materialin e një zone historike, ajo çka konservohet duhet të identifikohet dhe përkufizohet me kujdes. Vlera historike e qyteteve dhe vendbanimeve tradicionale gjendet në strukturat dhe përbërjen e tyre. Për rrjedhojë, autenticiteti dhe vazhdimësia historike do të humbiste nëse konservohen vetëm fasadat dhe hyrjet e ndërtesave historike, ndërkohë që përbërja e vjetër e këtyre objekteve zëvendësohet me ndërtime dhe materiale moderne. Aty ku është e mundur, qëllimi duhet të jetë riaftësimi konservator i përbërjes dhe i materialeve origjinale.

8.2.2 Trajtimet në lidhje me autenticitetin e punës

Autenticiteti i punës lidhet me autenticitetin e materialit, por në këtë rast theksi vendoset tek ruajtja e provave mbi punën e përdorur gjatë ndërtimit. Si pasojë, këto trajtime i drejtohen potencialit arkeologjik të monumentit për të gjetur provat lidhur me këto teknika.

- ❑ *Qëllimi i trajtimit është rritja e jetëgjatësisë së të gjitha materialeve dhe elementeve që shërbejnë si prova që dëshmojnë për punën e përdorur gjatë ndërtimit. Nga ana tjetër, ky trajtim duhet të garantojë që kjo punë tradicionale nuk falsifikohet përmes ndërhyrjeve bashkëkohore.*

Konservimi. Vlera e autenticitetit të punës kuptohet më mirë nëpërmjet identifikimit, dokumentimit dhe analizës sistematike të prodhimeve dhe trajtimeve historike të materialeve ndërtimore, si dhe të metodave historike të ndërtimit. Ky hulumtim shërben si një referencë e nevojshme për të vlerësuar përputhshmërinë me trajtimet moderne të konservimit.

Konsolidimi. Në rastin e konsolidimit apo përforcimit strukturor, duhet të respektohet integriteti i sistemit strukturor historik, si dhe të ruhet forma e tij. Vetëm nëse do arrinim që së pari të kuptonim mënyrën se si vepron një ndërtesë në tërësinë e saj – d.m.th. si “ një sistem mjedisor strukturë-hapësirë” (Feilden, 1982) –, atëherë do të mund të zbatonim teknika të reja të përshtatshme, të kryenim përmirësime të përshtatshme mjedisore, si dhe të konceptonim funksione të reja të përshtatura.

Mirëmbajtja. Është shumë e rëndësishme që riparimi i burimeve të trashëgimisë të kryhet duke përdorur aftësi dhe materiale tradicionale të përshtatshme. Në rastet kur metodat tradicionale nuk janë të përshtatshme, konservimi i pronës kulturore mund të arrihet edhe me përdorimin e teknikave moderne. Këto teknika duhet të jenë të kthyeshme, të provuara në praktikë dhe të përshtatshme për përmasat e projektit dhe mjedisin e klimaterik.

Kur flitet për **arkitekturën popullore**, e cila shpesh përfshin materiale të ndjeshme dhe me jetëgjatësi të shkurtër (siç janë kashta, balta, dheu i ngjeshur, qerpiçi dhe druri), riparimi ose restaurimi i pjesëve të dëmtuara ose të konsumuara të objekteve duhet të kryhet duke përdorur të njëjtat lloje materialesh tradicionale dhe teknikash artizanale. Ruajtja e qëllimeve dhe detajeve të projektimit është po aq e rëndësishme sa edhe ruajtja e materialeve origjinale. Në shumë raste, këshillohet që të përdoren masa të përkohshme, me shpresën që ndonjë teknikë më e mirë do të zhvillohet në të ardhmen, sidomos atëherë kur konsolidimi mund të zvogëlonte integritetin e burimit dhe do të pengonte përpjekjet e ardhshme të konservimit.

8.2.3 Trajtimet në lidhje me autenticitetin e projektimit

Autenticiteti i projektimit (kompozimit) lidhet me projektimin arkitektonik, artistik, inxhinierik dhe funksional të monumentit, vendndodhjes ose peizazhit dhe mjedisit rrethues së tij. Edhe vlera përkujtimore e monumentit lidhet me autenticitetin e projektimit të tij, dhe varet nga lexueshmëria e këtij qëllimi.

- *Qëllimi është që të ruhet materiali dhe struktura origjinale në të cilën shfaqet projektimi, dhe aty ku është e mundur duhet të kryen restaurime ose trajtime të tjera të nevojshme, të cilat do të nxjerrin në pah format apo strukturat historike që lidhen me vlera e rëndësishme që janë fshehur nga ndryshimet, braktisja ose shkatërrimi.*

Shtresëzimi historik. Restaurimi që ka për qëllim rikrijimin apo rindërtimin e objektit në një formë (stil) e cila ka ekzistuar paraprakisht por që tashmë ka

humbur, nënkupton se dhe koha mund të kthehet mbrapsht. Rezultati i një pune të tillë bazohet mbi imagjinatën dhe fantazinë, dhe si i tillë quhet restaurim stilistik. Kjo qasje nënkupton eliminimin e pjesëve që kanë të bëjnë me periudha specifike të historisë. Edhe pse restaurimi stilistik është konsideruar si praktikë e pranueshme në të kaluarën, strategjitë bashkëkohore të restaurimit duhet të bazohen në gjendjen aktuale të burimit, në mënyrë që të vlerësohen dhe njihen kontributet dhe shtesat e të gjitha periudhave të rrjedhës kohore historike. Rilevimi, regjistrimi dhe dokumentimi sistematik janë të domosdoshëm për të kryer vlerësimin e gjendjes fizike të burimit dhe vlerësimin e integritetit të tij si një tërësi e vetme, bashkë me elementet individuale që e formojnë këtë tërësi (Brandi, 1963). Nga ana tjetër, është e domosdoshme që kopshtet historike dhe peizazhet natyrore të konservohen përmes një mirëmbajtjeje dhe një menaxhimi të ndjeshëm ndaj materialit bimor historik.

Kur flitet për **etapat historike të zhvillimit të mbivendosur**, shtresat e poshtme të shtresëzimit historik të burimit mund të ekspozohen për qëllime studimore dhe dokumentimi. Çdo ekspozim i fazave të mëparshme duhet të jetë i kujdesshëm dhe nuk duhet të vërë në rrezik konservimin e tyre, apo qoftë edhe të ul vlerat e tyre kontribuuese. Heqja e elementeve që përfaqësojnë fazat e ndryshme historike të një monumentit mund të kryhet vetëm në raste të jashtëzakonshme, si për shembull “kur ajo çka është hequr ka një rëndësi shumë të vogël, dhe materiali që nxirret në pah bart vlera arkeologjike dhe estetike, dhe është i ruajtur në gjendje të tillë që e justifikon ekspozimin e tyre”²². Këto janë kritere të vështira për t’u përmbushur.

Riintegrimi modern, apo plotësimi i pjesëve të humbura (*lacunae*), përgjithësisht është i pranueshëm për sa kohë që ekziston një unitet potencial që krijon baza të qëndrueshme, të cilat lejojnë që të ndërmerren këto veprime. Trajtimi i *pjesëve të humbura* bazohet në një vlerësim të kontekstit të tyre dhe ato duhen riintegruar duke u bazuar në evidenca. Nëse riintegrimi nuk e përmirëson unitetin potencial të tërësisë, apo nëse pjesët e humbura nuk mund të riintegrohen për shkak të përmasave, pozitës, apo karakterit artistik të humbjeve, atëherë ky nuk do të ishte një veprim i përshtatshëm²³. Sidoqoftë, nëse pjesët e humbura mund të riintegrohen në mënyrë të përshtatshme, atëherë trajtimi duhet të kryhet në përputhje me udhëzimet ndërkombëtare²⁴.

Megjithëse qëllimi i procesit të riintegritimit në ndërtesat historike, apo qoftë edhe burime

22 *Karta e Venecias*, Neni 11.

23 Teoria e trajtimit të pjesëve të humbura në veprat e artit është zhvilluar në “Istituto Centrale del Restauro”, në Romë. Shih Mora, Mora dhe Philippot, 1977, në bibliografi.

24 Shih Brandi, 1963, në bibliografi; *Karta e Venecias* e vitit 1964; dhe Rekomandimet e UNESCO-s që lidhen me këtë temë.

të tjera, është që të vendosë harmoninë me projektimin original në raport me ngjyrën, përmbajtjen dhe formën, çdo zëvendësim duhet të jetë në të njëjtën kohë edhe lehtësisht i dallueshëm nga origjinali, në mënyrë që restaurimi të mos falsifikojë dëshmitë artistike apo historike.²⁵ Gjatë diferencimit të elementeve të reja prej atyre të vjetra, duhet pasur një kujdes i veçantë që kontrasti i krijuar të mos jetë i tepruar. Qëllimi është që të tregohet dallimi, dhe jo që të theksohet ndryshimi mes të resë dhe të vjetrës. Për më tepër, numri i pjesëve të reja duhet të jetë i vogël në raport me përbërjen origjinale.

Nëse pjesët e humbura nuk mund të riintegrohen në mënyrën e duhur, ashtu siç ndodh zakonisht me strukturat e shkatërruara ku është humbur uniteti potencial i monumentit për shkak të mungesës së provave apo edhe të dëmtimeve të konsiderueshme, qëllimi kryesor i trajtimit duhet të jetë që të mirëmbajë gjendjen ekzistuese të rrënojave. Çdo përforsim, ose konsolidim i kryer në këto rrethana duhet të kryhet në formën e një ndërhyrjeje minimale për të garantuar stabilitetin e burimit, dhe pa komprometuar vlerat e tij estetike dhe arkitektonike. Interpretimi i historisë së këtyre siteve dhe vlerave historike që lidhen me monumentet duhet të zhvillohet nëpërmjet evidencave ekzistuese që janë në sit. Interpretimi mund të prezantohet përmes publikimeve, maketeve, fragmenteve apo ndonjë kombinimi tjetër në ekspozitën e sitit ose në muze.

Anastiloza. Në rastin kur në sit ekzistojnë elementet origjinale që janë shkëputur nga monumenti, atëherë mund të pranohet trajtimi përmes anastilozës, vetëm nëse ky proces bazohet në prova të besueshme në lidhje me vendin e saktë ku ndodheshin më parë këto elemente. Anastiloza mund të kontribuojë për të sqaruar më mirë projektimin original dhe rëndësinë artistike të monumentit për vëzhguesin. Sidoqoftë, duhet patur parasysh se elementet e shkëputura janë vjetruar në tokë, dhe shpesh janë dëmtuar deri në atë masë sa që e kanë humbur formën e tyre të projektimit dhe nuk janë më të përshtatshme për t'u përdorur gjatë anastilozës. Anastiloza e saktë është shumë e vështirë për t'u realizuar, dhe kjo gjë është vërtetuar nga përvoja në shumë site të rëndësishme. Si rrjedhojë, punime të tilla duhet të jenë të kufizuara. Këto ndërhyrje duhet të jenë gjithashtu të kthyeshme dhe të dokumentuara hollësisht. Nëse anastiloza ushtrohet në mënyrë të tepruar ajo mund ta transformojë një sit historik në një vend që duket si skenë filmi, duke ulur vlerat e saj kulturore. Rindërtimi i kryer duke përdorur materiale të reja nënkupton që rezultati i punës do të jetë një ndërtesë e re, dhe kështu autenticiteti historik humbet. Rindërtimi mund të çojë në keqinterpretim, veçanërisht kur kryhet në përmasa të mëdha.

²⁵ *Karta e Venecias*, Neni 12.

Megjithatë, ekzistojnë raste kur ripërtëritja është pjesë e një procesi tradicional, i cili bart në vetvete një rëndësi të veçantë. Rizbukurimi ose rindërtimi periodik i tempujve Shinto në Japoni përbën një shembull të këtij lloji procesi tradicional. Ripërtëritje të tilla ceremoniale duhet të kuptohen jashtë konceptit modern të restaurimit. Derisa qëllimi i konservimit është *mise-en-valeur* i monumenteve historike, ansambleve apo vendndodhjeve si pjesë e shoqërisë moderne, pa e humbur rëndësinë apo kuptimin e tyre, kjo nuk do të thotë se duhet të kundërshtohen traditat kulturore që mbahen gjallë, nëse ato kanë ruajtur autenticitetin e tyre si pjesë e shoqërisë.

Për sa i përket zonave me një rëndësi të veçantë (dhe posaçërisht qyteteve me Trashëgimi Botërore), mbrojtja dhe konservimi i të gjitha elementeve përbërëse si dhe i infrastrukturës së zonës mund të sigurohet nëpërmjet përcaktimit të prioriteteve të qarta. Çdo ndryshim, si dhe çdo ndërtim i ri i mundshëm që duhet të kryhen si pjesë e proceseve të riaftësimit, duhet t'i referohet qartazi vazhdimësisë historike dhe arkitektonike të zonave në fjalë.

8.2.4 Trajtimet në lidhje me autenticitetin e kontekstit

Tashmë pranohet se konservimi i trashëgimisë kulturore bën pjesë në fushën e përgjithshme të zhvillimit mjedisor dhe kulturor, dhe veçanërisht kur kemi të bëjmë me zona të mëdha brenda ose jashtë qyteteve. Strategjitë e qëndrueshme të menaxhimit të ndryshimeve që respektojnë trashëgiminë kulturore duhet të integrojnë praktikën e konservimit me qëllimet bashkëkohore ekonomike e sociale, përfshi këtu edhe turizmin.

Për rrjedhojë, vlerat e veçanta dhe karakteristikat e qyteteve historike dhe vendbanimeve tradicionale nëpër fshatra duhet të shihen si pjesë e një konteksti më të gjerë të planifikimit të zhvillimit rajonal, ose kombëtar. Kjo është shpesh edhe mënyra e vetme për të garantuar plotësimin e nevojave të tyre specifike funksionale, sociale dhe ekonomike gjatë fazave vendimtare të procedurave të rëndësishme të planifikimit. Autenticiteti i sitit reflektohet në marrëdhënien mes burimit dhe kontekstit të tij fizik. Kjo përfshin edhe vlerat e peizazhit dhe pamjes së qytetit, si dhe marrëdhënien e objekteve të ndërtuara nga njeriu me kontekstin e tyre mjedisor.

Ruajtja e monumenteve *in situ* është kërkesë bazike për ruajtjen e këtyre vlerave. Trajtimi i një siti do të ndikojë në ambientin e tij rrethues si dhe tek vlerat të cilat janë formuar dhe kanë evoluar gjatë procesit historik. Zakonisht, me rrjedhën e viteve një **monument i shkatërruar** ka fituar vlera specifike kulturore dhe është

bërë pjesë e ambientit të tij rrethues në formën e tij të shkatërruar. Kjo gjë është veçanërisht e vërtetë në ato raste kur rrënoja ka fituar rëndësi të veçantë si pjesë e një krijimi të mëvonshëm, siç është rasti me rrënojat mesjetare të Kroit të Abacisë në kontekstin e **peizazhit të lulishtes së zbukuruar** të Studley Royal-it, së shekullit të tetëmbëdhjetë. Në të njëjtën mënyrë, edhe rrënojat e monumenteve antike greke apo romake – të cilat njihen si pjesë e kulturës sonë në formën e tyre të shkatërruar – kanë nevojë të trajtohen përmes një politike rigoroze të konservimit të tyre si rrënoja. Vendimi për të ushtruar procesin e anastilozës gjithnjë duhet të marrë në konsideratë kontekstin historik e fizik, si dhe ekuilibrin e përgjithshëm të sitit.

Peizazhet, në vetvete, përbëjnë një çështje të rëndësishme. I tillë është dhe “Lake District” në Angli, që ka shekuj që tërheq vëmendjen e poetëve dhe artistëve. Një çështje paralele është edhe koncepti japonez i **peizazhit të huazuar**, i cili i shtrin vlerat pamore të një lulishteje (kopshti) përtej kufijve të saj – një koncept i cili është përdorur mjaft edhe në Evropë pas shekullit të shtatëmbëdhjetë –, si dhe **peizazhi kulturor** i cili është zhvilluar si dëshmi e ndërveprimit harmonik mes natyrës dhe ndërhyrjeve njerëzore për një periudhë të gjatë kohore. Meqenëse peizazhi kulturor është shpesh produkt i një mënyre të veçantë të jetuarit dhe lidhet ngushtë me të, çdo ndryshim në këtë mënyrë jetese do të nënkuptonte ndryshim në vetë peizazhin. A është e mundur që të konservohet plotësisht një mënyrë jetese e caktuar? Do të ishte më mirë nëse konservuesi mendon rreth konservimit të produkteve të rëndësishme të asaj mënyre të jetuarit, sesa për vetë mënyrën e jetesës.

Peizazhi kulturor formohet nga i tërë ambienti i formuar apo i ndërtuar nga njeriu. Brenda disa zonave ai mund të klasifikohet si me interes të veçantë historik, d.m.th. “peizazhet historike etnografike, historike të shoqërizuara, peizazhe fqinje historike”, apo ato me “interes bashkëkohor” (P. Goodchild, IoAAS, *pers. komm 1990*).

Të gjitha këto kërkojnë një përkujdesje të përshtatshme, një dokumentim dhe një planifikimin për mbrojtjen e tyre.²⁶

Cënimi dhe ndërhyrja e zhvillimit tregtar paraqet disa kërcënime tipike që mund t’u adresohen përgjegjësve për menaxhimin konservues. Për më tepër, përdorimi i ri – megjithëse i nisur me qëllime të mira – dhe sigurimi i shërbimeve dhe i infrastrukturës së re, mund të çojë në uljen e vlerës së monumentit origjinal si dhe të kontekstit mjedisor të tij. Çdo sportel, qendër informacioni dhe hapësirë ekspozimi duhet të planifikohet me kujdes të madh për të garantuar integritetin

²⁶ Udhëzuesit për trajtimin e peizazheve historike po hartohen nga Shërbimi i Shteteve të Bashkuara për Parqet Kombëtare.

e vendndodhjes. **Duhet të vendosen hapësira mbrojtëse me përmasa të mjaftueshme për të mbrojtur kontekstin e peizazhit apo qytetit historik nga elementet ndërhyrëse të cilat ulin vlerat kulturore. Planifikimi në nivel vendor dhe rajonal duhet të marrë parasysh *genius loci* dhe statusin e ngritur të sitit të Trashëgimisë Botërore, si dhe duhet të sigurojë që të gjitha llojet e kërcënimeve negative të mund të parandalohen apo kontrollohen në mënyrë rigoroze.**

8.3. KONKLUZIONI

Trashëgimia Botërore është një **burim** i ndjeshëm, **jo i ripërtërishëm dhe i pazëvendësueshëm**. Qëllimi i ruajtjes së siteve të Trashëgimisë Botërore është ruajtja e **autenticitetit** dhe e vlerave të tyre, për të cilat edhe janë përfshirë në Listën e Trashëgimisë. Rrjedhimisht, çdo trajtim duhet të bazohet në një strategji minimale ndërhyrjesh, si dhe duhet të përfshijë një program mirëmbajtjeje parandaluese dhe periodike. Shkalla e ndërhyrjes dhe teknikat e zbatuara varen nga vetë burimi individual, konteksti mjedisor i tij dhe kushtet klimaterike ndaj të cilave ky burim është i ekspozuar.

Procesi i vlerësimit të burimit do të shërbejë si korniza për vendosjen e prioriteteve për vlerat përfaqësuese, përcaktimin e objektivave të menaxhimit dhe përgatitjen e strategjive të prezantimit. Dokumentet të cilat përshkruajnë vlerat dhe veçoritë e vendndodhjes së Trashëgimisë Botërore duhet t'i bëjnë të qarta **vlerat dhe rëndësinë** e burimit për publikun e gjerë.

Trajtimi i suksesshëm i konservimit të siteve të Trashëgimisë Botërore varet nga efikasiteti i procesit të vlerësimit. Trajtimet varen nga karakteri i monumentit apo i sitit, por ato gjithnjë duhet të jenë të bazuara mbi **grykimin kritik**. Një rëndësi jashtëzakonisht të madhe gjatë planifikimit të çfarëdolloj trajtimi zë edhe marrja në konsideratë e vlerave specifike për të cilat siti është pranuar në Listën e Trashëgimisë Botërore. Rrjedhimisht, prioritetet e trajtimeve duhet të vendosen në përputhje me rekomandimet ndërkombëtare, si dhe duhen përgatitur edhe planet e veprimt për të ardhmen.

Propozimet për restaurim ose anastilozë të përmasave të mëdha për cilindo sit, si dhe propozimet e menaxhimit të cilat ndikojnë në mjedisin rrethues, duhet t'i dorëzohen Komitetit të Trashëgimisë Botërore për t'u shqyrtuar dhe komentuar para fillimit të punimeve. Strategjia thelbësore për sigurimin e parimit të **ndërhyrjes minimale** mund të zbatohet vetëm përmes **inspektimeve të rregullta dhe mirëmbajtjes parandaluese**.

8.3.1 Lista e kontrollit për menaxhimin

- ✓ A janë **përkufizuar** mjaftueshëm vlerat thelbësore të burimit tuaj të Trashëgimisë Botërore?
- ✓ A janë **përkufizuar** këto vlera në mënyrë të qartë në një dokument i cili është vënë në **dispozicion** të banorëve dhe përdoruesve të sitit të trashëgimisë?
- ✓ A i vlerësojnë **banorët dhe përdoruesit** vlerat e trashëgimisë së tyre në një mënyrë të përshtatshme?
- ✓ A reklamohen **objektivat e konservimit të Trashëgimisë Botërore** përmes politikave ekzistuese?
- ✓ A zbatohen **parimet** e shprehura në konventat dhe kartat ndërkombëtare?
- ✓ A janë vendosur **prioritetet** për trajtimin konservues në lidhje me vlerat?
- ✓ Në rastet kur propozohet një përdorim i ri i përshtatur, a është ruajtur sa duhet **autenticiteti** historik?

Kapitulli 9

PLANIFIKIMI URBAN DHE QYTETET E TRASHËGIMISË BOTËRORE

9.1 HYRJE

Periodha pas Luftës së Dytë Botërore u shoqërua me një rritje të zhvillimit industrial, numrit të popullsisë, si dhe konsumit të tepërt të burimeve botërore në mbarë globin. Për pasojë, është rritur edhe shqetësimi rreth zhvillimit të qëndrueshëm lidhur me ambientin natyror si dhe menaxhimin e përshtatshëm të burimeve. Ky shqetësim është shprehur edhe në konferencat ndërkombëtare si ato të Stokholmit të vitin 1972, Konferenca e Vendbanimeve në Vankuver, më 1976, Konferenca e Rio de Zhaneiros mbi ambientin, në vitin 1992, Konferenca e Vendbanimeve II në Stamboll, më 1996, si dhe Raporti “Brundtland” i Komisionit Botëror të Kombeve të Bashkuara mbi Ambientin dhe Zhvillimin, i publikuar më 1987.

Konventa e Trashëgimisë Botërore e reflekton këtë evolucion duke drejtuar vëmendjen tek vlerat universale të vendbanimeve historike dhe peizazheve kulturore, ku konservimi i trashëgimisë përballet në mënyrë të drejtpërdrejtë me vlerat dhe çështjet praktike të menaxhimit që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik dhe zhvillimin e komunitetit. Kontrolli i ndryshimeve dhe planifikimi i ambienteve të ndërtuara kanë një prirje drejt zbatimit të proceseve dinamike që synojnë të plotësojnë nevojat e reja të një komuniteti. Krahas ruajtjes së strukturave fizike dhe ruajtjes së marrëdhënies së krijuar me ambientin, konservimi urban duhet të përfshijë edhe mbarëvajtjen e funksioneve të përshtatshme, si dhe aty ku është e mundur edhe mënyrat tradicionale të përdorimit. Konservimi i qyteteve historike dhe peizazheve kulturore kërkon domosdoshmërisht angazhimin e profesionistëve të ndryshëm, duke përfshirë këtu planifikuesit urbanë, arkitektët, sociologët dhe administratorët. Në të njëjtën kohë, një element esencial i punës është edhe ndërgjegjësimi i popullsisë vendore, i teknikëve dhe i administratorëve mbi vlerat e trashëgimisë dhe rëndësinë e strukturave historike, duke nxitur përdorimin e materialeve tradicionale, mirëmbajtjen e rregullt dhe riparimin në kohën e duhur, si dhe duke përcaktuar kriteret për ndërtimin e strukturave dhe objekteve të reja – nëse kjo e fundit nuk mund të shmanget. Duke patur parasysh kompleksitetin e kësaj detyre, fokusi i këtij Udhëzuesi është detyrimisht i kufizuar brenda disa kornizave që nxjerrin në pah aspekte të veçanta të procesit të planifikimit konservues.

9.1.1 Cilësitë e qyteteve historike

Një qendër urbane historike e mbajtur në gjendje të mirë ofron disa avantazhe për qytetarët e saj. Qendra të tilla janë më intime dhe me përmasa njerëzore, dhe shpesh të pasura me aktivitete të larmishme. Duke krahasuar këto qendra me disa qytete të planifikuara kohët e fundit, qendrat historike mund të jenë edhe më të përshtatshme për t'u përdorur si vendbanime, për të patur funksione të veçanta publike, për të ofruar shërbime të përshtatshme, për të bërë pazarin si dhe për t'u zbavitur. Zakonisht, qyteti përqendrohet rreth disa ndërtesave kryesore, siç mund të jetë katedralja, xhamia, kështjella ose bashkia me sheshin e pazarit. Këmbësorët hasin shumë tipare të rafinuara në rrugët, rrugicat, madje edhe kanalet dhe urat e qytetit. Këto hapësira urbane kombinohen me njëra-tjetrën për të krijuar pamje dramatike që ngjallin ndjesi të ndryshme përmes ngjeshjes, zgjerimit, befasisë dhe pozicionimit të kujdesshëm të objekteve të bukura arkitektonike. Pamjet e ndërtesave kryesore të para nga rrugë dhe pozicione të ndryshme shërbejnë si pika të mira referimi. Ata qytetarë të cilët e njohin historinë e vendit do të kënaqen me ndjesinë e pjesëmarrjes në historinë e tij, si dhe me ndjenjën e vazhdimësisë së identitetit. Disa prej ndërtesave kryesore kanë një vlerë simbolike për qytetin, dhe pa to, vendi nuk do ishte më kurrë i njëjti.

Substanca dhe potenciali arkeologjik që mishërohet nga disa vlera historike si dhe autenticiteti i materialit shtrihen në strukturat e të gjitha ndërtesave dhe infrastrukturës së qyteteve historike. Shpeshherë, një pjesë e madhe e përmbajtjes urbane mund përfshijë disa ndërtesa të thjeshta pa ndonjë cilësi të veçantë artistike. Disa shembuj ndërtesash të tilla vihen re në arkitekturën anonime popullore që lidhet me sheshe të hapura, rrugica, rrugë dhe parqe. Janë pikërisht këto struktura dhe hapësira urbane, në të cilat ka evoluar jeta në qytet, ato që e bëjnë konceptin e qytetit historik të dallojë nga një grupim monumentesh. Shkatërrimi apo braktisja e tyre do të bënte që qyteti të humbiste esencën e vet, prandaj dhe duhen vendosur politika për trajtimin e tyre.

- ❑ *Vlera e një qyteti historik është e mishëruar në provat materiale të gurëve dhe strukturave të tij, dhe shpesh gjendet në sipërfaqen e tyre të dukshme. Ky shtresëzim historik përfshin provat dhe shenjat e lëna nga ndryshimet e shkaktuara me kalimin e kohës, si dhe lidhjet dhe vazhdimësinë që e bëjnë një ndërtesë individuale të jetë pjesë e një konteksti urban. Për rrjedhojë, ky shtresëzim përbën dhe vetë bazën për vendosjen e kriterëve për konservimin e qytetit historik.*

Në Romë mund të shihen rrënojat e strukturave antike romake, që po të mos kishin vlerën e tyre historike, do të dukeshin si struktura të thjeshta. Nga ana

tjetër, qytetet historike në Lindjen e Mesme dhe Afrikën Veriore tregojnë se si ndërtesat individuale formojnë vazhdimësinë e një modeli urban, i cili është i përbërë nga lagje të banuara që ofrojnë shërbime dhe që kanë hapësira publike dhe zona qendrore tregtare, si *souk* (treg, arabisht, v.j.) ose pazare. Përmbajta urbane e qyteteve të cilat janë ndërtuar gjatë një periudhe të gjatë përfshin elemente dhe funksione të cilat janë të lidhura ngushtë dhe të përziera me njëra-tjetrën.

Autenticiteti i projektimit të një qyteti historik është i shprehur në disa aspekte të ndryshme të qytetit. Ai reflektohet në projektimin e përgjithshëm të planit të qytetit, si dhe në projektimin arkitektonik, artistik, inxhinierik dhe funksional të ndërtesave individuale dhe marrëdhënieve të tyre me njëra-tjetrën dhe ambientin rrethues.

□ *Harmonia e krijuar nga materialet dhe metodat tradicionale të ndërtimit është pjesë e këtij autenticiteti, dhe si e tillë duhet të respektohet.*

Duhet të vazhdohet që të përdoren ngjyrat tradicionale që bazohen në pigmente natyrore ose bojëra gëlqerore. Për më tepër, përmbajtja dhe shkalla e përmasave të qytetit duhet të respektohet dhe të shmangen ndërhyrjet e reja. *Genius loci*, apo karakteri i vendit, e bën atë të veçantë duke i dhënë edhe cilësitë e tij specifike.

□ *Një qytet historik është një organizëm shumëfunksional me aktivitete të lidhura me strehimin si dhe me jetën sociale, politike dhe ekonomike. Meqenëse kjo është esenca e një organizmi urban, zona urbane duhet të jetë e përcaktuar saktë dhe të gjitha këto aspekte duhet të shqyrtohen dhe administrohen në mënyrë të përshtatshme.*

Në një zonë urbane historike, mirëmbajtja dhe ruajtja e të gjitha ndërtesave dhe funksioneve të tyre sociale është esenciale për të siguruar vazhdimësinë e qytetit si një entitet urban. Në mënyrë që të parandalohet degradimi strukturor dhe ekonomik, plani i konservimit duhet të parashikojë inspektime të rregullta nga arkitektë të konservimit. Plani duhet të marrë parasysh gjithashtu faktin se qytetet janë pjesë e një mjedisi më të gjerë që përfshin edhe ambientin rrethues. E vetmja mënyrë për të siguruar një ruajtje të përshtatshme është zgjerimi i politikave të planifikimit për të marrë në konsideratë edhe kontekstin e gjerë.

9.1.2 Rreziqet ndaj qyteteve historike

Sot, tërësia tradicionale dhe funksionale e qyteteve historike është shpeshherë në rrezik, veçanërisht në vendet në zhvillim. Në vijim janë renditur disa prej arsyeve të shumta që shkaktojnë këtë lloj degradimi:

- rritja demografike dhe lëvizja mbarëbotërore e popullsisë nga zonat fshatare drejt qendrave urbane sjell ndryshime sociale që mund të çojnë drejt shkatërrimit të qendrës historike. Këta faktorë ndikojnë në transformimin e pallateve në subjekte të tregtueshme ku shpesh shtëpitë janë të mbipopulluara nga njerëzit, duke i kthyer ato në hapësira banimi jo të shëndetshme;
- rritja e përdorimit të transportit motorik privat, i cili ka depërtuar edhe në zona të cilat nuk kanë qenë kurrë të projektuara për të lejuar kalimin e automjeteve që krijojnë ndotje atmosferike dhe dridhje shkatërruese;
- zhvillimi i ndërtimeve shumëkatëshe, të cilat u zënë frymën qendrave urbane historike, duke ndryshuar mikroklimën e tyre;
- ndryshimet në metodën dhe shkallën e veprimtarive industriale dhe tregtare që ndikon në funksionet ekonomike të zonave historike;
- lëvizja nga puna artizanale drejt prodhimit në masë, e cila krijon nevojën për ndërtesa më të mëdha, duke shkaktuar kështu edhe një rritje trafiku të papërbalueshme brenda zonave historike;
- futja në përdorim e funksioneve dhe shërbimeve moderne për të zëvendësuar infrastrukturën tradicionale, duke shkaktuar kështu teprica të këtyre shërbimeve dhe funksioneve; dhe
- mungesa e mirëmbajtjes së ndërtesave të vjetra dhe moskuptimi i vlerave të tyre kulturore dhe funksionale, duke rritur rreziqet e degradimit dhe shembjes.

Planifikuesit modernë shpesh nuk kanë arritur të kuptojnë vlerën e qendrave historike, dhe miratimi i pakontestuar i lejeve të kalimit të trafikut të motorizuar në shumë raste ka çuar drejt ndërtimit të rrugëve të gjera dhe të drejta në mes të qendrave historike të ndjeshme, duke shkatërruar përmasat e tyre njerëzore, strukturën tradicionale të rafinuar të përmbajtjes së tyre urbane, si dhe hapësirat intime. Një tjetër element që ka shkaktuar dëme në qendrat historike ka qenë edhe shtimi pa kriter i ndërtesave moderne të cilave u mungojnë si rrënjët kulturore ashtu edhe përputhshmëria mjedisore.

Zonat historike në gjendje jo të mirë mund të shndërrohen në epiqendra plot jetë, duke u bërë edhe tërheqëse për të gjitha kategoritë sociale përmes riorganizimit të një numri aktivitetesh të lidhura me vendbanimet, tregtinë, industrinë e lehtë dhe argëtimin. Menaxhimi urban duhet të ketë për qëllim krijimin e harmonisë, shmangien e funksioneve të padëshiruara dhe mirëmbajtjen e nivelit ekzistues të

ndërtesave dhe të vlerave të tyre funksionale dhe kulturore. Metodologjia e kësaj qasjeje quhet *konservim i integruar*.

9.2 OBJEKTIVAT E PLANIFIKIMIT

Në të gjitha studimet e planifikimit urban që kanë të bëjnë me qendrat historike, para se të gjenden zgjidhjet, është shumë e rëndësishme që paraprakisht të qartësohen objektivat. Modelet universale nuk ekzistojnë, pasi teknikat varen nga burimet profesionale dhe hartimi dhe zbatimi i politikave sociale dhe fizike që janë të realizueshme në secilën qendër historike.

- *Në qytetet e Trashëgimisë Botërore, objektivi kryesor është ruajtja e përmbajtjes urbane nëpërmjet përdorimit të dobishëm.*

Në një shkallë urbane, konservimi përfshin jo vetëm vlerat kulturore dhe historike por edhe ndërlidhjet e trashëguara të tyre ekonomike dhe sociale. Qyteti, apo qyteza, historike ngre probleme të konservimit që lindin më shumë për shkak të qasjeve politike dhe ekonomike sesa për shkaqe të lidhura me aspektet fizike. Qyteti është produkt i disa periudhave historike dhe i marrëdhënieve specifike sociale, kulturore, antropologjike, gjeografike dhe ekonomike.

- *Qendra historike është pjesë përbërëse e një tërësie më të madhe dhe duhet të studiohet si pjesë e realitetit të sotëm dinamik, e jo thjesht si një objekt statik ku mund të meditosh dhe ku mund të zhvillohet turizmi.*

Historikisht, të ardhurat dhe pasuria që prodhohet në qytet është investuar në objekte kulturi, monumente, shtëpi luksoze, kopshte, etj. Sot, problemi qëndron në kontrollin e zhvillimit të vazhdueshëm që krijohet në qytet, ku përdorimi privat në disa raste duhet të shndërrohet në atë kolektiv. Për pasojë, veprimet që reklamojnë konservimin janë të lidhura më shumë me instrumentet dinamike politike sesa me mjetet statistike apo teknike. Si rrjedhojë, programi i shfrytëzimit social dhe ekonomik të qytetit dhe rajonit të tij ka një rëndësi të jashtëzakonshme.

9.2.1 Konservimi i integruar

- *Konservimi i integruar nënkupton pajtimin e kërkesave të konservimit me objektivat e planifikimit urban; d.m.th. që gjatë procesit të përgjithshëm të planifikimit duhen që vlerat dhe interesat e përmbajtjes ekzistuese historike të merren në konsideratë në nivel të barabartë me faktorë të tjerë.*

Duke patur parasysh se qytetet e Trashëgimisë Botërore njihen për “vlerën e tyre të jashtëzakonshme universale”, garantimi i ruajtjes së përshtatshme të

autenticitetit dhe vlerave kulturore është diçka jetike. Konservimi i integruar përfshin konservimin dhe riaftësimin e ndërtesave dhe zonave historike, si dhe sigurimin e shërbimeve të përshtatshme publike që respektojnë kriteret në bazë të të cilave janë ndërtuar këto zona. Për të patur një sukses afatgjatë, ky proces duhet të kryhet në përgjithësi në bashkëpunim me banorët, duke përdorur si mjete legjislativonin dhe normat e planifikimit.

- ❑ *Baza për çdo planifikim dhe ndërhyrje në përmbajtjen ekzistuese është njohja dhe kuptimi i burimit në fjalë, si në aspektin e historisë së tij ashtu edhe në atë të gjendjes së tij ekzistuese.*
- ❑ *Pikënisja për planifikimin konservues duhet të jetë identifikimi i përmbajtjes historike të qytetit duke u bazuar në një studim dhe një analizë të hollësishme.*

Ndërtimet e reja mund të kuptohen në bazë të normave dhe standardeve me të cilat ato janë ndërtuar. Në përgjithësi, materialet e vjetra nuk kuptohen aq mirë, dhe prandaj ato duhet të studiohen me kujdes për të identifikuar kriteret dhe teknologjinë e ndërtimit të tyre. Ky zbrëthim i materialeve është më efikas nëse kryhet përmes analizës sistematike të tipologjisë arkitektonike, strukturore dhe funksionale të këtyre ndërtesave dhe të zonave urbane në të cilat ndodhen këto objekte. Kjo duhet të jetë dhe baza e planifikimit konservues, i cili në vetvete ka për qëllim të arrijë një efikasitet maksimal në lidhje me përdorimin e potencialit të zonave historike.

- ❑ *Identifikimi i materialit historik urban dhe i transformimeve urbane bëhet më i thjeshtë përmes studimit krahasues të planeve ekzistuese kadastrale dhe të dokumenteve korresponduese që datojnë nga periudha më të hershme historike.*

Periudhat e ndryshme historike kanë pasur ligje dhe zakone të ndryshme në varësi të motiveve specifike teknike, sociale, politike apo ekonomike. Identifikimi i këtyre arsyeve dhe i metodave të zbatimit të tyre (p.sh. përmes studimit të doracakëve bashkëkohorë) do të ndihmojë në kuptimin e logjikës së përdorur në ndërtimin dhe pozicionimin e ndërtesave, si dhe në projektimin e hapësirave publike.

Rrjedhimisht, është e mundur të identifikohen strukturat dhe hapësirat historike ekzistuese, si dhe shembjet dhe shtesat e reja. Këto analiza do të ndihmojnë në përkufizimin fizik të zonave ekzistuese me rëndësi historike, të zonave të ndërmjetme që do të vihen në funksion të mbrojtjes së tyre, si dhe në përgatitjen e normave të planifikimit për ruajtjen e përshtatshme të tyre.

Studimi i forcave që nxisin rritjen ekonomike në zonat urbane në përgjithësi mund të ndihmojë në vetëmbrojtjen e zonave historike. Një nga përgjegjësitë e planifikuesve është kontrolli i zhvillimit duke parandaluar ndërtimin e godinave të mëdha që ndërhyjnë në planin urban, si dhe duke frenuar fluksin e padëshiruar të trafikut dhe duke mos lejuar funksione që prishin ekuilibrin e qytetit. Godinat e larta me zyra duhet të pozicionohen larg qendrës historike, dhe e njëjta gjë vlen edhe për kullat e ujit, ndërtesat industriale dhe disa shërbime të tjera të cilat mund të shkaktojnë pengesa nëse nuk janë të pozicionuara me kujdes.

□ *Kërkesat për transport duhet të analizohen me kujdes në bazë të kapacitetit të zonave historike për t'i rezistuar trafikut të automjeteve dhe këmbësorëve.*

Disa zona historike janë të projektuara në një mënyrë të tillë që krijon pengesa të natyrshme ndaj trafikut të motorizuar (p.sh. me rrugë të ngushta apo të pjerrëta). Në secilin rast, kërkesat për trafik të motorizuar duhet të plotësohen në bazë të nevojave të domosdoshme të zonave specifike. Automjetet e mëdha duhet të ndalohen pasi pengojnë banorët dhe përshpejtojnë prishjen e ndërtesave historike. Megjithëse transporti i brendshëm duhet garantuar, do të ishte më mirë që trafiku i motorizuar të kalojë nëpër rrugë anësore apo përmes unazave, me dalje në zona të përshtatshme drejt qytetit historik.

Propozimi i UNESCO-s për konservimin e Qytetit të Vjetër të Aleppo-s (Bianca *et al.*, 1980) i ka identifikuar të gjitha këto rreziqe dhe ka paraqitur një plan bazë dhe disa rekomandime për studime të mëtejshme. Një nga shënimet më të rëndësishme është cituar në vijim:

Veçoritë thelbësore strukturore të përmbajtjes islamike nuk janë marrë parasysh [në planet e mëparshme]. Këto veçori përfshijnë karakterin e tërhequr nga brenda të arkitekturës së saj, integrimin e ndërtesave të veçuara në grupe më të mëdha, koherencën e përmbajtjes urbane dhe karakterin e veçantë të rrjetit rrugor për këmbësorë. Kufizimet specifike të qytetit të vjetër të krijuara për shkak të përmasave dhe tipologjisë arkitektonike, lejojnë zhvillimin e kufizuar të një numri aktivitetesh të lidhura drejtpërdrejt me trafikun e automjeteve.

Shumë zona historike, duke përfshirë edhe vetë qytetet e Trashëgimisë Botërore nuk ruhen dhe nuk mirëmbahen, dhe karakterizohen kryesisht nga zona të braktisura dhe banesa që nuk kanë infrastrukturën e duhur. Problemet e tyre të trafikut nxjerrin në pah konfliktin mes nevojave të këmbësorëve dhe automjeteve të motorizuara. Për shkak të historisë së tyre të gjatë, ato shpesh kanë modele të ndërlikuara të pronësisë së ndarë. Gjithashtu, mund të ketë edhe probleme ekonomike, dhe nëse vlerat e pronës e kalojnë vlerën e materialeve të ndërtesës,

atëherë ekziston rreziku i fillimit të ndërtimeve nga e para. Konservimi i integruar i këtyre qendrave nënkupton bashkimin e të gjitha forcave politike e teknike në një bashkëpunim fushash të ndryshme që përdorin aftësitë e arkeologut, etnografit, sociologut, historianit, si dhe ato të arkitektit dhe inxhinierit. Ky bashkëpunim duhet të udhëhiqet nga një planifikues urban i kualifikuar dhe i ndërgjegjësuar për rëndësinë e konservimit.

9.2.2 Kontrolli i ndryshimit

□ *Një nga objektivat e konservimit urban është kontrolli i nivelit të ndryshimit në sistemin urban. Rrjedhimisht, duhen kuptuar forcat sociale të këtij sistemi dhe shkaqet e mundshme të prishjes së tij.*

Përmbajtja urbane zakonisht ka një jetë të gjatë për shkak të qëndrueshmërisë relative të materialeve me të cilat është ndërtuar. Në të kundërt, aktivitetet njerëzore të cilat duhet të përshtaten brenda kësaj përmbajtjeje ndryshojnë shumë më shpejt (standartet e jetesës, numri mesatar i pjesëtarëve në familje, mënyrat e prodhimit, ndryshimet e sjella nga teknologjia, siç janë automjetet dhe televizioni, shpërngulja nga lufta apo fatkeqësitë natyrore). Me kalimin e kohës, mund të shkaktohen konflikte të lidhura me vjetrimin real apo në dukje të ndërtesave dhe infrastrukturave. Nëse nuk ndërmerren masat e duhura, kjo mund të çojë drejt një planifikimi të dëmshëm që mund të sjellë pasoja degraduese të mëtejshme ndaj strukturave ekzistuese.

Ekzistojnë dy lloje kryesore të daljes nga përdorimi lidhur me aspektin:

- Fiziko-strukturor apo funksional,
- dhe me pozicionimin apo mjedisin, që mund të ketë zhurma, trafik ose ndotje të ajrit.

Planifikimi i dëmshëm është një infeksion ekonomik që shkaktohet në mungesë të vendimeve apo për shkak të përpjekjeve tepër ambicioze që kanë për qëllim përshtetimin e modernizimit, por që kanë dështuar. Gjithashtu, planifikimi i dëmshëm ndodh edhe në ato raste kur nuk krijohet një plan reagimi ndaj fatkeqësisë natyrore në zonat sizmike apo në ato që janë të rrezikuara nga përmytjet. Në bazë të një analize tipologjike e funksionale të përgatitur mirë, dhe në bazë të një programi riaftësimi, menaxhimi i konservimit urban duhet të jetë në gjendje t'i përballojë ndryshimet, të zbusë konfliktet dhe të përkrahë përmirësimin gradual në zonat e lëna pas dore. Përpos kësaj, përvoja tregon se **ndërhyrjet minimale në disa momente kyçe rezultojnë edhe si zgjidhjet më të mira për komunitetin.**

Sistemet urbane dhe rajonale të qyteteve, qytezave dhe fshatrave kanë evoluar gjatë shekujve nën ndikimin e forcave, brenda të cilave mund të marrin vendime sipërmarrësit dhe pronarët e tokave të sektorit publik dhe privat. Në shumicën e komuniteteve ky veprim është kontrolluar nga kushtëzimet qeveritare apo vendore të cilat kanë vendosur disa kufizime. Në të kaluarën, përdorimi i teknologjisë dhe i stilit konsekuent të ndërtimit ka krijuar një harmoni, dhe niveli i veprimtarisë ka qenë i kufizuar. Vetëm në shekullin e njëzetë ndodhi që planifikimi urban dhe rajonal filloi të përdoret si një mjet për të zgjidhur konfliktet mes forcave të shfrenuara dhe egocentrike të tregut dhe qëllimeve dhe objektivave të komunitetit.

Një planifikim i tillë është kthyer në një funksion të qeverisë, i cili mbështetet në legjisllacionin përkatës për këtë fushë ku punon dhe një makineri e tërë administrative me akordime financiare. Zakonisht, ky funksion përfshin përgatitjen e planit, zbatimin e tij dhe rishikimin. Procesi i përgjithshëm dallon qartazi nga njëri shtet tek tjetri dhe nga një periudhë kohore në tjetrën. Ky proces duhet të ndërlidhet me kulturën dhe zakonet e secilit shtet në mënyrë individuale, duke marrë parasysh edhe burimet profesionale që janë në dispozicion brenda atij shteti. Huazimi i sistemeve të gatshme është gabim, pasi sistemi mund të mos korrespondojë me nevojat apo dëshirat e vetë popullatës. Qytetet e Trashëgimisë Botërore duhet të jenë vende ku njerëzit jetojnë, kryejnë punët e tyre dhe kalojnë kohën e lirë; ato nuk janë muze.

9.3 PROCEDURA E PLANIFIKIMIT

Edhe pse të vetëdijshëm për dallimin mes planifikimit të përgjithshëm fizik dhe planifikimit në zonat e veçuara me vlera specifike kulturore, ne mund të identifikojmë një model për procesin e planifikimit urban i cili është adoptuar në mbarë botën në nivele të ndryshme përshtatjeje dhe me përqendrim në pjesë të ndryshme. Procesi përfshin:

- identifikimin e situatës aktuale;
- një parashikim të ngjarjeve në të ardhmen në mungesë të ndërhyrjeve të planifikuara;
- formulimin e mundësive të ndryshme që do të krijohen në të ardhmen si pasojë e ndërhyrjeve të planifikuara;
- vlerësimin e realizueshmërisë dhe dëshirës për të patur mundësi të tilla;
- analizën e hollësishme për mundësitë e përzgjedhura;
- formulimin e programit për zbatimin e mundësive me mjetet e duhura

ligjore, administrative, financiare, etj; dhe

- rishikimin e këtyre mundësive pas zbatimit, duke marrë parasysh përvojën e fituar. Kjo gjë kërkon që ngjarjet të monitorohen rregullisht.

Një plan tipik i përgjithshëm urbanistik është i përbërë nga dy elemente bazë. Elementi i parë konsiston në përshkrimin e përdoruesve aktualë dhe të ardhshëm të zonës së trajtuar nga plani (d.m.th., ata që banojnë apo e shfrytëzojnë atë në aktivitetet e tyre të përditshme). Elementi i dytë konsiston në sigurimin e kombinimit të përshtatshëm të përdorimit të tokës për këto aktivitete, siç janë industria, qendrat tregtare dhe shkollat, në mënyrë që zona të zhvillohet fizikisht në një mënyrë të përshtatshme.

Në rastin e qyteteve dhe qytezave historike që kanë fituar statutin e të qenit pjesë e Trashëgimisë Botërore, teknikat normale të planifikimit urban shpeshherë janë shumë të ngurta dhe përgjithësisht janë të papërshtatshme. Teknikat normale të këtij planifikimi përfshijnë studimet e tendencave demografike, lëvizjet e popullatës, trafikut dhe transportit (duke përfshirë edhe rritjen e numrit të automjeteve) dhe propozimet për zonimin e aktiviteteve dhe caktimin e hapësirës për zhvillimet ndërtimore të reja, si dhe përmirësimin e qarkullimit të trafikut.

Koncepti i zonimit – kufizimi i një zone për një kategori përdorimi specifik – bie në kundërshtim me pasurinë kulturore dhe larminë sociale të një qendre historike në kulmin e lulëzimit të saj. Statistikat që bazohen mbi zonimin nuk japin informacione aq të sakta rreth pronave specifike. Gjithashtu, ekziston rreziku që standardet të zbatohen pa analizuar mjaftueshëm realitetin ekzistues historik, gjë që mund të çojë drejt shkatërrimit të përmasave dhe përbërjes urbane ekzistuese.

Trajtimi i problemeve sociale në zonat historike ka nevojë për studime të plota që përdorin një metodologji të përshtatshme me kushtet vendore. Gjithashtu, duhet të shikohet me kujdes edhe modeli i pronësisë dhe i ndikimit të traditave dhe të praktikave ligjore të Shtetit Anëtar. Nëse këto praktika dhe tradita, apo qoftë edhe zbatimi i tyre i pamenduar mirë, bien ndesh me praktikat e menaxhimit efikas, atëherë ndryshimet duhet të kryhen gradualisht, ose me anë të legjislacionit. Në këtë çështje, edukimi dhe formimi profesional luajnë një rol të rëndësishëm.

Planet kombëtare dhe rajonale mund të kenë një ndikim të konsiderueshëm mbi Sitet e Trashëgimisë Botërore. Këto plane duhet të studiohen me shumë kujdes dhe çdo ndryshim i nevojshëm për menaxhimin konservues duhet të propozohet në kohën e duhur. Disa rreziqe tipike përfshijnë planet për ndërtimin e rrugëve

të reja, zhvillimi i industrisë dhe lëshimi në ajër i gazrave ndotës. Konservimi i sitit të Trashëgimisë Botërore duhet të jetë një prioritet i lartë për të gjitha nivelet e planifikimit urban, që nga plani i përgjithshëm komunal deri tek strategjitë e rrethit, të qarkut dhe ato në nivel kombëtar.

- *Në mënyra të ndryshme, problemet që hasen në qytetet e Trashëgimisë Botërore janë të lidhura me çështjet më të përgjithshme mjedisore dhe me kontrollin e zhvillimit.*

Këto çështje janë të shprehura qartë në raportin e Komisionit Botëror mbi Mjedisin dhe Zhvillimin, të vitin 1987 (Kombet e Bashkuara, 1987), dhe në Deklaratën e Tokios të të njëjtit vit dhe të publikuar në të njëjtin raport. Megjithëse këto raporte pranojnë se varfëria është burimi kryesor i degradimit ambiental, ato gjithashtu theksojnë nevojën për një bashkëpunim në nivel ndërkombëtar për të ndryshuar cilësinë e zhvillimit dhe për të konservuar e përmirësuar bazën e burimeve. Kjo do të thotë se teknologjia duhet ridrejtuar dhe faktorët e rrezikshëm duhen menaxhuar mirë, duke integruar edhe çështjet mjedisore dhe ekonomike në procesin e vendimmarrjes. Kjo qasje e re do të rriste kërkesën për **planifikimin konservues të integruar** të trashëgimisë kulturore përmes një menaxhimi realist dhe një **zhvillimi të qëndrueshëm** të burimeve kulturore ekzistuese.

Autoritetet kombëtare dhe vendore shpesh herë mbajnë qëndrime kontradiktore lidhur me caktimin e prioriteteve të planifikimit urban. Kontradiktat mund të zgjidhen duke u nisur nga situata ekzistuese dhe duke përdorur inspektime të rregullta për të identifikuar gjendjen dhe situatën e vërtetë të burimit.

9.3.1 Inspektimet dhe sondazhet

- *Plani urbanistik duhet të lidhet me potencialin e materialit të ndërtimeve ekzistuese. Inspektimi i hollësishëm i gjithë materialit historik që ka mbijetuar do t'u jepte planifikuesve një mundësi për të planifikuar në mënyrë realiste, duke përdorur burimet kulturore në mënyrën më të mirë të mundshme.*

Menaxhimi i zonave urbane historike dallon nga mënyra konvencionale e planifikimit urban nga fakti se inspektimet kryhen në intervale të rregullta kohorë. Nëse dihet me saktësi ajo çka gjendet në një sit dhe nëse është krijuar një inventar i plotë, atëherë mund të identifikohen edhe vlerat arkeologjike. Nganjëherë, ndërtesat që nuk bien në sy mund të fshehin struktura të rëndësishme që ia vlejné të restaurohen.

Ka disa mënyra se si mund të organizohen llojet e inspektimeve të rregullta. Nëse

në nivel vendor nuk gjenden aftësitë e duhura profesionale, atëherë Komisioni i Sitit mund të miratojë ngritjen e një paneli arkitektësh të përshtatshëm, dhe të përgatisë udhëzimet për procedurën. Në varësi të rrethanave, do të ishte në dobi të vendndodhjes nëse Komisioni do ta subvenciononte, ose mbulonte, të tërë koston e kësaj pune. Pronarët duhet të jenë të gatshëm të lejojnë që këto inspektime të kryhen në pronat e tyre, por atyre duhet t'iu dorëzohet kopja e raportit mbi pronën e tyre në mënyrë që të kuptojnë se inspektimet e rregullta e ulin koston afatgjatë të përkujdesjes ndaj pronës.

9.3.2 Zbatimi

Në shumë shtete procedurat e planifikimit hartohen nga lart-poshtë, prej nivelit shtetëror në atë të rretheve, dhe nga rrethet në qytete. E njëjta gjë mund të ndodhë edhe në rastet kur përgjegjësia kryesore u është caktuar komunave. Autoriteti përgjegjës për zbatimin do të drejtojë, ndikojë ose kontrollojë veprimet e agjencive të zhvillimit dhe atyre të konservimit dhe rinovimit. Autoriteti planifikues mund të ketë funksione të veçanta zbatuese për sektorë të veçantë, siç është sigurimi i elementeve të infrastrukturës së ujësjellësit, kanalizimeve, largimit të ujërave të reshjeve, energjisë elektrike, rrugëve, parkingut dhe hapësirave për banim, si dhe konservimin e ndërtesave dhe qendrave historike. Zbatimi është domosdoshmërisht një aktivitet i vazhdueshëm, i cili fillon gjatë procesit të planifikimit urban. Në të njëjtën mënyrë, edhe procesi i monitorimit dhe i rishikimit periodik të planit është një proces i vazhdueshëm.

- ❑ *Gjatë vlerësimit të vlerave të një objekti, siti apo qendre historike, planifikuesi konservues zakonisht punon nga poshtë-lart: së pari, dokumenton historinë e sitit dhe gjendjen aktuale, e më pas propozon ndërhyrjen minimale të nevojshme për të parandaluar rrënimin/shkatërrimin.*
- ❑ *Arsyet që çojnë drejt rrënimin mund të jenë ekonomike, kulturore ose fizike. Konservimi vetëm mund ta ngadalësojë përkeqësimin që rrjedh si pasojë e shkaqeve fizike. Por, duke inkurajuar ndërgjegjësimin publik rreth vlerave të sitit, konservimi mund të ndryshojë edhe qëndrimet kulturore, dhe me ndihmën e planifikimit mundet edhe që të mënjanojë shkaqet ekonomike që çojnë drejt rrënimin.*

Planifikimi konservues është veçanërisht i rëndësishëm për sa i përket riaftësimin të qendrave historike. Sidoqoftë, edhe qytetet me programe të sofistikuara të planifikimit urban shpesh nuk marrin parasysh gjendjen aktuale të trashëgimisë kulturore dhe kapacitetin e saj për të ofruar përdorime alternative. (Riaftësimi është një domosdoshmëri ekonomike në shumicën e zonave historike dhe do të diskutohet më tej.)

- *Planifikuesi duhet të respektojë jo vetëm hapësirat dhe ndërtesat historike, por edhe elementet jo të matshme të trashëgimisë kulturore të shfaqura si vlera të komunitetit apo jetës qytetare. Qëllimi i planifikimit duhet të jetë që të sigurojë se ndryshimi i planifikuar shmang, për aq sa mund të parashikohet, ndërprerjen e tendencave tradicionale dhe bashkëkohore të jetës së komunitetit. Megjithëse nuk mund të realizohet ndalimi i rrjedhës kohore të jetës qytetare, është e udhës që ndryshimet të ndihmohen duke respektuar zgjedhjet e personave që i ndër marrin ato.*

9.3.3 Kërkesat ndaj personelit

Në mënyrë që procesi i planifikimit të kryhet sa më mirë dhe me të gjitha studimet e nevojshme, ka disa kërkesa të rrepta që rëndojnë mbi organikën profesionale. Jo çdo shtet ka në dispozicion një numër të mjaftueshëm punonjësish për të organizuar një sistem të sofistikuar të planifikimit që respekton nevojat e njerëzve. Në të vërtetë, planifikimi urban ka prirjen për të qenë aq i komplikuar sa që një njeri i thjeshtë shpesh heq dorë nga përpjekja për të kuptuar procedurat dhe logjikën e procesit. Për më tepër, edhe vonesat e gjata në procesin e vendimmarrjes nuk ndihmojnë në këtë drejtim.

Një nga objektivat e planifikimit konservues duhet të jetë edhe vendosja e një sistemi komunikimi me pronarët që u jep atyre udhëzime mbi trajtimin e pronave të tyre. Ky komunikim mund të zgjerohet me përcaktimin e zonave të konservimit dhe emërimin e një arkitekti-planifikues dhe të një vlerësuesi që do të administrojnë udhëzimet. Dhe pse nuk është e përsosur, kjo metodë lejon një nisje të shpejtë të procedurave për mbrojtjen e nevojshme për vendndodhjet në vendet në zhvillim.

9.3.4. Raporti dhe plani i konservimit

Hapi i radhës në procedurën e planifikimit konservues është përgatitja e raportit të konservimit të qendrës historike nga këshilltarë të pavarur. Ky raport do duhet të përfshijë hulumtimin nëpër arkiva ashtu si dhe një seri sondazhesh të materialeve. Rezultatet duhet të përmbliken dhe të ilustrohen duke përdorur harta me një shkallë madhësie të përshtatshme²⁷. Plani i konservimit dhe standardet e zbatimit do të bazohen mbi këtë raport, duke i dhënë konsideratën e duhur ligjeve dhe rregulloreve në fuqi, si dhe duke u bazuar mbi këshillimet me pronarët. Do të ishte

²⁷ Në harta mund të përdoren ngjyra apo hijëzime për të identifikuar llojet e ndryshme të informacionit. Më së shumti preferohet të përdoren hijëzimet, meqenëse ato mundësojnë një riprodhim të lehtë me anë të fotokopjes të atij materiali që është dokumentuar në bardhë e zi.

e dobishme që të prodhohej një seri udhëzuesish praktikë, ose doracakë, që u japin informacion pronarëve rreth çështjeve teknike.

Raporti dhe plani duhet të përmbajnë rilevime dhe dokumente; që do të thotë:

- **Harta:** hartat bazike të cilat tregojnë qytetin në tërësi dhe qendrën historike në veçanti.
- **Pronësia:** hartat që tregojnë pronësinë dhe përdorimin aktual të pronave historike.
- **Historia:** një ilustrim i zhvillimit të përgjithshëm historik të gjithë zonës urbane, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë zonave kyçe. Gjithashtu, duhet të përgatitet një paraqitje që tregon vjetërsinë dhe fazat historike të gjendjes ekzistuese të ndërtesave.
- **Tipologjia:** (a) sondazhet e tipologjisë arkitektonike, strukturore dhe funksionale të ndërtesave; (b) tipologjia e hapësirave të hapura publike dhe private; (c) analizat e peizazhit dhe pamjes së qytetit.
- **Gjendja:** një sondazh i gjendjes fizike të secilës pronë historike, infrastrukturës dhe shërbimeve në zonat përkatëse të konservimit.
- **Plani i Konservimit:** përbëhet nga harta në të cilën caktohet politika e propozuar e konservimit dhe nivelet e trajtimit, si dhe standardet dhe rregulloret që duhen zbatuar.

Harta dhe Pronësia: Për të nisur punimet nevojiten një seri hartash që tregojnë të tërë qytetin dhe zonat historike në një shkallë që lejon identifikimin e pronave individuale dhe kufijve të tyre (p.sh. 1:500 apo 1:250). Gjithashtu, nevojitet edhe një hartë që tregon pronësinë dhe përdoruesit e pronës (p.sh. private, publike, tregtare, industriale, fetare, etj). Një hartë e tillë mund të kombinojë në mënyrë efikase informacionin e regjistrit të pronave dhe të dhënat e nxjerra nga kadastra përmes bashkëpunimit me autoritetet vendore. Do të ishte e dobishme sikur të krahasohej edhe pronësia aktuale me një fazë të mëparshme, për të identifikuar ndikimin që ka zhvillimi modern. Në një fazë më të përparuar, mund të jetë e dëshirueshme që të përgatiten harta të cilat tregojnë planimetrinë e objekteve. Sondazhi, gjithashtu duhet të japë edhe informacione rreth infrastrukturës dhe situatës gjeologjike të zonës.

Historia: Duhet përgatitur një seri hartash për të ilustruar zhvillimin historik të zonës së përgjithshme urbane, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë zonave kyçe. Gjithashtu, duhen identifikuar edhe shkaqet e zhvillimit ose rrënimit në

periudhat e ndryshme. Ky sondazh duhet të shoqërohet me studimin e plotë bibliografik dhe përmbledhjen e vizatimeve historike, gravurat, hartat dhe planet urbane të mëparshme. Është e rëndësishme që si pjesë e analizës të verifikohen edhe niveli i zbatimit të planeve urbane të mëparshme si dhe përcaktimi i fazave përkatëse për çdo element aktual të identifikuar. Ky sondazh është thelbësor jo vetëm për vendosjen e kriterëve të ndërtimit të strukturave fizike ekzistuese, por edhe për identifikimin e zonave të tyre funksionale, dhe mund të shërbejë si një bazë të dhënash për riaftësimin e mundshëm në të ardhmen. Për më tepër, duhet të identifikohen edhe vjetërsia dhe fazat historike të ndërtesave, dhe në një hartë tjetër duhet të paraqiten ndërtesat dhe zonat të cilat kanë një mbrojtje të posaçme nga autoritetet²⁸.

Tipologjia dhe Gjendja: Sondazhet dhe hartat rezultuese do të tregojnë tipologjinë e ndërtesave historike dhe të hapësirave të hapura private e publike. Ato janë bazuar në regjistrimin dhe kryerjen e sondazheve për ndërtesat historike, me qëllim qartësimin e kriterëve për projektimin dhe ndërtimin e tyre. Elementet e ndryshme të ndërtimit duhet të regjistrohen dhe të paraqiten në doracakë bashkëkohorë. Aty ku është e mundur, në këto doracakë duhet paraqitur edhe funksioni, materialet dhe metodat e ndërtimit (p.sh. projektimi, strukturat e dyshemesë, çatitë, oborret, si dhe pozita e shkallëve, dyerve dhe dritareve). Pronat mund të kategorizohen në bazë të tipit dhe funksionit të tyre (p.sh. ndërtesa publike, komplekse fetare ose ndërtesa të komunitetit, pallate, banesa, banesa me oborr, etj).

Kjo analizë duhet të shoqërohet me informacione të dokumentuara, duke përfshirë:

- një sondazh të transformimeve në kohë,
- sqarimet rreth gjendjes së pronave, dhe
- përcaktimin e statusit social dhe ekonomik të zonave përkatëse.

Këto dokumente formojnë referencën bazë për rekomandimet lidhur me trajtimet. Sondazhi mund të zgjerohet me një analizë të peizazhit apo pamjes së qytetit; një analizë kjo që merr parasysh kriteret e projektimit dhe thekson ansamblet e

²⁸ Kriteri për listimin e ndërtesave duhet të përcaktohet paraprakisht, por së paku duhen përfshirë të gjitha ndërtesat që janë ndërtuar më shumë se 100 vjet më parë, bashkë me shumicën e atyre që janë ndërtuar mbi 80 vjet më parë. Ndërtesat më të reja mund të listohen kur ekzistojnë disa arsye të veçanta. Ndërtesat e listuara mund të ndahen në kategori (p.sh. *Kategoria 1*: Interes kombëtar, *Kategoria 2*: Interesi rajonal apo qarkor; *Kategoria 3*: Vlera vendore apo panorama urbane e qytetit). Edhe pse kategoritë duhet të kenë një ndikim mbi menaxhimin e këtyre pronave, ato nuk duhet të merren në konsideratë si baza për të kryer vlerësimin, pasi vlerat historike në konservimin urban u referohen materialit të gjithë qytetit ose qytezës.

ndërtesave, hapësirat dhe zonat për zbavitje, parqet dhe kopshtet historike, pamjen e ndërtesave apo rrugëve, dhe pamjet jashtë qendrës historike, duke shërbyer kështu si referencë e mirë për planifikim konservues dhe zhvillimin e mundshëm modern të rajonit. Në këtë kontekst, është tepër e rëndësishme që të shënohen dhe paraqiten ndërtesat të cilat janë të rëndësishme për ndjenjat e identitetit të qytetarëve.

Masterplani i Konservimit është një dokument që përmbledh konkluzionet që dalin nga analizat e mësipërme. Ai përbëhet nga një Hartë e Masterplanit të Konservimit dhe Normativat e Zbatimit. Plani do të përcaktojë politikën e propozuar të konservimit për secilën zonë në mënyrë individuale, si dhe do të paraqesë parametrat për trajtimin e ndërtesave apo zonave të veçanta. Zonat e mbrojtjes së veçantë, zonat ndërmjetëse mbrojtëse dhe zonat në të cilat zbatohen udhëzuesit duhet të jenë të paraqitura sa më qartë. Përveç kësaj, plani duhet të identifikojë zonat ku nuk do të lejohet ndërtimi i ndërtesave të larta, si dhe zonat dhe kushtëzimet për zhvillim modern (p.sh. ndërtesat e mëdha apo të larta, vendndodhjet industriale, etj.), në mënyrë që të shmanget dëmtimi i vlerave në zonat historike. Ky dokument duhet të shërbejë si baza e referencave për planifikimin e konservimit të integruar për qytetin në tërësi, dhe për pronat individuale që i përkasin atij.

Çështja e përdorimit duhet të adresohet në **Masterplanin e Konservimit**. Ajo duhet bazuar mbi analizën sistematike të tipologjisë dhe kushteve të fondit të ndërtesave, si dhe mbi nevojat dhe kërkesat (p.sh. hyrjet fizike në godinë, shërbimet) e zonës. Do të ishte mirë nëse planifikuesit urbanë, menaxhuesit e pronave dhe arkitektët punojnë së bashku lidhur me ndërtesat që kanë një potencial për t'i shërbyer publikut apo komunitetit. Planifikuesi urban duhet të dijë nëse zonës së qendrës historike i mungon ndonjë lloj hapësire apo funksion i përbashkët – p.sh. një bibliotekë apo shkollë –, ashtu si dhe arkitekti duhet të ketë njohuri për qëndrueshmërinë e ndërtesave dhe zonat rrethuese kur diskutohet mbi funksionet e propozuara. Menaxherët e pronave mund ta gjejnë pronarin dhe t'i bëjnë të ditur detajet ligjore për shfrytëzim e pronës. **Me kombinimin e këtyre aftësive, dhe veçanërisht falë menaxherit të pronave, do të mundësohet zhvillimi i qendrës historike, duke kaluar nga braktisja drejt lulëzimit të saj.**

9.3.5 Nivelet e ndërhyrjes

Kur flitet për ambientin e ndërtuar, roli që luan konservimi krijohet nga vetë fondi ekzistues fizik i ndërtesave. Aty ky mbizotërojnë vlerat e përdorimit, mund të ketë pasur ndryshime të vazhdueshme për t'i përmbushur nevojat e ndryshme socio-ekonomike. Për më tepër, brenda çdo viti zhvillimet e reja ndërtimore janë shumë

më të vogla në përmasa dhe materiale në raport me materialin e përgjithshëm ekzistues urban.

Si pasojë, plani i konservimit duhet të marrë parasysh fondin ekzistues të ndërtesave gjatë ciklit të zhvillimit të këtij fondi, si dhe ndryshimet e planifikuara për të ardhmen. Konservimi përmes riaftësimit është një veçori kryesore e planifikimit të së ardhmes së zonës urbane. Konservimi duhet të ketë gjithnjë përparësi në krahasim me mundësitë e ndërtimit modern.

9.3.6 Mirëmbajtja

□ *Mirëmbajtja e rregullt është e domosdoshme për ruajtjen e materialit përbërës të ndërtesave.*

Ndërtesat e punuara me qerpiç kërkojnë përkujdesje vjetore ndaj çatave dhe mureve. Në Afrikë, llaçi gëlqeror duhet të zëvendësohet çdo 2-3 vjet. Metalet duhen mbrojtur nga ndryshku, ndërsa druri duhet mbrojtur nga insektet dhe rritja e kërpudhave. Në klima me nivel të lartë lagështie, lyerja e shpeshtë përbën një pjesë bazike të procesit të mirëmbajtjes. Në shumë vende konsiderohet si praktikë e mirë që ngjyra e fasadave të shtëpive dhe objekteve mbështetëse të ruhet në gjendje të mirë, duke i lyer rregullisht. Kjo praktikë krijon një ambient tradicional që shpreh qëndrimet vendore. Tradita të këtilla mund të mos ekzistojnë më në disa shtete si pasojë e ndërprerjes së traditave të mirëmbajtjes për shkak të ndryshimeve të shpejta socio-ekonomike. Në disa vende të tjera, si Italia, arkitektura mund të përmbajë materiale ndërtimi më të qëndrueshme të cilat kanë sjellë zhvillimin e qasjeve të ndryshme ndaj sipërfaqeve të suvatuara.

Çdo rilyerje duhet të bëhet duke respektuar skemën origjinale të ngjyrave dhe llojit të ngjyrave të përdorura, duke u bazuar në studimet historike të mbështetura nga hulumtime teknike. Në Nikko, Japoni, ekziston një tempull i cili lyhet me llak çdo 25 vjet, ndërsa në afërsi të tij ekziston një varrezë e shekullit të shtatë e cila ende ruan dekorimet origjinale të cilat thjesht janë zbehur pak. Të dy sitet i përshtaten kontekstit të tyre, pasi tradita ka përcaktuar disa praktika që bëjnë që ndërtesat të përputhen me funksionin e tyre. Në ditët e sotme është vështirë të gjenden pigmentet dhe bojërat tradicionale. Plumbi është ndaluar si substancë përbërëse e bojërave në shumicën e vendeve, dhe pigmentet moderne janë shumë më të stërholluara. Bojërat bashkëkohore të krijuara për të lyer mbi beton, apo sipërfaqe të ngjashme, janë shpesh të papërshtatshme për ndërtesat historike pasi nuk i lejojnë ato të marrin frymë. Këto lloj bojërash formojnë një pengesë avulli të pakalueshme, e cila mund të ketë efekte shkatërruese kur e mban lagështinë përbrenda. Jo

vetëm që këto bojëra nuk vjetrohen me hijeshi, por shpesh është edhe vështirë që sipërfaqja të rilyhet. Rekomandohet që menaxhuesit e një siti të Trashëgimisë Kulturore Botërore të hartojnë një politikë për lyerjen dhe ridekorimin. Mund të ekzistojë nevoja për t'iu rikthyer teknikave tradicionale, duke i përgatitur bojërat me receta tradicionale. Nëse do të konsiderohet e nevojshme, duhet të sigurohen lejet e posaçme për përdorimin e atyre materialeve që nuk gjenden më në tregun e zakonshëm, siç ka ndodhur në Mbretërinë e Bashkuar në rastet e ndërtesave të Kategorisë së Parë.

9.3.7 Riaftësimi

Në kontekstin e planifikimit urban, **rigjallërimi** nënkupton masat planifikuese të cilat janë të domosdoshme për përmirësimin e aktiviteteve sociale dhe ekonomike brenda një zone apo qyteti historik që ka humbur gjallërinë e funksionit të tij origjinal, ku ndërtesat dhe hapësirat urbane historike nuk janë më në përdorim dhe janë gjysmë të shkatërruara. Qëllimi i rigjallërimit duhet të jetë gjetja e ekuilibrit të nevojshëm ndërmjet konservimit dhe zhvillimit.

Rigjallërimi i një zone historike e cila është e varfër ekonomikisht mund të kërkojë riaftësimin e një numri të madh të shtëpive tradicionale, si dhe të ndërtesave të vjetruara e të lëna pas dore – si kishat, manastiret, depot dhe fabrikat.

Riaftësimi nënkupton përmirësimet fizike të cilat janë të domosdoshme për të siguruar shfrytëzimin e përshtatshëm të një strukture të zbrazët apo të shfrytëzuar keq. Riaftësimi gjithnjë duhet të përpiqet të risjellë në përdorim një funksion sa më të ngjashëm me funksionin origjinal, në mënyrë që të kryhet një ndërhyrje sa më e vogël dhe që të mos humbasin vlerat kulturore. Kjo e fundit justifikohet edhe nga ana ekonomike.

☐ *Sa më afër me funksionin origjinal që të jetë funksioni i ndërtesës së riaftësuar, aq më pak punë do të ketë dhe aq më mirë do të jetë për planin urbanistik në përgjithësi.*

Njollat sipërfaqësore dhe mungesa e mirëmbajtjes shpesh i bindin njerëzit se ndërtesat duhet të shemben. Megjithatë, nëse themelet, muret dhe dyshemetë janë në gjendje të mirë, shtëpia në përgjithësi mund të riparohet, edhe nëse kjo gjë nënkupton vendosjen e një çatie të re së bashku me instalimin e ujit të ngrohtë e të ftohtë, dhe të shërbimeve elektrike dhe mekanike.

☐ *Megjithëse rindërtimi i pjesshëm i një strukture të vetme në gjendje të shkatërruar në mënyrë të konsiderueshme (p.sh. nga tërmeti apo braktisja) mund të kryhet*

me përgjegjësi, duhet treguar kujdes në lidhje me cilësinë e trajtimeve të tilla dhe ndikimit që ato kanë mbi qytetin historik në tërësinë e tij.

Në të tilla raste, nëse është e mundur, çdo pjesë thelbësore e ndërtesës duhet mirëmbajtur *in situ* (si p.sh. një mur që ende qëndron i ngritur). Për më tepër, një ndërtim i ri duhet të kryhet me materiale dhe teknologji që përputhet me ndërtesën. Është vërejtur se një strukturë koherente është më e sigurt dhe më rezistuese (p.sh. ndaj lëvizjeve sizmike) se një sistem strukturor i përzier që përmban një kombinim të gurit dhe drurit tradicional me çelikun dhe betonin modern. Çdo propozim për konsolidim strukturor duhet të paraprihet nga një vlerësim tërësor i sistemit ekzistues strukturor, në mënyrë që ai të përdoret në potencialin e tij maksimal.

- ❑ *Nëse nevojiten shtesa, ato duhet të realizohen me materiale të cilat përputhen me materialet e strukturës ekzistuese. Nëse nuk ka në dispozicion materiale tradicionale, materialet e reja duhet të përdoren në një mënyrë që nuk pengon konservimin e strukturës origjinale.*

Përfshirja e strukturave bashkëkohore të ngurta në sisteme jo të paracaktuara në mënyrë të ngurtë mund të ketë efekte negative për shkak të peshës së tyre të shtuar dhe reagimit të tyre të ndryshëm ndaj aktivitetit sizmik. Një tjetër aspekt i cili duhet të merret parasysh është se përdorimi i tepërt i materialeve të reja mund të ndryshojë përbërjen tradicionale urbane deri në atë masë sa të komprometojë edhe autenticitetin.

Konservimi nuk duhet të kufizojë standardet e jetesës për banorët e një zone historike. Sidoqoftë, përmbushja e pritshmërive lidhur me stilin e jetesës moderne nënkupton edhe një sfidë në vetvete. Nëse banorët kanë automjete, duhet që për shembull atyre t'u sigurohet edhe parkingu pa ndërhyrë në përbërjen ekzistuese urbane. Krahas kësaj, duhet plotësuar edhe nevoja për të instaluar ujë, energjinë elektrike dhe gazin, ashtu si edhe nevoja për kanalizim dhe heqjen e ujërave të krijuara nga reshjet atmosferike. I duhet kushtuar vëmendje edhe intimitetit akustik; burimet e zhurmës – posaçërisht restorantet dhe klubet – duhet të jenë të kufizuara.

- ❑ *Shërbimet e reja nuk duhet të vendosen në një zonë historike pa u siguruar më parë që zona ka aftësi për t'i përballuar, përdorur, dhe mirëmbajtur ato. Standardet bashkëkohore të jetesës mund të mos përputhen me mënyrën e jetesës së banorëve apo infrastrukturën ekzistuese (p.sh. furnizimin me ujë, energjinë elektrike, heqjen e mbeturinave, etj.)*

Udhëzimet specifike për **riaftësimin** e një zone historike duhet të hartohen në

përputhje me kushtet vendore kulturore dhe fizike. Shembuj të këtyre udhëzimeve mund të gjenden në Standardet dhe Udhëzuesin e adoptuar nga Departamenti i Brendshëm i Shteteve të Bashkuara (Anon. 1983), apo në udhëzuesin e përgatitur për masterplanin e Lamu-s në Kenia (Siravo dhe Pulver, 1986). Udhëzues të tillë duhet të jenë në përputhje me rekomandimet ndërkombëtare, dhe në rastin e vendndodhjeve të Trashëgimisë Botërore, ata duhet të përputhen edhe me kërkesat e Konventës.

9.3.8 Projektimi i strukturave të reja

❑ *Objektivi parësor i planifikimit konservues, në veçanti kur bëhet fjalë për vendndodhjet e Trashëgimisë Botërore, është konservimi i materialit historik ekzistues. Ndërtimi i strukturave të reja nuk duhet të jetë një pretekst për të shkatërruar të vjetrat. Megjithatë, ndodh që strukturat e reja të jenë të nevojshme për të rivendosur vazhdimësinë arkitektonike dhe funksionale, dhe për të eliminuar rrezikun e rrënimit të mëtejshëm - p.sh. aty ku parcela të zbrazëta mund të rrezikojnë objektet përreth.*

Ndërtesat plotësuese për nga vetë përkufizimi janë ndërtime bashkëkohore dhe duhet të shprehin frymën e së tashmes. Në të njëjtën kohë, projektimi i tyre duhet të ketë parasysh edhe projektimin e kontekstit të tyre historik. Projektimi i ndërtesave plotësuese duhet të bazohet mbi një analizë të qartë dhe sistematike të morfologjisë së përbërjes ekzistuese urbane dhe funksioneve të saj. Në parim, ai duhet të synojë të integrojë hapësirat bosh në përmbajtjen urbane. Zgjidhjet e këtyre problemeve të projektimit varen nga vlerat specifike kulturore dhe traditat e zonës historike, nga tipi dhe gjendja e strukturave ekzistuese, nga shkalla e homogjenitetit të vendit, etj.

Në ato raste kur është e pamundur të hartohen udhëzues të përgjithshëm të cilët zbatohen në të gjitha rastet e strukturave plotësuese në të gjitha zonat historike, mund të krijohen udhëzues specifikë për site apo rajone kulturore të veçanta. Pikat e mëposhtme mund të jenë të dobishme për nënvizimin e disa aspekteve që duhet të merren parasysh. Ndërtimet e reja duhet të kenë:

- **një ritëm** në harmoni me ritmet urbane dhe modelet morfologjike të përmbajtjes së ambientit rrethues;
- **një masë të ekuilibruar** me kontekstin e tyre – jo shumë të madhe për të prishur përmasat njerëzore të qendrës historike, dhe jo të bazuar në kombinime artificiale të disa pjesëve për të mundësuar një funksion të gjerë;

- një vijë **rrugore kufizuese** në përputhje me vijën e ndërtesave ekzistuese;
- **një siluetë** që respekton karakterin dhe siluetën tradicionale vendore;
- **materiale** që janë tradicionale, apo të përputhshme me materialet tradicionale;
- **dritare** me karakter të ngjashëm dhe me një raport mur-dritare që është tipik për ndërtesat e të njëjtës zonë; si dhe të jenë me një
- **cilësi të lartë** të ndërtimit dhe projektimit, i cili mund të arrihet përmes raporteve të kujdesshme dhe – aty ku është e përshtatshme – përmes dekorimeve mbi relievin e rrafshët ose përmes trajtimeve me plastikë.

Faktorët që lidhen me pamjen e qytetit rrallë herë mund të justifikojnë riprodhimin e një ndërtese të humbur. Një zgjidhje e tillë zakonisht konsiderohet një *pastiço* (përzjerje) arkitektonike. Praktika e fasadizimit (d.m.th. e ruajtjes së fasadës dhe ndërtimit të një strukture të re pas saj) i hedh në erë parimet bazike të konservimit urban, pasi ajo rezulton në shkatërrimin e materialit ekzistues. Praktika të tilla zakonisht shoqërohen me vendosjen e funksioneve të reja dhe të përmasave të mëdha, që nuk përputhen me përmbajtjen historike. Ndërtimet e reja në qendrat historike duhet të kenë një gjallëri artistike dhe të jenë të projektuara në përputhje me standardet më të larta, duke bashkëjetuar në harmoni me përmasat dhe karakterin e sitit të Trashëgimisë Botërore në të cilën ndërtohen.

9.3.9 Veprimet administrative

Sistemi urban është një përmbledhje komplekse e disa burimeve të shumëllojshme të cilat janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën. Rrjedhimisht, ky sistem duhet të konsiderohet në tërësinë e tij. Niveli më i thjeshtë i këtij sistemi përbëhet nga shërbimet dhe hapësirat urbane: ujësjellësi, kanalizimet, energjia elektrike, trafiku dhe hapësirat për parking. Disa burime konsumohen dhe ripërtërihen (p.sh. bimësia), por ndërtesat historike nuk hyjnë në këtë kategori. Menaxhimi privat i burimeve jo të ripërtërishme, i cili ka për qëllim pasurimin e shpejtë mund t'i konsumojë shumë shpejt këto burime. Menaxhimi i suksesshëm i siteve të Trashëgimisë Botërore varet nga qëllime më të mëdha. Nuk është e nevojshme që përfitimet administrative të jenë përfitime monetare, pasi ato mund të jenë në formën e përfitimeve shoqërore, statusit, prestigjit ose politike.

Administratorët e qyteteve të Trashëgimisë Botërore duhet të ballafaqohen me realitetin aktual që ushtron një presion të konsiderueshëm në qendrat historike. Në

shumicën e shoqërive të sotme mënyra tradicionale e jetesës po ndryshon, dhe mes të tjerash kjo prodhon edhe ndryshime të shpejta dhe të thella të karakterit të qyteteve në pjesët ku është e përqendruar popullata dhe aty ku kultura bashkëkohore kërkon hapësira për t'u shprehur. Qytetet janë viktimat e privileguara të ndryshimit, dhe për këtë arsye menaxhimi i ndryshimeve bëhet edhe më i nevojshëm – kjo është dhe sfida që i pret administratorët e tyre.

Kur kontrolli i ndryshimeve duhet të ushtrohet brenda një politike konservimi të një qyteti të Trashëgimisë Botërore, këto probleme përfaqësojnë një nivel më të lartë të sfidave për ata që janë zgjedhur apo emëruar për t'i menaxhuar ato. Për të mos u mbytur nga ndërtesat e vjetra, dhe për të mos u gjuhëzuar para aspekteve më të errëta të së tashmes, këto qytete historike duhet të menaxhohen nga profesionistë vizionarë, të kualifikuar dhe të mirë-informuar. Një komision i përbërë nga profesionistë të fushave të ndryshme duhet të jetë përgjegjës për konservimin e materialit historik të qytetit, duke iu përmbajtur rregulloreve të vendosura dhe duke përdorur një metodë efikase të monitorimit të efekteve të punës së tij.

Si përfundim, menaxhimi i zonave urbane historike përfshin:

- **analizën e morfologjisë urbane**, me studime sistematike të tipologjisë, gjendjes, funksionit dhe përdorimit të ndërtesave, si dhe identifikimin e shkaqeve ekonomike të zhvillimit dhe rrënimit;
- **menaxhimin e pronave me inspektime të rregullta**, dhe një **strategji të mirëmbajtjes**, duke përfshirë kontrollin e ngjyrave dhe të dekoreve të jashtme (të fasadave);
- **skema modeste të riaftësisimit** dhe jo skema ambicioze; dhe
- **kontributin shoqëror dhe këshillimet me banorët.**

□ *Planifikimi konservues është një aktivitet që ka për qëllim të krijojë një urë lidhëse midis të tashmes dhe të ardhmes që do të preferonim. Planifikimi konservues është një element kritik në menaxhimin e burimeve kulturore.*

9.4 LISTA E KONTROLLIT PËR KONSERVIMIN URBAN

Komiteti i Sitit do të ballafaqohet me shumë pyetje specifike, si p.sh.:

- ✓ A janë përcaktuar mjaftueshëm **vlerat thelbësore që bart** qyteti i Trashëgimisë Botërore?
- ✓ A reklamohen **objektivat** e konservimit të Trashëgimisë Botërore përmes politikave ekzistuese?

- ✓ A zbatohen **parimet** e deklaruara në kongreset dhe kartat ndërkombëtare?
- ✓ A janë përditësuar **ligjet dhe rregulloret** në fuqi?
- ✓ A **zbatohen** ato në mënyrë efikase? Nëse jo, ku kanë dështuar?
- ✓ A kanë **banorët një** perceptim të kënaqshëm mbi vlerat e trashëgimisë së tyre?
- ✓ A është **infrastruktura e përshtatshme** dhe në gjendje të mirë?
- ✓ A tregojnë **pronarët e pronave** një rezistencë kundër politikave të konservimit?
- ✓ Si mund të shmanget plogështia dhe mospjesëmarrja e **palëve të interesuara**?
- ✓ Si mund të pajtohet **detyra për të mbrojtur kundrejt** joshjes financiare që ngjallin zhvillimet e reja ndërtimore ose shpërnguljet e shumta?
- ✓ A është e kënaqshme **marrëdhënia** mes pronarëve dhe ekspertëve?
- ✓ A funksionojnë në mënyrë të kënaqshme procedurat për **zbatimin e planeve** të konservimit?
- ✓ Cila është **kostoja e ndërhyrjeve** që kanë për qëllim mbrojtjen dhe riaftësimin?
- ✓ A janë shqyrtuar të gjitha mundësitë e **financimit**? A mund të ndihmojnë fondacionet dhe donatorët privatë? A mund të zbatohen politikat e fondeve të hapura pa kufizime vjetore? A janë të tejkalueshme vështirësitë financiare?
- ✓ A japin ndihmë financiare nivelet e larta të **qeverisë**?
- ✓ Në çfarë niveli përdoren **të ardhurat** që nxirren **nga turistët** për të kontribuar drejt konservimit?
- ✓ A ka **nxitje financiare dhe fiskale** për t'i inkurajuar pronarët t'i mirëmbajnë dhe riaftësojnë pronat e tyre?
- ✓ A është i përshtatshëm kontrolli mbi **ndihmën financiare dhe fiskale**?
- ✓ A është i domosdoshëm zbatimi i **kontrollit të qirasë** përmes një çmimi tavan për të shmangur shpërnguljen e qiraxhinjve?
- ✓ A është e mundur të sigurohen të ardhura **të arsyeshme nga investimet financiare** për të kryer riaftësimin nëse është ruajtur autenticiteti historik dhe vlerat arkeologjike?

- ✓ Si është ruajtur **autenticiteti historik** në propozimet për funksionit e reja të përshtatura?
- ✓ Si vlerësohen **ndikimet kulturore, ekonomike dhe fiskale** të programeve?
- ✓ A ekziston një **dokumentim i përshtatshëm** i lagjeve historike dhe ndërtesave individuale?
- ✓ A kryhen **inspektime të rregullta** të ndërtesave historike?
- ✓ A jepen **subvencione** për t'i inkurajuar pronarët që të kërkojnë inspektime dhe raportime të tilla?
- ✓ A ekziston një **strategji për mirëmbajtjen**?
- ✓ A ekzistojnë **mjeshtër artizanë dhe materiale** në dispozicion për të kryer mirëmbajtjen, riparimin dhe restaurimin e ndërtesave historike?
- ✓ A ka **ekspertizë** të mjaftueshme në dispozicion?
 - arkitektë
 - inxhinierë
 - arkeologë
 - historianë të artit
 - konservues
 - administratorë
- ✓ A mund të ndikohen **lëvizjet demografike** (p.sh. mbipopullimi apo largimi nga qendrat historike)?
- ✓ Cili është **ndikimi social i turizmit** tek banorët?
- ✓ A mundet të lehtësohet **përdorimi i tepërt i qendrave historike nga turistët**, dhe nëse po, nga kush?
- ✓ Cilat janë **vlerat shitesë** të qyteteve të Trashëgimisë Botërore dhe si mund të shfrytëzohen ato?

Kapitulli 10

VIZITORËT E VENDNDODHJEVE TË TRASHËGIMISË BOTËRORE

10.1 HYRJE

Tashmë, industria e turizmit është bërë pjesë e kulturës tonë dhe e ekonomisë ndërkombëtare, dhe në aspektin financiar ajo zë vendin e dytë pas industrisë së naftës. Turizmi është dinamik, por ai nuk duhet zhvilluar shumë shpejtë. Turizmi duhet zhvilluar pa tejkaluar kufizimet e kapacitetit të sitit dhe infrastrukturës mbështetëse. Ashtu siç theksohet edhe në Deklaratën e Manilës të Organizatës Botërore të Turizmit, përfitimi ekonomik nuk është qëllimi i vetëm i turizmit. Turizmi duhet të përmirësojë cilësinë e jetës së popullsisë vendore pa komprometuar kulturën autoktone.

□ *Vizita në një sit të Trashëgimisë Botërore mund të jetë një përvojë intelektuale, dhe ata vizitorë që janë të përgatitur do të përfitojnë më shumë nga kjo përvojë.*

Shumica e vizitorëve të siteve të Trashëgimisë Botërore kërkojnë diçka të re; ata kërkojnë të ndërrojnë atmosferë, apo të shijojnë një përvojë të cilën mund t'ia tregojnë më pas miqve të tyre. Disa janë të interesuar për trashëgiminë e tyre kulturore, të tjerët për arkeologji apo arkitekturë. Një pjesë e detyrës së menaxherit është që të sigurohet se vizita do të jetë e kënaqshme dhe interesante për të gjithë. Një kujdes i tillë do të ndihmonte në ndërtimin e mbështetjes politike për konservimin, grumbullimin e valutës së huaj, hapjen e vendeve të reja të punës dhe rritjen e të ardhurave. Shpresa është që disa njerëz do të largohen nga siti me një interes më të madh për kulturën e tyre, në krahasim me interesin e tyre para vizitës në vendndodhje.

Nëse nxënësit nuk kënaqen gjatë vizitës së tyre, ata mund të shmangin më tej të gjitha sitet e Trashëgimisë Botërore për një kohë të gjatë, dhe madje edhe mos t'ua prezantojnë ato fëmijëve të tyre. Nxënësit janë një grup i vështirë për t'iu ngjallur interesin ndaj siteve të trashëgimisë, por nuk është në interesin afatgjatë të konservimit që nxënësit të vijnë dhe të kthehen të dëshpëruar – më mirë do të ishte të mos vijnë fare.

Vizitat bëhen të këndshme dhe interesante nëse mendohet për interesin dhe qëndrimet e vizitorëve para se të mendohet për burimet, dhe kjo mund të jetë e

vështirë për menaxherët e siteve, shumica e të cilëve i vendosin vizitorët në fund të listës. Ekspertët e turizmit, e menaxhimit të vizitorëve, e prezantimeve dhe e marketingut mund të jenë një ndihmë e madhe. Anketimet e vizitorëve ndihmojnë në identifikimin e interesave të tyre, duke marrë të dhëna edhe mbi prejardhjen e tyre, sa gjatë qëndrojnë, rikthimin e tyre për vizita të tjera dhe si dhe sa para mund të kenë shpenzuar.

Plani i menaxhimit për sitin e trashëgimisë duhet të shprehë objektivat e shërbimit ndaj vizitorëve. Në mënyrë që të evitohen konfliktet, objektivat duhet të diskutohen me Komisionin e Sitit, autoritetet vendore dhe organizatat e turizmit. Ky plan do të duhet të adresojë çështje të tilla si të ardhurat nga biletat e hyrjes, përfitimet e bizneseve vendore të turizmit, dëmet e mundshme ndaj burimit të trashëgimisë, trajtimin e vizitorëve të zhgënjyer, mbipopullimin, reduktimin e vizitorëve në oraret e fluksit më të lartë, si dhe kombinimin e vizitorëve të ndryshëm. Do të ishte me dobi nëse bëhen disa dallime mes njerëzve të cilët janë në një vizitë të organizuar, atyre që janë me pushime, vizitorëve ditorë, grupeve shkollore, delegatëve të konferencave dhe ekspertëve. Plani i menaxhimit mund të kishte objektiva të ndryshme për secilin prej grupeve të lartpërmendura.

10.1.1 Nevojat e vizitorëve

Të gjithë vizitorët e vlerësojnë:

- pritjen e ngrohtë dhe ndihmën kur ka probleme ose aksidente;
- ambientin e pastër, pa plehra dhe të mirëmbajtur;
- shpjegimin mbi ato gjëra që konsiderohen tabu për vendasit dhe qëndrimet fetare ose kulturore (p.sh. ndaj derrave në vendet islamike, ndaj lopëve në vendet të besimit Hindu, si dhe veshjen dhe sjelljen e përshtatshme në vendet fetare, etj);
- prezantimin në një mënyrë të kuptueshme të historisë së monumentit apo vendndodhjes dhe thesareve të saj; dhe
- sigurinë dhe mbrojtjen për ta dhe sendet e tyre personale.

Sipas marrëveshjeve ndërkombëtare, vizitorët të cilët kalojnë një natë larg shtëpisë së tyre quhen turistë. Këta persona kanë nevojë për hotele, bujtina, hapësira kampingu, restorante si dhe lloje të ndryshme transporti. Turistët, gjithashtu do të kërkojnë dyqane për të plotësuar nevojat e tyre specifike. Sigurimi i të gjitha këtyre elementeve është i rëndësishëm për një sit të trashëgimisë kulturore, pasi

pa to, shumë persona nuk do të mund të prezantoheshin dot me kulturën vendase. Shërbime të tilla nuk hyjnë në detyrat e zakonshme të menaxherëve të sitit, por për këto shërbime nevojitet bashkëpunimi mes autoriteteve publike dhe sektorit privat.

- *Menaxhimi i mirë i vizitorëve do të reduktojë nevojën për shpenzime për promovimin dhe reklamimin e sitit së trashëgimisë, Përmes një menaxhimi të mirë vetë vendndodhja do të bëhet tërheqëse dhe e njohur për median, e cila edhe do ta reklamojë atë në të njëjtën kohë. Në shumë raste lind një konflikt politikash mes menaxherëve të sitit që kërkojnë një numër të kufizuar vizitorësh në mënyrë që siti të mos dëmtohet, dhe bordeve të turizmit apo interesave tregtare të cilat duan ta përdorin vendndodhjen për të tërhequr vizitorët.*

10.1.2 Vandalizmi dhe dëmtimet

Vandalizmi shpesh lind nga mërziçja dhe për rrjedhojë, një prezantim i mirë i sitit i ul mundësitë për veprime të tilla. Shumë probleme të tjera të sigurisë mund të zgjidhen nëpërmjet një menaxhimi të mirë, të shoqëruar herë pas here edhe me patrullime policore. Fatkeqësisht, turizmi mund t'i vjetrojë objektet shumë shpejt. Edhe pse nuk ka studime që dokumentojnë mirë dëmet e shkaktuara nga vizitorët, dëshmitë rrethore tregojnë se dëme të tilla e rrisin koston e konservimit. Në vende të shenjta vizitorët duhet të udhëzohen që të mbajnë qetësi dhe të mos përdorin aparate fotografike me blic. Pirja e duhanit dhe hedhja e mbeturinave duhet të jetë e kontrolluar. Vizitorët duhet t'i mbahen shtigjeve të përcaktuara, dhe duhet të jetë e ndaluar që ata të këpusin lule të egra dhe të shkarravisin mbishkrime.

10.1.3 Mirëpritja e vizitorëve

- *Qëndrimi i stafit ndaj vizitorëve është faktori më i rëndësishëm në sigurimin e një vizite të këndshme. Secili vizitor duhet të ndihet i mirëpritur në një mënyrë sa më individuale që të jetë e mundur, si dhe duhet të ekzistojë një pikë e dallueshme dhe e shënuar qartë për dhënien e ndihmës në rast aksidenti apo të ndonjë vështirësie. Çdo rrezik i veçantë duhet të jetë i shpjeguar qartë, duke përfshirë këtu kafshët dhe bimët e rrezikshme, vjedhjet, etj.*

Asgjë nuk e prish përvojën e vizitorit më shumë sesa vjedhjet, dhe veçanërisht nëse vidhen pasaporta, aparate fotografike apo regjistrime filmike. Punonjësit që ruajnë dhe pastrojnë sitin duhet të sigurohen që të shmangin vjedhjet ose dëmet, pa harruar se vizitorët duhet të trajtohen si mysafirë të mirëpritur dhe të ndihmohen.

Është e rëndësishme që stafi të jetë i sjellshëm gjatë tërë kohës, sado i bezdisshëm që mund të jetë vizitori.

Tabelat dhe hartat që tregojnë planin e sitit në shkallë të lartë duhet të jenë të vendosura brenda hapësira të parkimit, si dhe në çdo vend tjetër ku të huajt mund të humbasin rrugën. Tabelat duhet të vendosen aty ku nuk u shkaktojnë dëme strukturave të vjetra, pa e prishur panoramën. Monitorimi i kujdesshëm i sjelljes së vizitorëve mund të ndihmojë në vendosjen strategjike të tabelave dhe shenjave orientuese.

Qëllimi i tabelave dhe shenjave orientuese është që të ndihmojnë vizitorin, e jo domosdoshmërisht të tërheqin vëmendjen te thesaret më të rëndësishme. Ciceronët duhet të mbajnë shirita në krahu, apo uniforma, në mënyrë që të identifikohen lehtë dhe t'u kërkohet ndihmë. Shitësit e suvenireve, lypësit dhe ciceronët jozyrtarë nuk duhet të lejohen të hyjnë në sitin e trashëgimisë, ku mund të shpërqendrojnë apo ngacmojnë vizitorët. Gjithashtu, edhe taksitë dhe karrocet duhet të jenë të kontrolluara.

10.2 MIRËMBAJTJA E SITIT

Mënyra më e mirë për të shmangur hedhjen e mbeturinave në vende të papërshtatshme është mbledhja e menjëhershme e tyre pasi ato të jenë hedhur. Koshat e mbeturinave duhet të zbrazen rregullisht. Në disa shtete hidhen më pak mbeturina nëse nuk ka kosha për mbeturina. Në disa shtete të tjera, janë penalizimet për hedhjen e mbeturinave ato që e frenojnë këtë veprim. Në rastet kur një pjesë e sitit të trashëgimisë përdoret për zbavitje apo aktivitete të veçanta, pas përfundimit të aktivitetit është mirë nëse kërkohet nga organizatorët që të heqin të gjitha mbeturinat, pajisjet e veçanta, tezgat, etj.

Përdorimi i sitit për regjistrimin e filmave mund të jetë një aktivitet fitimprurës, dhe mund t'i bëjë sitin një reklamë të mirë. Sidoqoftë, regjisorëve dhe ekipeve televizive duhet t'u jepen udhëzime të qarta për të shmangur dëmtimet e paqëllimshme ndaj burimit të trashëgimisë. Nxehtësia që lëshojnë pajisjet e tyre të ndriçimit mund të dëmtojë materialin kulturor dhe kjo përbën një rrezik të mundshëm për shkaktimin e zjarreve.

Vendet e parkimit duhet të mbahen të pastra dhe gropat me baltë duhet të mbushen. Duhet të vendosen shenja paralajmëruese ndaj vjedhjes. Vendet e mëdha të parkimit që ndodhen afër siteve të trashëgimisë duhet të ndahen në sektorë më të vegjël nëpërmjet kodërvarreve, bimësisë dhe rregullimit të gjelbërimit, ose të shmangen plotësisht. Në rastet kur përdoren vendet e parkimit të vendosura në

distancë, duhet të sigurohet transporti deri në vendndodhje për personat e moshuar dhe ata me aftësi të kufizuara.

10.3 PREZANTIMI DHE INTERPRETIMI

Të gjitha sitet e Trashëgimisë Botërore kanë më shumë se një tregim të rëndësishëm mbi historinë e tyre: mënyra se si ato janë ndërtuar apo shkatërruar, njerëzit që kanë jetuar aty, aktivitetet dhe ngjarjet e ndryshme, përdorimin e mëparshëm të sitit e ndoshta edhe rrëfenja mbi thesare të njohura. Gjatë prezantimit dhe interpretimit të rrëfimit historik të sitit të trashëgimisë, është e rëndësishme që të kryhet një përzgjedhje e elementeve më interesante për kategoritë e njerëzve të cilët do të tërheq siti: historitë që kanë të bëjnë me vetë jetën e njerëzve janë shpesh dhe ato më të famshmet.

□ *Qëllimet e interpretimit të sitit të trashëgimisë duhet të jenë të përcaktuara mirë para se të fillojë puna, dhe duhet të rishikohen rregullisht bazuar mbi përvojën dhe ndryshimet në mënyrën e të menduarit.*

Materialet dhe teknologjia që përdoret për të interpretuar historinë e sitit gjatë vizitave duhet të zgjidhen për të qenë sa më efikase që të jetë e mundur për të gjithë vizitorët, pa e dëmtuar pamjen apo ambientin e sitit të trashëgimisë. Për shembull, pajisjet e zërit dhe ndriçimit (*Son et lumière*) mund të dëmtojnë muret e vjetra apo të pengojnë ambientin e përgjithshëm gjatë orëve të ndryshme të ditës. Shenjat që shpjegojnë gjërat mund të prishin panoramën apo edhe të shkaktojnë dëme gjatë vendosjes së tyre. Mjetet e komunikimit të përdorura për interpretim mund të përfshijnë:

- Lajmërimi të shkruara qartë, panele shpjeguese, planimetri, fletushka, udhërrëfyes, libra për suvenire dhe libra shpjeguese në gjuhë të ndryshme sipas nevojës,
- ciceronë apo mësues,
- muze, ekspozita, makete, shembuj të materialeve të ndërtimit, kopje të veprave të artit, fotografi ose monedha;
- diorama, vende për dëgjim përmes kufjeve, aparate të lëvizshëm për dëgjim, dhe
- filma, televizorë, video, prezantime me video-projektor, shfaqje, muzikë, shfaqje përmes zërit dhe dritës, dhe ndriçime për të theksuar tipare të veçanta.

Në përzgjedhjen e mënyrës së komunikimit mund të bëhen shumë lehtë edhe gabime, duke harxhuar me shumë para se ç'është e nevojshme, duke komprometuar pamjen e sitit, duke shqetësuar vizitorët përmes tureve me ciceronë dhe nganjëherë fletushkat dhe tabelat shpjeguese mund të jenë të shkruara me gabime. Mënyra më e mirë për të filluar komunikimin është duke përcaktuar mesazhin që dëshirohet të përcillet si dhe duke përcaktuar publikun që do t'i përcillet ky mesazh. Secili sit është unik, dhe diçka që ka funksionuar në një sit të trashëgimisë jo domosdoshmërisht rezulton efektive edhe në vendndodhje të tjera. Për të gjitha sitet e trashëgimisë me rëndësi botërore duhet të caktohet një buxhet i konsiderueshëm për interpretimin e tyre, duke përdorur ekspertët e përshtatshëm për t'u këshilluar.

Shpesh ia vlen që të përgatitet dhe të shitet një libër udhërrëfyes i thjeshtë, i cili mund të kuptohet lehtësisht nga persona që kanë pak, apo aspak, njohuri mbi sitin. Ndërkohë që për ata studentë që vijnë të përgatitur për të mësuar më shumë mbi sitin duhet të ekzistojnë udhërrëfyes të detajuar të cilët janë kontrolluar për saktësinë e tyre nga ekspertët përkatës, dhe të cilët nuk ndërtojnë interpretime spekulative, por përfshijnë referenca për të marrë më shumë informacion.

Shpesh herë, në një sit të trashëgimisë jepet edhe informacion i përgjithshëm për turistët. Ky shërbim në përgjithësi është i dobishëm dhe mund të rezultojë edhe fitimprurës, duke fituar që nga shitja e udhëzuesve dhe e hartave për turistët, e deri tek dhënia e këshillave, rezervimi i hoteleve dhe i biletave për teatër, shitja e fletushkave për vende të tjera tërheqëse, dhe sigurimin e informacionit mbi transportin. Nëse një shërbim i tillë është shumë i gjerë në informacion, ai duhet ndarë nga shërbimi që jepet lidhur me vlerat dhe shpjegimin e sitit për të evituar radhët e gjata. Një burim i rëndësishëm të ardhurash mund të jenë edhe librat me ilustrime që shiten si suvenirë për t'i kujtuar njerëzit për vizitën e tyre, si dhe kartolinat me fotografi dhe librat mbi tema të ndryshme lidhur me vendndodhjen.

Panelet shpjeguese duhet të punohen bukur dhe me kujdes duke përdorur një material të qëndrueshëm për ndërtimin e tyre, dhe duke përzgjedhur një stil shkrimi tërheqës si dhe ngjyra tërheqëse. Stili i shkrimit dhe i grafikës së paneleve duhet të jetë i njësuar për të gjitha panelet që vendosen në sit, dhe ky stil duhet të dallohet qartë nga ai i përdorur për sinjalistikën rrugore dhe dhënien e drejtimeve, si dhe nga tabelat që tërheqin vëmendjen mbi rreziqe të mundshme. Evitoni përdorimin e terminologjisë teknike, dhe aty ku është e nevojshme vendoseni këtë terminologji gjithnjë brenda kllapave. Prezantimi i këtyre tabelave shpeshherë përbën edhe njërin prej elementeve më të rëndësishëm të interpretimit të sitit, prandaj dhe paraqitja e mirë e tyre duhet të konsiderohet me shumë përparësi. Këshillohet që një person i vetëm, i vetëdijshëm mbi çështjet e prezantimit pamor të ngarkohet

me përgjegjësinë për të krijuar tabelat dhe për të vendosur mbi pozicionimin e tyre si dhe gjithashtu për të kontrolluar sasinë e tabelave në vendndodhje.

Prezantimet audio-vizuale duhet të jenë të cilësisë më të lartë, dhe zakonisht ato nuk duhet të zgjasin më shumë se 10-15 minuta. Prezantimet me drita dhe tinguj mund të zgjasin më shumë, por duhet të siguroheni që skenari i tyre të jetë dramatik, t'i përmbahet fakteve historike dhe të jetë pa paragjykime apo diskriminime.

Ngjarje të ndryshme që kanë ndodhur në të kaluarën e sitit mund të shpjegohen përmes riprodhimeve të pjesshme ose të plota. Këto riprodhime kanë avantazhin që mund të zëvendësohen pasi të jenë vjetruar. Për këto riprodhime, brenda mundësive, duhen përdorur të njëjtat materiale tradicionale që janë përdorur edhe për objektet origjinale, pasi materialet moderne si plastika nuk do të vjetroheshin në të njëjtën mënyrë.

Për shkak se gjuhët më të përdorura (si anglishtja dhe frëngjishtja) shqiptohen në mënyra të ndryshme në vende të ndryshme të botës, nuk mund të pretendohet se ato do të kuptohen nga vizitorët, qoftë edhe nga ata persona që i përdorin ato si gjuhë mëmë. Ky faktor mund të ndikojë në përdorimin e pikave të dëgjimit dhe ciceronëve deri në atë masë sa që ndonjëherë është më mirë të përdoret vetëm materiali i shkruar. Ekranet ndërvepruese që mund të ndryshojnë faqen e informacionit me shtypjen e butonave, si dhe të japin përgjigje me shkrim, apo përmes skicave, mund të jenë një alternativë e mirë ndaj pikave të dëgjimit.

Ciceronët duhet të jenë të përgatitur mirë dhe me njohuri të mjaftueshme. Ata duhet të jenë të licensuar nga shteti ose të punësuar nga grupi menaxhues i sitit të trashëgimisë. Grupet shkollore duhet të grumbullohen dhe të informohen në një vend të posaçëm të paracaktuar për këtë qëllim, dhe mundësisht brenda një objekti. Punonjësit në detyrën e instruktorit mund t'u vijnë në ndihmë mësuesve të nxënësve gjatë shpjegimit të vendndodhjes së trashëgimisë, dhe madje do të ishte në të mirë të vizitës nëse mësuesi ftohet në vendndodhje para se të kryhet vizita e planifikuar. Në këtë kontekst, do të ishte e dobishme nëse do të ekzistonte material edukativ edhe për mësuesit.

Gërmimet arkeologjike mund të shpjegohen me anë të paneleve, ose nëpërmjet një ciceroni, apo edhe në të dyja mënyrat. Mund të lindë nevoja që të ndërtohen platforma të posaçme nga ku vizitorët mund të vëzhgojnë objektet pa i penguar ata që kryejnë gërmimet. Informacioni duhet të përditësohet rregullisht, dhe zbulime të veçanta mund të shpallen në media vetëm atëherë kur nuk shtojnë problemet e menaxhimit të vizitorëve.

Fëmijët do ta kuptojnë më mirë historinë e sitit të trashëgimisë nëse u jepet mundësia të flasin me aktorë që luajnë role historike, nëse shohin apo edhe marrin pjesë në inskenime të ngjarjeve të rëndësishme, nëse dëgjojnë balada të kënduara, apo edhe nëse shohin prezantime me tinguj, me drita dhe me aktorë. Aktorët duhet të jenë të pranishëm në momentet e duhura dhe në shfaqjet që reklamohen shumë. Prezantimet duhet t'i shkojnë për shtat audiencës specifike me informacione të sakta, por mund të lejohet edhe pak liri artistike.

10.4 MENAXHIMI I VIZITORËVE

Kur numri i vizitorëve është i madh, mund të përdoren teknikat e menaxhimit të vizitorëve për të evituar uljen e nivelit të kënaqësisë që siti jep për publikun. Nëpërmjet këtyre teknikave mund të evitohen edhe dëmet fizike të shkaktuara ndaj burimit historik, si dhe të reduktohen kostot e mirëmbajtjes dhe të rriten të ardhurat.

Trysnia e ushtruar për shkak të vizitorëve të shumtë mund të ulët nëse në afërsi të sitit ekzistojnë edhe vende të tjera tërheqëse për publikun. Këto të fundit mund të përfshijnë një kopsht zoologjik, një akvarium, një park për t'u argëtuar, një plazh apo edhe shfaqje të ndryshme zbavitëse. Meqenëse sitet më të ndjeshme të trashëgimisë janë ato të cilat janë shumë të njohura dhe të reklamuar, dhe që nuk kanë asnjë vend tjetër tërheqës afër tyre, atëherë bordet që drejojnë menaxhimin e turizmit duhet të evitojnë reklamimin e tepërt të këtyre siteve. Këto borde gjithashtu mund të ndihmojnë në zhvillimin e vendeve të tjera tërheqëse afër sitit, apo qoftë edhe ta drejojnë vëmendjen e turistëve në site të tjerat më pak të njohura që kanë kapacitetet e mjaftueshme për të pritur vizitorë.

- ❑ *Oraret e fluksit të turistëve mund të reduktohen përmes një sistemi rezervimesh për grupe të organizuara, si dhe duke kufizuar numrin e vizitorëve brenda një orari të caktuar.*
- ❑ *Gjithashtu, edhe ndryshime të vogla që kryhen në kohën kur mbërrijnë vizitorët mund ta ulin presionin deri në nivelin e duhur.*
- ❑ *Do të ishte e dobishme që të ekzistojnë itinerare alternative për grupe të ndryshme vizitorësh, në mënyrë që nëse disa grupe mbërrijnë në të njëjtën kohë, atëherë ata mund të ndahen dhe të ndjekin itinerare me gjatësi të ndryshme.*

Dëmtimet në dysheme mund të reduktohen duke përdorur disa rripa qilimash, duke lyer me bojë, duke vendosur disa rripa gome, etj. Bari mund të mirëmbahet më lehtë nëse shtigjet e këmbësorëve lëvizin rregullisht me nga një metër largësi në mënyrë periodike. Nuk është e lehtë të riparohet dëmi i shkaktuar nga prekja

e mijëra duarve, apo nga fryma e njeriut, prandaj dhe në disa raste njerëzit duhen mbajtur në një distancë të kontrolluar nga objekti.

Vizitorëve duhet t'u lejojehet ta vizitojnë një sit të trashëgimisë sipas ritmit të tyre. Në rastet kur për shkak të sigurisë nuk është e mundur që të kryhen vizita individuale, atëherë qarkullimi i grupeve me ciceron mund të jetë në orare të ndryshme, dhe vizitorëve mund t'u jepet mundësia të zgjedhin mes vizitave më të shpejta dhe atyre më të ngadalta dhe më të hollësishme. Si pasojë e faktit që turmat e njerëzve brenda ndërtesave mund ta rrisin lagështinë relative deri aty sa mund të shkaktohen dëmtime, numri maksimal i vizitorëve brenda një periudhe kohore duhet të kontrollohet me rreptësi.

- ❑ *Shtigjet e vizitorëve duhet t'u përshtaten prirjes natyrore të njeriut për t'u kthyer majtas kur hyn brenda një hapësire.*
- ❑ *Dyqanet duhet të jenë të vendosura në mënyrë të përshtatshme në afërsi të hyrjes apo dalje nga vendndodhja.*

Pagesa për hyrjen duhet të caktohet aq sa të ardhurat të mundësojnë përmirësimin e shërbimeve për vizitorët pa ulur fondet që përdoren për konservim, të cilat duhet të jenë në një buxhet të ndarë. Pagesa për hyrjen mund të ndryshojë nga dita në ditë në mënyrë që të inkurajojë një shpërndarje të atyre orareve që kanë fluksin më të madh të vizitorëve, dhe kjo metodë është mënyra më e mirë për të përcaktuar se sa interesante dhe e këndshme është një sit. Nëse njerëzit paguajnë për të vizituar një sit ata presin të shohin diçka në shkëmbim të parave që kanë shpenzuar, dhe në të kundërt ata do jenë gati të kritikojnë. Për të zhvilluar më tej një sit dhe për të rritur kënaqësinë që ai u jep vizitorëve mund të përdoren edhe të ardhurat shtesë që fitohen nga shitja ushqimit, librave të ndryshëm, fotografive, vizatimeve, udhërrëfyesve, suvenireve, etj. Në momentin kur vendoset për herë të parë një çmim për biletën e hyrjes mund të ketë edhe ankesa. Në këto raste, është e këshillueshme që banorëve vendas t'u jepet mundësia për të hyrë falas, apo qoftë të caktohet edhe një ditë (e qetë) gjatë javës, apo pas një orari të caktuar, kur ata mund të hyjnë falas. Pagesa për biletën e hyrjes gjithashtu mund të lihet mbi baza vullnetare, duke u siguruar që ata të cilët nuk paguajnë kalojnë nga e njëjta hyrje dhe e njëjta derë e kontrolluar nga stafi.

Sa herë që të jetë e mundur duhet që një pagesë e vetme të mundësojë hyrjen në të gjithë sitin e trashëgimisë, pasi një praktikë e tillë siguron sasinë më të madhe të të ardhurave dhe ul koston për punonjësit e administratës. Nëse ka ndërtesa të ndryshme të cilat mund të vizitohen, atëherë në secilën hyrje mund të vendoset nga një biletë e vetme. Nëse numri i vendeve tërheqëse është i madh, atëherë

mund të ofrohen zgjidhje të ndryshme për ta mbajtur çmimin e biletës në nivele të arsyeshme, dhe në këto raste mundësitë e tjera duhet të jenë të prezantuara qartë. Në përgjithësi, menaxhimi i vizitorëve duhet të ketë parasysh hapësirat dhe rregullimet fizike si dhe përpjekjen për të bindur vizitorët nëpërmjet një rregulloreje, tabelave drejtuese si dhe vendosjes së punonjësve të sigurisë në një mënyrë sa më të përshtatshme.

Menaxhimi i vizitorëve në sitet e Trashëgimisë Botërore ka nevojë edhe për adoptimin e një strategjie të reklamimit të sitit. Vëmendja mund të drejtohet tek ato vende të veçanta të cilat nuk janë shumë të vizituara, duke treguar oraret më të përshtatshme për vizita gjatë ditës për ato pjesë të sitit që janë më të njohura. Reklamata që i drejtohen publikut, si dhe operatorëve turistikë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, mund të kufizohen brenda stinëve të caktuara, apo duke përdorur kategori të caktuara të medias për të ndikuar në llojin e njerëzve që nxiten për të vizituar sitin. Pagesa me çmim më të ulët mund t'i ofrohen grupeve në *bona fide* të cilat janë të interesuara në aspekte të ndryshme të trashëgimisë kulturore. Në të njëjtën kohë mund të sigurohen privilegje të veçanta për grupet që vijnë me qëllime të mirëfillta edukative.

Radhët e gjata që krijohen para hyrjes nuk janë asnjëherë të dëshirueshme pasi ato ulin nivelin e kënaqësisë së vizitorëve si dhe bllokojnë sitin dhe vendet e parkingut. Për rrjedhojë, duhet të vendoset dhe respektohet një kufi për numrin maksimal të vizitorëve. Për më tepër, nëpërmjet përdorimit të teknikave të menaxhimit mund të ulet edhe ndjesia negative që shkaktohet si pasojë e një grumbullimi të madh njerëzish.

10.4.1 Reklamimi

Meqenëse sitet e Trashëgimisë Botërore përfaqësojnë edhe prona të rëndësishme ekonomike dhe kulturore, është e pamundur që të shmanget reklamimi dhe publikimi i vlerave të tyre nga ana e njerëzve që e bëjnë këtë gjë si një detyrë të përditshme apo që e kanë në interes të tyre. Edhe në rastet kur punonjësit e menaxhimi të sitit nuk kanë ekspertizën e nevojshme për të realizuar një punë efikase me kosto sa më të ulët, ata sidoqoftë duhet të ndikojë në mënyrën se si bëhet reklamimi për të pasur sa më shumë përfitime që të jetë e mundur për sitin, dhe sa më pak aspekte negative në lidhje me konservimin e tij.

Për sa i përket reklamimit, siti i trashëgimisë është një produkt brenda tregut botëror. Ajo duhet të përshkruhet në mënyrë korrekte, por sa më të larmishme për të tërhequr vizitorët, dhe gjithnjë duke e bërë plotësisht të qartë llojin dhe kapacitetin e hapësirave në dispozicion të vizitorëve.

Krijimi i të gjitha materialeve reklamuese duhet të jetë i standardit sa më të lartë për të rritur prestigjin e sitit dhe punonjësve që e menaxhojnë atë. Sidoqoftë, para se të kryhen shpenzime për çdo lloj reklamimi, duhet të përcaktohet me kujdes auditori tek i cili do të përcillet mesazhi, si dhe të identifikohen interesat e këtij auditori.

10.4.2 Kodi i praktikave të veprimtarive

Vendosja e ekuilibrit mes zhvillimit të turizmit dhe konservimit të Trashëgimisë Kulturore Botërore është diçka thelbësore, si kundër edhe koordinimi i përpjekjeve në këto dy drejtime për të pasur përfitime të dyanshme. Drejtori i Përgjithshëm i “Trustit Kombëtar të Anglisë”, Z. A. Stirling, në fjalimin e tij në konferencën e ICOMOS-it në Canterbury, Mbretëri e Bashkuar, në vitin 1990, propozoi këtë Kod të Praktikave për burimet që ishin nën kujdestarinë e tij:

1. Planet gjithëpërfshirëse të zhvillimit turistik janë thelbësore, pasi ato paracaktjnë kushtëzimet e çdo lloj zhvillimi të potencialit turistik.
2. Çdo plan zhvillimi duhet të ketë si parimi bazë rritjen e përfitimeve, qoftë për konservimin, në kuptimin më të gjerë të këtij termi, qoftë për turizmin. Ky parim duhet të jetë pjesë e qëllimit të themelimit të të gjitha agjencive kombëtare të turizmit dhe si dhe e drejtorive të turizmit brenda autoriteteve vendore.
3. Një përqindje e madhe e të ardhurave që nxirren nga turizmi duhet të investohet në të mirë të konservimit në nivel kombëtar dhe rajonal.
4. Elementi parësor në përzgjedhjen e mundësive të zhvillimit turistik duhet të jetë interesi afatgjatë në të mirë të njerëzve që jetojnë dhe punojnë në çdo komunitet që mirëpret vizitorët.
5. Programet e edukimit duhet të ndihmojnë dhe të ftojnë turistët të respektojnë dhe kuptojnë mënyrën e jetesës së komunitetit vendor, kulturën, historinë dhe besimin e tij fetar. Politikat e turizmit duhet t’i marrin parasysh këta faktorë.
6. Projektimi i ndërtesave, vendeve dhe sistemeve të reja të transportit duhet të minimizojnë efektet potencialisht të dëmshme të turizmit. Kufizimi i ndotjes duhet të jetë i inkuadruar brenda çdo infrastrukture. Kur bëhet fjalë për site me bukuri të rralla natyrore,

ndërhyrja me struktura të krijuara nga njeriu duhet të shmanget sa më shumë që të jetë e mundur.

7. Menaxhimi i mirë duhet të përcaktojë nivelin e pranueshëm të zhvillimit turistik si dhe të caktojë kufij për t'i ruajtur këto nivele.

Këto parime janë njëlloj të zbatueshme për sitet e Trashëgimisë Botërore dhe vlejnë për t'u marrë parasysh gjatë zhvillimi të çdo lloj plani të menaxhimit.

REFERENCAT

- ANON, 1983. *The Secretary of the Interior's Standards for rehabilitation and Guidelines for Rehabilitating Historic Buildings*. Revised 1983. US Dept. Interior, National Parks Service, Washington D.C. [US Govt Printing Office ref: 1983:0-416-688]
- ASHURST, J. & ASHURST, N. 1988. *Practical Building Conservation*. Vol 1: Stone Masonry [ISBN 0 291 39745 X]; Vol. 2: Brick Terracotta and Earth [ISBN 0 291 39745 8]; Vol. 3: Mortars, Plasters and Renders [ISBN 0 291 39747 6]; Vol. 4: Metals [ISBN 0 291 39748 4]; Vol. 5: Wood, Glass and Resins, and Technical Bibliography [ISBN 0 291 39776 X]. English Heritage Technical Handbooks series. Aldershot, UK: Gower Technical Press.
- BECKMANN, POUL. 1995 *Structural Aspects of Building Conservation*. International Series in Structural Engineering. London: McGraw-Hill.
- BIANCA, S., DAVID, J-C, QUDSI, A., BETON, Y., & CHAUFFERT-YVART, B. 1980. *The Conservation of the Old City of Aleppo*. Report prepared by UNESCO for the Government of the Syrian Arabic Republic. UNESCO report ref. PP/1979-80/4/7.6/05 FMR/CC/CH/80/139 (Bianca, etc.)
- BRANDI, C. 1963. *Teoria del restauro*. Romë: Ediz. Stoeia Letteratura.
- CERVELLATI, P.L., SCANNAVINI, R., & DE ANGELIS, C. 1977. *La nuova cultura delle citta*. Milan: Mondadori.
- CESARI, C. 1982. *Considerations on the Problems of Integrated Conservation*. Shënime të ligjëratave, Kursi i ICCROM-it për Konservimin Arkitektonik.
- CLEERE, H. (ed.) 1989. *Archaeological Heritage Management in the Modern World*. [One World Archaeology Series, vol. 9], London: Unwin Hyman.
- _____. 1996. Protecting the world's cultural heritage. In: Marks, S. (ed) *Concerning Buildings. Studies in Honour of Sir Bernard Feilden*, 82-95. London: Bittersworth.
- COUNCIL OF EUROPE. 1975. "Declaration of Amsterdam". The European Charter of the Architectural Heritage, adopted by the Committee of ministers of the Council of Europe, , 26 September 1975, and solemnly proclaimed at the Congress on the European Architectural Heritage, Amsterdam, the Netherlands, 21-25 October 1975.

- FEILDEN, Sir Bernard M. 1982. *Conservation of Historic Buildings*. Technical Studies in the Arts, Archaeology and Architecture Series. London: Butterworth Scientific. ISBN 0 408 10782 0
- _____ 1987. *Between Two Earthquakes: Cultural Property in Seismic Zones*. Los Angeles, CA: the Getty Conservation Institute & ICCROM, ISBN 0 89236 128 X
- FIRE PROTECTION ASSOCIATION. Pa datë. *Heritage under fire: A guide to the protection of historic buildings*. Botuar nga Fire Protection Assoc., 140 Aldersfate ST., London EC1A 4HX, UK, on behalf of the UK Working Party on Fire Safety in Historic Buildings. ISBN 0 902167 94 4
- FITCHM J.M. 1982. *Historic Preservation: Curatorial Management of the Built World*. New York, NY: McGraw-Hill.
- HOLLY, M.A. 1984. *Panofsky and the Foundations of Art History*. Ithaca, NY: Cornell Univ. Press,
- ICCROM. 1983 [The UNESCO; ICCROM & ICOMOS] *International Meeting of Coordinators of Training in Architectural Conservation/Reunion internationale des coordinateurs pour la formation en conservation architecturale*. Romë, 2-4 dhjetor 1982 [në anglisht dhe frëngjisht] Romë: ICCROM.
- ICCROM-GCI. 1994. *International Directory on Training in Conservation of Cultural Heritage*. Los Angeles: The Getty Conservation Institute & ICCROM.
- ICOMOS. 1971. The “Venice Charter” [International Charter for the Conservation and Restoration of Monuments and Sites.] Adopted at “The Monument for the Man”, the 2nd International Congress of Restoration , Venice, 25-31 may 1964. Padova, Italy: Marsilio Editori on behalf of ICOMOS.
- ICOMOS. 1987. *The International Charter for the Conservation and Restoration of Historic Towns and urban Areas*. Adopted at “Old Cultures in New Worlds”, The [ICOMOS] 8th Generally Assembly and International Symposium, Washington D.C., 10-15 October 1987. Washington DC: ICOMOS.
- JOKILEHTO, J. 1986. A history of architectural conservation: the contribution of English, French, German and Italian thought towards an international approach to the conservation of cultural property. D. Phil. Thesis. Univ. York, UK.

- _____. 1996. International Standards, principles and charters of conservation. In: Marks, S. (ed) *Concerning Buildings. Studies in Honour of Sir Bernard Feilden*, 55-81. London: Butterworths.
- LARSEN, K.E. (ed.) 1995. *Nara Conference on Authenticity in relation to the World Heritage Convention. Nara, Japan, 1-6 November 1994. Proceedings*. UNESCO World Heritage Centre, Agency for Cultural Affairs (Japan), ICCROM and ICOMOS. Trondheim, Norway: Tapir Publishers.
- LARSEN, K.E., & MARESTEIN, N. (eds.) 1992. Proc. *International Symposium on Fire Protection of Historic Buildings and Towns*, Risør, Norway, 12-14 September 1990. Publ. By Tapir Forlag, on behalf of Central Office of Historic Monuments and Sites, Norway, and the Norwegian Institute of Technology, in cooperation with the ICOMOS International Wood Committee.
- _____. 1995. *Conference on authenticity in relation to the World Heritage Convention. Preparatory Workshop, Bergen, Norway, 21 January – 2 February 1994. Workshop Proceedings*. Riksantikvaren (Directorate for Cultural Heritage), Norway. Norway: Tapiri Forlag.
- MARKS, S. (ed.) 1996. *Concerning Buildings. Studies in Honour of Sir Bernard Feilden*. London: Buttersworth.
- MORA, P., MORA, L., & PHILIPPOT, P. 1977. *La conservation des peintures murales*. Bologna: Editrice Compositori, for ICCROM. Published in 1984 in English as *The Conservation of Wall Paintings*. London: Butterworth. ISBN 0 408 10812 6
- ORGAN, R.M. 1975. The Organisation of an integrated facility for conservation. *Bulletin de l'Institut Royal du Patrimoine Artistique*, **15**: 283-301.
- REIGL, A. 1903. *Der Moderne Denkmalkultus, sein Wesen, seine Entstehung*. Vienna. English translation published in 1982 as "Modern cult of Monuments: its character and its origin". *Oppositions*, **25**: 20-51.
- SEASE, C. 1987. *A Conservation Manual for the Field Archaeologist, Archaeological Research Tools*, Vol.4. Institute of Archaeology, UCLA. ISBN 0 917956 59 1
- SIRAVO, F. & PULVER, A. 1986. *Planning Lamu: Conservation of an East African Seaport*. Nairobi: The National Museums of Kenya.

dhe Kisha e “Saint Margaret (1987)

Katedralja “Canterbury”, “Abacia of St

Augustine”, dhe Kisha e “St. Martin (1988)

Ishulli Henderson (1988)

Kulla e Londrës (1988)

“Gough” dhe Ishujt (1995, 2004)

Qyteti i Vjetër dhe i Ri i Edinburgut (1995)

“Maritime Greenwich” (1997)

Zemra e “Orkney” Neolitik (1999)

Peizazhi Industrial “Blaenavon” (2000)

Qyteza Historike e “St. George” dhe Fortifikimet e saj, “Bermuda” (2000)

Mullinjët e Luginës “Derwent” (2001)

“Dorset” dhe Bregu i “East Devon” (2001)

“New Lanark” (2001)

“Saltaire” (2001)

Kopshtet Botanike Mbretërore, “Kew” (2003)

Liverpul – Qyteti Tregtar Detar (2004)

Ambienti dhe Peizazhi i Minierave në

“Cornwall” dhe “West Devon”(2006)

MEKSIKË

Qendra Historike e “Mexico City” dhe “Xochimilco” (1987)
 Qendra Historike e “Oaxaca” dhe Vendndodhja Arkeologjike e “Monte Albán” (1987)
 Qendra Historike “Puebla” (1987)
 Qyteti “Palenque” para-kolonizimit Spanjoll dhe Parku Kombëtar i tij (1987)
 Qyteti “Teotihuacan” (1987)
 “Sian Ka’an” (1987)
 Qyteti Historik i “Guanajuato” dhe Minierat e Afërta (1988)
 Qyteti i “Chichen-Itza” (1988)
 Qendra Historike në “Morelia” (1991)
 “El Tajin”, Qyteti i vjetër (1992)
 Qendra Historike e “Zacatecas” (1993)
 Pikturat në Shkëmbinjë në “Sierra de San Francisco” (1993)
 Vendbanimi i Balenave “El Vizcaino” (1993)
 Manastiret e Hershme të Shekullit 16 në Shpatet e “Popocatepetl” (1994)
 Zona e Monumenteve Historike të “Querétaro”(1996)
 Qyteza e Hershme e “Uxmal” (1996)
 “Hospicio Cabañas”, “Guadalajara” (1997)
 Zona Arkeologjike “Paquimé, Casas Grandes” (1998)
 Zona e Monumenteve Historike e “Tlacotalpan” (1998)
 Zona e Monumenteve Historike e “Xochicalco” (1999)
 Qyteza Historike e Fortifikuar “Campeche” (1999)
 Qyteti i Lashtë “Maya”i “Calakmul”, “Campeche” (2002)
 Misionet Françeskane në “Sierra Gorda” në “Querétaro” (2003)
 Shtëpia dhe Studio e “Luis Barragán” (2004)
 Ishujt dhe Zonat e Mbrojtura të Gjirit të Kalifornisë (2005, 2007)
 Peizazhet “Agave” dhe Hapërsirat e Lashta Industriale të Tekilës (2006)
 Kampusi i Qytetit të Universitetit Qendror të “Universidad Nacional Autónoma de México” (UNAM) (2007)
 Zona Natyrore e Biosferës së Fluturës Monarke (2008)
 Qyteti i Mbrojtur i “San Miguel” dhe

Vendbanimi i “Jesús Nazareno de Atotonilco” (2008)

MOLDAVI

Harku Gjeodetik i Struve-s (2005)

MONGOLI

Gjiri “Uvs Nuur” (2003)
 Peizazhi Kulturor i Luginës “Orkhon” (2004)

MOZAMBIK

Ishulli i Mozambikut (1991)

NAMIBI

Twyfelfontein apo Ui-aes (2007)

NEPAL

Lugina Katmandu (1979, 2006)
 Parku Kombëtar Sagarmatha (1979)
 Parku Kombëtar Mbretëror “Chitwan” (1984)
 Lumbini, Vendlindja e Zotit Buda (1997)

NIKARAGUA

Rrënojat e “León Viejo” (2000)

NIGER

Rezervat Natyrore “Air dhe Ténéré” (1991)
 Parku Kombëtar “W” i Nigerit (1996)

NIGERI

Peizazhi Kulturor Sukur (1999)
 Korija e Shenjtë e “Osun-Osogbo” (2005)

NORVEGJI

“Bryggen” (1979)
 Kisha Stave në Urnes (1979)
 Qyteti i Miniatorëve “Røros” (1980)
 Arti Shkëmbor i Altës (1985)
 “Vegaëyan” – Arkipelagu i Vegas (2004)
 Harku Gjeodetik i Struvesit (2005)
 Fjordet e Norvegjisë Perëndimore – “Geirangerfjord” dhe “Nærøyfjord” (2005)

OMAN

Fortesa Bahla (1987)
 Sitet Arkeologjike në Bat, Al-Khutm dhe Al-Ayn (1988)
 Vendbanimi Arab “Oryx” (1994) Hequr nga Lista në vitin 2007
 Vendi i “Frankincense” (2000)
 Sistemet e Vaditjes Aflaj në Oman (2006)

PAKISTAN

Rrënojat Arkeologjike në “Moenjodaro” (1980)

Rrënojat Budiste e Takht-i-Bahi dhe Rrënojat e Qyteti Fqinj në “Sahr-i-Bahlol” (1980)
 “Taxila” (1980)
 Fortesa dhe Kopshtet Shalamar në Lahore (1981)
 Monumentet Historike në “Thatta” (1981)
 Fortesa Rohtas (1997)

PANAMA

Fortifikimet në Anën e Karaibeve të Panamasë “Portobelo-San Lorenzo” (1980)
 Parku Kombëtar Darien (1981)
 Vargmali Talamanca – Rezerva “La Amistad” / Parku Kombëtar “La Amistad” (1983, 1990)
 Vendndodhja Arkeologjike e “Panamá Viejo” dhe Rajoni Historik i Panamasë (1997, 2003)
 Parku Kombëtar “Coiba” dhe Zona e tij speciale e mbrojtjes detare (2005)

PAPUA GUINEA E RE

Vendndodhja e Hershme Agrikulturore “Kuk” (2008)

PARAGUAI

Misionet Jezuite të “La Santísima Trinidad de Paraná” dhe “Jesús de Tavarangue” (1993)

PERU

Qyteti “Cuzco” (1983)
 Vendbanimi Historik i Maçu-Piçut (1983)
 “Chavin”, Vendodhje arkeologjike (1985)
 Parku Kombëtar “Huascarán” (1985) #
 Zona Arkeologjike “Chan Chan” (1986)
 Parku Kombëtar “Manú” (1987)
 Qendra Historike e Limas (1988, 1991)
 Parku Kombëtar “Río Abiseo” (1990, 1992)
 Vijat dhe Gjeoglifet në “Nasca” dhe “Pampas de Jumana” (1994)
 Qendra Historike e Qytetit “Arequipa” (2000)

POLONI

Qendra Historike e Krakovit (1978)
 Miniera e Kripës në “Wieliczka” (1978)
 “Auschwitz Birkenau”, Kampi Nazist Gjerman i Përqëndrimit dhe i Shfarrosjes (1940-1945) (1979)
 “Belovezhskaya Pushcha” / Pylli Białowieża (1979, 1992)
 Qendra Historike e Warsaw-ës (1980)
 Qyteti i Vjetër i “Zamość”-it (1992)

Kështjella e Urdhërit Teutonik në Malbork (1997)
 Qyteti Mesjetar i Torunit (1997)
 “Kalwaria Zebrzydowska”: Kompleksi i Peizazhit të Parkut dhe Arkitekturës Maneriste dhe Parku i Pelegrinazhit (1999)
 Kishat e Paqes në “Jawor” dhe “Swidnica” (2001)
 Kishat e Drurit në Poloninë e Vogël Jugore (2003)
 Parku “Muskauer” / Parku “Muzakowski” (2004)
 Salla e Mijëvjeçarit në “Wroclaw” (2006)

PORTUGALI

Zona Qendrore e Qytetit “Angra do Heroísmo” në Azuret (1983)
 Manastiri i Krishtit në Tomar (1983)
 Manastiri “Batalha” (1983)
 Manastiri “Hieronymites” dhe Kulla e Belemit në Lisbonë (1983)
 Qendra Historike Evoras (1986)
 Manastiri “Alcobaça” (1989)
 Peizazhi Kulturor i Sintras (1995)
 Qendra Historike e Oportos (1996)
 Sitet e Artit Shkëmbor Parahistorik në Luginën “Côa” (1998)
 “Laurisilva” e Madeirës (1999)
 Rajoni i Verës “Alto Douro” (2001)
 Qendra Historike e Guimarães (2001)
 Peizazhi i Kulturës së Vreshtave në Ishullin Pico (2004)

QIPRO

Pafos (1980)
 Kishat e Pikturuara në rajonin “Troodos” (1985, 2001)
 “Choirokoitia” (1998)

REPUBLIKA E AFRIKËS

QENDRORE

Parku Kombëtar “Manovo-Gounda St. Floris” (1988)

REPUBLIKA ARABE E SIRISË

Qyteti i Lashtë i Damaskusit (1979)
 Qyteti i Lashtë i Bosras (1980)
 Vendndodhjai i Palmirës (1980)
 Qyteti i Lashtë i Alepos (1986)
 “Crac des Chevaliers” dhe “Qal’at Salah El-Din” (2006)

REPUBLIKA E BASHKUAR E TANZANISË

Zona e Konservimit Ngorongoro (1979)
 Rrënojat “Kilwa Kisiwani” dhe Rrënojat “Songo Mnara” (1981)
 Parku Kombëtar i Serengetit (1981)
 Rezerva e Kafshëve të Egra në Selous (1982)
 Parku Kombëtar Kilimanxharos (1987)
 Qyteti Guror i Zanzibarit (2000)
 Vendndodhjet e Artit Shkëmbor në Kondoia (2006)

REPUBLIKA ÇEKE

Qendra Historike e “Český Krumlov” (1992)
 Qendra Historike e Pragës (1992)
 Qendra Historike e “Telč” (1992)
 Kisha e Pelegrinazhit të “St. John” të “Nepomuk” në “Zelená Hora” (1994)
 “Kutná Hora”: Qendra Historike e Qytetit dhe Kisha e “St. Barbara” Katedralja e Zonjës Tonë në “Sedlec” (1995)
 Peizazhi Kulturor “Lednice-Valtice” (1996)
 Kopshtet dhe Kështjella në “Kromčíž” (1998)
 Zona Natyrore e Fshatit Historik “Holočovice” (1998)
 Kështjella “Litomyšl” (1999)
 Shtylla e Triadës së Shenjtë në “Olomouc” (2000)
 Vila “Tugendhat” në “Brno” (2001)
 Lagja e Hebrnjëve dhe Bazilika e “St. Procopius” në “Třebíč” (2003)

REPUBLIKA DEMOKRATIKE E KONGOS

Parku Kombëtar Virunga (1979)
 Parku Kombëtar Kahuzi-Biega (1980)
 Parku Kombëtar Garamba (1980)
 Parku Kombëtar Salonga (1984)
 Zona Natyrore Okapi (1996)

REPUBLIKA DEMOKRATIKE POPULLORE E LAOS

Qyteti i “Luang Prabang” (1995)
 “Vat Phou” dhe Vendbanimet e Lashta brenda Peizazhit Kulturor “Champasak” (2001)

REPUBLIKA DOMENIKANE

Qyteti i Periudhës Kolone i “Santo Domingo”-s (1990)

REPUBLIKA ISLAMIKE E IRANIT

“Meidan Emam”, “Esfahan” (1979)
 “Persepolis” (1979)
 “Tchogha Zanbil” (1979)
 “Takht-e Soleyman” (2003)
 “Bam” dhe Peizazhi i tij Kulturor (2004, 2007)
 “Pasargadae” (2004)
 “Soltaniyeh” (2005)
 “Bisotun” (2006)
 Struktural Klerike Armene në Iran (2008)

REPUBLIKA E KORESË

Tempulli “Haeinsa Janggyeong Panjeon”, Magazinat e Blloqeve të Drurit “Tripitaka Koreana” (1995)
 Faltorja “Jongmyo” (1995)
 “Seokguram Grotto” në tempullin “Bulguksa” (1995)
 Kompleksi i Pallatit “Changdeokgung” (1997)
 Fortesa “Hwaseong” (1997)
 Vendndodhjet “Dolmene Gochang”, “Hwasun” dhe “Ganghwa” (2000)
 Zonat Historike në “Gyeongju” (2000)
 Ishulli Vullkanik “Jeju” dhe “Tubet e Llavës” (2007)

REPUBLIKA POPULLORE DEMOKRATIKE E KORESË

Kompleksi i Varrezave “Koguryo” (2004)

RUMANI

Delta e Danubit (1991)
 Kishat e Moldavisë (1993)
 Manastiri i Horezut (1993)
 Fshatrat me Kishat e Fortifikuara në Transilvani (1993, 1999)
 Fortesa Daciane e Maleve Orastie (1999)
 Qendra Historike “Sighişoara” (1999)
 Kishat e Drurit në Maramureş (1999)

SAN MARINO

Qendra Historike e San Marinos dhe Mali Titano (2008)

SELIA E SHENJTË – VATIKANI

Qendra Historike e Romës, Pronat e Selisë së Shenjtë në Qytetin me të Drejta Ekstraterritoriale dhe “San Paolo Fuori le Mura” (1980, 1990)
 Qyteti i Vatikanit (1984)

SENEGAL

Ishulli “Gorée” (1978)
 Parku Kombëtar “Niokolo-Koba” (1981)
 Vendbanimi i Zogut Kombëtar Djoudj (1981)
 Ishulli “Saint-Louis” (2000, 2007)
 Rrathët e Gurëve në Senegambia (2006)

SERBI

“Stari Ras” dhe “Sopoćani” (1979)
 Manastiri Studenica (1986)
 Monumentet Mesjetare në Kosovë (2004, 2006)
 “Gamzigrad-Romuliana”, Pallati i Galeriusit (2007)

SLLOVAKI

Qyteti Historik “Banská Štiavnica” dhe Monumentet Teknike në Afërsi të tij (1993)
 “Spišský Hrad” dhe Monumentet Kulturore të Asocuara (1993)
 “Vlkolínec” (1993)
 Shpellat “Aggtelek Karst” dhe “Slovak Karst” (1995, 2000)
 Rezerva e Konservuar e “Qytetit Bardejov” (2000)
 Pyjet e Hershme të Ahut në Karpate (2007)
 Kishat e Drurit në pjesën Sllovaqe të Zonës së Maleve Karpate (2008)

SLLOVENI

Shpellat “Škocjan” (1986)

SPANJË

“Alhambra Generalife” dhe “Albayzín” në Granada (1984, 1994)
 Katedralja e Burgosit (1984)
 Qendra Historike e Kordobas (1984, 1994)
 Manastiri dhe Siti Eskurial, në Madrid (1984)
 Veprat e “Antoni Gaudit” (1984, 2005)
 Shpella e Altamiras dhe Arti i Shpellave Paleolitike në Spanjën Veriore (1985, 2008)
 Monumentet e Oviedos dhe Mbretëria e Asturias (1985, 1998)
 Qyteza e Vjetër “Ávila” me Kishat e saj “Ekstra-Muros” (1985, 2007)
 Qyteti i Vjetër i Segovias dhe Ujësllësi i tij (1985)
 “Santiago de Compostela”, Qyteti i Vjetër (1985)
 Parku Kombëtar “Garajonay” (1986)
 Qyteti Historik i Toledos (1986)
 Arkitektura “Mudejar” e Aragonit (1986, 2001)

Qyteti i Vjetër “Cáceres” (1986)
 Katedralja “Alcázar” dhe “Archivo de Indias” në Sevilje (1987)
 Qyteti i Vjetër i Salamankas (1988)
 Manastiri Poblet (1991)
 Ansambli Arkeologjik i Meridas (1993)
 Shtegu i “Santiago de Compostela” (1993)
 Manastiri Mbretëror “Santa María de Guadalupe” (1993)
 Parku Kombëtar “Doñana” (1994, 2005)
 Qyteza e Fortifikuar Historike “Cuenca” (1996)
 “La Lonja de la Seda de Valencia” (1996)
 “Las Médulas” (1997)
 “Palau de la Música Catalana” dhe “Hospital de Sant Pau Barcelona” (1997)
 Pirenejt – “Mont Perdu” (1997, 1999)
 “San Millán Yuso” dhe Manastiret “Suso” (1997)
 Arti Shkëmbor i Basenit Mesdhetar në Gadishullin Iberian (1998)
 Universiteti dhe Qarku Historik i “Alcalá de Henares” (1998)
 Ibica, Biodiversiteti dhe Kultura (1999)
 “San Cristóbal de La Laguna” (1999)
 Ansambli Arkeologjik “Tárraco” (2000)
 Siti Arkeologjik “Atapuerca” (2000)
 Kishat Romake Katalane të “Vall de Boi” (2000)
 “Palmeral e Elche” (2000)
 Muret Romake Lugo (2000)
 Peizazhi Kulturor i “Aranjuez” (2001)
 Ansamblet Monumentale të Rilindjes në “Úbeda” dhe “Baeza” (2003)
 Ura “Vizcaya” (2006)
 Parku Kombëtar Teide (2007)

SRI LANKË

Qyteti i Lashtë “Polonnaruwa” (1982)
 Qyteti i Lashtë “Sigiriya” (1982)
 Qyteti i Shenjtë “Anuradhapura” (1982)
 Qyteza e Vjetër “Galle” dhe Fortifikimet e saj (1988)
 Qyteti i Shenjtë “Kandy” (1988)
 Rezerva Pyjore “Sinharaja” (1988)
 Tempulli i Artë “Dambulla” (1991)

SUDAN

“Gebel Barkal” dhe Sitet e Rajonit të Napatanit (2003)

SURINAMI

Rezerva Natyrore Qendrore e Surinames (2000)
 Qyteti i Brendshëm Historik i Paramaribos (2002)

SUEDI

Territori Mbretëror i “Drottningholm” (1991)
 “Birka” dhe “Hovgarden” (1993)
 “Engelsberg Ironworks” (1993)
 Gdhendjet Shkëmbore në Tanum (1994)
 “Skogskyrkogården” (1994)
 Qyteza Hanse atike në “Visby” (1995)
 Kisha Fshatare në “Gammelstad”, “Luleå” (1996)
 Zona Laponiane (1996)
 Porti Detar “Karlskrona” (1998)
 Peizazhi Agrikulturor në jug të “Öland” (2000)
 Bregu i Lartë / Arkipelagu Kvarken (2000, 2006)
 Zona e Minierave të Maleve të Mëdha të Bakrit në Falun (2001)
 Radio Stacioni Varberg (2004)
 Harku Gjeodetik i Struvesë (2005)

SHËN KITSI DHE NEVISI

Parku Kombëtar “Brimstone Hill Fortress” (1999)

SHËN LUSIA

Zona e Menaxhimit të Pitonëve (2004)

SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS

Parku Kombëtar “Mesa Verde” (1978)
 Parku Kombëtar “Yellowstone” (1978)
 Parku Kombëtar “Everglades” (1979)
 Parku Kombëtar “Grand Canyon” (1979)
 “Independence Hall” (1979)
 “Kluane” / “Wrangell-St Elias” / “Glacier Bay” / “Tatshenshini-Elsek” (1979, 1992, 1994)
 Parqet Kombëtar dhe Shtetërore “Redwood” (1980)
 Parku Kombëtar “Mammoth Cave” (1981)
 Parku Kombëtar Olimpik (1981)
 Vendndodhja Historike Shtetërore “Cahokia Mounds” (1982)
 “La Fortaleza” dhe Vendndodhja Historike Kombëtare “San Juan” në Porto Riko (1983)
 Parku Kombëtar “Great Smoky Mountains” (1983)
 Statuja e Lirisë (1984)
 Parku Kombëtar “Yosemite” (1984)
 Kultura “Chaco” (1987)
 Parku Kombëtar i Vullkaneve në “Hawaii” (1987)
 “Monticello” dhe “University of Virginia in

Charlottesville” (1987)
 “Pueblo de Taos” (1992)
 Parku Kombëtar “Carlsbad Caverns” (1995)
 Parku Ndërkombëtar i Paqes “Waterton Glacier” (1995)

TAJLANDE

Qyteti Historik “Ayutthaya” (1991)
 Qyteza Historike “Sukhothai” dhe Qytezat Historike të Asocuar (1991)
 Vebdbanimi e Kafshëve të Egra “Thungyai-Huai Kha Khaeng” (1991)
 Siti Arkeologjik “Ban Chiang” (1992)
 Kompleksi Pyjor “Dong Phrayayen-Khao Yai” (2005)

TOGO

“Koutammakou”, Vendi “Batammariba” (2004)

TUNIZI

Amfiteatri “El Jem” (1979)
 Medina e Tunisit (1979)
 Siti i Kartagjenës (1979)
 Parku Kombëtar “Ichkeul” (1980)
 Qyteti Punik i Kerkuanës dhe Nekropolisit i tij (1985, 1986)
 “Kairouan” (1988)
 Medina “Sousse” (1988)
 “Dougga / Thugga” (1997)

TURKMENISTAN

Parku Shtetëror Historik e Kuturor Mervi i Lashtë (1999)
 “Kunya-Urgench” (2005)
 Fortesa Parthiane në Nisa (2007)

TURQI

Parku Kombëtar “Göreme” dhe Sitet Shkëmbore në “Cappadocia” (1985)
 Xhamia e Madhe dhe Spitali “Divri i” (1985)
 Zonat Historike të Stambollit (1985)
 “Hattusha”: Kryqyteti “Hititi” (1986)
 “Nemrut Da” (1987)
 “Hierapolis-Pamukkale” (1988)
 “Xanthos-Letoon” (1988)
 Qyteti “Safranbolu” (1994)
 Sitet Arekologjike të Trojës (1998)

UGANDË

Parku Kombëtar i Padeptueshëm “Bwindi” (1994)
 Parku Kombëtar i Maleve “Rwenzori” (1994)

Varrezat e Mbretërve “Buganda” në “Kasubi” (2001)

UKRAINË

Kiev: Katedralja Shën Sofia dhe Ndërtesat e Tjera Klerike, Kiev - “Pechersk Lavra” (1990, 2005)

“L’viv” – Grupimi i ndërtesave të Qendrës Historike (1998)

Harku Gjeodetik i Struvesë (2005)

Pyjet e Hershme të Ahut në Karpate (2007)

URUGUAI

Lagja Historike e Qytetit “Colonia del Sacramento” (1995)

UZBEKISTAN

“Itchan Kala” (1990)

Qendra Historike e “Bukhara” (1993)

Qendra Historike e “Shakhrisyabz” (2000)

“Samarkand” – Udhëkryqet e Kulturave (2001)

VANUATU

Territori i Kreut “Roi Mata” (2008)

VENEZUELË

“Coro” dhe Porti i tij (1993)

Parku Kombëtar “Canaima” (1994)

“Ciudad Universitaria de Caracas” (2000)

VIETNAM

Kompleksi i Monumenteve “Hué” (1993)

Gjiri “Ha Long” (1994, 2000)

Qyteza e Lashtë “Hoi An” (1999)

Faltorja “My Son” (1999)

Parku Kombëtar “Phong Nha-Ke Bang” (2003)

ZAMBIE

“Mosi-oa-Tunya” / Ujëvarat e Viktorias (1989)

ZELANDË E RE

“Te Wahipounamu” – Jugperendimi i Zelandës së Re (1990)

Parku Kombëtar Tongariro (1990, 1993)

Ishujt Sub-Antarktidë të Zelandës së Re (1998)

ZIMBABVE

Parku Kombëtar “Mana Pools”, Zonat e Shkretëtirës “Sapi” dhe “Chewore” (1984)
Monumenti Kombëtar Madhështor i Zimbabves (1986)

Monumenti Kombëtar i Rrënojave “Khami” (1986)

“Mosi-oa-Tunya” / Ujëvarat e Viktorias (1989)

Kodrat “Matobo” (2003)

ZVICËR

Manastiri “Benedictine of St. John” në “Müstair” (1983)

Manastiri “St. Gall” (1983)

Qyteti i Vjetër i Bernes (1983)

Tre Kështjella, Muret Mbrojtëse dhe Stomat e Qyteti Tregtar në “Bellinzona” (2000)

Alpet Zvicëriane “Jungfrau-Aletsch” (2001, 2007)

“Monte San Giorgio” (2003)

“Lavaux”, Brezaret e Vreshtave (2007)

Hekurudha “Rhaetiane” në Peizazhet “Albula / Bernina” (2008)

Arena Tektonike Zvicëriane në Sardonë (2008)

Shtojca E

**Udhëzuesi për edukimin dhe formimin profesional
në konservimin e monumenteve,
ansambleve dhe siteve**

Asambleja e Përgjithshme e Këshillit Ndërkombëtar të Monumenteve dhe të Siteve, ICOMOS, mbledhja në Kolombo, Sri Lankë, në seancën e saj të dhjetë nga 30 korriku e deri më 7 gusht, 1993;

Duke marrë parasysh gamën e shtrirjes së konceptit të *monumenteve, ansambleve dhe siteve*;

Duke marrë parasysh shumëllojshmërinë e veprimeve dhe të trajtimeve të nevojshme për konservimin e këtyre burimeve të trashëgimisë, dhe nevojën për një disiplinë të përbashkët për drejtimin e tyre;

Duke qenë të vetëdijshëm se profesionet e ndryshme duhet të bashkëpunojnë brenda një discipline të përbashkët në kuadër të procesit të konservimit, e cila kërkon edukimin e përshtatshëm dhe formimin profesional përmes kurseve të posaçme për të garantuar komunikimin e mirë dhe veprime të koordinuara gjatë procesit të konservimit;

Duke theksuar Kartën e Venecias dhe doktrinat e tjera të ICOMOS-it që lidhen me të, dhe nevojën për të siguruar një referencë për institucionet dhe organet e përfshira në zhvillimin e programeve të kurseve të formimit profesional, si dhe për të ndihmuar në përcaktimin dhe ndërtimin e standardeve të duhura dhe kritereve të përshtatshme për t'i përmbushur kërkesat specifike kulturore dhe teknike të secilit komunitet dhe rajon;

Adopton udhëzuesin e mëposhtëm dhe Rekomandon që ai të shpërndahej për të informuar institucionet, organizatat dhe autoritetet që kanë lidhje me të.

Qëllimi i Udhëzuesit

1. Qëllimi i këtij dokumenti është që të japë një shtysë drejt themelimit të standardeve dhe udhëzimeve për edukimin dhe kurset e formimit profesional në konservimin e monumenteve, grupeve të ndërtesave (ansambleve) dhe siteve të përcaktuara si trashëgimi kulturore në bazë të Konventës së Trashëgimisë Botërore të vitit 1972. Ato përfshijnë ndërtesat historike, zonat dhe qytetet historike, sitet arkeologjike

dhe përmbajtjet e tyre, si dhe peizazhet kulturore e historike. Konservimi është dhe do të vazhdojë të mbetet një çështje urgjente.

Konservimi

2. Konservimi i trashëgimisë kulturore tanimë konsiderohet si një pjesë e fushës më të gjerë të zhvillimit të ambientit dhe kulturës. Strategjitë e menaxhimit të qëndrueshëm të ndryshimeve të cilat respektojnë trashëgiminë kulturore kërkojnë integrimin e qëndrimeve të konservimit me objektivat bashkëkohore ekonomike e shoqërore, përfshi këtu edhe turizmin.

3. Objekti i konservimit është të zgjasë jetën e trashëgimisë kulturore, dhe nëse është e mundur edhe të qartësojë mesazhin artistik dhe historik brenda saj pa humbur autenticitetin dhe domethënien e saj. Konservimi është aktivitet kulturor, historik, teknik si dhe profesion i bazuar në studime shoqërore dhe shkencore si dhe në hulumtimin sistematik. Konservimi duhet të respektojë kontekstin kulturor.

Programet dhe kurset edukative dhe ato të formimit profesional

4. Ekziston nevoja për të zhvilluar një qasje gjithëpërfshirëse ndaj trashëgimisë sonë në bazë të pluralizmit dhe larmisë kulturore. Kjo qasje duhet respektuar nga profesionistët, mjeshtrit artizanë dhe administratorët. Konservimi kërkon aftësi vëzhguese, analitike dhe sintetizuese. Konservuesi duhet të ketë një qasje të lakueshme por pragmatike të bazuar mbi ndërgjegjësimin kulturor i cili duhet të mbizotërojë në të gjitha punët në praktikë, edukimin dhe formimin e përshtatshëm. Për më tepër, konservimi kërkon edhe aftësi të mira vendimmarrëse dhe një kuptim mbi raportet duke kuptuar mirë edhe nevojat e komunitetit. Në këtë aktivitet shumëdisiplinor ka nevojë për shumë aftësi profesionale dhe profesione të ndryshme.

5. Punët e konservimit duhet t'u besohen vetëm atyre personave që janë kompetentë në këto aktivitete të specializuara. Edukimi dhe formimi profesional duhet të ketë si rezultat formimin e një sërë profesionistësh dhe konservuesish që janë në gjendje:

- a) të kuptojnë një monument, ansambël apo sit dhe të identifikojnë rëndësinë emocionale, kulturore dhe funksionale;
- b) të kuptojnë historinë dhe teknologjinë e monumenteve, ansambleve dhe siteve në mënyrë që të përcaktojnë identitetin e tyre, planin e konservimit si dhe të interpretojnë rezultatet e hulumtimit të tyre;
- c) të kuptojnë ambientin e monumentit, ansamblit apo sitit, përmbajtjen dhe

- rrethinat e tyre në lidhje me ndërtesat, kopshtet apo peizazhet e tjera;
- d) të gjejnë dhe të kuptojnë të gjitha burimet e mundshme të informacionit që kanë lidhje me monumentin, ansamblin apo sitin që po studiohet;
 - e) të kuptojnë dhe të analizojnë sjelljen e monumenteve, ansambleve dhe siteve si sisteme komplekse;
 - f) të diagnostifikojnë shkaqet e brendshme dhe të jashtme të prishjes si baza për të identifikuar veprimet e nevojshme;
 - g) të inspektojnë dhe përgatisin raporte të kuptueshme edhe për lexues që nuk janë specialistë lidhur me monumentet, ansamblet apo sitet, duke përdorur ilustrime grafike përmes skicave ose fotografive;
 - h) të njohin, të kuptojnë dhe të aplikojnë konventat dhe rekomandimet e UNESCO-s dhe ICOMOS-it si dhe kartat, rregulloret dhe udhëzuesit e tjerë të njohur;
 - i) të marrin vendime të ekuilibruara të bazuara në parime të përbashkëta etike si dhe të pranojnë përgjegjësinë për mbarëvajtjen afatgjate të trashëgimisë kulturore;
 - j) të dinë kur duhet kërkuar këshillë dhe kur duhen përcaktuar fushat që duhet të studiohen nga specialistë të ndryshëm, si p.sh. pikturat murale, skulpturat dhe objektet me vlera artistike dhe historike, dhe/ose studime të materialeve dhe sistemeve;
 - k) të japin këshilla me ekspertizë rreth strategjive të mirëmbajtjes, politikave të menaxhimit dhe kuadrit të politikave për mbrojtjen ambientale dhe ruajtjen e monumenteve dhe përmbajtjes së tyre, si dhe të siteve;
 - l) të dokumentojnë punimet e zbatuara dhe të kujdesen që ato të jenë të vizitueshme nga publiku;
 - m) të punojnë në grupe të përbëra nga profesionistë të disiplinave të ndryshme, duke përdorur metoda të përshtatshme;
 - n) të punojnë me banorët, administratorët dhe planifikuesit për të zgjidhur konfliktet si dhe të zhvillojnë strategji të konservimit të përshtatshme për nevojat, aftësitë dhe burimet vendore;

Qëllimet e kurseve

6. Ekziston nevoja për t'i përçuar njohuritë e qëndrimeve dhe qasjeve të konservimit tek të gjithë ata të cilët mund të kenë një ndikim direkt apo indirekt në pronat kulturore.

7. Praktika e konservimit është e shtrirë në shumë fusha, dhe rrjedhimisht edhe temat e kurseve duhet të përfshijnë fusha të ndryshme. Profesionistëve, duke përfshirë edhe akademikët dhe mjeshtrit artizanë të specializuar, të cilët e kanë përfunduar kualifikimin e tyre të zakonshëm do t'u nevojiten kualifikime të mëtejshme për t'u bërë konservues. E njëjta gjë vlen edhe për ata të cilët duan të punojnë vetëm brenda një ambienti historik.

8. Konservuesit duhet të sigurohen që të gjithë artizanët dhe punonjësit e një monumenti, ansambli apo siti të respektojnë vlerat dhe rëndësinë e këtyre të fundit.

9. Kurset përgatitore duhet të përfshijnë kualifikimin mbi gatishmërinë në rastin e një fatkeqësie dhe mbi metodat e zbutjes së dëmeve mbi pronën kulturore, përmes përforsimit dhe përmirësimit të parandalimit të zjarrit dhe masave të tjera të sigurisë.

10. Zanatet tradicionale janë një burim i vlefshëm kulturor. Mjeshtrit artizanë të cilët kanë fituar një nivel të lartë aftësish të punëve me dorë duhet të stërviten më tej në lidhje me punën konservuese me udhëzimet mbi historinë e zanatit të tyre, detajet dhe praktikat historike, si dhe mbi teorinë e konservimit dhe nevojën për dokumentim. Shumë aftësi historike duhet të regjistrohen dhe të ringjallen.

Organizimi i edukimit dhe i kursit të formimit profesional

11. Ekzistojnë shumë metoda të pranueshme për të arritur edukimin dhe formimin e duhur. Variantet e ndryshme do të varen nga traditat dhe legjislacioni, si dhe nga konteksti administrativ dhe ekonomik i secilit rajon kulturor. Në nivel ndërkombëtar, duhet inkurajuar shkëmbimi aktiv i ideve dhe i mendimeve rreth qasjeve të reja në edukim dhe formim profesional mes institucioneve kombëtare të vendeve të ndryshme. Rrjeti i bashkëpunimit mes individëve dhe institucioneve është diçka thelbësore në suksesin e këtij shkëmbimi.

12. Edukimi dhe sensibilizimi mbi konservimin duhet të fillojë në shkolla dhe të vazhdojë më tej në universitete e më gjerë. Këto institucione kanë një rol të rëndësishëm në rritjen e ndërgjegjësimit pamor dhe kulturor, duke përmirësuar aftësinë për të lexuar dhe kuptuar elementet e trashëgimisë sonë kulturore, si dhe

duke ofruar përgatitjen e duhur kulturore të kandidatëve për një kurs formimi profesional apo një edukimi të specializuar. Për profesionet e ndryshme duhet inkurajuar ushtrimi në praktikë.

13. Kurset për zhvillimin e vazhdueshëm profesional mund të përmirësojnë edukimin dhe stërvitjen fillestare të profesionistëve. Kurset afatgjata me kohë të pjeshme janë një metodë e mirë për të marrë njohuri të avancuara, dhe një metodë e tillë është mjaft e dobishme në qendrat me një numër të madh popullsie. Kurset e shkurta mund t'i pasurojnë profesionistët me këndvështrime të ndryshme, por ato nuk mund t'u mësojnë atyre aftësi apo të mundësojnë kuptimin e mirëfilltë të konservimit. Ato mund të ndihmojnë në prezantimin me konceptet dhe teknikat e konservimit në menaxhimin e ambientit të ndërtuar dhe të atij natyror, si dhe të objekteve brenda tij.

14. Pjesëmarrësit në kurset e specializuara duhet të jenë të kalibrit të lartë, zakonisht duke pasur përvojë në punë praktike të ndërthurur me edukimin dhe stërvitjen e përshtatshme. Kurset e specializuara duhet të mbulojnë tema në shumë disiplina duke prezantuar edhe lëndët bazë për të gjithë pjesëmarrësit, si dhe duke ofruar lëndë me zgjedhje për të rritur kapacitetet dhe/apo për të mbushur boshllëqet e edukimit dhe stërvitjes së mëparshme. Në mënyrë që të plotësohet edukimi dhe stërvitja e konservuesit është e rekomandueshme që të kryhen stazhe të ndryshme për t'i mundësuar pjesëmarrësve përvojë praktike në terren.

15. Secili shtet apo grup rajonal duhet të inkurajohet që të ndërtojë të paktën një institut të organizuar në mënyrë gjithëpërfshirëse i cili ofron edukimin, stërvitjen dhe kurse të specializuara. Mund të nevojiten dekada të tëra për të vendosur një shërbim konservimi plotësisht kompetent. Si pasojë, mund të nevojiten masa të posaçme afatshkurtra, duke përfshirë edhe integrimin e nismave të reja në programet ekzistuese, në mënyrë që të arrihet deri aty sa të krijohen programe të reja të kompletuara në të gjitha aspektet. Duhet inkurajuar shkëmbimi i mësuesve, ekspertëve dhe studentëve brenda vendit, në nivel rajonal, dhe në nivel ndërkombëtar.

Burimet

16. Burimet e nevojshme për kurset e specializuara mund të përfshijnë:

- a) një numër të përshtatshëm pjesëmarrësish të nivelit të duhur, dhe teorikisht të grupmoshës 15 deri 25 vjeç;
- b) një koordinator të përhershëm të cilit i jepet edhe mbështetja e përshtatshme administrative;
- c) instruktorë me njohuri me baza të forta teorike dhe përvojë në praktike në

fushën konservimit, si dhe me aftësi pedagogjike;

- d) hapësira të pajisura mirë, të cilat përfshijnë hapësirat për të mbajtur leksione me pajisje audio-vizuale, video, studio, laboratorë, reparte për punën me dorë, dhoma për seminare dhe zyra për stafin;
- e) biblioteka dhe qendra dokumentimi që përmbajnë referenca për koleksione të ndryshme, hapësira për një punë kërkimore të koordinuar, dhe akses në rrjete informacioni të kompjuterizuara;
- f) një sërë monumentesh, ansamblesh dhe sitiesh brenda një rrezeje të arsyeshme.

17. Konservimi varet nga dokumentimi i përshtatshëm për të kuptuar monumentet, ansamblet apo sietet dhe ambientin e tyre përkatës. Çdo shtet duhet të ketë një institut për të kryer hulumtimin dhe një arkiv për regjistrimin e trashëgimisë kulturore dhe të të gjitha punimeve konservuese të kryera mbi këtë trashëgimi. Kursi duhet të zhvillohet brenda përgjegjësi të arkivit të identifikuar në nivel kombëtar.

18. Financimi i pagesave dhe i bursave për studim mund të kërkojë një mbështetje të veçantë për pjesëmarrësit që janë në mes të karrierës së tyre, pasi ata mund të kenë edhe detyrime personale.

(Gusht 1993)

Shtojca F

Parimet e regjistrimit të monumenteve, grupeve të ndërtesave dhe siteve

(Teksti i ratifikuar nga Asambleja e Përgjithshme e 11-të e ICOMOS-it, mbajtur në Sofje, Bullgari, nga data 5 deri më 9 tetor 1996)

Meqenëse trashëgimia kulturore është një shprehje unike e arritjes njerëzore; dhe pasi kjo trashëgimi kulturore është vazhdimisht në rrezik; dhe meqenëse regjistrimi është njëra nga mënyrat kryesore të disponueshme për t'i dhënë kuptim, domethënie, si dhe për të përkufizuar dhe njohur vlerat e trashëgimisë kulturore; dhe pasi përgjegjësia për konservimin dhe mirëmbajtjen e trashëgimisë kulturore i mbetet jo vetëm pronarëve por edhe specialistëve dhe profesionistëve të konservimit, menaxherëve, politikanëve dhe administratorëve që punojnë në të gjitha nivelet e qeverisjes, si dhe me publikun; dhe siç e kërkon edhe Neni 16 i Kartës së Venecias, regjistrimi i natyrës së trashëgimisë kulturore është diçka thelbësore që duhet kryer nga organizata dhe individë të përgjegjshëm.

Qëllimi i këtij dokumenti është që të caktojë arsyet kryesore, përgjegjësitë, masat e planifikimit, përmbytjen, menaxhimin dhe rëndësinë e shpërndarjes së regjistrimit dhe dokumentimit të trashëgimisë kulturore.

Përkufizimet e fjalëve të përdorura në këtë dokument:

Trashëgimia Kulturore i referohet monumenteve, grupeve të ndërtesave dhe siteve me vlera trashëgimie, që përbëjnë ambientin e ndërtuar apo atë historik.

Regjistrimi është grumbullimi i informacionit që përshkruan konfigurimin fizik, gjendjen dhe shfrytëzimin e monumenteve, grupeve të ndërtesave dhe siteve në pika të ndryshme kohore, dhe kjo gjë përbën një element thelbësor për procesin e konservimit.

Të dhënat e monumenteve, grupeve të ndërtesave dhe siteve mund të përfshijnë dëshmi të prekshme si dhe ato jo të prekshme, dhe përbëjnë një pjesë të dokumentimit i cili mund të kontribuojë në kuptimin e trashëgimisë kulturore dhe vlerave që lidhen me të.

Arsyet e nevojës për të bërë regjistrimin

1. Regjistrimi i trashëgimisë kulturore është një element i domosdoshëm për të:

- a) fituar njohuri për të avancuar kuptimin e trashëgimisë kulturore, vlerat dhe evolucionin e saj;
- b) rritur interesimin dhe përfshirjen e njerëzve në ruajtjen e trashëgimisë nëpërmjet shpërndarjes së të dhënave të regjistruara;
- c) mundësuar menaxhimin e mirinformuar dhe kontrollin e punimeve të ndërtimit dhe të të gjitha ndryshimeve të trashëgimisë kulturore;
- d) siguruar që mirëmbajtja dhe konservimi i trashëgimisë kryhet duke respektuar formën e burimit të trashëgimisë, materialin e tij përbërës, si dhe ndërtimin dhe rëndësinë e tij historike dhe kulturore.

2. Regjistrimi duhet të kryhet në nivelin e duhur të detajeve në mënyrë që:

- a) të sigurojë të dhëna për procesin e identifikimit, kuptimit, interpretimit dhe prezantimit të trashëgimisë, si për të shtyrë përfshirjen e publikut;
- b) të sigurojë të dhëna të përhershme të të gjitha monumenteve, grupeve të ndërtesave dhe siteve të cilat duhet të shkatërrohen apo të ndryshohen në ndonjë mënyrë, apo edhe kur ekziston rreziku nga fatkeqësitë natyrore apo aktivitetet njerëzore;
- c) të sigurojë të dhëna për administratorët dhe planifikuesit në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor për të ndërmarrë vendime dhe politika të arsyeshme të planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit;
- d) të sigurojë informacionin bazë mbi të cilin mund të identifikohet shfrytëzimi i përshtatshëm dhe i qëndrueshëm, dhe mbi të cilin mund të planifikohet hulumtimi efikas, menaxhimi, programet e mirëmbajtjes dhe punimet e ndërtimit.

3. Regjistrimi i trashëgimisë kulturore duhet të shikohet me përparësi dhe duhet të kryhen veçanërisht:

- a) kur përpilohet inventarizimi kombëtar, rajonal, ose vendor;
- b) si një pjesë e integruar e aktivitetit të hulumtimit dhe konservimit;
- c) para, gjatë dhe pas çdo riparimi, ndryshimi apo ndërhyrjeje tjetër, dhe kur dëshmitë historike të objektit zbulohen gjatë kryerjes së këtyre punimeve;

- d) kur planifikohet shembja e plotë apo e pjesshme, shkatërrimi, braktisja, shpërngulja, apo kur trashëgimia rrezikon të dëmtohet nga veprimet njerëzore apo forcat e jashtme natyrore;
- e) gjatë apo pas çrregullimeve aksidentale apo të paparashikuara të cilat dëmtojnë trashëgiminë kulturore;
- f) kur ndryshon funksioni apo përgjegjësia mbi menaxhimin apo kontrollin.

Përgjegjësia mbi regjistrimin

1. Përkushtimi në nivel kombëtar për të konservuar trashëgiminë ka nevojë për të njëjtin përkushtim edhe ndaj procesit të regjistrimit.
2. Për shkak të shkallës së kompleksitetit të procesit të regjistrimit dhe të interpretimit, nevojitet që të punësohen individë me aftësi, njohuri dhe ndërgjegjësimin e përshtatshëm për detyrat e kësaj pune. Për ta arritur këtë mund të jetë e nevojshme të ndërmerren programe formimi profesional.
3. Në përgjithësi, procesi i regjistrimit mund të përfshijë individë të aftë të cilët bashkëpunojnë me njeri-tjetrin, siç janë ata individë që janë ekspertë të specializuar të regjistrimit të trashëgimisë, të sondazheve, të konservimit, të arkitekturës, të inxhinierisë, të hulumtimeve, të historisë së arkitekturës, të arkeologjisë mbi dhe nën tokë, si dhe këshilltarë të tjerë të specializuar.
4. Të gjithë menaxherët e trashëgimisë kulturore kanë përgjegjësinë për të siguruar regjistrimin e përshtatshëm, cilësinë dhe përditësimin e të dhënave të regjistruara.

Planifikimi për të kryer regjistrimin

1. Para se të përgatiten të dhëna të reja, duhet që të gjenden burimet ekzistuese të informacionit, dhe të ekzaminohet përshtatshmëria e tyre.
 - a) Lloji i të dhënave që përmbajnë informacione të tilla duhet të nxirret nëpërmjet sondazheve, vizatimeve, fotografive, përshkrimeve të publikuara apo të papublikuara, dhe dokumenteve të tjera që kanë lidhje me origjinën dhe historinë e ndërtesës, grupit të ndërtesave apo vendndodhjes. Hulumtimi i të dhënave të reja dhe të vjetra është diçka shumë e rëndësishme;
 - b) Të dhënat ekzistuese duhet të kërkohen në vende si arkivat publike kombëtare dhe vendore; në arkiva profesionale, institucionale apo private, si dhe në biblioteka apo muzeume;

- c) Të dhënat duhet të kërkohen e hulumtohen duke u këshilluar nga afër me individë dhe organizata të cilat kanë njohuri mbi ndërtesën, grupin e ndërtesave apo siteve, apo qoftë edhe me ata që e kanë pasur në pronësi ose që kanë banuar në objekt, si dhe me ata që e kanë regjistruar, ndërtuar, ruajtur objektin apo që kanë bërë hulumtime rreth tij.
2. Nisur nga analiza e mësipërme, përzgjedhja e shtrirjes, nivelit dhe metodave të regjistrimit kërkon që:
- a) Metodatat e regjistrimit dhe të tipit të dokumentacionit të prodhuar të jenë të përshtatshme me natyrën e trashëgimisë, qëllimin e regjistrimit, kontekstin kulturor dhe financimin ose burimet e tjera në dispozicion. Kufizimet, si ato në aspektin e burimeve financiare, mund të shtyjnë që regjistrimit të kryhet i ndarë në faza. Metoda të tilla mund të përfshijnë përshkrime dhe analiza të mëparshme, fotografi (ajrore apo tokësore), fotografi të korrigjuara, fotogrametri, sondazhe gjeofizike, planimetri, vizatime dhe skica, riprodhime apo teknologji të tjera tradicionale ose moderne;
- b) Sa herë që të jetë e mundur, metodologjitë e regjistrimit duhet të përdorin teknika jo ndërhyrëse, dhe nuk duhet t'i shkaktojnë dëme objektit që regjistrohet;
- c) Arsyet për qëllimin e planifikimit dhe metodës së regjistrimit duhet të formulohet dhe deklarohet në mënyrë të qartë;
- d) Materialet e përdorura për përpilimin e regjistrimit duhet të jenë të arquivueshme.

Përmbajtja e regjistrimit

1. Çdo regjistrim duhet të identifikohet nëpërmjet:
- a) emrit të ndërtesës, grupit të ndërtesave apo siteve;
- b) një numri të veçantë referimi;
- c) datës së kryerjes së regjistrimit;
- d) emrit të organizatës që kryen regjistrimin;
- e) referencave të kontrolluara mbi regjistrime dhe raporte të tjera që kanë lidhje me objektin. Këto referenca mund të përfshijnë dokumentimin fotografik, grafik, tregimtar apo bibliografik të objektit, si dhe të dhëna arkeologjike dhe mjedisore.

2. Vendndodhja dhe shtrirja e monumentit, grupit të ndërtesave apo sitit duhet të jepet në mënyrë të saktë. Kjo mund të arrihet përmes përshkrimit, hartave, planimetrive dhe fotografive ajrore. Në fshatra, referencat apo koordinatat tre dimensionale hartografike mund të jenë të vetmet metoda të mundshme për të bërë regjistrimin. Në zonat urbane, një adresë apo referencë e rrugës mund të jetë e mjaftueshme.

3. Regjistrimet e reja duhet të përmendin burimet e të gjitha informacioneve të cilat nuk janë marrë drejtpërdrejt nga monumenti, grupi i ndërtesave apo vetë siti.

4. Regjistrimet duhet të përfshijnë disa ose të gjitha informacionet e mëposhtme:

a) tipin, formën dhe dimensionet e ndërtesës, monumentit apo sitit;

b) karakteristikat e brendshme dhe të jashtme të monumentit, grupit të ndërtesave apo sitit;

c) natyrën, cilësinë, rëndësinë artistike dhe shkencore të trashëgimisë dhe elementeve përbërëse të saj, rëndësinë kulturore, artistike dhe shkencore të: materialeve, pjesëve përbërëse dhe të ndërtimit, dekorimit, ornamenteve dhe mbishkrimeve, shërbimeve, pjesëve të montuara dhe makinerive, strukturave ndihmëse, kopshteve, veçorive peizazhore, kulturore, topografike dhe natyrore;

d) teknologjinë tradicionale dhe moderne dhe aftësitë e përdorura gjatë ndërtimit dhe mirëmbajtjes;

e) dëshmi për të përcaktuar datën e origjinës, autorësinë, pronësinë, projektimin, shtrirjen, shfrytëzimin dhe dekorimin origjinal;

f) dëshmi për të përcaktuar historinë e shfrytëzimit të objektit, ngjarjeve të lidhura me të, ndryshimeve strukturore dhe dekorative, dhe ndikimin e forcave të jashtme njerëzore dhe natyrore;

g) historinë e menaxhimit, mirëmbajtjes dhe riparimeve;

h) elementet përfaqësuese apo shembujt e ndërtimit apo materialeve të vendndodhjes;

i) një vlerësim të gjendjes aktuale të trashëgimisë;

j) një vlerësim të marrëdhënies pamore dhe funksionale mes trashëgimisë dhe mjedisit të saj rrethues;

k) një vlerësim të konflikteve dhe rreziqeve nga veprimtaria njerëzore dhe naty-

rore, dhe nga ndotja mjedisore apo shfrytëzimi i pronave në afërsi.

5. Gjatë shqyrtimit të arsyeve të ndryshme që justifikojnë regjistrimin (shiko Paragrafin 1.2 më lart) do nevojiten nivele të ndryshme detajesh. Të gjitha informacionet e mësipërme, edhe nëse përmenden shkurtimisht, japin informacione të rëndësishme mbi planifikimin vendor dhe kontrollin e menaxhimit të ndërtimeve. Informacione më të hollësishme zakonisht kërkohen nga pronari, menaxheri apo shfrytëzuesi i sitit apo ndërtesës me qëllim konservimin, mirëmbajtjen apo shfrytëzimin.

Menaxhimi, përhapja dhe shkëmbimi i të dhënave

1. Të dhënat origjinale të regjistrimit duhet të ruhen në arkiva të sigurta, dhe mjedisi i brendshëm i arkivit duhet të sigurojë qëndrueshmërinë e informacionit si dhe të mos lejojë prishjen, në përputhje me standardet e pranuar në nivel ndërkombëtar.

2. Një kopje e plotë rezervë e këtyre të dhënave duhet të ruhet në një vend tjetër të sigurt.

3. Kopjet e regjistrimeve duhet të jenë të disponueshme për autoritetet e njohura me ligj, profesionistët e interesuar dhe publikun, dhe aty ku është e mundur ato duhet të jenë të disponueshme edhe për qëllime të lidhura me hulumtimin, kontrollin e zhvillimit dhe proceset e tjera administrative dhe ligjore.

4. Të dhëna të përditësuara duhet të jenë gjithnjë në dispozicion, dhe nëse është e mundur ato duhet të gjenden në vetë sitin, për të ndihmuar në hulumtimin e trashëgimisë, menaxhimit, mirëmbajtjes dhe të shpëtimit në rast fatkeqësie.

5. Formati i të dhënave duhet të jetë i standardizuar, dhe të dhënat duhet të jenë të indeksuara sa herë që të jetë e mundur për të lehtësuar shkëmbimin dhe gjetjen e informacionit në nivel vendor, kombëtar dhe ndërkombëtar.

6. Sa herë që të jetë e mundur duhet që të kuptohet përdorimi i përshtatshëm i teknologjisë së informacionit gjatë grumbullimit, menaxhimit dhe përhapjes efikase së të dhënave.

7. Vendi ku mbahen të dhënat duhet të bëhet i njohur për publikun.

8. Sa herë që të jetë e mundur duhet të publikohet dhe shpërndahet një raport i rezultateve kryesore të çdo regjistrimi.



ISBN 978-99956-51-09-1



9 789995 651091

